

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

KONTRIBUTI
I PROF. REMZI NESIMIT
PËR GJUHËN SHQIPE
DHE GJUHËSINË
SHQIPTARE

(Sesion shkencor mbajtur më 21.03.2019, Shkup)

24



Shkup, 2019

Boton:
INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIR TËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

Vëllimi 24 – 2019
Biblioteka: **SCUPI**

Për botuesin:
Dr. Skender Asani

Këshilli redaktues:
Zeqirija Ibrahim
Bukurije Mustafa
Shejnazë Ajdini–Murtezi
Idaete Sinani

Sekretar i redaksisë:
Idaete Sinani

Copyright©ITSHKSH, 2019
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për botuesin.

ISBN: 978–608–4653– 94–3

www.itsh.edu.mk

Ky botim financohet nga:



Republika e Maqedonisë së Veriut

Ministria e Kulturës

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

KONTRIBUTI
I PROF. REMZI NESIMIT
PËR GJUHËN SHQIPE
DHE GJUHËSINË
SHQIPTARE

(Sesion shkencor mbajtur më 21.03.2019, Shkup)

24

SCUPI
Shkup, 2019



Remzi Nesimi
(25.12.1933 – 04.02.2018)

TRYEZA E LËNDËS:

Hyrje	7
Fjalë përshëndetëse: Skender ASANI	9
Fjalë përshëndetëse: Ali JASHARI	11
Fjalë përshëndetëse: Valbona TOSKA	13
Qemal MURATI : PROF. REMZI NESIMI – PRIJATAR I ALBANOLOGJISË SHKENCORE NË MAQEDONI	17
Emil LAFE : PERSONALITETI SHKENCOR I PROF. REMZI NESIMIT DHE DISA DETYRA TË SOTME NË FUSHËN E ZBATIMIT TË SHQIPES STANDARDE	25
Olger BRAME : NDIHMESAT E PROFESOR REMZI NESIMIT PËR STANDARDIN E SHQIPES.....	34
Haki YMERI – BINA : NJË BISEDË ME PROFESORIN REMZI NESIMI LIDHUR ME ZBATIMIN E PARIMIT MORFOLOGJIK DHE TRADICIONAL	41
Avzi MUSTAFA : KONTRIBUTI I REMZI NESIMIT NË HARTIMIN E TEKSTEVE SHKOLLORE.....	48
Zeqirja NEZIRI & Izaim MURTEZANI : NDIHMESA E REMZI NESIMIT NË MBLEDHJEN E LETËRSISË GOJORE	55
Agim POLOSKA : VEPRIMTARIA E FRYTSHME GJUHËSORE E PROF. REMZI NESIMIT	66
Asllan HAMITI : PROFESOR REMZI NESIMI – STUDIUES I TË FOLMEVE SHQIPE NË MAQEDONI.....	72
Ismet OSMANI : REMZI NESIMI, STUDIUES I PËRKUSHTUAR I SHQIPES LETRARE.....	83
Mustafa IBRAHIMI : KONTRIBUTI I PROFESOR REMZI NESIMIT NË DIFTONGIMIN E VOKALEVE / DHE UNË TË FOLMET E GRUPIT TË GEGËRISHTES QENDRORE	90

Berton SULEJMANI: KONTRIBUTI I PROFESOR REMZI NESIMIT PËR SHQIPEN STANDARDE NË MAQEDONI SI DHE STUDIMET E TIJ PËR SINTAKSËN E GJUHËS SHQIPE	97
Bukurije MUSTAFA: VËSHTRIM MBI LIBRIN “УЧЕБНИК ПО АЛБАХСКИ ЈАЗИК” I REMZI NESIMIT DHE LEKSIONET PËR FOLËSIT JOSHQIPTARË	109
Ajten HAJDARI – QAMILI: PËRVOJË E PAHARRUAR ME REMZI NESIMIN SI PEDAGOG I GJUHËS SHQIPE	114
Zeqirija IBRAHIMI: ALBANOLOGU I PARË NË MAQEDONI ...	119
Hidajete AZIZI: KËNDVËSHTRIMI I PROFESORIT REMZI NESIMI PËR TOPONIMINË E IMPONUAR	126
Shejnaze AJDINI–MURTEZI: SHTJELLIMI I GRAMATIKËS NË TEKSTET SHKOLLORE TË REMZI NESIMIT.....	141
Farketa DIBRA – ZEQRIRI: APARATURA DIDAKTIKE NË TEKSTET SHKOLLORE TË PROF.REMZI NESIMIT.....	155
Besnik EMINI: REMZI NESIMI NË KONGRESIN E DREJTSHKRIMIT	165
Idaete SINANI: NDIHMESA E PROFESOR REMZI NESIMIT PËR LEKSIKUN E SHQIPES.....	172

HYRJE

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, që nga themelimi i tij e deri më tani, ka dhënë shumë nga vetja për t'u dëshmuar si strumbullar i zhvillimeve shkencore e kulturore të shqiptarëve në Maqedoni. Përveç aktiviteteve nga më të ndryshmet, në qendër të të cilave janë organizimet e tubimeve të shumta shkencore, që kanë mbledhur në vatrën e Institutit studimes më eminentë nga vendi, nga rajoni e më gjerë, Instituti e ka ndier të nevojshme edhe të përkujtojë, të nderojë e të shënojë emra të mëdhenj, që kanë dhënë kontribute të jashtëzakonshme për kulturën dhe shkencën shqiptare. Në vazhden e kësaj veprimtarie, është organizuar edhe sesioni shkencor i titulluar *“Kontributi i Prof. Remzi Nesimit për gjuhën shqipe dhe gjuhësinë shqiptare”*. Në vëllimin e këtij botimi të veçantë të “Scupit” janë përmbledhur të gjitha kumtesat e lexuara në këtë sesion. Organizimi i këtij sesioni për Insittutin paraqet një nder, por edhe detyrë. Pjesa dërrmuese e punonjësve të Institutit, respektivisht të Sektorit të Gjuhës, i cili organizoi këtë sesion janë ish-studentë të tij të cilët kutojnë përvojën mbresëlënëse me profesorin Remzi Nesimi.

Kur flitet për një personalitet çfarë ishte profesori Remzi, para së gjithash, duhet kujtuar natyrën njerëzore të tij, një shëmbëlltyrë për të gjithë ne. Urtësia, modestia, mirësjellja e matura, janë simbol i emrit të tij dhe njëherazi pasuria më e madhe që mund të ketë çdo njeri.

Profesor R.N. ishte një mik i madh i Institutit tonë, themelimi i të cilit qe një ëndërr e kamotshme e tij. Këtë Institut, ai ka nderuar me praninë e tij me rastin e shënimit nga ana jonë, e 40-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, me ç’rast do të shprehet me plot optimizëm, si në vijim: *“ëndrrat e brezave tanë u bënë realitet, dhe ne sot kemi një gjuhë të njësuar shqipe”*. Institutin tone profesori e ka nderuar edhe me dhurimin e një fondi shumë të

pasur të botimeve të cilat në bibliotekën tone zënë një vend të posaçëm në shenjë miradijeje.

Gjatë rrugëtimit të tij jetësor, me gjithë këto virtyte që pati, po edhe duke u ballafaquar me sfida të rënda, profesori i nderuar hapi shtigje të reja në fushën e albanologjisë shkencore në Maqedoni, për ç'arsye edhe mund të quhet si prijës në shumë drejtime të kësaj fushe.

Merita e tij për kulturën shqiptare në përgjithësi e për atë të shqiptarëve të Maqedonisë në veçanti, për shkencat filologjike shqiptare në përgjithësi e për Drejtshkrimin e gjuhës shqipe në veçanti (përmes pjesëmarrjes së drejtpërdrejt në Kongresin e Drejtshkrimit në Tiranë), merita për shkollën shqipe e arsimin universitar (përmes hartimit të teksteve shkollore e universitare) si dhe merita për formimin e brezave të shumtë të filologëve shqiptarë në Maqedoni, është e pamohueshme. I pamohueshëm është edhe fakti që ai i takoi brezit, i cili nuk e pati të lehtë barrën mbi supe, në një kohë kur, siç do të thoshte vetë profesori, *“çka nuk u trillua dhe nuk u shpif kundër çdo gjëje kombëtare shqiptare”*. Një jetë të tërë, profesori ia kushtoi çështjes së gjuhës letrare dhe zbatimit të saj, duke qenë i vetëdijshëm për rëndësinë themeltare që ka gjuha për qenësinë e një kombi. Kështu do të shprehet profesori: *“Gjuha letrare është thesari më i madh dhe shoqëruesi më besnik i kulturës dhe shkencës”*.

Shqiptarët e Maqedonisë patën një nevojë të jashtëzakonshme për një njeri të madh, çfarë ishte profesori. Ai jetoi me ne, u nda nga jeta, por kujtimet për të janë të pavdekshme. Të pavdekshëm e bën thesari i ti tij i çmuar që na la trashëgim për tërë kulturën shqiptare në përgjithësi.

Shkup, tetor 2019

Redaksia

SKENDER ASANI

drejtor i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup

I nderuari rektor i Universitetit të Korçës,

I nderuari prof. Emil Lafe,

E nderuara familje Nesimi,

Të dashur studiues e kolegë,

Në hapjen e këtij sesioni shkencor i kam dy ndjenja të kundërta, që dua t'i shpalos. Nga njëra anë, më vjen shumë mirë që më në fund e kemi këtë institut dhe që kemi mundësi të mblidhemi e të ndërrojmë figura kaq të rëndësishme e të mëdha të kombit tonë, ndërsa nga ana tjetër, më vjen keq që mbase shumë figura të tjera, në mungesë të një instituti si ky yni, mund edhe të jenë harruar e të mos përmenden më.

Prandaj, të dashur të pranishëm, sesioni shkencor kushtuar prof. Remzi Nesimit nuk është sesion shkencor vetëm për Profesorin, por është edhe simbolika e mirënjohjes për gjithë kontributin që e kanë dhënë studiuesit, arsimtarët, profesorët dhe edukatorët tanë më të mirë e më të devotshëm ndër vite.

Nëse më lejohet të jem subjektiv, më vjen mirë që në Institut kemi një garë ose një luftë të ftohtë, në kuptimin pozitiv, mes meje dhe kolegut tim, Zeqirija Ibrahim: sa herë që unë propozoj ta ndërrojmë një historian a një figurë të historisë kombëtare, ai gjithnjë e ka propozimin për një gjuhëtar. Sidoqoftë, sesioni i sotëm shkencor është kontribut i gjithë Departamentit të Gjuhës Shqipe në Institut, në krye me kolegen Hidajete Azizi, andaj unë dua t'i përgëzoj të gjithë për punën që e kanë bërë ata.

Me këtë rast i falënderoj të gjithë studiuesit që janë paraqitur me kumtesa, si dhe juve të pranishmit e tjerë, që me ardhjen tuaj në këtë sesion e keni nderuar emrin e profesorit tonë dhe punën e Institutit.

E nëse i referohem asaj që thashë në fillim, për fund dua t'ju them se prof. Remzi Nesimi e prof. Masar Kodra, të mjedisit tonë, ose Hasan Prishtina, Fan Noli e Shaban Demiraj, që janë pronë e mbarë kulturës dhe historisë shqiptare, nuk janë të fundit në këtë kolonë, porse janë rruazat e para të vargut të gjatë të personaliteteve që presin t'i ndriçojmë. Andaj ne edhe në të ardhmen do të vazhdojmë të shpalosim figura të tjera të rëndësishme të albanologjisë në Maqedoni, por jo vetëm, ngase besojmë se ky është detyrimi ynë shkencor dhe kombëtar.

Ju dëshiroj punë të mbarë dhe takime më të shpeshta.

Ju faleminderit!

Shkup, 21 mars 2019

ALI JASHARI

rektor i Universitetit “Fan S. Noli” – Korçë

FJALË QË NUK IA THASHË DOT PROF. REMZI NESIMIT QË NË GJALLJE

Sot, në këtë tubim “In memoriam” për prof. Remzi Nesimin, kam diçka për të kumtuar, ca fjalë që profesorit nuk ia thashë dot që në gjallje, ngaqë s’e kisha shkuar në mendje se do të ndahej kaq shpejt nga ne.

Nuk i kam folur asnjëherë për “njohjen” tonë të parë, kur unë isha student në degën e gjuhë–letërsisë në Universitetin e Tiranës. Në nëntor të vitit 1972, ne, një grup studentësh të filologjisë, na mori prof. Shaban Demiraj (në atë kohë shef i departamentit të gjuhësisë) për të ndjekur punimet e Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe. Qysh atëherë e kam ngulitur në mendje portretin e prof. Remziut, tek mbajti kumtesën për procesin e njësimimit të shqipes letrare në Maqedoni.

Rasti e solli që prof. Remziun ta njoh nga afër pas 36 vjetësh në Tetovë, në dhjetor të vitit 2008, në një konferencë kushtuar 100–vjetorit të lindjes së prof. Çabejt. Ai kishte ardhur nga Shkupi të dëgjonte dhe të nderonte prof. Çabejn. Sapo mbarova së lexuari kumtesën time për prof. Çabejn, në pushim, prof. Remziu m’u afrua dhe unë e takova gjithë emocione e mall, sikur të ishim miq të paparë prej vitesh. Portreti i tij ishte po ai i vitit 1972, veçse tani i thinjur dhe me bastun. –Më vjen shumë mirë që u njohëm nga afër, –më tha. –Të përgëzoj për tekstin “Gjuha shqipe për studentët”. Ne ua kemi dhënë studentëve tanë në Shkup për ta mësuar mirë shqipen. Këto fjalë të ngrohja më gëzuan shumë.

“Takimi” tjetër ishte në nëntor të vitit 2012, kur në Universitetin e Korçës u organizua Akademia Jubilare me rastin e 40–vjetorit të

Kongresit të Drejtshkrimit, ku ishin ftuar dhe delegatët e kongresit. Prof. Remziu nuk mundi të vinte vetë, por aty ishte vajza e profesorit, Valbona, pasardhëse e denjë e rrugës së mundimshme për mësimin e shqipës në Maqedoni.

Pas kësaj, m'u krijua mundësia që prof. Remziun ta takoj disa herë në shtëpinë e tij në Shkup. Mbjaj mend që një ditë i shpura disa botime të Universitetit të Korçës dhe simbolin e ABC-së në qeramikë, punuar nga një njeshtër korçar. U emocionua shumë. – Do ta mbaj këtu, – më tha – në ballë të librave, dhe më tregoi me dorë pamjen nga biblioteka e tij shumë e pasur.

Tani që prof. Remziun nuk e kemi mes nesh, kam sjellë këtu emblemën e Universitetit të Korçës, që ai e nderonte aq shumë, shoqëruar me një diplomë mirënjohjeje ku shkruhen fjalët që s'ia thashë dot në gjallje të tij. Po i lexoj: PERSONALITET I SHQUAR I GJUHËS SHQIPE NË MBARË TROJET SHQIP-TARE, DELEGAT NË KONGRESIN E DREJTSHKRIMIT (1972), STUDIUES I PALODHUR I SHQIPES, PEDAGOG I PËRKORË QË ME FJALËN E GJALLË DHE TË SHKRUAR MËKOI BREZA TË TËRË NXËNËSISH DHE STUDENTËSH ME DASHURINË DHE DIJEN PËR SHQIPEN TONË TË BUKUR. NË SHENJË MIRËNJOHJEJE NGA PEDAGOGËT DHE STUDENTËT E UNIVERSITETIT "FAN S.NOLI".

Në fund, dëshiroj të falënderoj familjen e prof. Remziut, bashkëshorten e denjë dhe fëmijët, drejtorin e Institutit, prof. Skender Asanin, si dhe prof. Zeqirija Ibrahimin, që e ka organizuar këtë veprimtari modeste dhe shumë domethënëse, duke treguar më së miri se profetët çmohen e nderohen në vendin e tyre.

Faleminderit!

VALBONA TOSKA

përfaqësuese e familjes së prof. R. Nesimit

Të nderuar,

Në emër të familjes së prof. Remzi Nesimit, përkatësisht në emër të bashkëshortes – Atixhe, në emër të djalit – Ilir dhe bashkëshortes së tij Siana, në emër të nipit Valon, mbesës Brikena dhe në emrin tim,

Nga zemra ju falënderoj të gjithë ju që këtë ditë ia keni kushtuar Profesor Remzi Nesimit.

Falënderoj z. Zeqirja Ibrahimimi që me shumë përkushtim inicioi këtë sesion duke mundësuar kështu, që një vit pas ndarjes nga jeta, të na e sjellë figurën e tij përsëri në mesin tonë.

Falënderoj z. Skender Asani që nga pozita e drejtorit të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, mbështeti këtë iniciativë dhe e bëri të mundur realizimin e saj.

Falënderoj znj. Hidajete Azizi që organizoi mbarëvajtjen dhe u përkujdes për çdo detaj.

Falënderoj në mënyrë të veçantë prof. Emil Lafën që përkrah kumtesës, me prezencën e tij fizike, lidhjes Shkup – Tiranë i dha një kuptim shumë domethënës.

Falënderoj Rektorin e Universitetit të Korçës prof. Ali Jasharin dhe prof. Olger Bramen, të cilët me ardhjen e tyre gjithashtu sollën simbolikën e unitetit.

I falënderoj të gjithë pjesëmarrësit që me kumtesat e tyre do të hedhin dritë mbi veprimtarinë e prof. Remzi Nesimit.

I falënderoj të gjithë të pranishmit që me praninë e tyre shprehin respekt për, ndoshta mikun, kolegun, bashkëpunëtorin apo profesorin e tyre.

Preokupimi profesional i prof. Remzi Nesimit ishte gjuha shqipe. Gjuhën e njëzuar ai e shihte si „një thesar të madh të kombit tonë dhe si shoqëruesin më besnik të kulturës në përgjithësi”. Thoshte se ajo është ndoshta e vetmja komponentë e përbashkët e të gjithë shqiptarëve. Duke e trajtuar në këtë mënyrë, gjatë ligjëratave të tij nuk mbante thjesht leksione për paradigmat dhe funksionet e fjalëve të gjuhës shqipe, por çdo mendim i tij synonte të bartë te brezi i ri dashurinë që e kishte ai vetë për gjuhën dhe kombin. Këtë dashuri e kishte fituar në rrethin familjar ku përcaktimi kombëtar kishte bërë që, bashkë me vëllezërit e tij, qysh në moshë shumë të re të shijojë vrazhdësinë e shtetit ku jetonte. Ndoshta pikërisht qëndrimi në burg në moshë të mitur ka ndikuar që urtësia ta shoqërojë gjatë gjithë jetës së tij të mëtejme. Vërtet ishte i kursyer në fjalë, por misionin e kultivimit të gjuhës e bënte në çdo hap. Në arsimin e lartë rreth 40 vjet u ligjëroi shumë studentëve. Përpiloi tekste shkollore që shërbyen për gjenerata të tëra. Studioi karakteristikat e të folmeve të caktuara. Luftoi për pastërtinë e gjuhës. Organizoi disa aktivitete lidhur me gjuhën shqipe. Ishte në dispozicion të çdo subjekti, qoftë profesional qoftë politik, për ta ndihmuar me kompetencat e tij.

Në kuadër të kësaj veprimtarie, janë disa momente të caktuara, të cilat sot do t'i ndaj me ju e që ndoshta flasin për botën e tij të brendshme.

Kështu, nga qëndrimi në Tiranë në vitin 1972 kujtimet e tij lidheshin sa me rëndësinë e aktiviteteve, po aq me njohjet e drejtpërdrejta që bëri me emrat më autoritarë të albanologjisë. Kontaktet e vendosura një herë, u shndërruan në miqësi të përjetshme. Deri në fund të jetës, këto miqësi për të mbetën një vlerë e pakrahasueshme me asgjë tjetër. Sot në mesin tonë kemi dy profesorë të nderuar, të cilët ai për herë të parë i takoi në 72–shin e largët. Me sakrificën që kanë bërë për të qenë sot këtu me ne, ata sikur vërtetojnë sa të drejtë ka pasur që miqësinë e sinqertë e ka çmuar mbi të çdo gjë tjetër.

I përfshirë edhe vetë në përpjekjet për realizimin e së drejtës për arsim të lartë në gjuhën shqipe, themelimin e Universitetit të Tetovës e përjetoi me shumë entuziazëm. Por, duke u shkolluar vetë në një kohë kur femrat shqiptare përfshiheshin fare pak në ciklet e larta të arsimit, hapja e këtij universiteti e gëzoi më shumë për faktin që numri i studentëve gjithnjë e më shumë konkurrohej nga numri i studenteve. Tek ai ishte shumë e theksuar ndjenja për barazinë gjinore. Kurrë nuk e dëgjova të bëjë ndonjë dallim rreth përkatësisë gjinore të njerëzve. Madje ai vlerësonte se ngritja e femrës është ndoshta më e rëndësishme, ngaqë vetëm një nënë e edukuar mund të ngrëjë familje të përparuar.

Një ngjarje shumë e rëndësishme për të ishte angazhimi i tij rreth botimit të veprës së mirënjohur të prof. Shaban Demirajt *“Gjuhësi ballkanike”*. Për shkak të rrethanave të vështira në Shqipëri, e kishte marrë përsipër që kjo veper të botohet në Shkup dhe ai të sigurojë mjetet e botimit. Shumë arsimtarë, ish studentë të tij e kishin përkrahur dhe e kishin siguruar se shumë lehtë do të mblidhnin mjetet e nevojshme. Mirëpo punët nuk shkuan kështu. Sa shumë mërzitej për këtë. Nuk e kuptonte se si ishte e mundur që afaristë të ndryshëm të financojnë pa asnjë problem organizimet e zgjedhjeve të miss-eve të lagjeve e qyteteve dhe të mos duan të ndihmojnë për botimin e një vepre kapitale për ne. Kur në fund, me ndihmën e shtëpisë botuese Logos-A dhe me përkrahjen e një numri të vogël të afaristëve arriti ta botojë veprën, gëzimi i tij nuk kishte fund. Më duket se atëherë për herë të parë u ballafaqua në mënyrë shumë konkrete me realitetin se bota shpirtërore dhe ajo materiale janë shumë larg njëra tjetrës.

Kur u themelua Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, hapja ceremoniale u bë në ambientet e vjetra, në çarshinë e vjetër. Ishte nëntor dhe moti ishte i ftohtë. Shëndeti i tij kishte filluar të rëndohej dhe kur unë i propozova që të ikim më herët, pa përfunduar ceremonia, refuzoi duke më thënë: „Kemi

pritur një jetë të tërë për të themeluar institucionet tona e tani të mos pres përfundimin e hapjes?”.

Më vjen shumë mirë që pikërisht ky institucion sot hapi zemrën dhe dyert për të nderuar atë.

Në fund, më lejoni që me një shembull të tregoj si e shihte ai vetë punën e tij.

Me rastin e shpalljes së një gramatike të tij si teksti më i mirë, prof. Remzi Nesimi mori fjalën dhe, ashtu qetë e me modesti, bëri një përjasje interesante. Gramatikën e tij e krahasoi me një orë. Po i parafrazoj fjalët e tij: *“Në kushte kur nuk kemi ndonjë orë të mirë, edhe një orë që ndonjëherë shkon para e ndonjëherë mbetet pas na duket e mirë, sepse na mundëson të orientohemi disi në kohë”*.

Meqë gjithnjë kam admiruar modestinë e tij të sinqertë, sot, kur unë po përpiqem të gjej vendin dhe rolin e tij në jetën arsimore, shkencore e kulturore të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut, do ta kopjoj dhe do të them që veprimtaria e Profesor Remzi Nesimit, parë në kontekstin hapësinor e kohor, ngjason tamam me atë orë që e përmend ai.

Por, megjithatë, dua të them që kjo „orë” bëri më të mirën për të gjithë ne – e orientoi shqipen që flitet në këto anë, në drejtimin e duhur, aty ku edhe e ka vendin, në trungun e përbashkët gjuhësor dhe kështu mbylli çdo mundësi për të kontestuar aspektet e identitetit kombëtar të shqiptarëve të këtushëm. Në qoftë se do të duhej të veçoja diçka që e përcakton vlerën e babait tim për shoqërinë shqiptare në Maqedoninë e Veriut, atëherë pa asnjë dyshim do t'i veçoja insistimin e tij për instalimin e shqipes standarde këtu te ne dhe përkushtimin e tij të jashtëzakonshëm për ruajtjen e saj.

Faleminderit edhe një herë të gjithëve!

QEMAL MURATI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore
të Shqiptarëve – Shkup*

**PROF. REMZI NESIMI – PRIJATAR
I ALBANOLOGJISË SHKENCORE
NË MAQEDONI**

Veprimtaria e prof. Remzi Nesimit në arsimin e lartë në gjuhën shqipe dhe puna e tij kërkimore–shkencore, e shtrirë në gati 40 vjet, i kanë dhënë një vend nderi jo vetëm në Maqedoni, por në mbarë arsimin universitar dhe në shkencat filologjike shqiptare. Prof. Remzi Nesimi është ikona e njeriut të ndershëm dhe të angazhuar, ikona e arsimit shqip dhe ikona e Albanologjisë shkencore në Maqedoni. Njerëz të tillë, edhe po të kërkosh me fener, rrallë mund të gjesh. Emri i tij meriton të përjetësohet në emërtimin e ndonjë institucioni të lartë arsimor a shkencor në Maqedoni. Apo, ta zëmë, në emërtimin e ndonjë çniumi: Çniumi “Remzi Nesimi” që do të jepej për kontribut të shquar në albanologji.

***Vëzhgues i mprehtë i gjuhës së popullit
dhe i shqipes standarde***

Gjuhëtari i njohur dhe njeriu i urtë prof. Remzi Nesimi (1933 – 2018), i cili ndërroi jetë më 3 shkurt 2018, në Shkup, në moshën 85–vjeçare, është albanolog i shquar dhe intelektual i përmasave kombëtare. Fshati Odër i Tetovës, ku kishte lindur më 25 dhjetor 1933, shkolla fillore e vendlindjes dhe gjimnazi i Tetovë, ku i mori njohuritë e para, i dhanë atij brumin e formimit fillestar prej atdhetari dhe i mbollën dashurinë për gjuhën shqipe, ku në këtë fushë do të ishte një misionar i vërtetë për një jetë të tërë. Për të marrë njohuritë më të thelluara për gjuhën, më 1955 regjistrohet në Degën e Albanologjisë në Fakultetin Filologjik të Universitetit të

Beogradit, ku u diplomua më 1960. Po në atë universitet, kreu edhe studimet pasuniversitare (më 1971), kurse doktoraturën e mbrojti në Universitetin e Prishtinës (1998) më temë: “*E folmja e Dervenit*”, para anëtarëve të Komisionit: Akad. Idriz Ajetit, Akad. Olivera Jashar–Nastevës dhe prof. Latif Mulakut. Ai cilësohet si një gjuhëtar i dalluar, veprimtar i shquar i shkollës shqipe në Maqedoni, profesor universitar me karrierë të pasur dhe merita të spikatura për formimin e disa brezave filologësh ndër shqiptarët e Maqedonisë, delegat në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe.

Me qëndrimin dhe pamjen e tij vizuale, me përkushtimin shkencor e kombëtar në albanologji e në edukologji, do të mund ta krahasonim me emra të mëdhenj të albanologjisë shkencore dhe, pse jo, ta quanim një Idriz Ajeti i Maqedonisë. Edhe në *Kongresin e drejtshkrimit të gjuhës shqipe* (20–25 Nëntor 1972), prof. Remzi Nesimi do ta paraqiste referatin e tij “*Procesi i njësisimit të shqipes letrare në Maqedon*”, i katërti me radhë, menjëherë pas prof. Mahir Domit, prof. E. Çabejt, dhe prof. I. Ajetit. E në këtë referat, kishte vënë si moto thënien e gjuhëtarit të madh Aleksandër Xhuvanit “*Njësia e gjuhës është njësia e kombit*”, dhe nisej nga rilindësit e mëdhenj që kishin punuar për gjuhën, se:

“*Gjuha letrare është thesari më i madh i një populli e njëkohësisht edhe shoqëruesi më besnik i kulturës në përgjithësi, pothuaj të gjithë ideologët dhe përfaqësuesit më kryesorë të Rilindjes sonë kombëtare çështjes së gjuhës i patën kushtuar kujdesin më të madh. Ata në kushtet e asaj kohe përcaktuan edhe drejtshkrimin e atëhershëm, e pastruan gjuhën nga barbarizmat, e pasuruan fondin leksikor me fjalë nga brumi i shqipes dhe në këtë mënyrë kryen një mision të lartë patriotik*”. Njëloj siç ka kryer një mision të tillë edhe vetë prof. Remzi Nesimi.

Në Kongresin e Drejtshkrimit (1972), Prof. Remzi Nesimi vuri në dukje se në Maqedoni, hap pas hapi, gjuha e shkruar erdhi duke u afruar me formën letrare të Shqipërisë. Kështu, pas botimit të projektit të drejtshkrimit në Tiranë (shkurt 1967), gazeta “*Flaka e*

vëllazërimit” në Shkup filloi ta zbatonte atë projekt, duke i paraprirë vendimit të njohur *Konsultës Gjuhësore të Prishtinës* (prill 1968) për njësimin gjuhësor me praktikën e shtetit amë, sipas parimit “*Një komb – një gjuhë letrare kombëtare.*”

Në veprimtarinë e tij kushtuar kryekreje gjuhës shqipe, punoi si redaktor gjuhësor në entin botues “*Rilindja*” të Prishtinës. Më pas kaloi në gazetën “*Flaka e vëllazërimit*”, që ka qenë gazeta kryesore në gjuhën shqipe në Republikën Socialiste të Maqedonisë. Në vitet 1962–1964 R. Nesimi punoi si lektor i gjuhës shqipe në Katedrën e Albanologjisë në Beograd, aty ku kishte kryer studimet. Në atë mjedis universitar pati mundësi të fitonte një kualifikim shkencor më të ngritur si në fushën e albanologjisë, ashtu edhe të gjuhësisë në përgjithësi. Me këtë përvojë të re të fituar, u kthye në mjedisin shqiptar në vitin shkollor 1964–1965 si pedagog i Akademisë Pedagogjike të Shkupit, ku përgatiteshin arsimtarë për arsimin e përgjithshëm në gjuhën shqipe. Më 1975 u emërua profesor i gjuhës shqipe në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Shkupit, ku shërbeu deri në fund të karrierës së tij si profesor universitar. Veprimtaria e prof. Remzi Nesimit në arsimin e lartë në gjuhën shqipe dhe puna e tij kërkimore–shkencore, e shtrirë në gati 40 vjet, i kanë dhënë një vend nderi jo vetëm në Maqedoni, por në mbarë arsimin universitar dhe në shkencat filologjike shqiptare.

Prof. Remzi Nesimi i ka ndjekur me vjimësi problemet teorike dhe praktike të gjuhës letrare, veçanërisht në fushën e drejtshkrimit e të gramatikës, të zhvillimit, të pasurimit e të pastrimit të saj, si dhe të zbatimit të normës letrare në botimet, në shtyp, në shkollë, në veprimtarinë publike. Pjesa më e madhe e artikujve që ka shkruar ai rreth këtyre temave, janë përfshirë në kreun e parë e të dytë të librit të tij “*Çështje gjuhësore*” (Shkup, 1998), i cili përbëhet nga pesë krerë: I. Çështje të normës letrare dhe të pastërtisë së gjuhës letrare; II. Shqipja e shkruar në Maqedoni; III. Nga të folmet shqipe në Maqedoni; IV. Përvjetorë; V. Shqipja në kontekstin ballkanik.

Prof. Remzi Nesimi i ka pasur shumë për zemër studimet nga fusha e ligjërimeve popullore. Ai ishte vëzhgues i mprehtë i gojës së popullit në të gjitha rrafshet e gjuhës. Kësaj fushe studimi i ka kushtuar një numër artikujsh si dhe disertacionin e doktoratës “*E folmja e Dervenit*” (krahinë ndërmjet Tetovës dhe Shkupit), të cilin e zgjeroi dhe e plotësoi më pas hap pas hapi, duke na dhënë një punim dialektologjik klasik, si nga ndërtimi, ashtu edhe nga përmbajtja dhe analizat që përmban (botuar më 2008). Studimi i tij i gjerë e i thelluar për të folmen e Dervenit plotëson hartën e dialektologjisë shqiptare me të dhëna të sigurta e me shpjegime të hollësishme për një të folme me karakteristika të veçanta të gegërishtes qendrore. Përshkrimi i së folmes së Dervenit në masën dhe në mënyrën si është bërë në këtë studim parakupton një njohje të gjerë të dialektologjisë shqiptare, nga njëra anë, dhe të sistemit të përgjithshëm të gjuhës shqipe në gjendjen e sotme e në zhvillimin historik të tij, nga ana tjetër. Studimi dëshmon se autori i tij i ka arritur të dyja këto caqe.

Shumë e rëndësishme është ndihmesa e prof. Remzi Nesimit në fushën e teksteve dhe botimeve të tjera shkollore. Teksti universitar i mësimin të gjuhës shqipe i hartuar në bashkëpunim me kolegen e tij, dr. Gjystina Shushka (botim i i parë Prishtinë 1987, i dyti Shkup 1989, i treti Beograd 1997) është përdorur vite me radhë në disa universitete të ish-Jugosllavisë. Prof. Remzi Nesimi ka hartuar rreth 12 tekste (në disa raste me bashkautorë) të gjuhës shqipe për arsimin parauniversitar në Maqedoni (për klasat V, VI, VII, VIII dhe për shkollat e mesme).

Prof. Remzi Nesimi ka meritë të veçantë për gjallërimin e jetës shkencore e kulturore të shqiptarëve në Maqedoni. Ai ka qenë pjesëmarrës në konferenca e simpoziume shkencore të rëndësishme, ka botuar artikuj edhe në revistat shkencore maqedonase, ku ka trajtuar çështje të marrëdhënieve të shqipes me maqedonishten, duke dëshmuar vullnetin për bashkëpunim me kolegët maqedonas dhe për trajtimin objektiv të marrëdhënieve ndërgjuhësore. Botimi

i përvitshëm “Godishen zbornik (Vjetar)” i Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Shkupit “Shën Kirili dhe Metodi” për vitin 2014 i është kushtuar prof. Remzi Nesimit në shenjë nderimi me rastin e 80-vjetorit të lindjes. Në këtë vëllim prej rreth 750 faqesh kanë botuar ndihmesat e tyre shkencore dhjetëra studiues shqiptarë, maqedonas e të tjerë.

Prof. Remzi Nesimi kishte një përkushtim të plotë për gjuhën shqipe. Edhe në momentet e fundit kur gjendja e tij shëndetësore sa vinte e i përkeqësohej, ka thënë fjalën e tij me peshë edhe në debatet e kohëve të fundit për çështjen e shqipes standarde. Në kundërshtim me pikëpanjen e disave se shqipja standarde në Kosovë (e pse jo edhe në Maqedoni) është e importuar dhe e imponuar nga toskët (pra nuk na duhet!), ai në një intervistë (nëntor 2013) shprehet se shqipen standarde përkundrazi e imponuan gegët, se po të mos ishte pëlqimi i tyre i njëzëshëm dhe i vullnetshëm në Konsultën e Prishtinës (1968), as Kongresi i Drejtshkrimit nuk mund të mbahej (Emil Lafë).

Prof. Remzi Nesimi ka merita edhe për botimin e veprës sintezuese të prof. Shaban Demirajt “Gjuhësi Ballkanike” (botuar shqip e maqedonisht, Focus – Shkup, 1994). Prandaj dhe prof. Demiraj që në hyrje të veprës së tij do të shprehte konsideratën më të lartë për të:

“Me këtë rast, e quaj për detyrë të falënderoj nga zemra Dr. Remzi Nesimin për interesimin e madh, që ka treguar për botimin e kësaj vepre, si edhe për korrektimin e bocave të saj.”

Personalitet i dalluar për mbrojtjen e shqipes standarde

Veprimtaria kontributdhënëse e prof. Nesimit dhe sjellja e tij e veçantë afruese me kolegë edhe më të rinj se ai në moshë, bënë që të njiheshim prej kohësh dhe të kishim me të edhe kontakte miqësore e bashkëpunim të ngushtë. E kjo, sepse e çmoja këtë figurë emblematike me vlera të mëdha njerëzore, diturore e kombëtare.



Si themelues dhe drejtor i parë i Seminarit Ndërkombëtar të Albanologjisë në Universitetin Shtetëror të Tetovës, në vitin 2008, projektova edhe dhënien e *Çmimit* “*Kongresi i Manastirit*” (1908) për studiues të shquar në fushën e albanologjisë. Dhe këtë *Çmim* pata nderin t’ia jepja prof. Remzi Nesimit dhe prof. Rexhep Qosjes, me motivacionin “*Për kontribut të veçantë në Albanologji*”, të cilin ata e meritonin plotësisht.

Po në atë vit, në kuadër të veprimtarisë së Seminarit Ndërkombëtar të Albanologjisë, me mbështetjen e parezervë që kisha të rektorit të USHT prof. dr. Sadi Bexheti, e vura në planin e botimeve edhe disertacionin e tij të doktoratës “*E folmja e Dervenit*” (2008), një vepër me shumë interes për dialektologjinë dhe për gjuhësinë shqiptare, por që dergjej e pabotuar. Objekt i këtij studimi dialektologjik monografik është përshkrimi i hollësishëm i së folmes shqipe të rajonit të Dervenit, që me lëndën që përmban dhe me akribinë shkencore mund të thuhet se është një vepër prijatë për studimet albanologjike në Maqedoni me interes shumë të madh.


Lidhur me huazimet apo ndikimet sllave në të folmen e Dervenit, prof. Nesini thekson se: duhet vënë në dukje fakti se, thuajse në të

gjitha të folmet shqipe të Maqedonisë e më gjerë, nuk kemi vërejtur ndonjë ndikim në fushën e sintaksës. Madje në këto të folme, nuk hasen as edhe kalke sllave siç ndodh rasti me gjuhën e shtypit e të mjeteve të tjera të informimit (f. 413).

Prof. Remzi Nesimi përfaqëson një personalitet të dalluar për mbrojtjen e shqipes standarde. E kishin zgjedhur në mënyrë jakobine në të ashtuquajturin Këshill Ndërkademi (2004), si përfaqësues nga Maqedonia, pa e konsultuar fare dhe pa e pyetur për ndërhyrjet arbitrare që planifikonin të bënin në kodin e drejtshkrimit të shqipes standarde. Në një takim që kam pasur me të, ai më pati njoftuar se dëshironte të tërhiqej nga ai këshill dhe se vendin

“vakant” më propozoi të ma linte mua. Ndërsa unë, i zënë ngushtë nga ndjenja e respektit për të, i shpreha qëndrimin tim se nuk do të pranoja të isha pjesë e asaj kreature antistandardiste.

Emri i profesor Remzi Nesimit është një emër i përveçëm jo vetëm si nomina personalia në gramatikë, por është emër i përveçëm si personalitet dhe linguist i shquar me të cilin lidhen fillesat e albanologjisë shkencore në Maqedoni. Ai punoi për shqipen me përkushtim një jetë të tërë dhe e mbrojti këtë gjuhë jo vetëm nga ata që e sulmonin së jashtmi, por dhe nga plëngprishësit e brendshëm.



“Në dhjetë vitet e fundit, siç dihet, nga disa individë filloi të sulmohet edhe gjuha jonë e njësuar, e cila është jo vetëm identiteti ynë kombëtar, por ndoshta edhe i vetmi komponent i përbashkët i gjithë shqiptarëve” – shprehet prof. Nesimi.

Prof. Remziu krijoi breza të tërë arsimtarësh e gjuhëtarësh për shqipen. Ai ka rrënjësuar thellë dashurinë dhe adhurimin për gjuhën shqipe edhe tek fëmijët, në rastin konkret tek e bija, Valbona, studiuese dhe profesoreshe shumë e përkushtuar që i qëndron në krah e në mbështetje të atit për mbrojtjen e pastërtisë së shqipes dhe për pohimin e vlerave të kulturës gjuhësore të shqiptarëve si hallka të shqiptarisë.

Prof. Remzi Nesimi është ikona e njeriut të ndershëm dhe të angazhuar, ikona e arsimit shqip dhe ikona e Albanologjisë shkencore në Maqedoni. Njerëz të tillë, edhe po të kërkosh me fener, rrallë mund të gjesh. Emri i tij meriton të përjetësohet në emërtimin e ndonjë institucioni të lartë arsimor a shkencor në Maqedoni. Apo, ta zëmë, në emërtimin e ndonjë çmimi: Çmimi “Remzi Nesimi” që do të jepej për kontribut të shquar në albanologji.

Prof. Remzi Nesimi është vlerësuar nga të gjithë në radhë të parë si një njeri fisnik, me karakter e cilësi të epërme njerëzore, si intelektual dhe pedagog par excellence, dhe si një studiues i përkushtuar i shqipes. “*Për studentët ishte goja më e ëmbël e të folurit, profesori më i sjellshëm, shembull i intelektit, urtësisë e dijes shkencore*” (siç shprehet Sulejman Mehazi, ish-student i prof. Nesimit). Për gjuhën dhe gjuhësinë shqiptare ai ishte një studiues me kontribute jo të papërfillshme. Veprat dhe studimet e të tij do të lënë gjurmë. Edhe kujtimi për të do të jetë i paharrueshëm.

EMIL LAFE

Intstituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë – Tiranë

**PERSONALITETI SHKENCOR
I PROF. REMZI NESIMIT DHE DISA DETYRA
TË SOTME NË FUSHËN E ZBATIMIT
TË SHQIPES STANDARDE**

Remzi Nesimi është një ndër njerëzit më mbresëlënës që kam pasur rastin të njoh. E kam takuar së pari në shtatorin e vitit 1972, kur u krijua dhe u mbledh në Tiranë Komisioni organizues i Kongresit të Drejtshkrimit. Në këtë Komision ai përfaqësonte punëtorët e gjuhës shqipe në Republikën e Maqedonisë. Duke i shtrënguar dorën, dukej sikur të përçohesh një rrymë ngrohtësie shpirtërore dhe një ndjenjë mirësie e fisnikërie të çiltër. Ashtu i afruar e i dashur prej natyre dhe me një ndriçim të brendshëm shpirtëror për atë ngjarje madhore që kishim marrë përsipër të organizonim së bashku, prof. Remzi Nesimi u miqësua menjëherë me të gjithë ne dhe ishte me të vërtetë kënaqësi të ndodheshe pranë tij.

Në Kongresin e Drejtshkrimit prof. Remzi Nesimi mbajti kumtesën “Procesi i njësimit të shqipes letrare në Maqedoni”¹. Si nëntitull të saj ai kishte zgjedhur një thënie të Aleksandër Xhuvanit: *Njësia e gjuhës është njësia e kombit*. Ky është edhe lajtmotivi i kumtesës së tij dhe i vetë Kongresit të Drejtshkrimit. Remzi Nesimi theksoi gjatë fjalës në Kongres vijimësinë e pandërprerë të përpjekjeve për një gjuhë letrare shqipe të zhvilluar e të njësuar që nga fillimet e Rilindjes Kombëtare. Këto përpjekje frymëzoheshin nga vlerësimi se “gjuha letrare është thesari më i madh i një populli

¹ Citimet nga kjo kumtesë jepen sipas botimit në vëllimin: *Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe 20-25 nëntor 1972. I*. Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë, 1973, f. 281–287.

e njëkohësisht edhe shoqëruesi më besnik i kulturës në përgjithësi.” Ne dëgjuam me vëmendje të përqendruar paraqitjen e tij të përmbledhur, por të qartë e të saktë të ecurisë së shqipes letrare në Maqedoni, ashtu siç e kishin përvijuar me arsyetime shkencore, me vetëdije kombëtare dhe duke shfrytëzuar të gjitha hapësirat ligjore, punëtorët e dalluar të gjuhës shqipe në institucionet arsimore e kulturore të Republikës. Kohët e fundit është botuar një dokument me shumë vlerë, që hedh dritë mbi trajtimin e çështjes së gjuhës letrare të shqiptarëve në Maqedoni dhe më gjerë në Jugosllavi. Dokumenti mban titullin: *Analizë studimore “Çështja e gjuhës së vetme letrare e kombësisë shqiptare në Jugosllavi”*². Ky raport studimor i hollësishëm ka pasur ndikim të ndjeshëm që problemi i formës së shqipes letrare të zgjidhej njëherë e përgjithmonë dhe drejt jo vetëm për shqiptarët në Republikën e Maqedonisë, por për gjithë popullsinë shqiptare në Jugosllavi.

Në kumtesën e tij në Kongresin e Drejtshkrimit prof. R. Nesimi përmendi, me një krenari të përlligjur, se në hapësirën e Republikës së Maqedonisë dhe me pjesëmarrjen e me mbështetjen aktive të shqiptarëve të këtyre anëve, janë zhvilluar këtu disa ngjarje madhore për gjuhën shqipe, të tilla si: Kongresi i Manastirit (1908), veprimtaria e gjerë e familjes Qiriazi, botimi i abetares së Parashqevi Qiriazit dhe i mjaft librave të tjerë shqip në Manastir, gjallërimi i lëvizjes kulturore e arsimore klubeve shqiptare, botimi i gazetave “Kosova” e “Shkupi”, që dilnin në Shkup, dhe më tej mbajtja e

² Kjo Analizë është zbuluar në Arkivin Shtetëror të Republikës së Maqedonisë dhe është botuar në: Qerim Lita, *Problemi shqiptar në RP(S) të Maqedonisë 1944–1974, Përmbledhje dokumentesh, Vëllimi VI, Arsimi, kultura, religjioni*, Logos-A, Shkup, 2018. Analiza është përgatitur nga një grup ekspertësh gjuhësorë të Komisionit për pakica nacionale të Lidhjes Socialiste të Popullit Punues të Maqedonisë (LSPPM): Dr. Petro Janura, Murteza Peza dhe Krume Jakovski. Nuk ka ndonjë datë të saktë se kur është hartuar, por, sipas prof. Qemal Muratit, që e ka përgatitur për botim te revista “Gjuha shqipe” (2018, nr. 3), duke gjykuar nga terminologjia e përdorur, mund të arrihet te konstatimi se ajo është hartuar midis periudhës kohore 1959–1962.

Kongresit të rëndësishëm të Dibrës në korrik 1909 dhe e Kongresit të Dytë të Manastirit (1910).

Mbi këtë trashëgimi të pasur rinisën dhe vijuan përpjekjet e mëtejshme në kushtet e reja që u krijuan gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore. Një arritje e madhe e asaj kohe ishte dalja e shqiptarëve nga analfabetizmi masiv: në Shqipëri më 1945 ishin rreth 90% analfabetë; në Kosovë e në Maqedoni, përqindja e analfabetizmit ndër shqiptarët ishte edhe më e lartë. Në këtë vështrim me të drejtë vëren prof. R. Nesimi në kumtesën e tij se “në kushtet e një prapambetjeje të ndjeshme intelektuale e shpirtërore ka qenë iluzion të mendohej për një njësim të plotë të gjuhës letrare kombëtare. Për këtë kanë qenë të vetëdijshëm si punonjësit shkencorë, ashtu edhe arsimitarët, punonjësit e kulturës dhe të gjithë ata që kanë të bëjnë me gjuhën e shkruar. Prandaj ecuria e njësimin të drejtshkrimit dhe e njësimin të plotë të gjuhës sonë ka qenë graduale e sistematike.” Në çështjen gjuhësore intelektualët shqiptarë në Maqedoni, – vërente më tej prof. R. Nesimi, – kanë pasur si parim udhëheqës që të ndiqej ai drejtshkrim, madje ajo gjuhë që përdorej në vendin amë. Ata kanë ndjekur dhe kanë zbatuar udhëzuesit drejtshkrimorë të botuar në Tiranë më 1948, 1951 e 1956. Punonjësit e kulturës dhe arsimitarët shqiptarë në Maqedoni nuk i lejuan vetes që të mbyllen në një gegërishte të prerë, me veçori të të folmeve krahnore, siç ka qenë rasti në disa qendra të tjera. Prof. R. Nesimi përmendi se në këshillimet gjuhësore të shqiptarëve në ish-Jugosllavi, të mbajtura në Prishtinë, gjuhëtarët e arsimitarët nga Maqedonia kanë pasur një ndikim të ndjeshëm për njësimin sa më të plotë të drejtshkrimit dhe të gjuhës letrare në tërësi. Në Konsultën Gjuhësore të Prishtinës (prill 1968) ata u shprehën që “shqipja letrare, kudo që të përdoret, duhet të ketë një drejtshkrim të njësuar... dhe ngulën këmbë për të bërë edhe hapin e fundit – të njësojmë jo vetëm drejtshkrimin, por edhe gjuhën letrare.” Ne dëgjuam atëherë me një ndjenjë admirimi se në Maqedoni gazeta qendrore në gjuhën shqipe “Flaka e vëllazërimit” (më parë “Flaka e vllaznimit”) kishte nisur të dilte në gjuhën e sotme letrare disa muaj para

Konsultës së Prishtinës dhe me këtë ishte realizuar praktikisht dëshira për një gjuhë të njësuar letrare. Edhe një herë mendimi ynë shkon sot tek ata që me urtësi dhe me arsye të shëndoshë e arritën këtë njësim, si edhe ta masat e atyre që e përqaftuan dhe e zbatuan me gjithë zemër. Pas një gjysmë shekulli ne vërejmë se ajo zgjidhje ka qenë e drejtë, e qëndrueshme dhe u ka hapur që atëherë rrugën shumë përafrimeve e njësimeve mbarëshqiptare, si e drejtë e ligjshme jona dhe që nuk cenon askënd. Në vend të një shqipeje letrare me variante të ndryshme rajonale, kemi sot një gjuhë shqipe standarde të njëjtë e të përbashkët për të gjithë shqiptarët dhe të ndërtuar e të zhvilluar me punën e me kontributin e përbashkët të gjithë shqiptarëve. Mjafton të kemi parasysll avancimin e sotshëm të statusit të gjuhës shqipe këtu me problemet konkrete të praktikës së zbatimit, për të kuptuar sa e gabuar do të kishte dalë rruga e adoptimit të varianteve letrare ose të policentrizmit gjuhësor në vend të një gjuhe letrare të vetme e të njësuar.

Prof. Dr. Remzi Nesimi përfaqëson intelektualin me vlera të shumta e të larta, veprimtarin dhe kontribuuesin e palodhur, mësuesin e shumë brezave dhe krijuesin që la pas një trashëgimi të pasur për albanologjinë, filologjinë, dialektologjinë, drejtshkrimin, gramatikën e për nëndisiplina të tjera. Personaliteti shkencor që ndërtoi prof. Remzi Nesimi gjatë shtegtitimit të tij nëpër rrugët e dijes dhe të arsimit ngjan me shumë figura të shquara të gjuhësisë shqiptare, të cilëve rrethanat e kohës kur jetuan, u shtruan përpara një qerthull detyrash e punësh. Remzi Nesimi u diplomua në Beograd, por u kthye *pranë vatrës, pranë punës*, siç thotë poeti Noli. Veprimtarinë arsimore e kërkimore e zhvilloi këtu, në mjedisin e ngrohtësisë shpirtërore të bashkëvendësve, duke u bërë pjesë e gëzimeve, shqetësimeve dhe hidhërimeve të jetës së përbashkët.

Duke u kthyer te veprimtaria shkencore, unë do të vlerësoja në mënyrë të veçantë punimin e tij të disertacionit për të folmen e Dervenit. Sipas njohjes dhe përvojës sime, dialektologjia është një fushë e mjaft e ndërlikuar. Do ta krahasoja në fushën e sportit me

dhjetëgarëshin (dekatloni), në kuptimin që dialektologu duhet të ketë përgatitje të shëndoshë e të jetë i aftë të punojë në të gjitha disiplinat kryesore gjuhës: në fonetikë e fonologji për të përshkruar sistemin fonologjik dhe veçoritë fonetike të tingujve të së folmes që studion; në morfologji e në sintaksë për të përshkruar sistemin gramatikor dhe për të zbuluar tiparet karakteristike dalluese e variationet e tij; në fonetikën historike e në gramatikën historike për të kuptuar dhe shpjeguar të sotmen si zhvillim i një faze më të hershme; në leksikologji e në semantikë për të zbuluar veçoritë leksikore e frazeologjike të së folmes, dhe natyrisht në dialektologji, për të ditur parimet e kriteret e një përshkrimi dialektologjik dhe për ta vështruar të folmen përkatëse në kuadrin e përgjithshëm të ligjërimeve të asaj gjuhe. Krahas tyre ai duhet të zotërojë njohuri të mjaftueshme edhe për kulturën popullore shpirtërore e materiale, për gjeografinë, historinë, ekonominë dhe demografinë e krahinës përkatëse. Në këtë vështrim unë jam shprehur se disertacioni i doktoratës “E folmja e Dervenit”, të cilin e zgjeroi dhe e plotësoi hap pas hapi (botuar më 2008, 500 faqe), përbën një punim dialektologjik klasik, si nga ndërtimi, ashtu edhe nga përmbajtja dhe analizat që përmban. Edhe gjuhëtarë të tjerë kanë nisur nga dialektologjia, për arsyt që shpjegova. Nga gjuhëtarët shqiptarë po përmend Eqrem Çabejnë dhe Idriz Ajetin, nga albanologët e huaj polakun Waclaw Cimochowski dhe amerikanin Eric P. Hamp, që u nda nga jeta para një muaji. Edhe ky disertacionin e tij për të folmen e fshatit arbëresh Vakaric në Kalabri (Vaccarizzo Albanese) e botoi më 1993, gati 40 vjet pasi e kishte mbrojtur në Universitetin e Çikagos. E mbajti nëpër duar aq gjatë duke e përpunuar e plotësuar kohë pas kohe. Unë besoj se dialektologjia, d.m.th. studimi i thelluar i një ligjërimi popullor të një territori të caktuar, e ka ndihmuar prof. R. Nesimin për t’u orientuar më mirë edhe në studimet e tjera. Kam parasysh këtu edhe çështjen e normës letrare. Dhe në këtë mes ai nuk e ka parë normën letrare si një lloj emëruesi të përbashkët që mund ta nxjerrin disa gjuhëtarë nga hartat laramane të një atlasit dialektologjik. Norma letrare, ashtu si vetë

gjuha, ka natyrë shoqërore dhe nuk mund të sajohet artificialisht nga persona të veçantë. Prandaj nuk mund të kenë sukses sajemat e ndërhyrjet subjektive në gjuhë (ende shprehen propozime të tilla). Norma letrare është rezultat i një përzgjedhjeje gjatë një procesi letrar. Ajo vjen e përhapet derisa bëhet mbizotëruese në gjuhën e shkrimit dhe kodifikohet nga gjuhëtarët të pajisur me dijet shkencore për strukturat gjuhësore dhe për elementet e tyre.

Ndjenjat e vërteta e të sinqerta të shqiptarëve ndaj fqinjëve i ka shprehur më së miri Rilindësi i Madh Naim Frashëri në vargjet:

Duam me fqinjët gjithënjë të rrojmë, të jetojmë,

Me sllavë, grekë e këdo me dashuri të shkojmë;

Po me një fjalë, një vështrim thellësisht të kuptohet

Q'ë drejt e tjetrit gjithënjë duhet të respektohet.³

Prof. R. Nesimi me vetitë e tij njerëzore e intelektuale dhe me formimin e kontributet e shumt në fushën e gjuhësisë e të arsimit, u bë një figurë shkencore e vlerësuar lart në rrethet universitare të Maqedonisë. Botimi i përvitshëm “Godishen zbornik (Vjetar)” i Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Shkupit “Shën Kirili dhe Metodi” për vitin 2014 i është kushtuar prof. Remzi Nesimit në shenjë nderimi me rastin e 80-vjetorit të lindjes. Në këtë vëllim prej rreth 750 faqesh kanë botuar ndihmesat e tyre shkencore dhjetëra studiues shqiptarë, maqedonas e të tjerë. Unë uroj që edhe më tej marrëdhëniet e ndërsjella shqiptaro-maqedonase edhe në fushën e shkencës, e posaçërisht të shkencave filologjike të jenë të tilla që personalitet shkencore me merita të larta të nderohen me botime festive të përbashkëta.

³ Cituar sipas: *Historia e letërsisë shqipe. II*. Universiteti Shtetëror i Tiranës - Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë. Tiranë, 1960, f. 306.

Përkujtimi dhe nderimi i figurave të dijes dhe arsimit me veprimtari shkencore si kjo e sotnja, është edhe një rast për të vështruar përgjegjësitë tona, për të ballafaquar punën tonë me detyrat, për të ballafaquar atë që kemi bërë e po bëjmë me atë që duhej të kishim bërë ose duhet të bëjmë.

Gjuhëtarët që merren me shqipen standarde dhe me gjendjen e zbatimit të saj në praktikë kanë arsye të jenë të shqetësuar. Nuk mund të ngushëllohem me këtë që edhe në vende të tjera, me tradita mjaft më të lashta arsimore e kulturore, sot kultura gjuhësore ka rënie të ndjeshme. Ne duhet të kujdesemi fort e më fort për gjuhën tonë. Gjuhëtarët e Shkollës së Pragës, që krijuan termin dhe disiplinën e *kulturës së gjuhës* (çekisht *kultura jazyka*), kanë pasur parasysh kuptimin e fjalës *kulturë* në bujqësi, d.m.th. kultivimi, përkujdesja ndaj një bime dhe bima vetë që kultivohet, p.sh. *kultura e grurit, misrit, e ullirit* etj. Pra gjuha letrare a standarde është si një bimë e kultivuar, që kërkon përkujdesje. Përkujdesja e parë dhe kryesorja është detyrë e shkollës. Por kjo nuk mjafton. Shkolla në çdo disiplinë na mëson të përgjithshmen në mënyrë që pastaj të jemi të aftë të zgjerojmë njohuritë në fusha të veçanta. Një gjuhë që kryen funksione shtetërore përballet me një gamë çështjesh të natyrave të ndryshme, sidomos të terminologjisë. Por në rastin e shqipes në Maqedoni ka edhe çështje të tjera, që lidhen me imitimim e paarsyeshëm qoftë të maqedonishtes e qoftë të serbishtes. Për këto kanë tërhequr shpesh vëmendjen gjuhëtarët e këtushëm (ndër ta edhe prof. R. Nesimi) si edhe kolegët nga Kosova. Por, siç kam vënë re, herë–herë edhe vetë atyre u përvindhen ndërtime që vetë i kanë kritikuar, sepse ndikimi i mjedisit gjuhësor është mjaft i fuqishëm. P.sh. një koleg i këtushëm më shkruante kohët e fundit për një libër: “vepra, sipas tematikës që trajton, është e ndarë në dhjetë krerë, *edhe atë*: 1)... 2) ...” Te ky shembull fjalët *dhe atë* janë krejt të panevojshme për ligjëratën shqipe, – e shumta mund të thuhet: *dhe pikërisht* (duke vijuar me numërimin e krerëve), por kurrsesi *dhe atë*, sepse përemri *atë* te ky kontekst nuk shënon ndonjë objekt, mbetet i zbrazët pa kuptim!

Një koleg tjetër më shkruante për *lëndë zgjedhore në nivel universiteti*; besoj se është fjala për atë që quhet *lëndë me zgjedhje* (studenti ka të drejtë të zgjedhë njërën nga dy–tri lëndë që i ofrohen). Me rastin e kësaj konference sugjeroj që ITSHKSH në Shkup t’i shtojë vetes një detyrë të re: të jetë këshilltar gjuhësor, i njohur zyrtarisht, i Kuvendit dhe i qeverisë së Maqedonisë së Veriut. Për këtë natyrisht duhet ngritur një grup pune (me punonjës të brendshëm e të jashtëm), që të gjallërojë edhe këshillimet gjuhësore në të gjitha format e mundshme. Shoqata e Gjuhësisë Shqiptare do të jetë e gatshme të bashkëpunojë kolegialisht ose dhe zyrtarisht me ju për çështje organizative e shkencore.

Barazia e gjuhëve nënkupton që edhe kujdesi për to të jetë i barabartë. Prandaj kujdesi për përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe duhet të jetë i njëjtë me kujdesin që tregohet këtu (me sa jam në dijeni) për maqedonishten. Prof. Idriz Ajeti këshillonte që në rastet e përdorimeve të ndryshme gjuhësore ndërmjet kësaj ane dhe Shqipërisë, si rregull, të ndiqet përdorimi i Shqipërisë. Kjo është e kuptueshme sepse atje është themeluar tradita e përdorimit të shqipes si gjuhë zyrtare e shtetit dhe përkujdesja për të nga disa breza gjuhëtarësh e shtetarësh të cilësuar. Por edhe këtu duhet pasur kujdes. Në Shqipëri kemi mjaft ndotje gjuhësore si pasojë e mangësisë së njohurive për gjuhën shqipe dhe e manisë për të përdorur fjalë e ndërtime të huaja krejt të panevojshme, që shumë lehtë po arrijnë edhe këtej, si p.sh. fjalët *siguracion, spostoj, spostohe, spostim, prezencë, performoj performancë* (në një tv të Tiranës dëgjova u dha një kronikë ku tregohet se fëmijët e kopshtit “Pranvera e jetës” kishin *performuar ...!!!*), ashtu siç arrijnë edhe te ne përdorime të gabuara të kësaj ane, p.sh. *veçmas* me kuptimin ‘veçanërisht’, ‘posaçërisht’⁴ ose *konferencë për shtyp* në vend të

⁴Ndajfolja *veçmas* (formë e zgjeruar e *veças*) ka kuptimin ‘jo së bashku; veç e veç’; përdoret edhe si parafjalë: *rrë veçmas* ose *veçmas shokëve*. Në gjuhën shqipe emërtimi *konferencë shtypi* është ndërtuar sipas frëngjishtes *conférence de presse* dhe italishtes *conferenza stampa*. Ky term i gazetarisë ka kuptimin: takim i personaliteteve shtetërore e shoqërore me përfaqësues të shtypit të shkruar a të

konferencë shtypi ose konferencë për shtypin; i ndihmon zhvillimit në vend të ndihmon për zhvillimin etj.

Sot një mjet i fuqishëm për përhapjen e njohurive për përdorimin e drejtë të gjuhës është interneti, i cili na sjell edhe arritjet e gjuhësisë kompjuterike. Një shërbim të madh na ka sjellë Qendra për Edukim dhe Përparim (QEP) në Prishtinë, që ka krijuar korrektorin automatik drejtshkrimor (tani nuk bëjmë dot pa të!) dhe mjete të tjera informatike për zotërimin e mirë të gjuhës shqipe. E quaj të domosdoshme që këto mjete informatike të bëhen të njohura e të përdoren rregullisht edhe në shkollë. Shpresoj se QEP, me bashkëpunimin e specialistëve të gjuhës (duke përfshirë këtu edhe hartuesit e teksteve mësimore) do të bëhet një partner i pazëvendësueshëm i shkollës shqipe.

Siç e përmenda më lart, përkujtimi dhe nderimi i figurave të dijes dhe arsimit është edhe një rast për të vështruar përgjegjësitë dhe detyrat tona të sotme. Uroj që kjo konferencë të shërbejë ndër të tjera edhe për një veprimtari më të organizuar e më të dendur në këtë drejtim. Le të punojmë së bashku! Bashkimi bën fuqinë!

folur për t'u bërë njoftime a për t'i sqaruar për çështje të rëndësishme ose për t'iu përgjigjur pyetjeve të tyre. Emërtimi *konferencë për shtyp* është ndërtuar gabim sipas serbishtes *конференција за штампу*. Në gjuhën shqipe për shtyp do të thotë 'për t'u shtypur në shtypshkronjë' (p.sh. kur themi: *libri po bëhet gati ose po përgatitet për shtyp*), prandaj *konferencë për shtyp* nuk ka kuptim. Në të vërtetë emërtimi i serbishtes (e cila nuk ka trajtë të shquar e të pashquar të emrit) duhej përkthyer *konferencë për shtypin* në kuptimin 'për përfaqësuesit e mjeteve të informimit'.

OLGER BRAME

Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë – Korçë

NDIHMESAT E PROFESOR REMZI NESIMIT PËR STANDARDIN E SHQIPES

Për më se 50 vjet gjuha dhe kultura shqipe ndër shqiptarë dhe veçanërisht ndër shqiptarët e Maqedonisë do të njihete ndihmesën e një prej emrave të shquar të albanologjisë, siç ishte profesor Remzi Nesimi. Një studiues, i cili do të prekte pothuajse të gjithë fushat e lëvrimin të gjuhës si: redaktor letrar, ku ndihmesa e vërtetë do të ishte në fushën e kulturës gjuhësore në botimet dhe shtypin shqip, si pedagog i Akademisë Pedagogjike të Shkupit, profesor në Katedrën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare në Universitetin e Shkupit për të formuar dhe nxjerrë breza të tërë mësime në fushën e shqipes, si dialektolog me studime të admirueshme nga fusha e ligjërimeve popullore, si didakt dhe autor tekstesh për të gjitha ciklet e shkollimit të shqipes në Maqedoni nga klasat e ulëta të shkollës e deri tek auditorët e universitetit, si studiues me vlera të padiskutueshme në fushën e shqipes, për shqipen dhe përtej sajme mbi 200 artikuj në revista shkencore e periodikë.

Për profesor Remzi Nesimin, siç thekson studiuesi Lafe, mund të thuhet se është ndër ata njerëz që janë ndodhur në kohën e duhur në vendin e duhur. Emri i tij është i mirënjohur jo vetëm në Maqedoni, por në mbarë botën intelektuale shqiptare, veçanërisht në rrethet e shkencave filologjike. Ai është mësues i nderuar i shumë brezave dhe një meritë e madhe e tij është se ka ditur t'u mësojë mirë studentëve të vet jo vetëm ato dije shkencore që kanë librat, por edhe diçka më tepër, që nuk e kanë librat, por që e rrezaton personaliteti i mësuesit, zemra dhe sjellja e tij. Prandaj

profesor Remzi Nesimi mbetet jo vetëm një mësimdhënës i cilësuar, por edhe një edukator kombëtar.⁵

Në këtë trajtesë të shkurtër do të përpiqemi të ndalemi në ndihmesën dhe rolin e padiskutueshëm të profesor Remzi Nesimit në fushën e standardit të shqipes, si përfaqësues i Maqedonisë në Komisionin e organizimit të Kongresit, anëtar i komisionit të hartimit të Rezolutës së Kongresit dhe firmëtar i saj, si dhe idhtar i zbatimit të këtij standardi në fushën e kulturës dhe të arsimit shqip në Maqedoni.

Profesor Remzi Nesimi, si pjesëmarrës dhe delegat në Kongresin e Drejtshkrimit në Tiranë, të mbajtur më vitin 1972, mbajti referatin: “Procesi i njësimt të shqipes letrare në Maqedoni”.⁶ Me një analizë të hollë përshkruese dhe shkencore ai argumenton me vetëdije të lartë rolin dhe rëndësinë e aprovimit të rregullave të drejtshkrimit të shqipes, duke theksuar se shqipja ka arritur atë shkallë zhvillimi që mund të shprehë çdo konceptim shkencor e letrar, duke mos ngelur prapa gjuhëve më të zhvilluara. Kongresin e Drejtshkrimit ai do ta përcaktonte si ngjarjen më të rëndësishme historike të kulturës shqiptare apo edhe si një mision në përmbushje të idealeve të Rilindjes Kombëtare. Argumentet e tij bindëse, me vetëdije të lartë shkencore, në mënyrë përshkruese që nga Kongresi i Manastirit e deri në Kongresin e Drejtshkrimit, do të nxirrnin në pah rrethanat dhe prirjet e lëvrimit të shqipes te shqiptarët në Maqedoni pas Luftës II Botërore si vijim i traditave të mëparshme, problematikat e drejtshkrimit jo të njësuar në fushën e botimeve, duke bërë lidhjen midis njësimt të ortografisë me njësimin e normës së shkruar nga njëra anë dhe kushteve historike të zhvillimit kulturor, nga ana tjetër. Argumentet dhe faktet bindëse të sjella në fjalën e tij se tashmë njësimi i drejtshkrimit dhe i

⁵ Emil Lafe, *Personaliteti shkencor i prof. Remzi Nesimit*, Perla, vëllimi 66, numri 3-4, 2013

⁶ Remzi Nesimi (Shkup), *Procesi i njësimt të shqipes letrare në Maqedoni*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Kongresi i Drejtshkrimit të gjuhës shqipe 20-25 nëntor 1972, Prishtinë, 1974

vetë shqipes është nevojë, i jep duke sjellë në vëmendje gjendjen e shqipes në Kosovë e sidomos në Maqedoni. Pa krahëmbajtje dhe me një arsytim të thellë shkencor, ai sjell në vëmendje punën e deriatëhershme të bërë në fusha të ndryshme të kulturës dhe arsimit me përdorimin e gjuhës shqipe në variantin letrar verior të mesëm si dhe ndihmën e arsimtarëve nga nga Elbasani e skajet jugore të Shqipërisë, të cilët shërbyen në qendra të ndryshme shqiptare në Maqedoni si në: Shkup, Tetovë, Dibër, Strugë, Gostivar etj. Nga na tjetër, me kujdesin e një fonologu dhe dialektologu të vëmendshëm ai përballëvë problematikat apo dallimet që krijojnë variantet e ndryshme të formave fonetike në Maqedoni e Kosovë, duke mbrojtur bindjen se parimi themelor i intelektualëve ka qenë që të ndiqet ajo ortografi, bile edhe ajo gjuhë, që përdoret në vendin amë. Ai nuk mund të lërë pa theksuar faktin që punonjësit e arsimit dhe kulturës në Maqedoni kanë qenë idhtarë për një drejtshkrim të njëzuar si edhe për një shqipe të njësishtme letrare kombëtare, fakt ky i mbrojtur bindshëm nga shqiptarët e Maqedonisë që në mbledhjen për ortografinë e shqipes në Prishtinë, më 1963, si edhe në Konsultën Gjuhësore të Prishtinës, më 1968. Kjo gjë, sipas profesorit, tashmë kishte filluar të zbatohet në Maqedoni me shkrimet te “Flaka e Vëllazërimit”, që para Konsultës së Prishtinës, e cila po dilte në gjuhën e sotme letrare, duke kumbuar më ëmbël për çdo shqipfolës.⁷ Dy vjet para mbajtjes së Kongresit të Drejtshkrimit, përkatësisht që në vitin 1970, në faqet e gazetës “Flaka e vëllazërimit” që botohet në Shkup, në shtatë numra të njëpasnjëshëm, ai paraqet dhe arsyeton rëndësinë dhe nevojën e konstituimit të një gjuhe të përbashkët letrare dhe standardizimin e saj.⁸

Nëse udha e tij si një idhtar i standardit dhe normës së njëzuar do të niste me Kongresin e Drejtshkrimit, ky do të ishte vetëm pikëfillimi i

⁷ Po aty.

⁸ Asllan Hamiti – Ajten Qamili – *Ismet Osmani, Kontributi i delegatëve të Kongresit të Drejtshkrimit nga Maqedonia për shqipen standarde*, Akademia Jubilare me rastin e 40-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit, Universiteti i Korçës, Nëntor, 2012, fq.40-46.

një përpjekjeje të vazhdueshme të tij, me çdo formë e çdo mjet, në arsim, botime, tekste dhe punë të pafund kërkimore–shkencore, për ta ruajtur dhe promovuar këtë standard. Ai ishte i bindur, duke e shpallur këtë edhe në mendimet dhe përpjekjet më të mëvonshme të tij se, duhet mbajtur mirë parasysh që gjuha shqipe letrare nuk u formua e nuk u vendos në Kongresin e Drejtshkrimit (1972), por disa vjet më parë në Konsultën Gjuhësore të Prishtinës (1968) dhe, po të mos ishte ajo Konsultë, nuk do të mbahej as Kongresi.⁹

Konsulta e Prishtinës, sipas profesorit, është baza e vendosjes së gjuhës së sotme standarde ose e gjuhës së njësuar për të gjithë hapësirën ku banon populli shqiptar. Gjuhën letrare këtu te ne e themeluan me punën dhe përpjekjet e tyre gjuhëtarët shqiptarë të këtyre anëve, të Kosovës dhe të Maqedonisë, me këmbëngulje që të kemi një gjuhë të vetme, pasi ishte pa kuptim, ishte jashtë logjikës së historisë dhe të kohës, që një popull i vogël i ndarë në shtete të ndryshme, të ishte i ndarë edhe me variante të ndryshme të gjuhës letrare.

I ndërgjegjshëm se për gjuhën letrare ka pasur dhe ka diskutime, ai argumenton bindshëm se:

“...debatet për shqipen letrare, për rrugët dhe mënyrat e themelimit të saj kanë nisur herët, që nga fillimet e Rilindjes Kombëtare. Në ditët tona më duket se po krijohen disa shqetësime të panevojshme lidhur me këtë çështje, sepse kemi tashmë një gjuhë letrare kombëtare, e cila u formua për një kohë mjaft të gjatë dhe i ka përballuar e i përballon funksionet e saj gjithnjë në rritje si gjuhë e administratës, e shkollës, e shkencës, e letërsisë, e shtypit dhe publicistikës, e radiotelevizionit, e veprimtarisë ushtarake, fetare etj., jo vetëm në Shqipëri e në Kosovë, por edhe në Maqedoni”¹⁰.

⁹ Remzi Nesimi, *Rreth diskutimeve dhe detyrave tona për gjuhën shqipe*, Perla, vëllimi 66, numri 3-4, 2013, fq.37-40.

¹⁰ Remzi Nesimi, *Rreth diskutimeve dhe detyrave tona për gjuhën shqipe*, Perla, vëllimi 66, numri 3-4, 2013, fq.37-40

Edhe në rrethanat e reja që u krijuan pas vitit 1999, me krijimin e Këshillit Ndërkademiç, si organizëm mbarëkombëtar, përfaqësuar nga akademitë e Shqipërisë dhe Kosovës, profesor Remzi Nesimi do të ishte përfaqësues i shqiptarëve të Maqedonisë, megjithëse nuk do të rrinte pa dhënë sugjerimet e tij lidhur me atë se si duhet të funksiononte dhe të punonte ky Këshill. Nuk do të rreshte së dhëni mendimet e tij të vyera në ndihmë të shqipes dhe standardit të saj. Me një logjikë të ftohtë dhe të argumentuar ai thekson se çdo komb serioz i kushton shumë rëndësi çështjes së gjuhës, prandaj edhe qenia e një Këshilli që do të bëjë planifikimin gjuhësor, që do të kujdeset për zhvillimin dhe zbatimin e njëjtë të gjuhës standarde është më se e nevojshme. Në radhë të parë, gjuha standarde dhe në përgjithësi gjuha shqipe, ka nevojë të pasurohet me fjalë të reja të nevojshme për etapën e sotme të zhvillimit shoqëror, ekonomik e shkencor. Prandaj këtë veprimtari duhet ta orientojë e ta drejtojë një Këshill që është kompetent për çështjet gjuhësore.¹¹ Ai vazhdon me këmbëngulje të theksojë se gjuha, si një organizëm i gjallë, zhvillohet vazhdimisht dhe si e tillë duhet të vëzhgohet e të përpunohet në vijimësi. Kjo duhet të mbetet detyrë themelore për gjuhësinë shqiptare. Lidhur me këtë ai shtron si detyrë konkrete trajtimin shkencor të një sërë çështjesh gjuhësore, siç janë disa raste në sistemin e emrave e të foljeve, si dhe një çështjeje mjaft delikate për të, siç është pastërtia e gjuhës. Duhet të vazhdohet ende me përpjekjet për ta ruajtur pastërtinë e gjuhës nga ndikimi i gjuhëve të tjera, nga huazimet e panevojshme. Jemi mësuar të marrim fjalë, por edhe ndërtime fjalish të panevojshme. E gjejmë të gatshme një fjalë a një shprehje dhe, në vend që ta themi shqip, e themi ashtu si na vjen më lehtë.

Lidhur me këto çështje gjuhësore, d.m.th. të përdorimit të drejtë e të bukur të pasurisë së gjuhës shqipe, për ruajtjen dhe nxjerrjen në pah të vlerave të saj, duhet të flitet vazhdimisht dhe gjuha të shkojë përpara, të zhvillohet më tej— vazhdon profesori, duke theksuar se

¹¹Po aty.

këtë mund ta bëjnë specialistët, gazetarët e shkrimtarët, ndërsa gjuhëtarët vetëm e sistemojnë, e formulojnë dhe vulosin. Pastrimin e gjuhës shqipe nga fjalët e huaja të panevojshme, ruajtjen e pastërtisë së saj e konsideron si një detyrë të rëndësishme, por nga ana tjetër thekson se duhet të thithet thesari leksikor i të folmeve të ndryshme, që të pasurohet gjuha letrare, e cila burimin e ka tek dialektet, duke u shprehur: *Pse të marrim miell të huaj, kur kemi tonin?*¹² Por përsëri, me qetësinë, kujdesin dhe përvullësinë e tij fisnike si njeri dhe studiues, thekson se kjo gjë duhet bërë në mënyrë të natyrshme, pa zell të tepruar për purizëm të skajshëm, por me masë, për të ruajtur veçantinë dhe origjinalitetin e gjuhës sonë.

Duke nxjerrë në pah rolin e padiskutueshëm të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë e Kosovës, Instituteve të Albanologjisë së Prishtinës e Tiranës, Institutit të Trashëgimisë Kulturore në Shkup, madje gjithë katedrave të gjuhësisë në universitete, ai fuqishëm ngrë zërin se është e nevojshme të ndihmojmë njëri-tjetrin me mirëkuptim e për një qëllim të përbashkët: të mbrojmë dhe të pasurojmë gjuhën shqipe si mjeti kryesor për zhvillimin e mëtejshëm të kulturës sonë të përbashkët dhe të njësisë sonë kombëtare.

I përcaktuar si personalitet i shquar i botës intelektuale shqiptare, i cili ka dhënë kontribut të çmueshëm në shkencat filologjike, në fushën e dialektologjisë, duke promovuar me intelektualizëm të pashoq pasuritë shpirtërore e gjuhësore dhe kulturës shqiptare në përgjithësi¹³, si gjuhëtar i kohës së duhur, në vendin e duhur, kreu punën e duhur¹⁴, si një njeri i mirë dhe familjar shembullor, të cilin, si rrallëkë e stoliste virtyti i modestisë dhe i gatishmërisë për t'i ndihmuar studentët dhe të gjithë njerëzit, ai mbetet një ndër personalitetet më në zë të mbarë gjuhësisë shqiptare.

¹² Po aty, fq. 39-40

¹³ Koha.net., 04 February 2018 13:19 <https://www.koha.net/kulture/73496/vdes-profesori-dhe-pedagogu-remzi-nesimi/>

¹⁴ Emil Lafe, *Remzi Nesimi, gjuhëtar i kohës së duhur kreu punën e duhur*, <http://maqedoniashqiptare.com/>, on: February 05, 2018

Shkoi në amshim, në kujtesën tonë kombëtare, duke lënë pas vetes një zbrazëti (se humbëm një njeri të veçantë), por njëherësh duke lënë pas vetes një vepër të madhe gjuhësore dhe pedagogjike¹⁵. Intelektuali me vlera të jashtëzakonshme, veprimtari dhe kontribuesi i palodhur, krijuesi që la pas një trashëgimi të pasur për albanologjinë, filologjinë, drejtshkrimin, gramatikën dhe për shumë nëndisiplina të tjera gjuhësore¹⁶.

Personalisht pata fatin ta njoh nga afër e ndonëse në kushte jo fort të mira shëndetësore, meraku i tij ishte vetëm një: *gjuha shqipe*. Disa ditë pas ndarjes fizike nga kjo jetë, në një artikull shtypi lexoj: RILINDËSI I PËRSHPIRTSHËM I GJUHËSISË SHQIPTARE! – shtërgu i fundit rilindas që në gjithë jetën e tij ka mbryjtur fjalën shqipe, duke i dhënë asaj arkitekturën e përveçme të shkencës së gjuhësisë, strukturën gramatikore dhe gjithë përmasat e eksplorimit të vjetërsisë. Një përcaktim me pak fjalë që përmbledh një personalitet të fuqishëm e të shquar të botës intelektuale shqiptare.

Referime:

1. Asllan Hamiti – Ajten Qamili – *Ismet Osmani, Kontributi i delegatëve të Kongresit të Drejtshkrimit nga Maqedonia për shqipen standarde*, Akademia Jubilare me rastin e 40-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit, Universiteti i Korçës, Nëntor, 2012, fq.40–46
2. Emil Lafe, *Personaliteti shkencor i prof. Remzi Nesimit*, Perla, vëllimi 66, numri 3–4, 2013
3. Emil Lafe, *Remzi Nesimi, gjuhëtari që në kohën e duhur kreu punën e duhur*, <http://maqedoniashqiptare.comon>: February 05, 2018
4. Remzi Nesimi (Shkup), *Procesi i njësimt të shqipes letrare në Maqedoni*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Kongresi i Drejtshkrimit të gjuhës shqipe 20–25 nëntor 1972, Prishtinë, 1974
5. Remzi Nesimi, *Rreth diskutimeve dhe detyrave tona për gjuhën shqipe*, Perla, vëllimi 66, numri 3–4, 2013, fq.37–40
6. <https://www.koha.net/kulture/73496/vdes-profesori-dhe-pedagogu-remzi-nesimi/>
7. <https://portalb.mk/501861-largimi-i-njeriut-te-vecante/>
8. <http://old.zhurnal.mk/content/?id=18241323428>

¹⁵ <https://portalb.mk/501861-largimi-i-njeriut-te-vecante/0:01,06-02-2018>

¹⁶ <http://old.zhurnal.mk/04.02.2018,13:23|B.M.>

NJË BISEDË ME PROFESORIN REMZI NESIMI LIDHUR ME ZBATIMIN E PARIMIT MORFOLOGJIK DHE TRADICIONAL

Përsëritjet e mia të përzemërta organizatorëve që patën mirësinë ta organizojnë këtë konferencë shkencore për nder të kolegut tonë të ndjerë të Katedrës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe. Përsëritjet edhe pjesëmarrësve në këtë konferencë shkencore, të cilët me praninë e tyre na nderojnë edhe ne, të cilët patëm fatin të punojmë me profesorin Remzi Nesimi. Profesori i ndjerë ishte pjesëtar i gjeneratës së dytë, së bashku me profesorin Xhevat Gega në Katedrën e gjuhës dhe letërsisë shqipe, e unë me ca shokë të gjeneratës së tretë, një albanolog i formuar shumë vonë pas 20 vjet shërbimi në arsim si mësues i matematikës në shkollat fillore dhe të mesme të Kumanovës dhe të Shkupit. Si i tillë, i ri në profesion e plak në moshë, kisha nevojë për të, ndërsa ai ishte i pakursyer për të më ndihmuar.

Mu për këtë Profesor Remziut i kam borxh të madh për shumë këshilla që i kisha prej tij. Ai përveç që më ishte anëtar i komisionit për mbrojtje të temës së doktoratës, me profesorë: Bari Becin, Miço Samarën, Gjovalin Shkurtaç, Mehmet Çelikun dhe Xheladin Gosturanin, ai edhe mandej më mbeti mësuesi më i mirë dhe më i denjë, gjithmonë i gatshëm, në çdo moment, të më ndihmojë.

Profesorët Remziut, Xhevati dhe unë ishim më pleq në katedër dhe në një kohë të zymtë të arsimit shqip mbanim një peshë pak më të rëndë kur duhej të mbrohet katedra po edhe kauza e arsimit shqip, i cili ishte në shënjestër për ta shkatërruar. Mbaj në mend një pjesëmarrje në një takim në Kuvendin e atëhershëm të Maqedonisë. Bëhej fjalë për ndryshimin e toponimeve. Për shembull, Shkupin

duhej ta quanim Skopje, edhe toponime të tjera për të cilët kërkohej me këmbëngulje t'i përdornim sipas sistemit toponimik maqedonas. Normalisht se ishim kundër një gjëje të tillë. Aty pranë ishte edhe ai Kali i Trojës, Nejazi Limanovski, turbulluesi më i madh i kësaj çështjeje dhe vetëm dëgjonte se cili po e ngrënë sado pak zërin që ta bënte punën e tij për t'i diferencuar njerëzit e arsimit nga puna. Edhe unë, pasi u lexua referati i përgatitur në katedër, në diskutim pyeta se kush jemi ne si një katedër, çfarë ingerencash kemi që të veprojmë kështu siç kërkon. A e dini Ju se çfarë formash rasore mund të marrë fjala Skopje në lakim: *Skopje; i (e) Skopjes; Skopjes; Skopjen; prej Skopjes*. Vallë, këto forma rasore të këtij toponimi mund të jenë shqipe dhe ç'dobi ka maqedonishtja nëse ato në këso formash përdoren në gjuhën standarde shqipe? Cili ishte ai që dërgoi letër qarkore nëpër shkollat shqipe për të kërkuar një punë plotësisht jonormale dhe të pamundur për ndërrimin e toponimeve. Brenda dy javëve erdhi letra në fakultet në të cilën kërkohej diferencimi im nga partia, normalisht edhe nga puna. Kush e kishte hallin e Partisë? Në pyetje ishte puna. Mbas shumë mbledhjeve shpëtova falë mbrojtjes së një partiaku të madh maqedonas, koleg imi nga gjimnazi, intervenimit të Vullnet Starovës, Kryetarit të Këshillit Ekzekutiv (Parlament i asaj kohe), njëkohësisht edhe intervenimit të një miku shqiptar, të profesor Remziut, shpëtova me dënimin—parapërdorim nga puna.

Profesor Remziu ishte i gatshëm gjithmonë për të diskutuar për çdo problem shkencor, veçanërisht për drejtshkrimin e gjuhës standarde shqipe, si mbrojtës i tij dhe pjesëmarrës në Kongresin e Drejtshkrimit. Biseduam për zbatimin e parimit morfologjik dhe tradicional, për të mirat e tij, por edhe për problemet që mund t'i sjellë në gjuhë pas zbatimit me shekuj pa intervenuar për ta afruar anën pamore të gjuhës me anën dëgjimore. Bëmë fjalë për librin *“Le Cahie de poesie”* dhe përdorimin e tij në Francë, si mjet didaktik në sistemin arsimor të Francës.

Libri *“Le Cahie de poesie”*, është bërë mjet mësimor shumë i rëndësishëm për nxënësit e shkollave fillore në Francë, një libër në formë të një fletoreje pune, përplot me poezi të letërsisë frënge, po edhe të kulturave të tjera të të gjitha kohërave, me vlerë të verifikuar letrare në letërsinë botërore. Këto poezi duhet të mësohen përmendësh, por paraprakisht të kopjohen në faqet enkas të përgatitura për kopjim në vetë librin, të ushtrohet recitimi dhe memorizimi i tyre, pastaj diktimi, e më në fund edhe ilustrimi i asaj që është mësuar përmendësh. Në bisedë me të i analizuam të mirat dhe problemet e drejtshkrimit frëng.

Duke e përjashtuar veprimin e fundit—ilustrimin, si një veprim pedagogjik më me vlerë, pyetëm njëri—tjetrin se çfarë rëndësie metodike—pedagogjike kanë: kopjimi, diktimi, të mësuarit përmendësh, po edhe recitimi i këtyre poezive, si kërkesë mësimi në sistemin shkollor fillor frëng? Këto kërkesa programore realizohen me ndihmën e këtij mjete mësimor në këtë nivel shkollor. Kjo punë që kërkohet prej nxënësve të kësaj moshe notohet me rigorozitet të madh, prandaj ajo shpeshherë sjell edhe trauma në shpirtrat e këtyre vogëlushëve dhe vogëlusheve. Por mbasi tejkalohet kjo “torturë” e tërë dhe ky “ankth” të nxënësit, po edhe te prindërit e tyre, e tëra kjo përcillet jo vetëm me gëzim të madh, por edhe me një mburrje të madhe te të dy palët, si te nxënësit ashtu edhe te prindërit e tyre. Kjo punë sipas sistemit mësimor frëng është më se e nevojshme, prandaj atje ka kaluar në një traditë.

Normalisht një vlerësim jo të mirë për të gjitha fazat e këtij veprimi të këtillë e dhamë ne, duke u nisur nga kërkesat programore mësimore tonat, duke i parë si veprime jofrytëdhënëse, përgjithësisht, përveç ilustrimit të tekstit të lexuar ose poezisë së analizuar, që merren si një ndër kërkesat jashtëzakonisht të rëndësishme, jo vetëm në Francë, po edhe te ne, sepse në këtë fazë përfundimtare zhvillohet imagjinata e nxënësit, por jo edhe me anë të kopjimit të asaj që lexohet ose mësohet përmendësh. Drejtshkrimi ynë, i

mbështetur kryesisht në parimin fonetik,¹⁷ na siguron një komoditet më të madh, krahasuar me drejtshkrimet e gjuhëve që mbështeten më tepër në parimin tradicional.

Le të mendojmë pak më shtruar se ku janë benefitet e kësaj metode të aplikuar në Francë që preferon kopjimin, diktimin, mësimin përmendësh dhe recitimin e këtyre poezive?

Kjo bëhet, me siguri, thotë profesor Remziu, për të përvetësuar një fond të konsiderueshëm fjalësh, si njësi të plota, së bashku me format e tyre gramatikore, në bazë të kodit drejtshqiptimor dhe drejtshkrimor të gjuhës standarde frënge. Në këtë mënyrë evitohen dallimet në gjuhë që sjellin nxënësit e mikroambienteve të ndryshme familjare. Secili nga këta nxënës sjell një fond fjalësh të tijin, të cilin ai nuk mund ta harrojë lehtë, si një bagazh leksikor që e ka nga prindërit me gjuhë mikroambienti, me aftësi dhe me përgatitje të ndryshme shkollore. Këto probleme janë prezente në çdo proces mësimi gjuhësor të të gjithë popujt, por jo edhe në shkallë të njëjtë, shton profesori, diku hasen më shumë e diku më pak¹⁸. Problemet janë shumë më të mëdha, shtova unë, në ato gjuhë ku konceptet dëgjimore nuk përkojnë me ato pamore, që do të thotë se fjala e shqiptuar nuk përkon me formën e shkruar të saj. Në procesin mësimor të këtyre gjuhëve ushtrohet balancimi i këtyre koncepteve, prandaj përdorimi i kësaj fletoreje poezish (“Le cahie de poesie”) si mjet mësimor preferohet në Francë. Mësimi përmendësh ndihmon shqiptimin e drejtë të fjalëve, kopjimi me-morimin e formës së shkruar që nuk përkon me atë të dëgjuarën, ndërsa diktimi dhe verifikimi rigoroz i tij ndihmon balancimin ndërmjet dëgjimit të fjalës dhe formës shkrimore të saj. Frëngjishtja, anglishtja, gjermanishtja dhe të gjitha gjuhët e tjera si këto, kanë probleme të këtilla, meqë drejtshkrimin e tyre e mbështetin në

¹⁷ Kështu u deklaruan një numër i madh studiuesish në Kongresin e drejtshkrimit të gjuhës shqipe, Tiranë, më 20-25 nëntor 1972.

¹⁸ Në realitetin shqiptar një punë e këtillë nuk do të ishte plotësisht e pa nevojë në mikroambiente që ndodhen shumë larg bazës dialektore të gjuhës standarde shqipe, krahasuar me mikroambiente që ndodhen sa më afër bazës dialektore.

parimin morfologjik dhe tradicional. Kështu emri i qytetit frëng shkruhet “*Bordeaux*”, ndërsa lexohet *Bordo*, ndajfolja “*beaucoup*” e shkruar kështu, lexohet “*boku*”. Emri *Cezar* i perandorit romak, në anglishte shqiptohet dhe lexohet *Sicer* edhe pse shkruhet *Caesar*, emri i linguistit frëng *De Sosyr* shkruhet *De Saussure*, ndërsa emri i hotelit *Belvy – Belevoue*. Duke zbatuar parimin morfologjik dhe tradicional, emri i klubit futbollistik anglez *Bornmauth* shkruhet *Bournemouth*. Anglezët, për ta shkruar këtë emër ashtu siç duhet sipas rregullave drejtshkrimore të gjuhës së tyre, duhet ta mësojnë ashtu siç veprojnë edhe francezët me fletoren e tyre “*Le cahie de poesie*”. Ndërsa, ai që e dëgjon për herë të parë këtë emër, e provon ta shkruaj atë, siç preferon drejtshkrimi i gjuhës angleze, duhet të pyes si shkruhet ky emër germë për germë, ndryshe nuk do të mund ta shkruajë.

Në shembujt e dhënë më lart shihen vështirësitë në mospërputhjen e perceptimit dëgjimor me atë pamor, prandaj mbështetja vetëm në perceptime dëgjimore, nuk është e njaftueshme. Kështu në realitete të ndryshme mbeten vështirësitë e kapërcimit të shqiptimeve të ndryshme të fjalëve nëpër gjuhë dhe mikroambiente gjuhësore të ndryshme.

Këso problemesh, në masë shumë të vogël, shihen edhe në realitetin tonë të gjuhës shqipe, prandaj në rrugën e formimit të shprehive drejtshkrimore duhet të kombinohen perceptimet dëgjimore me ato pamore, por aq sa duhet, pa anashkaluar parimin fonetik, për të mos arrirë pas shumë shekujsh në situatë të gjuhës angleze, frënge ose të ndonjë gjuhe tjetër, në të cilat zbatohet parimi tradicional në masë shumë të madhe.

Kështu Prof. Mahir Domi, për probleme të këtilla gjuhësore, është shprehur në mënyrë decide në Kongresin e Drejtshkrimit¹⁹ në vitin 1972: “*Kur një gjuhë gjatë zhvillimit historik ka pësuar ndryshime*

¹⁹ Prof. Mahir Domi, në “*Parimi fonetik dhe zbatimi i tij në drejtshkrimin e shqipes*”, në *KDGJSH*, prej 20- 25 nëntor, 1972, Tiranë, f. 111. Të një mendimi janë edhe pjesëmarrësit e tjerë, si:

të mëdha, sidomos në fonetikë, po drejtshkrimin të saj s'i janë bërë nga koha në kohë rivlerësime për ta afruar, aq sa është e mundur, me sistemin fonetik të gjallë, krijohet një hon (zbrazëti e vërtetë) midis aspekteve të shkruar dhe të folur të gjuhës letrare, duke e bërë shumë të vështirë përvetësimin e rregullave drejtshkrimore..." Mu për këtë, Profesor Mahir Domi, po edhe pjesëmarrësit e tjerë²⁰ të Kongresit të Drejtshkrimin në vitin 1972 u pajtuan që Parimi themelor i rregullave të drejtshkrimin të shqipes të jetë PARIMI FONETIK... Kështu thuhet edhe në Rezolutën e Kongresit të Gjuhës Shqipe (RKDGJSH) me të cilën vendoset një lidhje e ngushtë midis formës së shkruar dhe asaj të folur të gjuhës letrare. Ky është një konstatim themelor që përmendet, thuajse edhe në të gjitha kumtesat dhe diskutimet e të gjithë delegatëve në të dy sektionet e punimeve²¹ të këtij Kongresi, po edhe në të gjitha Fonetikat e shqipes standarde.

Kohëve të fundit sikur harrohen këto qëndrime duke i dhënë përparësi zbatimit të PARIMIT MORFOLOGJIK të drejtshkrimin të shqipes, që do të thotë se fjala shqipe nuk duhet të pësojë ndryshime shumë në eptim (në lakim, zgjedhim, po edhe në formë të fjalëve të prejardhura, të përbëra dhe të përngjitura). Me këtë qëndrim anashkalohen perceptimet dëgjimore sepse ato vazhdimisht ndryshojnë, me se ndodh një errësim ndërnyjet dëgjimores dhe asaj pamore. Në këso rastesh vjen në ndihmë PARIMI TRADICIONAL, i cili mundëson një *"shkrim të fjalës ashtu si nuk shqiptohet, ose lexim të saj ashtu si nuk është shkruar"*.

Prof. Eqrem Çabej, "Mbi disa çështje të traditës së shkrimin dhe të drejtshkrimin të shqipes"; Fatmir Agalliu, "Rreth disa çështjeve të zbatimit morfologjik në drejtshkrimin e shqipes"; Doc. Anastas Dodi, "Drejtshkrimin dhe drejtshqiptimi letrar"; Prof. Bahri Beci, "Rreth parimit tradicional-historik në drejtshkrimin e shqipes"; Prof. Emil Lafe, "Drejtshkrimin dhe grafika e shqipes"; Prof. Jup Kast-rati, "Vijat e përgjithshme të zhvillimit historik të drejtshkrimin të shqipes(deri në çlirim)"; Prof. Koleç Topalli, "Mbi gërshetimin e parimit fonetik me parimin morfologjik në disa rregulla të drejtshkrimin të shqipes"; Menella Totoni, "Shkrimin i "ë"-së paratheksore" etj.

Nëse vazhdohet kështu, atëherë pas një periudhe shumë të gjatë mosintervenimi në drejtshkrim, për ta afruar, sado pak, shqiptimin me shkrimin, shqipja do ta ketë një fat si të anglishtes ose të frëngjishtes. Kjo gjuhë standarde shqipe do të bëhej gjuhë e letrës, (si do të thoshte prof. Çabej në kohë të zhvillimit të punëve të Kongresit në vitin 1972), sa e rëndë për shqiptarët, edhe më e rëndë për të huajt. Në këso kushtesh fëmijët tanë që do të ndiqnin atëherë arsimin shqip, do të kishin nevojë për mjete mësimi të ngjashme me një fletore si kjo e francezëve “*Le cahie de poesie*”. Vaj halli për ta, në vend që të mësojnë atë që do ta kërkojë koha, do të mundohen me kopjim dhe diktim tekstesh, për të cilat tani për tani, nuk kanë nevojë, falë këtij niveli të zhvillimit të standardit të gjuhës sonë. Por një ditë, kur do të heqim dorë nga ai përcaktim i delegatëve të Kongresit të Drejtshkrimit, për t’i dhënë përparësi parimit morfologjik, do të ketë nevojë për zbatim edhe të parimit tradicional, po edhe për një fletore të tipit “*Le cahie de poesie*”.

AVZI MUSTAFA

Fakulteti i Filologjisë “Blazhe Koneski” – Shkup

KONTRIBUTI I REMZI NESIMIT NË HARTIMIN E TEKSTEVE SHKOLLORE

Ma merr mendja se nuk do ta teproj nëse them se ne ende nuk e kemi shkruar si duhet historinë e arsimit kombëtar, ngase aty na mungojnë njerëz të caktuar me dije e kulturë të lartë, që kanë krijuar dhe kanë lënë gjurmë, pa të cilat nuk do të mund të shkohet më tej.

Meqë kam pasur fatin të merrem me figura të ndritura të arsimit kombëtar, në këtë trajtesë do të them disa mendime për njeriun që i përket elitës së intelektualëve të Maqedonisë dhe që na bën nder të veçantë të gjithëve. Prof. dr. Remzi Nesimi, jo vetëm si njeri i ditur në arsimin universitar, ku dha ndihmesën e madhe në krijimin e kuadrove, por edhe në shumë sfera të jetës tonë arsimore, shkencore e kulturore, me punën e tij vetëmohuese, pra falë meritave që rrallë mund të gjenden te një humanist i vërtetë, radhitet ndër emrat më të shquar të kombit. Unë nuk nguroj të them se shumëkush e mban titullin e nderuar “profesor”, por i vogël është numri i atyre që meritojnë këtë titull ashtu siç e meriton prof. dr. Remzi Nesimi. Unë vërtet ndjehem i nderuar që, si koleg, pata fatin të jem pranë tij 20 vjet, por çdoherë para tij si një nxënës, nga i cili mësova shumë gjëra të bukura.

Prof. dr. Remzi Nesimi, me punën e tij si profesor universitar e shkencëtar, si mbrojtës i normave të gjuhës shqipe dhe si hartues tekstesh në momentet më të vështira, kur ato mungonin me arsye e pa arsye, me qëndrueshmëri dhe me maturi diti si t’i tejkalojë barrierat që vinin shpeshherë në dëm të gjuhës e të arsimit shqip. Prandaj, puna e tij mban vlera të qëndrueshme dhe të mirëfillta arsimore e shkencore.

Prof. dr. Remzi Nesimi është një figurë me diapazon të gjerë, ndërsa vlerat e tij qëndrojnë në shumë rrafshë, por kontributin më të madh e dha në rrafshin gjuhësor. Trashëgimia e gjertanishme e Profesorit në fushën e gjuhës është shumë e madhe. Me këtë vepërimitari Profesori kishte pikësynimin kryesor, realizimin e idealeve të rilindësve tanë, që luftuan pareshtur për lëvrimin dhe përhapjen e gjuhës shqipe, si dhe për përdorimin e drejtë të saj sipas rregullave të standardizimit²². Ai pati gjithnjë me vete një bagazh të madh të njohurive të nevojshme për t'u marrë me përpilimin e teksteve shkollore, sepse ai dinte me maturi t'i shprehë cilësitë pozitive sikur të ishte vetë nxënës i shkollave fillore, të mesme ose student universiteti.

Parim kryesor i profesorit të nderuar ishte formimi dhe zotërimi i kulturës të të folurit dhe i kulturës së shkrimit, që, sipas dr. Remzi Nesimit, duhej kultivuar nëpërmjet gjuhës së teksteve dhe të të folurit të arsimitarit. Për zotërimin më të mirë të gjuhës, Profesori shpesh na udhëzonte që çdoherë të mbështetemi në parimin e shkallëshmërisë (gradualitetit), duke thënë se “*gjuha letrare duhet të shoqërohet duke formuar dhe rrënjosur një qëndrim të ndërgjegjshëm si të nxënësit, ashtu edhe tek arsimitarët*”.²³

Tekstet e prof. dr. Remzi Nesimit mund t'i grupojmë në tri grupe: 1) tekste dedikuar shkollës fillore, të mesme dhe tekste mësimore të gjuhës shqipe për të huajt; 2) tekste të leximit letrar dhe 3) tekste të përkthyer nga gjuha maqedonase nga shkencat natyrore. Këtë punë profesorit ia impononin shtëpitë botuese, sidomos redaktorët përgjegjës, sepse të ky profesor kishin besimin e madh të gjithë, sepse tekstet e tij do të kishin një gjuhë të pastër me terminologji shqipe dhe me gjuhë të normuar. Profesori Remzi këtë punë e bënte me shumë kujdes, sepse ai ishte i bindur se shprehitë e të folurit dhe të

²² Prof. dr. Remzi Nesimi ishte përfaqësues nga Maqedonia si anëtar i komitetit organizativ të Kongresit të Drejtshkrimit, të mbajtur më 20-25 nëntor 1972.

²³ Shënim imi.

shkruarit, në përshtatje me normat e gjuhës letrare kombëtare, rrënjosen gjatë periudhës së arsimit fillor.

Prof. dr. Remzi Nesimi këtë punë (hartimin e teksteve shkollore për nxënësit e shkollave shqipe në R. e Maqedonisë) e ka filluar që nga viti 1976, kur për herë të parë e botoi tekstin shkollor “*Gramatika e gjuhës shqipe për klasën IV*” me shtëpinë botuese “Prosvetno dello” në Shkup, me bashkautorë prof. Xhevat Gegën dhe prof. Hamza Rekën²⁴. Që nga viti 1985, në bazë të shpalljes së konkursit, si dorëshkrim më i mirë do të përzgjidhet teksti “*Gramatika e gjuhës shqipe për shkollat fillore kl. IV*” i prof. Remzi Nesimit dhe ky tekst do të përdoret deri më 1999. Më vitin 1978 do ta botojë “*Gramatikën e gjuhës shqipe për klasën V të shkollave fillore*”, e cila po ashtu do të përjetojë 12 ribotime²⁵. Më 1978 e botoi “*Gramatikën e gjuhës shqipe për klasën VI*”. Më 1980, në koautorësi me prof. Hamza Rekën, botoi “*Gramatikën për klasën VI*”, më 1982 e botoi “*Gramatikën e gjuhës shqipe për klasën VIII*”, që do të ribotohet deri më vitin 1999 dhe pastaj e botoi edhe “*Gramatikën e gjuhës shqipe – sintaksa për klasën VIII*”.

Ai, gjatë gjithë kohës, hap pas hapi, i ndoqi problemet e arsimit në R. e Maqedonisë. Gjuha shqipe, si specifike e arsimit të shqiptarëve të kësaj republike, mësohej si lëndë mësimore e veçantë, por edhe si mjet didaktik i arsimit të mëtejshëm në të gjitha lëndët e tjera, dhe sidomos gjatë shkollimit të mesëm. Në këtë hallkë të arsimit, ku ngjizet ndjenja e logjika e gjuhës sonë amtare, ai nuk ngurroi të marrë përsipër të hartojë edhe tekste të gramatikave për shkollat e mesme. Kështu prof. dr. Remzi Nesimi në vitin 1992 hartoi tekstin “*Gramatika e gjuhës shqipe për shkollat e mesme (fonetika, morfologjia dhe leksikologjia)*” – botues “Prosvetno dello”. Ky tekst përjetoj 5 ribotime dhe u përdor si tekst bazë deri në vitin 2000.

²⁴ Ky tekst me bashkautorin Hamza Reken do të përdoret deri më 1978.

²⁵ Shih: Florije Shahini, Ремзи Несими и албанската лингвистика (Remzi Nesimi dhe gjuhësia shqiptare), temë magjistrature, mbrojtur në Fakultetin e Filologjisë në Shkup në vitin 2012, f. 73.

Ndërkaq, në vitin 2001, në koautorësi me prof. Valbona Toskën, e botoi “*Gramatikën e gjuhës shqipe për shkollat e mesme II (sintaksa)*”, më 2002 e botoi tekstin “*Gjuhë shqipe dhe letërsi për vitin e parë*” dhe më 2004 tekstin “*Gjuha shqipe dhe letërsia për vitin e dytë të gjimnazit të reformuar*”.

Për nevojat e të huajve për mësimin e gjuhës dhe kulturës shqiptare ai në koautorësi me Justina Shushkën në vitin 1987 (në Prishtinë) dhe më pas, në vitin 1989 (në Shkup), e botoi “*Librin e gjuhës shqipe*” (Учебник по албански јазик). Ndërkaq, më 1992 ishte redaktor përgjegjës i librit „*Учиме македонски јазик*“²⁶.

Ndihmesë të rëndësishme prof. Remziu ka dhënë edhe në hartimin e teksteve të letërsisë për shkollat fillore të ciklit të lartë për klasat V, VI, VII dhe VIII të shkollave fillore, kurse në vitin 2002 e botoi librin “*Gjuha shqipe dhe letërsia për vitin e parë të shkollave të mesme*”.

Edhe pse profesori Remzi tërë potencialin shkencor e kishte drejtuar në studimin e gjuhës dhe në përgatitjen e teksteve të gjuhës dhe të letërsisë, atë shpesh e ngarkonin edhe me detyrën e përkthyesit të teksteve nga gjuha maqedonase, sidomos të teksteve të shkencave natyrore, por edhe të teksteve të tjera të fushave të ndryshme.

Prej vitit 1982 deri në vitin 1999, tekste të përkthyer nga prof. Remziu janë: “*Dituri natyre dhe shoqërie për kl. II*”, “*Biologjia për kl. VII*”. Këto tekste do të përjetojnë 10, respektivisht 12 ribotime.

Puna me hartimin e teksteve, si dhe përkthimet e ndryshme, shpeshherë për prof. Remziun ishin një angazhim që s’mund t’i ikte, në mënyrë që ashtu t’u dalë në ndihmë nxënësve dhe arsimtarëve. Ky ishte edhe fat si për nxënësit, ashtu edhe për arsimtarët, sepse ai i njihnte problemet e përvetësimit të gjuhës në themel dhe e mbante mendimi se shkolla, ashtu siç funksiononte në mjediset

²⁶ Florije Shahini po aty. F. 74

tona, nuk ishte në gjendje t'i përvetësojë vlerat gjuhësore, sidomos pas vitit 1972, sepse vërehej mungesa e zotërimit të kuptimeve leksikore e figurative të fjalës. Pra, krejt kjo punë e prof. Remziut, për hartimin e teksteve, bëhet në një kohë të vështirë, në kohën kur mungonin standardet në lëndën e gjuhës dhe të leximit letrar.

Prof. dr. Remzi Nesimi, si njohës i mirë i gjuhës, i tejkalonte kufijtë e asaj me të cilën gjuha amtare shikohej vetëm “si gjuhë letrare”²⁷ dhe në aspektin didaktik nga ana e mësuesve kërkohet që mësimi të fillojë e të mbarojë me analizën gramatikore, duke harruar që te nxënësit të nxitej mësimi dhe biseda për gjuhën e përditshme e jo për “atë gjuhë që u duhet për të marrë dhe për të dhënë informacion, atë gjuhë për të mësuar profesionin e ardhshëm”.²⁸

Synimi kryesor në të gjitha tekstet e hartuar nga ai ishte pasurimi i të folurit të nxënësve në shkollat fillore e të mesme, gjithnjë duke u mbështetur në përvojën e nxënësve, në pasurimin e fjalorit, në aftësimin e nxënësve për ndërtimin e drejtë të fjalëve dhe frazave, si dhe për përvetësimin e drejtshkrimit dhe drejtshqiptimit të njësuar.

Tekstet e hartuara nga profesor Remziu janë hartuar mbi bazën e kriterëve të caktuara shkencore, didaktike dhe pedagogjike. Në përcaktimin e shembujve çdoherë janë marrë në konsideratë pjesë të lidhura nga autorë të shquar të letërsisë shqiptare, nga publicistika e nga folklori. Kjo nuk ishte edhe pa qëllim, sepse te nxënësit, nëpërmjet shembujve, ngjallej dashuria ndaj gjuhës amtare. Për ta rritur nivelin teorik e shkencor në përzgjedhjen e përmbajtjeve të teksteve, për bazë është marrë përshtatja e përmbajtjeve me moshën e nxënësve. Kujdes të posaçëm i kushtonte përvetësimit të njohurive teorike në raport të drejtë me praktikën, por duke dhënë detyra me përparësi të karakterit zbatues të njohurive teorike. Kjo shihet edhe në faktin se, në përgatitjen e aparaturës metodike–

²⁷ Mimoza Gjokutaj, *Gjuha dhe ligjërimi në shkollë, studime shqiptare* 10, Shkodër, 1998, 127

²⁸ Po, aty, f. 128

pedagogjike, janë dhënë tekste me larmi ushtrimesh e detyrash me shumë sqarime për çështjet e veçanta teorike e drejtshkrimore.

I bindur në metodologjinë e mësimdhënies në shkollat tona, prof. Remziu punën e tekstit e shikonte vetëm si mjet për realizimin e mësimit, e jo si identifikim me procesin mësimor. Shpeshherë në biseda, Profesori nuk nguronte të thotë një të vërtetë se “*një tekst i mirë zgjedh shumë pyetje mësimore, mirëpo kur ai merr vetëm rolin e sigurisë, që arsimtarit t’ia tregojë rrugën e vërtetë*”.²⁹ Prandaj, në tekstet e profesorit Remzi kemi detyra kreative, që kanë për qëllim zhvillimin e të menduarit logjik, duke i udhëzuar kështu nxënësit në informacione të nevojshme. Marrë në përgjithësi, tekstet e hartuara nga ai në thelb përmbajnë dy koncepte: materiali i ri që ai e vendos në gramatikat e tij përmban një rend të tillë, që të gjithë lëmenjtë gjuhësore të jenë lidhur në bazë të parimit të funksionalitetit, duke pasur parasysh se lënda e gjuhës shqipe është mjaft e gjerë dhe e larmishme – aty përfsihen njohuri të disiplinave të ndryshme gjuhësore (fonetika, sintaksa, leksikologjia) dhe, i dyti, është parimi i sistematizimit, që nënkupton se për çdo njësi tematike ka tekst për ushtrime dhe detyra, si në drejtshkrim, ashtu edhe në drejtshqiptim. Tekstet janë të shkurtra dhe të zgjedhura enkas për ato dukuri gjuhësore që janë të nevojshme për t’u përvetësuar nga ana e nxënësve. Nëse ato shikohen nga aspekti i stilit dhe i gjuhës, janë korrekte, ndërsa sipas përmbajtjes janë interesante për moshën e tyre.

Aparatura metodike në tekste është e mbarështuar në atë mënyrë që nxënësit të jenë të koncentruar, të vëmendshëm, sepse në to ai ngërthen shumë pyetje, që për nxënësit janë interesante dhe nuk e largojnë atë nga qëllimi kryesor. Në përvetësimin e diturive gjuhësore ai udhëhiqet nga rregulla *nga e lehta tek e rënda*, por gjithëherë duke pasur parasysh paranjohuritë e nxënësve. Në të gjitha tekstet gjuhësore të hartuara prej tij dominon karakteri funksional në mësim, ashtu siç shprehet edhe pedagogu Maks Resner se:

²⁹ Shënim i im.

“Ç’është e lehtë e ç’është e rëndë për të nuk vendos shkolla, por personaliteti i nxënësit, natyra e tij”.³⁰

Në hartimin e teksteve prof. dr. Remzi Nesimi çdoherë merr për bazë karakteristikat psikologjike–didaktike për mësim aktiv, por kërkesa kryesore është respektimi i rregullave gjuhësore gjatë parashtrimit të pyetjeve, sepse çdo pyetje ka formulim të drejtë që duhet të kultivohet edhe tek arsimtarët pa përvojë, por edhe te nxënësit. Kështu, pyetjet e teksteve të tij në aparaturën didaktike për çdo tematikë janë të qarta dhe të kuptueshme. Te tekstet e Remzi Nesimit nuk hasim pyetje të pakuptueshme ose të papërcaktuara dhe me shumë kuptime, që ashtu të hutohet nxënësi.

Duke marrë në konsideratë edhe përvojën e gjatë në arsim, si dhe përvojën e tij në hartimin e teksteve shkollore të gjuhës në të gjitha nivelet e shkollimit, por edhe përdorimin e gjuhës në mjediset tona, nga këto tekste mund të nxjerrim edhe qëllimin didaktik se ç’veçori psikike–pedagogjike duhet të zhvillohet te nxënësit, cili lloj i ushtrimeve do të përdoret për zhvillimin e kujtesës e vëmendjes, duke kaluar nëpërmjet krahasimit, deduksionit, analizës dhe sintezës. Ai, gjithashtu, ka mbajtur llogari edhe për nivelin kulturor të nxënësve nga klasa në klasë, gjë që shihet në tekstet e hartuara, ku synohet zhvillimi i të menduarit aktiv e logjik dhe rritja e aftësisë përgjithësuese dhe sintetizuese, që kështu ata të mund të jenë në gjendje ta shohin e ta kuptojnë sa më mirë anën funksionale të fjalisë si njësi kuptimore dhe gramatikore.³¹

Për fund, dua të theksoj se prof. dr. Remzi Nesimi me sjelljen, diturinë dhe karakterin e tij, qoftë si pedagog universitar ose hartues i teksteve shkollore, ka kontribuar njaft në formimin e përgjithshëm gjuhësor ndër shqiptarët e Maqedonisë e më gjerë, sepse, ai e verifikon veten si njohës i madh i problemeve gjuhësore dhe si novator në procesin edukativo–mësimor.

³⁰ Maks Resher, *Nastavana teknika*, Beograd, 1962, f.47.

³¹ Remzi Nesimi & Valbona Toska, *Gramatika e gjuhës shqipe për shkollat e mesme II (Sintaksa)*, Shkup, 2001.

ZEQIRJA NEZIRI

Fakulteti i Filologjisë “Blazhe Koneski” – Shkup

IZAIM MURTEZANI

Instituti i Folklorit – Shkup

NDIHMESA E REMZI NESIMIT NË MBLEDHJEN E LETËRSISË GOJORE

1. Kah struktura përmbajtësore e përrallave të publikuara

“Të gjitha llojet e krijimtarisë gojore, përveç rëndësisë si material folklorik me brendi e formë të caktuar, do të shërbejnë në një masë të madhe edhe për studime linguistike e etnografike” (Nesimi 1984: 98). Nga këto fjalë të prof. dr. Remzi Nesimit, të thëna në një numër të revistës *“Jehona”*, në një shkrim të para 35 vjetëve po e nisim dhe trajtesën tonë shkencore. Nisur nga këto pikëpamje, në shkencën e albanologjisë është dëshmuar me kohë se në mbledhjen e letërsisë gojore një ndihmesë të çmueshme dhe shumë të rëndësishme për disa lloje të saj kanë dhënë edhe gjuhëtarët. Sa për ilustrim po përmendim disa emra të shekujve të kaluar. Ogyst Dosoni në librin e tij të gjuhës shqipe ka botuar disa lloje të lirikës. Para tij, dijetari e gjuhëtari arbëresh Dhimitër Kamarda, themelues i gjuhësisë krahasuese ndër shqiptarë, pat botuar baladën *“Olimpia dhe Vlastari”*. Kështu do të veprojë edhe dijetari gjerman Gustav Majer, autori i fjalorit të parë etimologjik të gjuhës shqipe, i cili do të botojë një fragment të Eposit Heroik Shqiptar (1896). Në këtë kontekst edhe Gaspër Jakova Merkuri në gramatikën e tij të gjuhës shqipe (1906) do të botojë një këngë të Eposit Heroik Shqiptar. Dy autorët e fundit hodhën gurthemelin e ekzistimit midis shqiptarëve të njërit prej ngrehinave poetike që në historinë e tyre të jetës së krijimtarisë gojore kanë arritur ta kenë popuj të rrallë, që në gjirin e

tyre kishin krijues të aftë që ngritën në këngë bëmat e bijëve të bashkësive të tyre etnike.

Prof. dr. Remzi Nesimi, si aneks të librit të tij monografik mbi të folmen e Dervenit (2008) ka botuar dhe 17 tekste (në prozë e poezi) dhe disa fjalë të urta e gjëgjëza të kësaj krahine, të cilët i ka shfrytëzuar për ta ngritur studimin e tij. Objekt studimi i kumtesës sonë janë këto 17 tekste, të cilat sipas llojit i përkasin prozës gojore, ndërsa 11 të tjerat bëjnë pjesë në llojet e lirikës. Në vazhdim shpalosim brendinë e teksteve që i referohen prozës popullore, të eksploruar në krahinë e Dervenit.

1. **“Di vllaznit”** (448–449) – përrallë mitike (Çajlanë: Havzi Ramadani): Dy vëllezër zihen mes tyre se kush e nxjerr njeriun në dritë: e drejta apo e shtrembëta. Pasi pyesin tre vetë, marrin përgjigjen se e shtrembëta. Ky, pasi ia nxorri sytë vëllait, e la në një mal. Natën dëgjoi kuvendin e lugetëve se ç’punë kishin bërë. Me ujin e tyre ky shëroi sytë dhe të bijën e mbretit. Vëllai që ia nxorri sytë kërkoi që dhe ai të bëjë të njëjtën gjë, por lugetërit e mbytën.

2. **“Ni nonë e ni gjal”** (449–450) – përrallë realiste (Rashçe: Ilaz Haxhiu): Flitet për një djalë që kur nisët për ushtri e ëma e porositë t’i sjellë thërrime buke. Kur kthehet është i mërziur se nuk e ka përmbushur amanetin, sepse në luftë i kishte ngrënë të gjitha thërrimet. Nëna i shpjegon qëllimin. Atëherë përqafohen të lumtur.

3. **“Ni bur e ni grue”** (450–451) – përrallë realiste (Rashçe: Mitat Kovaçi): flitet për një rrogat që nxit beun ta mbysë gruan e tij.

4. **“Dhonri”** (451–452) – përrallë realiste (Raoviq: Hafet Beqiri): Flitet për një dhëndër të ri, i cili porositet nga e shoqja të mos hajë shumë dhe, kur kjo ta prekë atë, ta lë bukën. Natën kërkon të hajë groshë dhe i mbesin duart në vorbë dhe kur shkon te përroi ta thejë vorbën i bije gjyshes që lante petka.

5. **“Tre vllazën”** (452–453) – përrallë realiste (Rashçe: Neshat Kovaçi): babai kishte tre djem dhe në prag të vdekjes i pyeti çfarë duan. Dy vëllezërit e mëdhenj kërkojnë para, ndërsa i vogli

këshillën e tij. Mbreti shpërndan lajmin se, kush do ta shohë gishtin e vajzës, të sjellë një sasi të hollash. Dy vëllezërit e mëdhenj e lënë pasurinë dhe i lavdërohen të voglit. Ky del nga shtëpia, takon një plak, i cili e mëson si të veprojë. Blejnë nga një çjap dhe para shtëpisë së mbretit e shalojnë mbrapshtë. Në mbrëmje kërkojnë të strehohen. Natën në dhomë hyn e bija e mbretit dhe kërkon djalin për një orë që ta mësojë si duhet të veprojë. Kur plaku e kërkon, i thotë që e do për gjithë jetën.

6. **“Magjari u bo kadi”** (454) – anekdotë (Raoviq: Semir Beqiri): Flitet për një fshatar që zbret në treg në Tetovë dhe kur kthehet në han nuk e gjenë gomarin. Mendon se është në shtëpi. Kur pa se nuk është as atje, mbushi një torbë me tagji dhe shkoi te kadija, ku e rrahin rojet. Ai u thotë se është gomari i tij që i ka humbur para disa ditëve, por ky qenka bërë kadi.

Nga përmbajtja e këtyre krijimeve që i referohen prozës popullore të trevës së Dervenit të Poshtëm mund të hetohet, veçmas në përrallën e parë të karakterit mitik, apo fantastik, prania e qenieve mitike, në rastin konkret – lugetërve. Dihet se *“përralla si lloj letrar i paraprin zhvillimit të prozës e të letërsisë së shkruar. Fakti se ajo është rrëfim që materializohet nëpërmjet gjuhës dëshmon se nëpërmjet rrëfimit e formëson realitetin artistik si model, si projektion, si fikcion. Përralla përshkruan një botë të pakufishme, ku personazhet veprojnë në kohë e në hapësirë të papërcaktuara; kalojnë pengesa të tilla që në realitet në asnjë mënyrë nuk mund të realizohen. Kjo dëshmon se realiteti i përrallës i kundërvihet realitetit jetësor. Ky realitet manifestohet si kërkesë për veprim të pakufishëm, ku mund të realizohet çdo dëshirë. Fiksioni dhe realiteti në përralla janë në raport kauzal dhe kushtëzues”* (Neziri, 2018: 267). Megjithatë, përralla e karakterit realist, apo novelist, për dallim nga ajo mitik, apo fantast, më shumë e ngushton elementin fikcional, apo elementin e të jashtëzakonshmes duke pretenduar ta paraqesë veprimin brenda kufijve të mundësisë e më pak të gjasës. Pra, në përmbajtjen e përrallave të kësaj natyre, të regjistruara dhe

të publikuara nga prof. Dr. Remzi Nesimi, mund të vërehen tema të ndryshme në të cilat shtjellohen probleme nga jeta e përditshme. Përrallat e tilla veçohen me mënyrën origjinale të pasqyrimit të subjektit, pastaj me dramaticitetin e paraqitjes së problemit, zgjidhjen interesante dhe të papritur të konfliktit e kështu me radhë. Në përrallat novelistike vërehet haptazi qëllimi moralizues, si një element tejet i preferuar në kuadër të bashkësive tradicionale. Në të vërtetë, nëpërmjet përmbajtjes së tyre atakohen dukuritë negative, madje edhe materializmi i tepruar, apo posedimi i pasurisë në vend të dijes. Në këtë kontekst, në përrallën e fundit me titull *Tre vllazën* jepet porosia, apo mesazhi se vetëm ai që gjakon pas dijes është i denjë t'i realizojë synimet e tij.

Në kuadër të prozës popullore, prof. dr. Remzi Nesimi ka publikuar edhe një anekdotë e cila atakon pushtetin osman, përkatësisht bartësit e tij, siç ishin, mes tjerash, edhe kadinjtë. Në të vërtetë, anekdotat janë përdorur me shkathtësi nga populli për t'i fshikulluar individët të cilët janë bartës të dukurive të pahijshme brenda shoqërisë. Misioni i anekdotës është që nëpërmjet mjeteve artistike, të godasë, apo të fshikullojë, dukuritë që janë pengesë serioze për zhvillimin normal të një shoqërie të caktuar. Në anekdotën me titull *Magjari u bo kadi* pasqyrohet nëpërmjet mjeteve artistike dukuria e ryshfetit që ndërlikojë me kadinjtë e korruptuar. Si rrjedhojë, fshatari pretendon se gomari i tij ishte shundërruar në kadi.

Në vija të përgjithshme, në përmbajtjet e prozës popullore reflektohet mendësia popullore ndaj dukurive të ndryshme jetësore, përkatësisht mpërhtësia dhe shkathtësia e gjykimit në raste dhe kondita të caktuara. Njëkohësisht mund të vërehet mënyra e dialogimit, por edhe leksiku tejet i pasur, madje me plot frazeologjizma të nduarduarshëm. Vlera e këtyre teksteve popullore, të eksploruar në trevën e apostrofuar qëndron në faktin se ato shërbejnë si një dokument i gjallë i një kohe të caktuar, veçmas kur dihet fakti se në kohën e sotme, krijimet e kësaj natyre nuk gjejnë zbatim praktik, madje edhe e folmja e krahinës në fjalë, por edhe e akëcilës krahinë

tjetër ndryshon me të madhe për shkak të ndikimit të gjuhës letrare, nënkuptohet nëpërmjet shkollimit, mjeteve të informimit, internetit e kështu me radhë. Një gjë të kësaj natyre kishte vërejtur shumë më herët edhe prof. dr. Remzi Nesimi i cili me të drejtë theksonte: *“me ndryshimet e kushteve jetësore, me transformimin e fshatit tonë, përkatësisht me përhapjen e arsimimit, me depërtimin e librit, të shtypit, të radjos e të televizionit, shumë vlera të krijimtarisë gojore kanë filluar të lihen pasdore, të zbehen e madje edhe të harrohen e të zhduken. Në ndeje e takime jo vetëm të rinjtë, por edhe më të moshuarit më nuk zbaviten me gjëgjëza për të provuar zgjuarsinë e mendjemprehtësinë e njëri tjetrit dhe nuk rrëfejnë përralla të gjata si dikur. Madje jemi edhe dëshmitarë edhe të ndryshimit të brendisë së këngëve të ndryshme lirike”* (Nesimi, 1984: 98–99).

Nga kjo që u tha rezulton se materiali folklorik përjeton transformime të përhershme. Mbledhja në një kohë të përshtatshme ndihmon shumë shpëtimin e tij dhe në studimet me karakter teorik nga ana e folkloristikës. Studimet e tilla do të bazoheshim mbi materialet e mbledhura më parë, pasi folkloristika është një disiplinë kryesisht e karakterit empirik. Si e tillë, ajo operon me materialin e mbledhur në terren të cilin e analizon, klasifikon dhe e krahason, nënkuptohet në përputhje me metodat dhe teoritë të cilat janë pjesë e saj përbërëse.

2. Kah veçoritë përmbajtësore të këngëve të publikuara

Prof. dr. Remzi Nesimi, ka publikuar në të njëjtin libër të tij më të rëndësishëm *“E folnja e Dervenit”*, edhe tekste që kanë të bëjnë me lirikën popullore të kësaj treve. Në të vërtetë, në trajtë të materialit ilustrativ janë publikuar 11 këngë të natyrës lirike. Shumica e këngëve, apo gjashtë prej tyre, janë shënuar në Dervenin e Poshtëm, përkatësisht në fshatin Raçe. Dy këngë lirike janë shënuar në fshatin Sullare e Poshtme, një në fshatin Bojanë, një në fshatin Llaskarcë dhe një në fshatin Çiflik që graviton në pjesën

tjetër të Dervenit, apo më konkretisht në Dervenin e Epërm që aktualisht i përket komunës së Zhelinës.

Të gjitha këngët posedojnë edhe emrat e bartësve të tyre, nënkuptohet të gjinisë femërore, pasi edhe këngët e mbledhura këndohen po ashtu nga gjinia femërore, si bartëse e një tradite më konservative dhe më autentike, veçmas kur dihet fakti se në të kaluarën gjinia femërore ka qenë e ndërlidhur kryekëput me njëdisin shtëpiak duke ruajtur në këtë mënyrë të pacënuara vlerat kulturore me taban tradicional, sidomos nga ndikimet e jashtme.

Përmbajtja e këngëve lirike, të regjistruara në fshatrat e apostrofuara, në shumicën e rasteve, u dedikohet të rinjve, apo rishtarëve që janë në pragun e fejesës, apo martesës. Këngët e tilla, në krahinën e Dervenit të Shkupit, janë shoqëruar si zakonisht me defa, kurse këtë e ilustron më mirë edhe një këngë me vargje të kësaj natyre, e regjistruar, nënkuptohet nga prof. dr. Remzi Nesimi. P. sh.: *Bijn di dahire, bumbulloj toka, / kujton dajxha i vet se jon topa. / Nuk m'i jon topat e Junonit. / Jon dahiret e Agim sulltonit. / Nuk m'i jon topat e Hinglizit-oj / M'i jon dahiret e Agim filizit-oj* (Nesimi, 2008: 455). Vargjet e këngëve tjera lirike afirmojnë procesin e aderimit të dy të rinjve të gjinive të kundërta në një fazë të re jetësore, në atë të pubertetit, përkatësisht në atë të martesës, me ç'rast ndryshon edhe statusi i tyre shoqëror. Nënkuptohet se rruga drejt ndryshimit të statusit shoqëror të dy të rinjve është e gjatë dhe kalon nëpër disa faza. Një ndër fazat e para drejt përfitimit të statusit të burrërisë, apo nusërisë, ka qenë shpallja publike e aktit të lidhjes së marrëdhënieve midis dy të rinjve. Kjo gjendje reflektohet nëpërmjet këngës si vijon: *Po na bije shajj, po na bije vdor, / na ka ardh ni mizhde, na ka ardh ni dor, / na ka ardh kollaj si me kput ni moll, / si me kput ni moll, moll pi remi-oj / Na ndajti në bes, nauk na rreni-oj* (Nesimi 2008: 458). Pra, siç mund të vërehet nga vargjet e kësaj kënge pasqyrohet krenaria e familjes së djalit e cila ka arritur në mënyrë fare të lehtë të synimi i tyre përfundimtar, përkatësisht-zënia e nuses.

Paraprakisht rishtarët, sidomos të gjinisë femërore duhej të përve-
tësonin një varg të shkathtësive të ndryshme, veçmas artizanatin e
punëdorës, si p. sh.: *Xhit punon, Sadete molla, n'od me çilima, / i
çepi ojat e bardha kit si trandafila. / Kit si trandafila, oja me tre kat.
/ Çepi, oj Sadete molla, mo të jese merak* (Nesimi 2008: 457). Pra,
përgatitja e pajës, përkatësisht shkathtësia për të depërtuar në “labi-
rinthet” e qepjes me gjilpërë, në të kaluarën, ka qenë një sprovë e
rëndësishme e inciacionit, apo rishtarisë së pubertetit, sidomos për
gjininë femërore. Ato nëpërmjet përvetësimit të kësaj shkathtësie,
hapnin portat e përfshirjes së tyre në një fazë të re të pjekurisë
intelektuale, nënkuptohet në funksion të martesës së tyre. Ky
aktivitet i punëdorës praktikohet një kohë tejet të gjatë, madje deri
në ditët e dasmës.

Edhe vargjet tjera të këngëve lirike që i ka regjistruar prof. dr.
Remzi Nesimi po ashtu afirmojnë logjikën e rishtarisë së pubertetit
e cila shënohet, mes tjerash, edhe me simbolikën e ngjyrave të
veshmbathjeve të caktuara. P. sh.: *Ori nause lule, ori vetullzez, /
kuj do ja losh skutaçen e zez. / Skutaçen e zez me lot do ta laj, /
ori shoçe dosa, nauk ta loe tajj, / nuk ta loe tajj, oj delie-oj, / e
kam pas skutaçe beqarije-oj* (Nesimi 2008: 457). Siç mund të vëre-
het nga përmbajtja e këngës në fjalë, ngjyra e zezë e pëstjellakut i
referohet statusit të vajzërisë. Dihet se statusi shoqëror në fjalë, në
përgjithësi në të gjitha trevat shqiptare, nuk nënkuptonte ndonjë
dekorim të theksuar të veshjeve popullore, por ishte i thjeshtë dhe
pa ndonjë përdorim të caktuar të ngjyrave të ndryshme. Në
kundërshtim me këtë logjikë, statusi i nusërisë nënkuptonte një
dekoracion të skajshëm, veçmas të pëstjellakut ku dominonte
ngjyra e kuqe, e cila, veç tjerash kishte edhe efekte magjike në
funksion të mbrojtjes nga syri i lig, por njëkohësisht edhe në
funksion të nxitjes së pjellorisë të nuses së re, veçmas të lindjes së
fëmijëve të gjinisë mashkullore, si një gjini më e preferuar në
kontekst të mjedisëve në të cilat dominonte sistemi patriarkal.

Njëkohësisht, vargjet e këngëve lirike të kësaj treve posedojnë në
brendinë e tyre edhe figura të ngjeshura stilistike. P. sh.: *Xhit*

punon, Sadete molla, n'od me çilima, / i çepi ojat e bardha kit si trandafila (Nesimi 2008: 457). Prof. dr. Remzi Nesimi duke iu referuar vlerave estetike të këngëve lirike me të drejtë thekson se ato posedojnë vlera të larta artistike, apo: *“nëpërmjet përshkrimeve të bukura, të pasura me mjete e shprehje artistike a figura letrare, nga të cilat spikat sidomos krahasimi, epiteti, metafora etj., vihen në dukje virtytet e larta të vajzës së bukur e besnike si dhe të djalit trim. Këto figura për nga fuqia shprehëse shpesh qëndrojnë në një shkallë të lartë sikurse edhe krijimet e poetëve më të shquar”* (Nesimi 1984: 97).

Vlera e këngëve në fjalë, jo vetëm e atyre të regjistruara nga prof. dr. Nesimi, por edhe të tjerave, qëndron edhe në mënyrën e këngëtimit të tyre. Ato këndëhohen nga dy zëra, si këngëtim tipik i trevës së Dervenit të Poshtëm, por edhe më gjerë. Zëri i parë i prin këngës, kurse zëri i dytë e shoqëron të parin, por në trajtën e burdonit. Kjo mënyrë e të kënduarit posedon një estetikë të veçantë muzikore, pasi kombinimi i dy zërave jo vetëm që sforcon intensitetin e fuqisë tonike, por njëherit ndikon edhe në vijën melodike e cila merr një ritëm më të ngadalësuar, por njëherit edhe më të veçantë. Duke iu referuar kësaj vlere etnomuzikologjike, studiuesi Lorenc Antoni me të drejtë thekson se dyzërëshi paraqitet në dy variante. Mund të fillojnë njëkohësisht zëri i parë me të dytin ose zëri i dytë të hyjë pas të parit, por, çdo herë në vende të ndryshme – qoftë më herët, qoftë më vonë. Mbarimet, përkundrazi, jo vetëm në këtë trajtë, por edhe në të gjitha të tjerat dhe, si në këngët e burrave, ashtu edhe të grave, janë gjithmonë, pa përjashtim, në unison. Në këngët më të zhvilluara, borduni herë pas here zbret për një sekondë më poshtë dhe, zakonisht mbarimin e këngës e marrin të dy zërat në unison” (Antoni 1974: 118).

3. Kah veçoria e “zhanreve të shkurtra” të publikuara

Prof. dr. Remzi Nesimi ka regjistruar dhe publikuar edhe thesare tjera folklorike nga treva e Dervenit të Shkupit. Ai ka dhënë

kontributin e tij edhe në publikimin e materialit folklorik që ndërlihet me të ashtuquajturat “zhanre të shkurtra”. Në këtë kontekst, ka publikuar 90 fjalë të urta, por njëkohësisht edhe 12 gjëgjëza. Radhitja e tyre është bërë sipas kriterit alfabetik, përkatësisht sipas shkronjës me të cilën ka filluar fjala që i dedikohet tekstit integral të fjalës së urtë, apo gjëgjëzës. Tanimë është e njohur se nëpërmjet përmbajtjeve të fjalëve të urta përfaqësohen mendime apo grykime, përkatësisht përgjithësime të nxjerra nga vëzhgimi i jetës dhe përvoja historiko–shoqërore e popullit. Në të vërtetë, afirmohet filozofia popullore që ndërlihet me shumë fusha të përvojës njerëzore, si drejtësinë, apo padrejtësinë. P. sh.: *I drejti hek por xhen selamet; Udha e drejt t’çet n’selamet; I drejt si tërkuza n’thes; Rraj shtrembët e fol drejt*. Po ashtu afirmohet edhe logjika popullore dedikuar punës, si: *Mos ja çullo hunët, por çulloja punët; Mos paç pun, luje derën; Ni uj çu hecën – pajhet; Pa zahmet s’ka rahmet; Uki e ka çafën e trash se i sosën punët vet; Koka–koka bohet oka*. Njëkohësisht, përmbajtja e fjalëve të urta, në shënjestër të saj, ka edhe mendjelehtësinë. P. sh.: *I ka ment mbaj kusul; E mcon voja pulën; Kraijët gjok e menden zog; Kraijët n’tra, mendt n’hava; Osh fukara për mend; Budalla brina s’ka*.

Struktura përmbajtësore e fjalëve tjera të urta, të publikuara nga Remzi Nesimi ndërlihet edhe me vese tjera të njerëzve si zilia, injoranca, mosmirënjohja, etj. P. sh.: *Copa e huj duket ma e madhe; Çaukën theknin e huj; Gjoja ja bon, kraijet ja hek; Gjoja llap, kraijet skap; Hajde bab t’i kallxoj kufajit e arës; Ta ha bukën e ta përmbajs kupën*. Pra, “fjalët e urta paraqiten si mesazhe të brezave. Populli, në fjalët e urta, shtron e zgjidh probleme që i kanë dalë në jetë gjatë historisë. Një lidhje e tillë e fjalës së urtë me jetën, me problemet e kohës, me mjedisin dhe kushtet konkrete, me ndërjegjen dhe me psikologjinë reale të popullit dëshmon për sensin e theksuar realist të këtij lloji folklorik. Një nga prirjet e tyre kryesore është shprehja e mendimit në mënyrë figurative. Kjo i lejon fjalës së urtë jo vetëm të bëjë përgjithësime të gjera, por, në të njëjtën kohë, i jep dhe karakter polisemik” (Xhagolli 2001: 162).

Njëkohësisht, fjalët e urta kanë marrëdhënie të ngushta edhe me lloje të tjera të krijimtarisë popullore. Lidhjet e tyre janë evidente me fabulat, përrallat novelistike, përrallat humoristike, si dhe me anekdotat. Edhe përkundër lidhjeve të këtilla, megjithatë fjalët e urta kanë një strukturë të pavarur, apo autonome dhe mbeten një lloj i veçantë i krijimtarisë popullore.

Prof. dr. Remzi Nesimi ka publikuar, siç theksuam më sipër, edhe 12 gjëegjëza. Dihet se *“gjëegjëzat janë krijime të shkurtra folklorike në të cilat shtrohet një problem për t’u zgjidhur, apo kërkohet të gjendet një send ose dukuri e caktuar nëpërmjet dhënies së tipareve të ngjashme a të afërta të ndonjë sendi a dukurie tjetër”* (Xhagolli 2007: 204). Pra, enigmat ose përgjigjet janë për trupat qiellorë (dielli, hëna, yjet), njeriun dhe veprimtarinë e tij, për ushqimin, banesën e tij, për natyrën që e rrethon, për botën bimore e shtazore, për zgjidhje problemesh, si p. sh.: *Ni lug tlin kit dunjan e përlin (dielli); Okolla mur, mbrenda qehur (sita); Osh t ni pel e coft e zort i ka t’xhalla (shtëpia); Rrumbullak, rrumbullak, treçin quma i ka n’bark (shalqini); Vet goliç e xhith dunjon e veshën (gjilpëra)* etj.

Siç mund të vërehet, gjëegjëza ka dy fusha kuptimore: së pari, ajo që ekziston në epiqendër të gjëegjzës, përkatësisht në planin e parë të përshkrimit; dhe së dyti, kuptimi i fshehtë, apo metaforik që ndodhet jashta tekstit të gjëegjzës. Pra, gjëegjëza, në esencë paraqet një shprehje dygjymtyrëshe, pasi përmban pyetjen dhe përgjigjen. Për shkak të një përbërje të kësaj natyre, studiuesi i njohur, Andre Joles, e krahason gjëegjzën me mitin duke theksuar: *“miti paraqet përgjigje në të cilin është përshirë pyetja; gjëegjëza paraqet pyetje që kërkon përgjigje”* (Jolles 1978: 93). Duhet theksuar po ashtu se gjëegjëza fillimisht ka pasur karakter magjiko-ritual, por më vonë ka përfutuar përmasa të argëtimit, veçmas në kuadër të botës fëmijërore.

Të gjitha këto materiale folklorike paraqesin një kontribut të theksuar të prof. dr. Remzi Nesimit edhe në fushën e mbledhjes, deshifrimit dhe publikimit të krijimtarisë popullore. Publikimi i tyre

ka ndikuar që ato të shpëtohen nga “dhëmbi i kohës” i cili i atakon ato në mënyrë të pamëshirshme. Nënkuptohej se prof. dr. Remzi Nesimi ishte i vetëdijshëm për këtë dukuri, andaj në një punim të tij me të drejtë theksonte se mbledhja e lëndës folklorike duhej të ishte imperativ i kohës. Ai me këtë rast bënte thirrje që kjo lëndë e pasur e krijimtarisë popullore të gjente rrugën e publikimit nëpër gazetat dhe revistat e kohës.

Pra, me këtë kontribut, por edhe me kontributet tjera, veçmas në fushën e gjuhësisë, prof. dr. Remzi Nesimi përdëftonte se ishte pionier i vërtetë i një dijeje albanologjike që po lindte me vështirësi edhe te shqiptarët e Maqedonisë të cilët atëbotë sikur ishin privuar dukshëm nga rruga institucionale e zhvillimit kulturor dhe shkençor, apo emancipimit të tyre në të gjitha segmentet e jetës shoqërore. Në këto kondita specifike që u referoheshin shqiptarëve të Maqedonisë, nënkuptohet të asaj kohe, prof. dr. Remzi Nesimi vendoste themelet e një ngrehine të re që identifikohet me dijen albanologjike në të cilën gjuha, apo lëvrimi i saj, por edhe folklori, gjithësesi se kishin një vend tejet të rëndësishëm, madje edhe më qenësor në kuadër të vlerave identitare. Si rrjedhojë e gjithë kësaj, mund të thuhet lirshëm se angazhimi i tillë i prof. dr. Remzi Nesimit ishte gjithësesi i përmasave promethiane.

Bibliografia:

ANTONI, Lorenc (1974): Trajtat polifonike të muzikës popullore vokale. *Gjurmime albanologjike. Folklor dhe etnologji. II. 1972*. Prishtinë.

JOLLES, Andre (1978): *Jednostavni oblici*. Zagreb.

NESIMI, Remzi (1984): Më tepër kujdes folklorit tonë: *Jehona*. Shkup, 3/84. v. XXII: 95–100.

NESIMI, Remzi (2008): *E folmja e Dervenit*. Universiteti Shtetëror i Tetovës. Botime të veçanta. Tetovë.

NEZIRI, Zeqirja (2018): *Epika gojore shqiptare*. Instituti “Alb–Shkenca”. Shkup.

XHAGOLLI, Agron (2001): *Klasifikimi i prozës popullore shqiptare*. Botimet “Dudaj”. Tiranë.

XHAGOLLI, Agron (2007): *Etnologjia dhe folklori shqiptar*. “Triptik”. Vlorë.

AGIM POLOSKA

Fakulteti i Filologjisë “Blazhe Koneski” – Shkup

VEPRIMTARIA E FRYTSHME GJUHËSORE E PROF. REMZI NESIMIT

Të dashur familjarë, auditor i respektuar!

Duke shënuar njëvjetorin e vdekjes së profesor Remzi Nesimit, përkujtojmë me respekt të thellë një ndër figurat më të shquara të shkencës e të kulturës shqiptare dhe albanologun më në zë të kohës sonë në Maqedoni. Këtë sesion shkencor ia kushtojmë këtij eruditi tonë të madh në shenjë falënderimi dhe respekti për kontributin e madh që ka dhënë si prind, pedagog, shkencëtar dhe intelektual në Fakultetin tonë dhe më gjerë. Kujtimi i tij për një kohë shumë të gjatë do të mbetet i pashlyer nga mendja e të gjithë atyre që e kanë njohur profesorin Remzi. Ne, sot do t'i ruajmë kujtimet më të mira për të, ndërsa të gjithë ata që e kanë njohur profesorin jo vetëm që krenohen me të si pedagog e studiues të palodhshëm të gjuhës, letërsisë dhe kulturës shqiptare në Maqedoni e më gjerë, por pse qe edhe një shëmbëlltyrë e veçantë ndaj të cilit gjithmonë do të shprehim respektin dhe miradijen tonë. Si anëtar i Katedrës dhe dikur asistent i profesorit jam tepër i emocionuar. Me këtë rast shpreh falënderimet më të thella Institutit për Trashëgimi Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup për organizimin e sesionit shkencor, kushtuar profesor Remzi Nesimit.

Profesor Remzi Nesimi është ndër themeluesit e parë të arsimit të lartë në gjuhën shqipe në Maqedoni, si dhe studiues i zellshëm dhe i pasionuar. Me përgatitjen e tij të thellë shkencore, profesionalizmin, bujarinë dhe sinqeritetin e pashoq nuk mburret vetëm Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqipe pranë Fakulteti Filologjik “Blazhe Koneski” në Shkup, por me këto virtyte të larta njerëzore mund të mburren edhe të gjithë ata që e kanë njohur profesorin.

Profesori Remzi, veçanërisht ka qenë i çmuar dhe i respektuar nga kolegët e Katedrës sonë dhe nga të gjithë kolegët e Katedrave të tjera. Ai kishte një respekt të veçantë nga gjithë kolektivi i fakultetit.

Prof. Remzi Nesimi lindi më 25 dhjetor të vitit 1933 në fshatin Odër të Tetovës. Shkollën fillore e mbaroi në vendlindje, ndërsa të mesmen në gjimnazin Kiril Pejçinoviç të Tetovës. Në vitin akademik 1955–1956 regjistrohet në Fakultetin Filozofik të Beogradit, në degën e Albanologjisë, ku edhe u diplomua. Në këtë qendër pati fatin që si profesorë t'i ketë gjuhëtarët dhe ballkanologët e njohur, ndër të cilët edhe prof. Idriz Ajetin, Vojsllav Dançetoviç, Aleksandër Beliqin e shumë të tjerë. Te këta gjuhëtarë të shquar u formua shumë herët si dijetar i gjithanshëm i shumë degëve gjuhësore. Pas kryerjes së studimeve, në shkurt të vitit 1960, profesor Nesimi kryen detyrën e lektorit dhe të redaktorit në Redaksinë e Botimeve të NGB Rilindja, në Prishtinë. Në të njëjtën detyrë ka punuar edhe në Redaksinë e “Flakës së vëllazërimit”, në Shkup, gjer në tetor të vitit 1962. Në vitin shkollor 1964/65 zgjedhet pedagog i gjuhës shqipe në Akademinë Pedagogjike Kliment Ohridski në Shkup, ndërsa në vitin 1967, në po të njëjtin institucion, zgjedhet profesor i gjuhës shqipe në Akademinë Pedagogjike Kliment Ohridski në Shkup.

Prej vitit 1975 e gjer në vitin shkollor 1998/99 profesor Nesimi angazhohet si mësues i gjuhës letrare shqipe në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Shkupit, në fillim si pedagog, pastaj si profesor inordinar dhe ordinar. Profesor Nesimi një emër njafit i njohur i shkencës albanologjike, është midis gjuhëtarëve më në zë të gjuhësisë shqiptare të gjysmës së dytë të shekullit XX dhe të fillimit të shekullit XXI.

Profesor Nesimi në Katedrën e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe do të ligjërojë gjuhën e sotme shqipe (fonetikë, morfologji dhe sintaksë). Ligjëtratat e profesorit Remzi shquheshin për nivelin e lartë akademik. Gjithnjë ka qenë në rrjedhë me të arriturat më të reja

gjuhësore të shkencave albanologjike dhe ballkanologjike. Profesori në mënyrë të veçantë angazhohej për zbatimin e metodologjisë shkencore për përvetësimin dhe mësimin e gjuhës shqipe nga të huajt. Përpyekjet e tij karakterizoheshin me një akribi të rreptë shkencore. Vazhdimisht përpiquej për përdorimin e drejtë të gjuhës shqipe, duke vënë theks të veçantë në pastërtinë e saj në të folur dhe në të shkruar. Fusha më e ngushtë e interesimit shkencor të tij, ka qenë gjuha letrare shqipe, sidomos disilpina e saj – sintaksa e gjuhës shqipe.

Përveç angazhimit të tij në Fakultet, profesor Nesimi kontributin e tij do ta japë edhe në përpilimin dhe hartimin e shumë teksteve shkollore të gjuhës shqipe të të gjitha niveleve (në ciklin e ulët, të mesëm dhe universitar). Është autor i gjashtë gramatikave të gjuhës shqipe (disa në koautorësi) për nevojat e shkollave fillore dhe të mesme. Për nevojat e studentëve, të cilët shqipen nuk e kanë gjuhë amtare, prof. Nesimi, në koautorësi me Gj. Shushkën, do të botojë një tekst universitar, në dy versione, serbokroatisht (Prishtinë, 1987) dhe maqedonisht (Shkup, 1989). Deri më tani ky tekst universitar, në njediset arsimore e shkencore, është pritur mjaft mirë dhe është më i përshtatshmi dhe më praktik për zotërimin e shqipes nga të huajt.

Me çështje të gjuhës letrare shqipe profesori Remzi fillon të merret që në vitin 1960, kur në faqet e gazetës “Rilindja”, “Flaka e vëllazërimit”, “Jehona” etj, do të botojë një sërë artikujsh, lidhur me përdorimin dhe zbatimin e normës letrare të gjuhës shqipe në të folur dhe në të shkruar. Çështja e pastërtisë së gjuhës dhe zbatimi praktik i normës letrare do të jetë preokupim i tij thuajse gjatë gjithë veprimtarisë hulumtuese dhe kërkimore. Kështu, profesor Nesimi në vitin 1970 në faqet e gazetës “Flaka e vëllazërimit” në shtatë numra të njëpasnjëshëm e shtron dhe e arsyeton rolin, rëndësinë dhe nevojën e konstituimit të një gjuhe të përbashkët letrare shqipe dhe standardizimin e saj. Me këtë rast do të veçonim punimin e profesorit me titull *Rreth fillimit të shqipes në Maqedoni*

gjatë luftës dhe pas Luftës së Dytë Botërore, pastaj Flaka dhe shqipja e shkruar te ne, Procesi i njësimin të shqipes letrare në Maqedoni etj. Siç dihet, profesori Remzi është edhe autor i një numri shumë të madh artikujsh, në formë kumtesash e njoftimesh, studimesh dhe monografish të fushave më të ndryshme albanologjike. Në këtë kontekst, vlen të përmendim se veprimtaria e pasur kërkimore–shkencore e profesor Nesimit lidhet edhe me kontributin e tij që dha për gjuhën e shkrimtarëve tanë të Rilindjes Kombëtare si dhe të disa shkrimtarëve bashkëkohorë të letërsisë shqiptare. Gjithë kjo veprimtari gjuhësore e profesor Nesimit do të kurorëzohet me studimin “*Çëshnje gjuhësore*”(Shkup, 1997). Në këtë studim, profesori interesim dhe kujdes të veçantë do t’u kushtojë pishtarëve të Rilindjes Kombëtare për kontributin e madh që dhanë për gjuhën shqipe, (S. Frashërit, N. Frashërit, V. Pashës, A. Z. Çajupit etj.). Gjithashtu, profesor Nesimi vemendje të veçantë do t’u kushtojë edhe figurave të shquara të letërsisë dhe kulturës shqiptare, që dhanë kontribut për ruajtjen dhe kultivimin e alfabetit të gjuhës shqipe, gjuhës së përbashkët shqipe, drejtshkrimit, kulturës së gjuhës (duke filluar me Josif Bagerin, Haki Stërmillin, Abdylazis Islamin, Murat Isakun e të tjerë.) Angazhimi i profesor Nesimit do të shfaqet edhe në pasqyrimin e punës së palodhshme dhe të kontributit që kanë dhënë për gjuhën shqipe albanologë të vendit dhe të huaj, si A. Xhuvani, E. Çabej, Sh. Demiraj, H. Bariqi, P. Skok, Fidler, V. Dançetoviq, R. Ismajli, B. Bokshi, I. Ajeti, L. Mulaku. Në punimet shkencore të profesor Remziut vërehen përpjekjet e tij të vazhdueshme për vërshimin e ndikimeve të gjuhëve të huaja, dhe sidomos të gjuhëve ballkanike në strukturën gramatikore dhe leksikore të shqipes. Këto ndikime (nga gjuhët sllave jugore, maqedonishtja dhe serbishtja) profesori i vëren në shtypin e përditshëm, në tekste shkollore, në përkthimet e ndryshme etj. Të gjitha këto lajthitje gjuhësore profesorit i bien në sy, sidomos gjatë aktit të përkthimit në të gjitha nivelet, konstruktet e gabueshme morfo–sintaksore, leksikore frazeologjike dhe fjalëformuese, që me të madhe përdorëshin në gjuhën shqipe të folur dhe të shkruar.

Këto pikëpanje të tij, profesori shpeshherë i theksonte në simpoziumet, konferencat dhe tubimet e ndryshme shkencore të organizuara në lidhje me zbatimin e gjuhës letrare shqipe, kudo ajo që flitej e shkruhej.

Gjatë kësaj periudhe (mbi pesëdhjetë vjet) ai u përjetësua dhe bashkëudhëtoi me studimet e gjuhës letrare shqipe. Profesor Nesimi bën pjesë në brezin e studiuesve të gjuhës shqipe, i cili kishte barrën e përkujdesjes në konstituimin, kristalizimin dhe standardizimin e saj në të gjitha institucionet arsimore, shkencore dhe kulturore në Maqedoni. Si rrallë kush, profesor Remziu përkujdesej me përkushtim për konsolidimin e gjuhës letrare shqipes, si dhe të ngritjes së nivelit të studimeve albanologjike në baza të shëndosha e të qëndrueshme shkencore. Kësaj detyre dhe këtij obligimi, profesor Nesimi ia doli në krye me sukses të lakmueshëm, falë një angazhimi dhe pune të palodhshme hulumtuese e kërkimore-shkencore, që e dha në Katedrën tonë (1975–1998). Siç dihet, profesor Nesimi bashkëudhëtoi me përpjekjet e studiuesve më në zë albanologë në konsolidimin dhe ngritjen e gjuhës letrare shqipe. Si kryetar i Lidhjes së Shoqatave të Arsimitarëve të Gjuhës dhe të Letërsisë Shqiptare, ishte njëri ndër organizatorët kryesorë për përgatitjen e Konferencës Shkencore për shënimin e 20 vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit (1972), që u mbajt në Tetovë (1992).

Kontribut të çmueshëm profesor Nesimi ka dhënë sidomos në fushën e dialektologjisë shqiptare, në të cilën veçohen dy monografite voluminoze *Veçoritë fonetike të së folmes shqipe të rrethit të Tetovës* (dorëshkrim) dhe disertacioni i doktoratës me titull *E folmja e Dervenit*. Të dy monografite nga shkenca albanologjike janë vlerësuar si një arritje e madhe për shkencat albanologjike dhe si të tilla ato shërbejnë si gurrëthemel për studime dhe hulumtime të mirëfillta dialektologjike. Këtë angazhim profesori do ta kurorëzojë si udhëheqës i Projektit për hulumtimin e studimeve të të folmeve shqipe në Maqedoni gjatë viteve 1995–1997. Në bashkëpunim me disa anëtarë të Katedrës së Gjuhës dhe të Letërsisë

Shqiptare të Shkupit (Z. Osmani, H. Ymeri, A. Poloska dhe A. Hamiti) dhe të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë të Tiranës (Ç. Bidollari dhe B. Beci), këtë projekt profesori e realizoi me sukses shumë të madh.

Një vend të veçantë në punën shkencore të profesorit zë edhe veprimtaria përkthyesë. Ka përkthyer dhe shqipëruar mbi 20 tituj veprash letrare të autorëve të njohur të letërsisë botërore, jugosllave dhe maqedonase. Veprimtaria e tij shkencore dallohet edhe si recensues i shumë teksteve shkollore të gjuhës shqipe për shkollat tetëvjeçare dhe të mesme të botuara në Shkup dhe në Prishtinë. Po kështu vlen të përmendim edhe ndihmesën e tij të madhe që dha si recensent në përpilimin e Fjalorit sllovenisht–shqip. Për profesor Remzi Nesimin dhe veprën e tij madhore mund të flitet shumë. Pas çdo leximi dhe analize ato zgjojnë interesim dhe inspirime të reja dhe ofrojnë një begati të madhe njohëse në lidhje me gjuhën letrare shqipe

Për rezultatet e arritura në fushën e arsimit, edukimit dhe shkencës, profesor Remziu është shpërblyer dhe nderuar me mirënjohje, diploma e medalje në Maqedoni, Shqipëri dhe Kosovë.

Dhe në fund, duke dashur ta kursej kohën dhe durimin Tuaj, po them që mungesa e Tij për një kohë të gjatë do të jetë e ndjeshme në mjedisin tonë.

ASLLAN HAMITI

Fakulteti i Filologjisë “Blazhe Koneski” – Shkup

PROFESOR REMZI NESIMI – STUDIUES I TË FOLMEVE SHQIPE NË MAQEDONI

Është nder dhe kënaqësi të thuash diçka për veprimtarinë pedagogjike, arsimore, shkencore e kulturore të figurave tona të shquara. Kam pasur fatin të jem student, magjistrant, doktorant e më pas bashkëpunëtor, koleg dhe mik i zotëri Remziut.

Prof. Remzi Nesimi ishte pedagog i shquar i gjuhës shqipe, i afërt dhe shumë i dashur. Është shembëlltyrë që edukon dhe frymëzon gjeneratat e reja. Krahas veprimtarisë studimore e shkencore nga fusha e gjuhës shqipe (drejtshkrim, gramatikë, dialektologji etj.), ai është autor ose bashkautor i mbi 20 teksteve shkollore, 100 punimeve shkencore, monografive si dhe mori pjesë në shumë konferenca e veprimtari të tjera shkencore, pedagogjike, shoqërore e kulturore. Ishte pjesëmarrës i Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe më 1972 në Tiranë.

Prof. Remzi Nesimi me një zë të veçantë është përfaqësuar edhe në Fjalorin Enciklopedik Shqiptarhartuar nga gjuhëtari i shquar Emil Lafe, me këtë tekst: “Nesimi Remzi (1933 – 2018 A.H.). Gjuhëtar, profesor. Lindi në fshatin Odri të Tetovës. Kreu gjimnazin në Tetovë. Ndoqi studimet e larta dhe u diplomua për albanologji në Universitetin e Beogradit (1960); po aty përfundoi edhe studimet pasuniversitare (1971). Mbrojti doktoratën në Universitetin e Prishtinës (1989). Ka punuar si lektor i gjuhës shqipe në katedrën albanologjike të Univesrsitetit të Beogradit (1962–1964), pedagog i gjuhës shqipe në Akademinë Pedagogjike në Shkup (1964–1975), profesor në katedrën e gjuhës dhe letërsisë shqiptare në Univer-sitetin e Shkupit (1975–1999). R. N. Është marrë me studimin e të folmeve shqipe të Maqedonisë, ka shkruar disertacionin e

doktoratës për të folmen shqipe të Dervenit dhe ka drejtuar projektin “Të folmet shqipe në Maqedoni”; në këtë kuadër ka hulumtuar edhe ndikimin e shqipes në të folmet e maqedonishtes. R. N. ka shkruar një varg punimesh e artikujsh nga fusha e gramatikës, onomastikës, kulturës së gjuhës etj.; ka botuar përmbledhjen “Çështje gjuhësore” (Shkup 1996); është bashkautor në dy tekste universitare për mësimin e gjuhës shqipe për serbët dhe maqedonasit dhe një vargu tekstesh shkollore për gjuhën e letërsinë shqipe në Maqedoni. Si delogat në Kongresin e Drejtshkrimit (shih) ka mbajtur referatin “Procesi i njësimin të shqipes letrare në Maqedoni.”³²

Nga karakteri ishte i sinqertë, bujar, besnik, zemërgjerë, human, arsindashës, largpamës, patriot. Mbollli e shpërndau dije, arsim, kulturë, shkencë, mençuri, urtësi. Qindra e mijëra studentë, gazetarë, mjekë, teologë, kolegët e Katedrës dhe gjithë intelektualët e tjerë shqiptarë jeni fryt i punës gjysmëshekullore të këtij kolosi të madh të arsimit e të shkencës shqiptare.

Profesor Remziu është pishtar i arsimit të lartë në gjuhën shqipe në Maqedoni si dhe studiues i dalluar i shqipes. Me punën e frytshme arsimore, shkencore e kulturore ka dhënë ndihmesë shumë të çmuar për përvetësimin e normës letrare në shkollat shqipe, në mediet e shkruara dhe elektronike në Maqedoni dhe përgjithësisht për kultivimin, pasurimin, ruajtjen e pastërtisë së shqipes nga elementet e huaja.

Më se gjysmë shekulli, përkatësisht që nga vitet e 60-ta të shekullit të kaluar me përkushtim e vetëmohim ka punuar për ngritjen e përgjithshme arsimore e kulturore dhe të vetëdijes kombëtare të popullit shqiptar në Maqedoni e më gjerë, për të lëvruar, kodifikuar dhe përpunuar shqipen standarde.

³² Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Qendra e Enciklopedisë Shqiptare, *Fjalor Enciklopedik Shqiptar (vëllimi III, N-ZH)*, Tiranë, 2009, f. 1837.

Nga pjesëmarrja në Kongresin e Drejtshkrimit, nga ligjërimet e shkrimit e prof. Remziut mund të nxirret porosia se jemi një komb, prandaj duhet të kemi një gjuhë të përbashkët. Ai vazhdimisht ka shkruar e folur për pastrimin, pasurimin dhe, përgjithësisht, për kulturën e gjuhës në Maqedoni e më gjerë.

Në këtë kumtesë kemi vëzhguar veprimtarinë shkencore të prof. Remzi Nesimit në fushën e dialektologjisë shqiptare, e veçmas në studimin e të folmeve shqipe në Maqedoninë e Veriut. Jemi përqendruar në studimin *Mbi disa veçori të sistemit vokalik të së folmes shqipe të rrethit të Tetovës*, nëmonografinë *E folmja e Dervenit* dhenëprojektin kërkimor-shkencor për vjeljen e materialit dialektor të të folmeve shqipe në Maqedoni.

1. Studimi *“Mbi disa veçori të sistemit vokalik të së folmes shqipe të rrethit të Tetovës”* jo rastësisht u botua nga Instituti Albanologjik i Prishtinës, Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978, f. 327–352 dhe u ribotua në Dialektologjia shqiptare V, nga ASHRPS e Shqipërisë, Tiranë, 1987, f. 176–203.

Në këtë studim përshkruhet në hollësi (edhe pse prof. Remziu me modesti e thotë disa veçori) sistemi vokalik i mbi 60 fshatrave të rrethit të Tetovës. Këtu lexuesi që në fillim të tekstit gjen të dhëna të rëndësishme historike, etimologjike, etnografike, sociolinguistike, statistikore, arsimore e ekonomike për Pollogun.

Me kompetencë profesionale e saktësi shkencore përshkruhet theksi, hundorësia e zanoreve, duke trajtuar çdo zanore veç e veç nga pikëpanja nyjëtimore, e këmbimit të tyre. Gjerësisht përshkruhen edhe dukuritë fonetike të të folmes shqipe të rrethit të Tetovës: zhbuzorëzimi, diftongimi, monoftongimi i togjeve të zanoreve, përngjashmimi, shpërngjashmimi, shtimi e rënia e tingujve etj. Kjo mënyrë e tillë e përshkrimit të hollësishtëm të sistemit zanor të të folmes së Dervenit ka shërbyer e mund të shërbejë edhe në të ardhmen si model i përshkrimit të tipareve fonetike të të folmeve shqipe.

2. *Vepra “E folmja e Dervenit”³³* e prof. Remzi Nesimit është monografi shteruese me vlerë të madhe për dialektologjinë shqiptare. Në këtë studim përshkruhet në hollësi e folmja e Dervenit në të gjitha sistemet gjuhësore: në fonetikë e fonologji, në morfologji, fjalëformim, sintaksë, frazeologji dhe leksik, duke hartuar edhe një fjalor dialektor. Në fund janë dhënë tekste autentike, një përmbyllje dhe literatura e konsultuar me mbi 240 njësi bibliografike.

Punimi fillon me një hyrje ku përcaktohet qartë objekti i studimit e më pas përmenden studiuesit që drejtpërdrejt apo tërthorazi kanë bërë fjalë për të folmet shqipe në Maqedoni. Me saktësi shkencore janë përcaktuar edhe pozita gjeografike dhe kufijtë e Dervenit. Është vënë re se Derveni paraqet një tërësi gjeografike, gjuhësore dhe etnografike.

Materialin dialektor profesori e voli me vrojtim të drejtpërdrejtë në të gjitha pikat e rajonit. Krahas pyetësorëve që ekzistojnë, për dukuritë specifike, sidomos në fushë të fonetikës, siç është diftongimi i zanoreve /i/ dhe /u/ të theksuara, qiellzorizimi i /g/–së, grupeve [pl, bl, fl]; afrikatizimi i /gj/–së dhe i /q/–së etj. dhe për disa çështje të morfologjisë, si për formimin e shumësit tek emrat, për fjalëformimin etj. autori ka përgatitur pyetësorë të veçantë. Në pikat e eksploruara është mbledhur edhe material folklorik si dhe toponimet e vendbanimeve, të cilat janë shfrytëzuar si lëndë gjuhësore.

Sipas tipareve gjuhësore, – me të drejtë konstaton autori –, e folmja e Dervenit i përket të folmeve lindore të gegërishtes qendrore. Këtë të folme, si edhe pjesën më të madhe të të folmeve të arealit të gegërishtes qendrore, e karakterizojnë disa veçori fonetike e morfologjike që e dallojnë nga të gjitha të folmet e tjera shqipe.

Sistemi fonetik i kësaj të folmeje është përshkruar në hollësi. Aty në mënyrë analitike janë shpjeguar theksi, gjatësia dhe hundorësia e

³³ Prof. dr. Remzi Nesimi, *E folmja e Dervenit*, Universiteti Shtetëror i Tetovës, Tetovë, Seminari Ndërkombëtar i Albanologjisë, 2008, 495 faqe.

zanoreve. Me një saktësi të madhe shkencore është përshkruar çdo zanore e bashkëtingëllore, duke dhënë shembuj të shumtë për dendurinë, përndarjen dhe ndërrimet me tinguj të tjerë. Nga vepra mund të nxjerrim si përfundim se disa veçori të kësaj të folmeje janë mbarëdialektore, por ka edhe nga ato që i përkasin gegërishtes qendrore si dhe një numër dukurish që kanë shtrirje më të kufizuar. Për të përfutuar idenë e tipareve fonetike e fonologjike të të folmes së Dervenit, kemi shkëputur disa nga to, si:

1. Diftongimi i /i/–së dhe i /ú/–së theksuar në variantet *aĭ*, *eĭ*, *eĭ* dhe *oĭ*: *shpi* > *shpaĭ*, *shpeĭ*, *shpëĭ*, *shpoĭ*, përkatësisht *cú:c* > *cú:c* > *cauç* dhe *couç*.
2. Nyjëtimi më i përparmë i mesgjuhoreve /q, gj/ deri në shkallën e afrikatizimit të tyre të plotë në /ç, xh/: *qalë* > *ça:f*; *gjak* > *xhak*.
3. Buzorëzimi i /ã/–së hundore në [õ] të hundorëzuar: *hõ:n* < *hãnë*, *nõn* < *nãnë*, *õ* < *ã:sht* etj.
4. Mosshqiptimi i /ë/–së së patheksuar: *fú:sh* < *fúshë*, *mo:ll* < *mollë*, *punt* < *punët*, *kmaĭsh* < *këmishë* etj.
5. Zhbuzorëzimi i /y/–së në /i/:*di* < *dy*, *ki* < *ky* dhe pastaj kjo /i/ i është nënshtruar ligjeve të diftongimit, sipas modelit *fýt* > *fit* > *fajt*, *sy* > *saj* etj.
6. Rënia ose këmbimi i zanoreve të patheksuara me /ë/–në: *akëll* < *akull*, *petull* < *petëll* etj.
7. Për shkak të ngarkesës së vogël funksionale të kundërvënies fonologjike të çiftit bashkëtingëllor të dridhëseve /r/ ~ /rr/ është rrafshuar ky opozicion dhe në këtë të folme kemi vetëm fonemën /r/.
8. Grupi bashkëtingëllor [nd] përgjithësisht ruhet i plotë, ndërsa togu [mb] përngjashmohet në [m].

9. Prapagjuhorja /g/ qiellzorizohet në [gʲ], si edhe grupet e bashkëtingëlloreve [pl], [bl] e [tl]: *plak* > *pqak* > *qak*, *flutur* > *fjutër*, *bletë* > *bgje:t* > *gjet* etj.
10. Monoftongimi i togjeve të zanoreve në një zanore të gjatë dhe aty ku është përftuar /i/-ja e gjatë, ajo i është nënshtruar diftongimit. Kështu, togu zanor [ie] te fjalët e tipit *diell*, *miell* si dhe togu [iɛ] i përftuar nga zhbuzorëzimi i [ye]-së, si *fyell* etj. monoftongohen në /i:/ të gjatë, e pastaj në shumicën e rasteve shpërbëhet në *aj*: *miell* > *mi:ll* > *maïll*, *fyell* > *fi:ll* > *fajll* etj.; ndërsa togu [ue] është më i qëndrueshëm: *grue*, *ka punaue*, *ka laraue*, por *ka shku*: etj.

Me interes për t'u përmendur është se dukurinë e shpërbërjes së zanoreve /i/ dhe /u/ të theksuara në këtë të folme, autori e ka shtjelluar më hollësisht se çdokush deri më tani, duke studiuar të gjithat kushtet fonetike: pozicionin në fjalë dhe fqinjësinë me tinguj të tjerë mbi një fond leksikor shumë të pasur. Dukuria e fonemave është vëzhguar në fjalë shqipe e në fjalë të huaja, në emërve dhe në emra njerëzish.

Me këtë monografi shteruese edhe sistemi morfologjik i të folmes së Dervenit është trajtuar në hollësi. Nga libri mësojmë se në këtë fushë tipare dalluese janë:

1. Përdorimi i mbaresave vetore në njëjës edhe te shumica e foljeve të zgjedhimit të dytë, sipas tipit: un(e) *shkuli*, ta! *shkulën*, ai *shkulën*.
2. Veçori e përgjithshme është përdorimi i qiellzores /j/ në vend të alveolares /ɲ/ në vetën e tretë njëjës në të pakryerën te foljet e zgjedhimit të parë: *punojte*, *shkojte* < *punonte*, *shkonte* e në disa fshatra edhe *punojke*, *shkojke*.
3. Kjo e folme dallohet edhe me ndërtimin e habitores mbi bazën e së tashmes e jo të së kryerës, sipas tipit *punojkam* < *punuakam*, *vaikam* < *ardhkam*.

4. Veçori karakteristike që e dallon këtë të folme nga shumë të folme të tjera është edhe përdorimi i disa foljeve apofonike në të kryerën e thjeshtë në formën e së tashmes, por me togun [ie] të reduktuar në [i:] të gjatë dhe pastaj të diftonguar në [aj]: *mbajlli, mbajlla* < mbjell, mbolla, *përcajlli, përcajlla* < përcjell, përcolla.
5. Në sistemin emëror veçori tipike është se të gjithë emrat e gjinisë mashkullore, pa përjashtim, shquhen duke marrë mbaresën *-i*, ndërsa ata të gjinisë femërore mbaresën *-a*, si *ahi, dushki, majki, zogi* etj. Rrjedhimisht këtu na dalin vetëm dy lakime: lakimi i parë i emrave të gjinisë mashkullore dhe ai i dytë i emrave të gjinisë femërore.

Lidhur me fjalëformimin, pas një analize të gjerë, prof. Remziu konstaton se “si në pjesën më të madhe të të folmeve të tjera, ashtu edhe në këtë të folme, për formimin e fjalëve të reja përdoren afër një e treta e prapashtesave të gjuhës shqipe dhe të atyre që në gjuhën tonë kanë hyrë nga gjuhët e tjera”.

Ky libër paraqet interes edhe me kreun për leksikun dhe shprehjet frazeologjike. Në këtë studim të mirëfilltë dialektor jepen edhe mbi 80 njësi frazeologjike që kanë shtrirje të kufizuar ose që njihen vetëm në të folmen e Dervenit.

Pjesën dërmuese të fondit leksikor, shkruan autori, – e përbëjnë fjalët e burimit që përdoren edhe në të folmet e tjera si dhe në gjuhën letrare, por në këtë të folme hasim edhe një numër të konsiderueshëm elementesh leksikore me prejardhje nga gjuhët orientale si dhe nga maqedonishtja që nuk janë karakteristike për mbarë shqipen. Janë sjellë shumë huazime të tilla nga fusha të ndryshme të jetës, të cilat paraqesin interes si për dialektologjinë ashtu edhe për gjuhësinë shqiptare.

Me interes është edhe fjalori i të folmes së Dervenit i radhitur sipas alfabetit. Aty gjejmë edhe shumë fjalë dhe shprehje të rralla, shumica e të cilave janë specifike vetëm për këtë të folme.

Mund të përfundojmë se në këtë studim sillen përshkrime, shpjegime dhe tëhollime me interes. Ai nuk është vetëm një përshkrim i rëndomtë dialektor, por në të gjejmë të gërshetuara analizën e gjendjes së sotme gjuhësore të të folmes, përqasjen me të folmet e tjera gege e veçmas me ato të gegërishtes qendrore, shpjegime teorike, duke u mbështetur në literaturën dialektologjike në përgjithësi dhe atë që lidhen me temën në veçanti. Në të jo rrallë autori ka dhënë shpjegime e gjykime origjinale, sidomos rreth kronologjisë së mundshme të dukurive të ndryshme që trajtohen.

Punimi përshkohet nga një stil shkencor, me një gjuhë të pasur dhe tekst të ndërlidhur për lakmi. Një punë e tillë, dëshmon formimin e gjerë e të shëndoshë teorik, praktik dhe metodologjik të autorit.

3. Prof. Remziu si udhëheqës i projektit kërkimor–shkencor për vjeljen e materialit dialektor të të folmeve shqipe në Maqedoni. Në një periudhë trivjeçare (gjatë viteve 1995–1997) për vjeljen e pasurisë së gjuhës së popullit, zotëri Remziu, në bashkëpunim me disa kolegë të Katedrës së Gjuhës dhe të Letërsisë Shqiptare të Shkupit: Haki Ymeri, Zihni Osmani, Agim Poloska dhe Asllan Hamiti si dhe Institutin e Gjuhësisë e të Letërsisë së Tiranës, përkatësisht me prof. Bahri Becin e Çlirim Bidollarin, udhëhoqi një projekt kërkimor–shkencor dhe u mblodh material dialektor në pika të ndryshme të të folmeve shqipe në Maqedoni.

Më kujtohet kur prof. Remziu na tuboi tok në zyrën e tij dhe na shpjegoi për qëllimin, rëndësinë dhe punën në terren që duhej ta bënim për vjeljen e pasurisë gjuhësore të të folmeve tona. Unë, atëherë si asistent (në moshën 35–vjeçare) u ndjeva shumë i nderuar për besimin që kishte profesori tek unë si dhe për gatishmërinë që të isha pjesë e këtij projekti.

Së pari u përcaktuan pikat dialektore që nga pjesa veriore e deri në pjesën jugore të Maqedonisë e më pas përzgjedhëm pyetësonin për vjeljen e materialit dialektor në fushën e fonetikës e të fonologjisë, të morfologjisë, të leksikut e të sintaksës së shqipes, përkatësisht po të njëjtin pyetësor që është përdorur për Atlasin dialektor të shqipes,

duke e pasuruar atë edhe me pyetje të tjera për të nxjerrë materialin e nevojshëm për të folmet shqipe në Maqedoni, si pjesë përbërëse e grupit të të folmeve të gegërishtes qendrore.

Materialin e vilnim me pyetje të tërthorta si dhe nga biseda e gjallë, duke marrë shënime si dhe me inçizime zanore. Mbaj mend organizimin e shkëlqyeshëm që e bënte ushëheqësi i projektit, mirësjelljen e tij, korrektësinë, profesionalizmin, mirësinë, korrektesinë e sjelljen shumë humane ndaj nesh si dhe ndaj të gjithë pjesëmarrësve të tjerë në këtë projekt madhor.

Pata fatin që të mësoj jo vetëm nga leksionet që mbante profesori në fakultet, por edhe nga ekspeditat dialektore në periudhë trivjeçare. Përfitova shumë nga ky projekt, si nga pikëpamja profesionale ashtu edhe në përcaktimin tim që në periudhën e mëpastajme të merrem me dialektologji. Natyrisht se për këtë u jam mirënjohës jo vetëm prof. Remziut, por edhe pjesëmarrësve të tjerë në këtë projekt, meqë mësova shumë edhe nga prof. Bahri Beci, Çlirim Bidollari, Haki Ymeri, Zihni Osmani po edhe nga kolegët e tjerë.

Si në takimet tona të punës në Fakultet, ashtu edhe gjatë vajtje-ardhjeve, përveç bisedave të rëndomta, trajtoheshin edhe çështje profesionale e shkencore.

Pasi u vol materiali i paraparë dialektor, në marrëveshje të profesoreve të mi me prof. Bahri Becin, atëherë Drejtor i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë në Tiranë, përfitova të shkoj në vizitë studimore në këtë Institut. Gjatë këtij qëndrimi dyjavor u njoftova drejtpërdrejt me punën hulumtuese e shkencore si dhe u ndjeva shumë mirë nga mikëpritja vëllazërore nga të gjithë punonjësit, e veçmas nga Ardian Doka e Merita Bruci (tani të dy pedagogë e studiues të afirmuar).

Studimet dialektologjike të prof. Remzi Nesimit kanë shërbyer si material i rëndësishëm për studime përgjithësuese për shqipen, si në

tekstet mësimore universitare të Dialektologjisë,³⁴ ashtu edhe në përfaqësimin e të folmeve shqipe në hartat e Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe, edhe pse në këtë çështje kemi disa vërejtje serioze.

Ndihmesën e prof. Remziut, përfshirë edhe të gjuhëtarëve të tjerë, për studimin e të folmeve shqipe në Maqedoni, rrjedhimisht edhe për dialektologjinë shqiptare në përgjithësi e kemi paraqitur në temën “Gjendja dhe perspektiva e studimeve dialektore në Maqedoni” librin tonë të Dialektologjisë (në bashkautorësi).³⁵

Punën e vjeljes së pasurisë gjuhësore, folklorike e etnografike të Shqiptarët e Maqedonisë së Veriut si dhe studimin e saj, që e filloi, e zgjeroi, e thelloi me shumë prurje të reja prof. Remziu, duhet vazhduar edhe më tej. Për nga detyra që ka, i bie Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve që me një projekt shumëvjeçar së pari të regjistrojë këtë pasuri të çmuar kombëtare që po humbet e tretet, për ta shpëtuar nga zhdukja si dhe për t’ua lënë trashëgim brezave të ardhshëm.

Literatura e konsultuar:

Hamiti, Asllan – Qamili, Ajten – Osmani, Ismet: *Kontributi i delegatëve të Kongresit të Drejtshkrimit nga Maqedonia për shqipen standarde*, “Akademia jubilarë me rastin e 40-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit”, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë, 16–17 nëntor 2012, f. 42–48.

Hamiti, Asllan: *Ndihmesa e profesor Remzi Nesimit për arsimin, shkencën dhe kulturën shqiptare*, „Filologjia”, Revistë Shkencore Ndërkombëtare për Gjuhësi, Letërsi dhe Kulturë, Viti I, prill, 2013, Universiteti Shtetëror i Tetovës, Tetovë, 2013, f. 101–109.

Hamiti, Asllan: *Ndihmesa e studiuesve të Maqedonisë në fushën e dialektologjisë shqiptare*, Malësia 5, Podgoricë, 2010, f. 79–84.

³⁴ Jorgji Gjinarri – Gjovalin Shkurtaj, *Dialektologjia*, ShBLU, Tiranë, 1997 në f. 105 thuhet: “Për të folmet shqipe të Maqedonisë duhen përmendur sidomos ndihmesat e studimet e Remzi Nesimit, Fadil Sulejmanit dhe A. Zenkut.”

³⁵ Asllan Hamiti – Ajten Qamili, *Dialektologjia e gjuhës shqipe*, Shkup, 2014, f. 92-99.

Hamiti, Asllan: *Prof. Remzi Nesimi – pedagog, humanist dhe studiues i shqipe*, Shqyrtime albanologjike 5, Shkup, 1998, f. 11–18.

Хамити, Аслан: *Научно–образовниот профил на проф. Ремзи Несими*, Годишен Зборник на Филолошкиот факултет “Блаже Конески”, книга 39–40, Скопје, 2014, f. 21–36.

Mehmeti, D. Qani: *Kontributi i prof. Remzi Nesimit për gjuhën shqipe*, Shqyrtime albanologjike 5, Shkup, 1998, f. 115–125.

Nesimi, Mr. Remzi (Shkup): *Procesi i njësimt të shqipes letrare në Maqedoni*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Kongresi i Drejtshkrimit të gjuhës shqipe 20–25 nëntor 1972, Prishtinë, 1974, f. 139–142.

Nesimi, Remzi: *Çështje gjuhësore*, Shkup, 1997.

Nesimi, Remzi: *E folmja e Dervenit*, Seminari i Albanologjisë, 2008.

Nesimi, Remzi: *Mbi disa veçori të sistemit vokalik të së folmes shqipe të rrethit të Tetovës*, Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978, f. 327–352 dhe Dialektologjia shqiptare V, ASHRPS e Shqipërisë, Tiranë, 1987, f. 176–203.

Nesimi, Remzi, *Përdorimi dhe diftongimi i vokaleve i dhe u në të folmen shqipe të rrethit të Tetovës*, Jehona 2, Shkup, 1972.

Poloska, Agim: *Bibliografia e punimeve, studimeve, artikujve dhe monografive shkencore të prof. dr. Remzi Nesimit*, Shqyrtime albanologjike 5, Shkup, 1998, f. 19–28.

Шаини, Флорије: *Ремзи Несими и албанската лингвистика* (punim magjistrature mbrojtur në Fakultetin e Filologjisë “Bllazhe Koneski” në Shkup), Shkup, 2012.

ISMET OSMANI

Fakulteti i Filologjisë “Blazhe Koneski” – Shkup

REMZI NESIMI, STUDIUES I PËRKUSHTUAR I SHQIPES LETRARE

Në studimet mbi zhvillimin dhe studimin e gjuhës dhe kulturës shqiptare jashtë Shqipërisë, një vend të nderuar zë edhe veprimtaria pedagogjike dhe akademike e prof. dr. Remzi Nesimit. Prof. Remzi Nesimi, duke u mbështetur në traditën e mëparshme të studimeve gjuhësore, të krijuar nga gjuhëtarët e mëdhenj, si E. Çabej, A. Xhuvani, K. Cipo, Sh. Demiraj e të tjerë, ka krijuar individualitetin e tij shkencor e akademik, duke u dhënë studimeve të gjuhës dhe kulturës shqiptare një shtrirje më të gjerë.

Veprimtaria pedagogjike dhe akademike e prof. Remzi Nesimi në shërbim të arsimit shqiptar në Republikën e Maqedonisë dëshmon për një intelektual që, falë punës së tij plot pasion e këmbëngulje, profilizon portretin e vet shkencor, duke u renditur ndër ata që kanë punuar për t'i dhënë gjuhësisë shqiptare një fytyrë të re bashkëkohore.

Për rreth 40 vjet i përkushtohet punës arsimore e shkencore, në fillim si lektor i gjuhës shqipe në Katedrën e Albanologjisë në Beograd. Më pas, kthehet në Shkup si pedagog i gjuhës shqipe në Akademinë Pedagogjike “Klimenti i Ohrit” në Shkup, ku plot dhjetë vjet (1964 – 1974) do të angazhohet në përgatitjen e kuadrit të gjuhës shqipe për shkollat fillore dhe mësuesve në rajon e më gjerë. Nga viti 1975 e deri më 1999 ishte profesor në Katedrën e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqiptare të Fakultetit të Filologjisë në Shkup. Po kështu, për disa vjet prof. Remziu mbajti edhe leksione në lëndët e gjuhës shqipe në Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup. Me një vetëdije të lartë kombëtare, i shtyrë nga dëshira e flaktë për arsimimin e shqiptarëve, për disa vite rresht ligjëroi në

Universitetin (siç e quanin jolegal) të Tetovës edhe përskaaj rreziqeve e pasojave që mund të kishte asokohe.³⁶

Me zell e punë këmbëngulëse, arriti të bëhet një zë i gjuhësisë shqiptare me frymën e kërkesës që qe e kakarakterizuar edhe me gatishmërinë për të kryer me përkushtim çdo detyrë që i ngarkohej.

Prof. Remziu është pishtar i arsimit të lartë në gjuhën shqipe në Maqedoni si dhe studiues i zellshëm i shqipes. Me punën e frytshme arsimore, shkencore e kulturore ka dhënë ndihmesë shumë të çmuar për përvetësimin e normës letrare në shkollat shqipe, në mediet e shkruara dhe elektronike në Maqedoni dhe përgjithësisht për kultivimin, pasurimin, ruajtjen e pastërtisë së shqipes nga elementet e huaja, në veçanti nga elementet sllave. Çështja e pastërtisë së gjuhës dhe zbatimi praktik i normës letrare përbën boshtin kryesor të gjithë veprimtarisë së tij kërkimore në fushë të shqipes.

Me çështje gjuhësore fillon të merret që në vitin 1960, kur në faqet e gazetës “Rilindja” boton tre artikuj lidhur me pastërtinë e gjuhës letrare shqipe. Dy vjet para mbajtjes së Kongresit të Drejtshkrimit, përkatësisht që më 1970 në faqet e gazetës “Flaka e Vëllazërimit” që botohej në Shkup, në shtatë numra të njëpasnjëshëm paraqet dhe arsyeton rëndësinë dhe nevojën e konstituimit të një gjuhe të përbashkët letrare dhe standardizimin e saj. Prof. Nesimi argumenton se gjuha standarde është krijesë kombëtare dhe si në gjuhët e tjera, edhe në gjuhën tonë, për të arritur deri në kristalizimin e një norme drejtshkrimore morfologjike të caktuar është dashur një rrugë e gjatë me prurje e kundërshti, me analogji e kundërvënie. Dhe, jo rastësisht prof. Remzi Nesimi³⁷ moto të referatit të lexuar në

³⁶ Asllan Hamiti, Prof. Remzi Nesimi – *pedagog, humanist dhe studiues i shqipes*, Shqyrtime albanologjike 5, Shkup, 1998, f. 11-18.

³⁷ Remzi Nesimi, përveçse ishte pjesëmarrës në Kongres, ai ishte edhe njëri nga nënshkruesit e rezolutës së këtij kongresi bashkë me prof. dr. Petro Janurën, drejtor i Degës së Gjuhës Shqipe në Universitetin e Shkupit dhe Sefedin Sulejmanin, drejtor i Njësisë së bashkuar të punës botuese “Flaka e vëllazërimit”, Shkup.

Kongresin e Drejtshkrimit,³⁸ me titull “Procesi i njësimt të shqipes letrare në Maqedoni”³⁹ kishte vënë thënien e prof. Aleksandër Xhuvanit: “*Njësia e gjuhës është njësia e kombit*”, duke në bërë me dije për rrjedhën e zhvillimit të shqipes letrare në Maqedoni pas Luftës së Dytë Botërore e më pas. Me këtë rast, ai vë në dukje përpjekjet e shqiptarëve të Maqedonisë për zhvillimin e shqipes letrare, duke thënë se: “Sikurse në qendra të ndryshme – në Stamboll, në Bukuresht etj., ashtu edhe në Maqedoni janë bërë mjaft përpjekje për zhvillimin e shqipes letrare. Sidomos një vend të rëndësishëm në këtë proces, përkatësisht në krijimin e alfabetit përfundimtar të shqipes, zë edhe Manastiri, i cili prej kohësh ka qenë qendër e njohur kulture në Gadishullin Ballkanik.

Një vit pas mbajtjes së Kongresit të Manastirit ..., Shoqëria botuese letrare e po këtij qyteti botoi edhe Abetaren e njëjës nga pedagogët e para të arsimit kombëtar, Parashqevi Qiriazi. Po kështu, në këtë vend e në qendrat e tjera vepruan edhe mjaft shoqëri kulturore; u botuan gazeta, siç janë “Kosova” (1908) e “Shkupi”, që dilnin në Shkup. Por për shkak të rrethanave të njohura historike, për më se 30 vjet, sikurse në Kosovë ashtu edhe në Maqedoni, u shua çdo gjurmë e kulturës kombëtare. Vetëm pas Luftës së Dytë Botërore, krahas me hapjen e shkollave në gjuhën shqipe prej fillores e gjer në shkollat e larta, filloi tek ne edhe veprimtaria e gjerë botuese në gjuhën shqipe”.

Prof. Remzi Nesimi bashkë me pjesëmarrësit e tjerë nga Maqedonia (Petro Janurën dhe Sefedin Sulejmanin, të cilët ishin edhe anëtarë komisionesh të punës së Kongresit) në intervistën me titull: “*Për një gjuhë kristale, stabile*” dhënë gazetës “Flaka e Vëllazërimit” më 10. 12. 1972, vë në dukje aktivitetin dhe përshtypjet lidhur me mbarëvajtjen e punës së kongresit, ku thotë: “Mendoj se Kongresi u

³⁸ Mr. Remzi Nesimi (Shkup), *Procesi i njësimt të shqipes letrare në Maqedoni*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Kongresi i Drejtshkrimit të gjuhës shqipe 20-25 nëntor 1972, Prishtinë, 1974, f. 139-142.

³⁹ Kumtesa botohet në gazetën “Flaka e Vëllazërimit” më 3 dhjetor 1972.

mbajt në një kohë të duhur, kur më ishin pjekur kushtet për unifikimin e plotë të drejtshkrimit dhe të gjuhës shqipe. *E kjo, siç duhet, ka qenë ideal i të gjithë letrarëve, gjuhëtarëve shqiptarë, që nga Rilindja e deri më sot*”.⁴⁰

Kongresit të Drejtshkrimit të mbajtur më 1972 i paraprin një ngjarje tjetër shumë e rëndësishme për historinë tonë gjuhësore e kulturore – Konsulta Prishtinë e mbajtur katër vjet më parë, më 1968 në Prishtinë. Ngjarje kjo ku marrin pjesë 150 intelektualë e shkencëtarë nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi e viset e tjera shqiptare, e cila i hapi rrugën e njësimin tonë gjuhësor dhe bëri që Kongresi i Drejtshkrimit që do të mbahet katër vjet me vonë të quhet kongres mbarëkombëtar. Prof. Remzi Nesimi, është një ndër pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë dhe bashkë me Besim Bokshin dhe Hilmi Aganin përbëjnë Komisionin për hartimin e konkluzave të konsultës, në të cilat theksohet rëndësia e tri mbledhjeve gjuhësore (të mbajtura në Tiranë) që i kanë paraprirë Konsultës, rëndësia e njësimin gjuhësor, zbatimi i menjëhershëm i projekt-ortografisë (Rilindja, 23 prill 1968). Dhe, që nga viti 1968, nga të gjithë shqiptarët e ish-Jugosllavisë (Kosovë, në Mal të Zi, në Maqedoni) në gjithë veprimtarinë ligjërimore të shkruar u zbatua vendimi i Konsultës.

Ndërkaq, Konsulta e Prishtinës bëri bashkimin gjuhësor të të gjithë shqiptarëve kudo që janë, duke pranuar si norme Projektin e Rregullave të Drejtshkrimit të Tiranës të vitit 1967, duke hequr dorë nga rregullat e drejtshkrimit të vitit 1964 të gegërishtes standarde dhe, bëri që shqiptarët e Kosovës, të Maqedonisë, Malit të Zi, Luginës së Preshevës t’i japin fund rrugës ndarëse gjuhësore nëpër të cilën kishin ecur në historinë e tyre të gjatë gjuhësore dhe hapi rrugën e bashkimit gjuhësor.

Konsulta e Prishtinës i dha shtysë këtij procesi aspak të lehtë, duke pasur parasysh shumë rrethana e momente të zhvillimeve politike, shoqërore e ekonomike, po sidomos arsimore e kulturore, dhe bëri

⁴⁰ Gazeta Flaka e vëllazërimit, 10. 12. 1972, f. 6.

që katër vjet më vonë, më 1972 të mbahet Kongresi i Drejtshkrimit. Ngjarje kjo shumë e rëndësishme shkencore e kulturore në shkallë kombëtare shqiptare, e cila mblodhi shkencëtarë e studiues të shqipes nga të gjitha viset e qendrat më të mëdha të studimeve albanologjike jo vetëm në Shqipëri e në Kosovë, në Maqedoni, Mal të Zi, po edhe nga arbëreshët e Italisë.

Lidhur me të prof Remzi Nesimi do të shprehet: “Sikurse drejtshkrimi i vitit 1965 që paraqet një hap para në krahasim me drejtshkrimin e vitit 1951–52, ashtu edhe drejtshkrimi definitiv i gjuhës shqipe paraqet disa lehtësi. Intencat kryesore të pjesëmarrësve të Kongresit si dhe të hartuesve të projektit kanë qenë që të kemi një drejtshkrim sa më pak përjashtime. Në drejtshkrimin e ri pothuajse janë rrafshuar të gjitha dubletet që aty-këtu figurojnë në projektin e rregullave të vitit 1967. Po kështu do të jetë një lehtësim për nxënësit dhe redaksitë ndarja e fjalëve në fund të rreshtit, sepse sipas këtij drejtshkrimi thjeshtohen shumë kriteret rigorozë të deritashme”.⁴¹

Kontributi i prof. Remzi Nesimi është i gjerë e kompleks, në fonetikë, morfologji e dialektologji (E Follnja e Dervenit, Shkup, 2008), në fushën e normës drejtshkrimore, në planifikimin e politikave gjuhësore duke dëshmuar kështu një nivel të lartë në mendimin teoriko-shkencor të gjuhësisë shqiptare.

Nuk ka dyshim që në gamën e veprimtarisë shkencore të tij, spikatën në mënyrë të plotë e të padiskutueshme, ndihmesat e tij në fushën e normave të gjuhës standarde shqipe, si lektor – redaktor i një numri të madh (afër 30) veprash të ndryshme letrare, shkencore, kulturore si dhe i shumë teksteve shkollorë të botuara në Maqedoni e Kosovë.⁴², mbi 100 artikuj, studime, shqipërime (mbi 20) e monografi me vlerë shkencore.

⁴¹ Gazeta Flaka e vëllazërimit, 10. 12. 1972, f. 6.

⁴² Agim Poloska, *Bibliografia e punimeve, studimeve, artikujve dhe monografive shkencore të prof. dr. Remzi Nesimit*, Shqyrtime albanologjike 5, Shkup, 1998, f.19-28.

Në filozofinë dhe metodologjinë e punimeve shkencore janë shkruar në mënyrë harmonike arritjet e gjuhësisë shqiptare me prirjet sistemore të formësimit të gjuhës standarde. Kjo punë e vyer rezultoi e suksesshme për ruajtjen e fizionomisë dhe të qëndrueshmërisë së gjuhës standarde në rrugën e intelektualizimit dhe të demokratizimit të saj të pandërprerë, duke kapërcyer me sukses vështirësitë në zotërimin e përdorimit të saj.

Prof. Remzi Nesimi, me punën e tij të palodhshme dëshmohej në shumë aktivitete të tjera krijuese e botuese. Ka qenë anëtar i Komitetit Republikan të Arsimit e të Kulturës, anëtar i Pleqësisë Republikane Pedagogjike të Maqedonisë, anëtar i kolegjiut të Redaksisë së Jehonës (përgjegjës dhe redaktor i rubrikës së gjuhësisë), anëtar i Këshillit Redaktues të Teksteve Shkollore në gjuhën shqipe në Shtëpinë Botuese “Prosvetno Dello”, anëtar i Komisionit Republikan për përsosje kërkimore–shkencore të kuadrit, anëtar i Pleqësisë për përkujdesjen dhe zhvillimin e gjuhës letrare në Radio–Televizionin e Maqedonisë, anëtar i Kolegjiut redaktues të revistës shkencore “Gjurmime albanologjike” – Prishtinë etj. Për bashkëpunim profesional të frytshëm dhe të vazhdueshëm me institucionet arsimore e kulturore, prof. dr. Remzi Nesimi është nderuar me disa mirënjohje, diploma e medalje.⁴³

Veprimtaria shkencore e prof. R. Nesimit ka ndihmuar dhe po ndihmon në ngritjen cilësore të studimeve gjuhësore të shqipes. Ndihmesa e Nesimit është e dobishme jo vetëm për studentët dhe mësuesit, por edhe më gjerë, për studiuesit e gjuhës shqipe në mjediset universitare shqiptare.

⁴³ Qani D. Mehmeti, *Kontributi i prof. Remzi Nesimit për gjuhën shqipe*, Shqyrtime albanologjike 5, Shkup, 1998, f. 115-125.

Literatura:

1. Asllan Hamiti, Prof. Remzi Nesimi – pedagog, humanist dhe studiues i shqipes, Shqyrtime albanologjike 5, Shkup, 1998, f. 11–18.
2. Аслан Хамити, Научно–образовниот профил на проф. Ремзи несими, Годишен Зборник, Книга 39–40, Скопје, 2014, стр. 21–36.
3. Agim Poloska, Bibliografia e punimeve, studimeve, artikujve dhe monografive shkencore të prof. dr. Remzi Nesimit, Shqyrtime albanologjike 5, Shkup, 1998, f. 19–28.
4. Besnik Emimi, Pasqyrimi i Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe të vitit 1972 në shtypin e kohës në Maqedoni, Scupi, Shkup, 2012, f. 153–162.
5. Emil Lefe, Personaliteti shkencor i prof. Remzi Nesimit (me rastin e 80–vjetorit të lindjes), Годишен Зборник, Книга 39–40, Скопје, 2014, f. 37–40.
6. Исмет Османи, Придонесот на проф. Ремзи Несими за албанскиот стандарден јазик, Годишен Зборник, Книга 39–40, Скопје, 2014, стр. 79–84.
7. Qani D. Mehmeti, Kontributi i prof. Remzi Nesimit për gjuhën shqipe, Shqyrtime albanologjike 5, Shkup, 1998, f. 115–125.
8. Remzi Nesimi (Shkup), Procesi i njësimt të shqipes letrare në Maqedoni, IAP, Kongresi i Drejtshkrimit të gjuhës shqipe 20–25 nëntor 1972, Prishtinë, 1974, f. 139–142.
9. Sefedin Sylejmani, Kongresi i Drejtshkrimit të gjuhës shqipe 20–25 nëntor 1972, I, Tiranë, 1973, f. 199–200.
10. IAP, Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, Prishtinë, 1974.

MUSTAFA IBRAHIMI

Universiteti “Nënë Tereza” – Shkup

KONTRIBUTI I PROFESOR REMZI NESIMIT NË DIFTONGIMIN E VOKALEVE *I* DHE *U* NË TË FOLMET E GRUPIT TË GEGËRISHTES QENDRORE

Profesor Remzi Nesimi ishte personalitet i shquar i botës intelektuale shqiptare, i cili dha kontribut të çmueshëm në shkencat filologjike, duke promovuar me intelektualizëm të pashoq pasuritë shpirtërore e gjuhësore dhe kulturës shqiptare në përgjithësi.

Në studimet e tij, midis tjerash rëndësi të veçantë i ka kushtuar edhe fushës së dialektologjisë, e në veçanti diftongimit si dukuri fonetike, që është objekt studimi në këtë kumtesë. Midis tjerash, jemi bazuar kryesisht në studimet e tij, që kanë të bëjnë me këtë çështje, siç janë: “*Përdorimi dhe diftongimi i vokaleve i dhe u në të folmen shqipe të rrethit të Tetovës*”, botuar në vitin 1972, në numrin 2 të revistës shkencore “Jehona”, që botohej në Shkup dhe në monografinë e tij “*E folmja e Dervenit*” botuar në vitin 2008, USHT, Tetovë.

Nga këto studime shkencore, vijnë në përfundim se profesor Nesimi, kishte njohuri të sakta për shtrirjen gjeografike të të folmeve shqipe në Maqedoni dhe në gjerë, e në veçanti për diftongimin, si një dukuri karakteristike e të folmeve shqipe në Maqedoni, që sipas profesorit zona e diftongimit të *i*-së dhe *u*-së është mjaft e gjerë. Këtë dukuri e hasim në të folmen shqipe të rrethit të Kumanovës, të Prilepit, të Krushovës, në fshatrat e Strugës: *Dollogozhdë, Livadhi, Veleshtë, Paum, Gorencë e të tjera*, përjashtim bëjnë fshatrat Frëngovë, Kalishtë dhe Radolishtë (Nesimi 1972:57). Në pikëpamje të ndryshimeve fonetike, sidomos në pikëpamje të

diftongimit, e folnja e Tetovës përputhet me të folmet tjera të Gegërisë së Mesme, si me atë të Mirditës, me të Dibrës, të Lumës, të Lurës, të Matit etj. (Nesimi 1972:56).

Diftongimi i vokalit –i–

Në të folmet e gegërishtes qendrore, zanorja *i* diftongohet në të gjitha pozitat e fjalës. Këtë fonemë e paraqesin si variante fakultative diftongjet: ai, ei, ëi, oi (Gjinari 1975:48). Sipas materialeve toponomastike del se kjo dukuri fonetike ka qenë e pranishme që nga shek XV–XVI (Nesimi 1972:57). Për këtë flasin toponimet *Balldre–ni*<*Ball Drinit, Meredit (1416)*<*Mirditë* (Desnickaja 1958:156), *Prelli*<*Prilli* (Beci 1965:265).

Diftongimi i vokalit –i–, paraqitet në pjesën veriore të Shqipërisë në zonën e Krujës, të Mirditës, kap Matin e gjithë Dibrën dhe Lumën (Gjinari 1975:79), pra në veri deri në Kabash, në jug deri në Zhupal dhe Zerçan ndërsa në perëndim deri në Koshnjët (Beci 1965:263). Në Maqedoni zona e diftongimit të zanores *Ë* është mjaft e madhe. Ky fenomen haset edhe në të folmen e Kumanovës, Kërçovës, Dibrës, Shkupit (sidomos e folnja e Karshiakës) (Ymeri 1998:52–53), Gostivarit, Strugës, Dollogozhdës, Livadhisë, Velesh–tës, Pamit, Gorencit, etj., me përjashtim të fshatrave: Frengovë, Kalisht dhe Radolishtë (Nesimi 1972:57), në rrethin e Krushovës (Zhitoshë, Borinë, Jakrenovë, Sazhdevë, Bellushinë, përjashtim bëjnë Presilla, Nerova dhe Aldançja), si dhe në territorin e Prilepit, me përjashtim të të ardhurve nga Jabollçishta dhe Sjenica (Sanxhak), të cilët sot jetojnë në Gostirazh përkatësisht në Llazhani.

Profesor Nesimi do të theksojë se në të folmen shqipe të rrethit të Tetovës sikurse edhe në krahinat tjera të kësaj zone dialektore i–ja e theksuar në disa lokalitete ka dhënë diftongun *ai* e në disa *ei*. Por ka edhe lokalitete, që kanë dhënë edhe diftongun *–oi* (Nesimi 1972:57).

Diftongun *ai* e gjejmë kryesisht në fshatrat periferike në verilindje të Tetovës, si në : Jazhincë, Orashë, Odri, Përvcë etj., si p.sh: *mair*<*mîrë*, *mullai*<*mulli*, *vai*<*vi* etj.

Në këtë koine gjuhësore, por me disa ndryshime të vogla fonetike, hynë edhe fshatrat në juglindje të Tetovës ku shtrihet Derveni i Shkupit me fshatrat: Radushë, Sullarë, Kopanicë, Bojanë etj. Fshatrat e Dervenit të Tetovës, i cili fillon nga fshati Grupçin dhe përfshin Merovën, Novo Sellën, Cerovën, Çifligun, Zhelinën, Stremnicën, Debërcën e të tjera. Në këto fshatra kemi: *vaiç*<*viç*, *fais*<*fis*, *maish* <*mish* etj., me përjashtim të disa fshatrave malore mbi Tetovë, ku përdoret *mish*.

Në fshatrat malore të Tetovës, si në: Gajre, Lisec, Sellcë etj. dominojnë dy variante edhe *ai* edhe *ei*. Kështu dëgjohej *fais* edhe *fëis*, *vaiç* edhe *veiç*, *train* edhe *treim* etj. Profesor Nesimi kishte vërejtur se në këtë rajon i-ja që është rezultat i itaçizmit të y-së, gjithnjë jep variantin *ai*: *frain* < *frin* < *fryn*, *fait* < *fit* < *fyt*; por edhe *fëit* < *fýt*, *fëill* < *fýell* etj. Në këtë rajon, profesor Nesimi thekson se në variantin *ai* është zbrëthyer edhe i-ja nazale, si për shembull: *mullai* < *mulli*, *shtrai* < *shtri*, *nxai* < *nxî* etj. (Nesimi 1972:58).

Laramani variantesh *ai* dhe *ei* hasim edhe në vendbanimet në mes Tetovës dhe të Gostivarit dhe në fshatrat që shtrihen në territorin e ashtuquajtur Podgor. Kështu për shembull në fshatin Rakovec, Bogovinë, Miletinë, Çellopek etj. dominon varianti *ei*: *neip* < *nîp*, *shei* < *shi*, *seini* < *syni* etj.; kurse në shumë fshatrat tjera si Sllatinë, Dobrosh, Odri, Nerasht dominojnë të dyja variantet: *sai*vi dhe *seivi*.

Variantin *oi* respektivisht *oei*, e has në ca fshatra malore si në Bozovcë, Veshallë, Nerasht e tjera. P.sh. *soei*<*sy*, *toei*<*ty*<*ti*, *poeit*<*pyetë*. Varianti *oi* haset në verilindje të Tetovës në fshatrat *Odri*, *Orashë*, *Jazhincë* etj. Në fshatrat e Dervenit të Tetovës, në të folmen e Pollogut të Epërm, të Gostivarit, si në fshatin Çegran, në të folmen e Strugës si në fshatin Veleshtë, p.sh. *moir*<*mîrë*, *frik* <

frik etj. Në të folmen e Dibrës haset varianti ëi: *kmëish* < *këmishë*, *krëjp* < *kripë*, *mëik* < *mik* etj.

Me të drejtë profesor Nesimi konkludon se përveç fjalëve të leksikut të shqipes fenomeni i diftongimit të i-së paraqitet edhe në fjalët e huazuara orientale, si p.sh: *açëik*, *açaik*; *iqinai*, *iqinei*, *iqinoi* etj. Kjo dukuri fonetike paraqitet edhe te huazimet me prejardhje sllave, edhe atë si te ato të kohës më të vjetër, ashtu edhe te ato të kohës më të re. Te huazimet sllave sipas rregullës diftongohen fjalët që përfundojnë me sufiksën: Në ato sllave: *kosait*, *koseit*; *përzhëit*, *përzhait*; *smeteit*, *smetait* etj. (Nesimi 1972:59–61).

Z a n o r j a –u–

Një inovacion i përgjithshëm jo vetëm për të folmen e Tetovës por edhe për numrin më të madh të të folmeve të gegërishtes qendrore, paraqet diftongimi i zanores së theksuar u në variante fakultative au dhe ou. Ky fenomen paraqitet në të gjitha regjionet dhe vendet ku haset edhe diftongimi i zanores së theksuar i (Tagliviani 1942:44–45), pra në Krujë, Mat, Mirëditë, Lurë, Lumë, Dibër, Gostivar, Tetovë, Kërçovë, Prilep, Shkup, Kumanovë (Gjinari 1975:48).

Profesor Nesimi në studimin e tij thekson se, në pjesën më të madhe të arealit gjuhësor të rrethit të Tetovës *u*-ja e theksuar zberthehet në *au*, por në disa fshatra të Malësisë si në: Shipkovicë, Veshallë, Bozovcë etj., ajo ka dhënë diftongun sekondar *ou* sikurse në të folmen e Dibrës dhe të rrethinës së saj (Nesimi 1972:67). P.sh. *kataun* < *katund*, *nause* < *nuse*, *raush* < *rushë*, *taurk* < *turk* etj.

Diftongimi i *u*-së e hasim edhe te huazimet me prejardhje turke: *llakaun* (<llokum), *kusaur* (<kusur);

– procesi i diftongimit të zanores u haset edhe te emrat personal, veçanërisht tek ato me prejardhje orientale. P.sh.: *Isauf* (<*Isuf*), *Nasauf* (<*Nasuf*).

Në vijat ndarëse fonologjike zanoret udhe, kur përdoren me formën e shkurtër të përemrit, gjatë bashkimit të tyre lidhen në ua. Por, në të folmen tonë kjo formë e shkurtër ka kaluar në v, që është rast edhe me të folmen e Tetovës (Ismajli 1986:59) dhe me të folmen e Dibrës (Basha 1989:158), p.sh.: *va dhash* (<ua dhashë), *va shes* (<ua shes), *va gërkova* (<ua kërkova), *va lishova* (<ua lëshova).

Z a n o r j a - y -

Një karakteristikë e veçantë gjuhësore që është veçori vetëm e shqiptarëve të Prilepit dhe të Krushevës, dhe nuk haset gati në asnjë të folme tjetër, është diftongimi i zanores **y** në **ay** dhe në raste shumë të rralla edhe **ey** në të gjitha pozicionet e fjalës. Pavarësisht nga gjatësia e tyre, zanorja e theksuar y diftongohet në të gjitha pozitrat:

a) në pozitë nistore të fjalës: *ayll* (<yll), *ayn* (<hynë), *ayf* (<yf), *aymër* (<ymër);

b) në pozitë të mesme: *fraym* (<frymë), *fayt* (<fyt), *qymayr* (qymyr), *taym* (<tym), etj.;

c) diftongimi është i pranishëm edhe në pozitë fundore të fjalës: *say* (<sy), *atay* (<aty), *tay* (<ty), *ay* (<hy), *fray* (<fry) etj.;

Diftongimi i zanores ynëay haset edhe në huazimet me prejardhje turke, në këto raste: *syfayr* (<syfyr), *sayrme* (<surme), *çyryk* (<çyryk).

Dukuri karakteristike me diftongimin e zanores ynëay haset edhe gjatë reduktimit të grupeve të zanoreve ye përkatësisht ie, gjatë së cilës fitohen këto procese fonetike:

ye > **y** > **ay**: *fayll* (<fyll <fyell); *kraye* (<kry <krye);

ie > **y** > **ay**: *mayll* (<myll <miell); *fayr* (<fyr <fier);

Përfundimi

Me analizimin e gjerë dhe të saktë të diftongimit të **i**-së dhe **u**-së në të folmet shqipe në Maqedoni, prof. Remzi Nesimi jo vetëm që e kompletoi, por e precizoi dhe e plotësoi edhe më tej këtë dukuri, në krahasim me studimet e mëparshme sipërfaqësore të studiuesve Bahri Beci dhe Jorgi Gjinari. Por medoemos duhet të theksojmë, se të tre studiuesit nuk kishin arritur të zbulojnë edhe një dukuri, gjegjësisht nuk e zbuluan edhe diftongimin e **y**-së që përdoret dendur dhe që është edhe sot shumë aktive në të folmen e Prilepit dhe Krushovës, sidomos në fshatin Cërnilishtë dhe pjesërisht në fshatin Zhitoshë dhe në disa fshatra tjera, si Desovë, Peshtalovë, Debresh, Llazhan, Jakrenovë, Borinë dhe Sazhdovë. Përjashtim bëjnë tre fshatrat e Krushovës: Presill, Alldançe dhe Nerovë, ku mungon diftongimi i të tre vokaleve: **i**, **u** dhe **y**.

Megjithatë, nga studimet dhe materialet e botuara, jo vetëm për dukurinë e diftongimit, por edhe studimet e tjera në fushën e dialektologjisë, profesor Remzi Nesimi ka rezervuar një vend të veçantë dhe të rëndësishëm në fushën e studimeve dialektologjike për të folmet shqipe në Maqedoni. Me plot të drejtë mund të themi se profesor Remziut i takon plejadës së profesorëve të parë që shqyrtuan dhe zbardhën disa dukuri dialektore jo vetëm për të folmet shqipe në Maqedoni, por edhe në përgjithësi. Në këtë mënyrë vepra e prof. Remziut do të shërbejë si literaturë bazë për të folmet e grupit të gegërishtes qendrore dhe në përgjithësi do të jetë një referencë e domosdoshme për dialektologjinë shqiptare në përgjithësi.

Referenca:

- BASHA, Naim. (1989). *E folnija e qytetit të Dibrës*. “Studime Gjuhësore” II (Dialektologji), Prishtinë.
- BECI, Bahri. (1965). *Mbi katër inovacione fonetike të të folmeve të Gegënisë së mesme*. Konferenca e parë e studimeve albanologjike. Tiranë.
- DESNICKAJA, Agnia. (1958). *Albanski jezik i ego Dialekti*, Leningrad.
- GJINARI, Jorgji. (1975). *Dialektologjia shqiptare*. Tiranë.
- IBRAHIMI, Mustafa (2005). *E folnija shqipe e rrethit të Prilepit dhe Krushevës*. Interlingua, Shkup.
- IBRAHIMI, Mustafa (2010). *Diftongimi i zanoreve -i,- u dhe -y në të folmen e Prilepit dhe Krushevës*. Në revistën “Zëri i Pelagonisë”, nr. 1-2 (36-37) / 2010. Shkup, f.32-44.
- ISMAJLI, Rexhep. (1986). *Sistemi i zanoreve të shqipes së shekullit XVIII*, “Gjurmime Albanologjike” , nr.15 –1985, Prishtinë 1986.
- NESIMI, Remzi. (1972). *Përdorimi dhe diftongimi i vokaleve i dhe u në të folmen shqipe të rrethit të Tetovës*, “Jehona” nr.2, Shkup.
- NESIMI, Remzi. (2008). *“E folnija e Dervenit”*. USHT, Tetovë.
- TAGLIVIANI, C. (1942). *Le parlate albanesi di tipo ghego orientale*, “Dardania e Macedonia nord-accidentale”, “La terre albanese redente” I Kosovo”, Roma.
- YMERI, Haki. (1998). *E folnija shqipe e Karshiakës*, Shkup.


BERTON SULEJMANI

Universiteti i Tetovës – Tetovë

KONTRIBUTI I PROFESOR REMZI NESIMIT PËR SHQIPEN STANDARDE NË MAQEDONI SI DHE STUDIMET E TIJ PËR SINTAKSËN E GJUHËS SHQIPE

I. Prof. dr. Remzi Nesimi do të mbetet sinonim i gjuhësisë shqiptare në Maqedoni e më gjerë. Punoj pa u lodhur në shërbim të shkollës, të shkencës dhe të kulturës shqiptare. Veprimtaria e tij shkencore është e gjerë dhe e shumanshme. Askush nga gjuhëtarët shqiptarë, cilido që të jetë vokacioni a fusha themelore e kërkimit të tyre, nuk e ka quajtur dhe nuk e quan të tepërt ose të panevojshme që t'u kushtojë vëmendje edhe çështjeve që kanë të bëjnë me normën e shqipes standarde. Prof. R. Nesimit i ka rënë barra së pari, që të përballojë çështjen e ndërlikuar, kisha thënë edhe nga faktorë jashtëgjuhësorë, të zhvillimit të shqipes standarde në Maqedoni. Luhatjet e shumta drejtshkrimore që viheshin re në praktikën shkollore dhe në shtypin tonë, i dhanë një detyrë kombëtare prof. Remziut që nëpërmjet shkrimeve të ndryshme të botuara në gazetën “Flaka e vëllazërimit”, por edhe nëpërmjet radio Shkupit etj., të bëjë përpjekje që të ngrejë nivelin e zbatimit të standardit gjuhësor dhe t’ua bëjë me dije arsimtarëve, gazetarëve, redaktorëve etj., se kujdesi për shqipen standarde, për njohjen e për zbatimin e normës gjuhësore, mbi të gjitha, është edhe detyrë kombëtare për të gjithë.

Një nga rubrikat që zinte vend kryesor në gazetën “Flaka e vëllazërimit” ishte ajo me titull: „*Ç’thotë profesori i shqipes*”. Këtë rubrikë e mbulonte z. Rexhep Zllatku, ndërsa profesori që jepte përgjigje ishte prof. Remzi Nesimi. Ja disa nga pyetjet më të shpeshta të kohës që i drejtoheshin profesorit të gjuhës shqipe:



1. A duhet ta flasas atë gjuhën e pleqve tanë të cilën e di ashtu siç është apo gegërishten letrare?⁴⁴Jo. Për këtë dilemë nuk kam, – shprehej ai që e parashtronte pyetjen. Por, ç’të bëj që nuk e di? Profesor Remzi Nesimi kështu i përgjigjej: *Në pyetjen tuaj se a duhet të përpiqemi që ta flasim ose, më mirë të themi, që ta vëmë në jetë gjuhën e unifikuar, lirisht mund të përgjigjemi se nuk duhet të presim asnjë moment. E këtë në radhë të parë duhet ta bëjnë shkollat, sepse redaksitë, siç e dimë, qysh me kohë – pas Konsultës gjuhësore në Prishtinë (e „Flaka” edhe më parë) – e përdorin këtë gjuhë.*

2. Kujt i takon kjo detyrë së pari? (kupto: kusht duhet ta flasë gjuhën e unifikuar së pari?) – Prof. R. Nesimi: *Përveç shkollave dhe redaksive janë të obliguara të gjitha institucionet kulturore dhe administrative, në radhë të parë teatri, organet administrative etj.*⁴⁵

3. Po për përpjekjet individuale? Pse, siç dihet, ja po mbushen dy vjet qysh se u pajtuam që ta unifikojmë gjuhën tonë por, megjithatë, ne, si në jetën e përditshme, ashtu edhe në disa raste të karakterit zyrtar dhe publik, vazhdojmë me të mëparshmen...Prof. R. Nesimi: *Kjo është çështje e komplikuar. Mendojmë se do të kalojë edhe një kohë e gjatë derisa intelektualët tanë ta flasin*

⁴⁴ Gazeta „Flaka e vëllazërimit” (kulturë, arsim, shkencë, zbavitje, humor..., nr 972/4 e enjte, 29 kallnor (janar) 1970, f. 2.

⁴⁵ Gazeta „Flaka e vëllazërimit” (kulturë, arsim, shkencë, zbavitje, humor..., nr 973/5 e enjte, 5 fror (shkurt) 1970, f. 2.

rrjedhshëm këtë gjuhë. Këtu hasin vështirësi edhe punëtorët profesionalë – sidomos kur është fjala e të folurit. Ndoshta në shkrimet tona kemi bërë hapa përpara, por në të folur, siç thamë, do përpjete brenda një kohe relativisht të gjatë. Tjetër gjë është ta shkruash, tjetër ta flasësh. Për këtë të gjithë kemi qenë të vetëdijshëm kur vendosëm ta unifikojmë gjuhën.⁴⁶

4. **Shok profesor,** (do të shkruhej në atë kohë), **cilat elemente paraqesin vështirësi më të mëdha për përvetësimin e gjuhës së unifikuar?** Prof. R. Nesimi: *Të flitet për vështirësitë, do të thotë të përmenden shkurtimisht ato pak ndryshime në mes të toskërishtes e gegërishtes e këto kryesisht janë 3–4 elemente në fonetikë, si p.sh. kthimi i **a**–së hundore në **ë** para tingujve hundorë **n** dhe **m** e kjo bëhet për t'u zhdukur i ashtuquajturit nazalitet. Kështu kemi: hana – hëna, kamba – këmba etj. Element tjetër është edhe kthimi i diftongut të gegërishtes **ue** në **ua**, p.sh. grue – grua, mue – mua etj; por jo edhe te mbiemrat foljorë që formohen me prapashtesën – **shëm**, –**shme**, si: i lexueshëm e lexueshme, i durueshëm e durueshme si edhe ca emra foljorë që mbarojnë me **ues**, si: mësues, mësuese; lundruet, kallëzues etj. por me këtë rast duhet theksuar se çështja e këtyre emrave akoma është e diskutueshme, veç tjerash, thekson prof. Nesimi.⁴⁷*

5. **Pse u morr toskërishtja si bazë për gjuhën e përbashkët?**⁴⁸ *Fakti që quhet gjuhë e unifikuar apo e përbashkët do të thotë se për formimin e saj janë marrë elemente nga të dy kryedialektet e shqipes. Megjithatë, në pikëpamje të fonetikës gjuha e unifikuar më tepër është bazuar në elementet fonetike toske dhe atë me të drejtë. Në radhë të parë duhet përmendur se dialekti i jugut që me kohë ka qenë më i përpunuar. Përveç kësaj në këtë dialekt kemi një tingëllim më melodik gjë që ligjërimin e bën më muzikor, prandaj*

⁴⁶ Po aty.

⁴⁷ Gazeta „Flaka e vëllazërimit” (kulturë, arsim, shkencë, zbavitje, humor..., nr 975/6 e enjte, 5 mars 1970, f. 2.

⁴⁸ Gazeta „Flaka e vëllazërimit” (kulturë, arsim, shkencë, zbavitje, humor..., nr 977/8 e enjte, 19 fror (shkurt) 1970, f. 2.

shqipja radhitet ndër gjuhët më melodike të botës. Që toskërishtja është më melodike flet edhe denazalizimi i tingujve hundorë të gegërishtes, – shkruan prof Nesimi.⁴⁹

6. Kryedialektet e shqipes kanë edhe ndryshime në fondin e fjalëve, si p.sh. *fshat – katund, qumësht – tambël* etj. Ç'mendoni për fatin e këtyre fjalëve në gjuhën e përbashkët? Prof. R. Nesimi: *Është e vërtetë se dialektet, përveç elementeve të tjera, ndryshojnë në mes tyre edhe në pikëpamje të fjalorit. Për fat të mirë, ndryshimet e këtilla në mes dy kryedialekteve të shqipes janë minimale, gjë që edhe e lehtësojnë procesin e unifikimit të kësaj gjuhe. Por disa fjalë si: *tambël, katund, katundar* mendojmë se do të mbeten si dialektizma, – shkruan profesori në fjalë i gjuhës shqipe.*

II. Pastërtinë e gjuhës në fushën e fjalorit, në kuptimin e mënjanimin të fjalëve të huaja të panevojshme, por edhe ndikimeve të maqedonishtes mbi shqipen në fushën e gramatikës do ta nxisin që prof. R. Nesimi të bëjë përpjekje të vazhdueshme gjatë punës së tij për t'i mënjeluar e për t'i zëvendësuar me fjalë shqipe si dhe kallet sllave për t'i zëvendësuar me ndërtime sintaksore të shqipes. Nga ndikimet sllave në fushë të sintaksës, profesori në mënyrë të veçantë trajton fjalorin e meshkujve, te të cilët përveç elementeve leksikore sllave, vëren edhe ndonjë ndikim në fushë të sintaksës, përkatësisht në ndërtimet sintaksore me lidhëza të maqedonishtes. Ndër këto, përdorim më të dendur ka lidhëza **a**, për të cilën në gjuhën e shkruar përdoren lidhëzat *ndërsa, kurse*, si edhe lidhëza bashkërenditëse *e*. P.sh.: *Ata kit qejf se pasha na e dha dorën, [a] Osman Arnauti u bo mazun. Ene folin ene qeshin, [a] burri po i sheh e z'don me i çel sait. Ene zon me pisëllaue, [a] askerët po çuditen. [A] kur u kthaie, s'ja ka dhon.*

III. Nga ana tjetër, botoi mjaft tekste shkollore (Gramatika të gjuhës shqipe për shkollat filllore dhe ato të mesme), monografi shkencore, artikuj shkencorë etj. Librat e tij për sintaksën e shqipes, qofshin

⁴⁹ Po aty.

tekste shkollore a studime dialektore, padyshim kanë një vlerë të veçantë në krijimtarinë e tij.

Studimet e prof. Remzi Nesimit në fushën e sintaksës. Ai ka dhënë një ndihmesë të vyer në studimin e sintaksës së gjuhës shqipe, duke hartuar disa “*Sintaksa të gjuhës shqipe*” që kanë shërbyer si tekste shkollore për shkollat filllore dhe për shkollat e mesme në Maqedoni. Teksti shkollor me titull *Gramatika e gjuhës shqipe për shkollat e mesme II (SINTAKSA)* me bashkautor mr. Valbona Toskën, do të jetë objekt yni për kontributin e tij në këtë fushë. Kjo vepër ka shërbyer si tekst mësimor edhe për arsimin e lartë (është përdorur, por edhe vazhdon të jetë literaturë plotësuese për studentët e katedrave të gjuhës shqipe në Shkup e Tetovë, por edhe për studentët e Fakultetit të Pedagogjisë në Shkup, Tetovë e më gjerë) për përgatitjen e mësimeve të ardhshme të gjuhës shqipe. Objekt yni i studimit gjithashtu do të jetë edhe një pjesë e studimeve të sintaksës popullore (pjesë e monografisë shkencore me titull, “*E folmja e Dërvenit*”, fq. 375 – 390).

Teksti shkollor Gram. 2, SINTAKSA ka 170 faqe. Fillon me njohuri të përgjithshme të sintaksës si pjesë e gramatikës për të cilën jep këtë përkufizim: *Sintaksa është ajo pjesë e gramatikës, e cila merret me bashkimin e fjalëve në togfjalësh e në fjali, sipas rregullave sintaksore dhe në këtë mënyrë na bën të mundur t’i shprehim drejt mendimet tona* (fq.3). Tregon edhe rëndësinë e madhe që ka sintaksa si disiplinë shkencore. Themeluesin e saj, gjuhëtarin grek Apolon Diskolin e trajton po aty (fq.3) duke e përfshirë edhe përkufizimin e tij, që prej shekullit II të e.s. për sintaksën: “*Sintaksa është shkencë e fjalisë dhe e funksionit të fjalëve të saj*”. Ky përkufizim, vërtetë është ashtu siç e thotë prof. Remziu, se gjer në ditët tona nuk e ka humbur aktualitetin.

Dihet se sintaksa ndahet në 1. sintaksën e fjalisë dhe 2. sintaksën e periudhës. Në kapitullin II, *Sintaksa e fjalisë* përfshin faqet 15 deri në 86 të librit. Fillon me fjalinë si njësi sintaksore duke përfshirë tipat e fjalive sipas llojit të kumtimit (dëftore, dëshirore dhe nxitëse,

pyetëse); fjalitë pohore dhe mohore; fjalitë sipas ndërtimit (njëkrye–gjinymtyrëshe, të paplota, dykryegjinymtyrëshe).

Rreth gjnymtyrëve kryesore të fjalisë, kryefjalën dhe kallëzuesin e në veçanti llojet e kallëzuesit prof. R. Nesimi mbështet në Gr. e Akad. (GRAMATIKA E GJUHËS SHQIPE 2, ASHSH, IGJL, Tiranë, 2002), dhe dallon kallëzuesin foljor (të thjeshtë dhe të përbërë) dhe kallëzuesin emëror. Përshtatjen e kryegjinymtyrëve, pra të kallëzuesit me kryefjalën e trajton në faqet 35–36 të librit. Tregon se kallëzuesi foljor përshtatet me kryefjalën në vetë dhe në numër, d.m.th. në çfarë numri dhe vete përdoret kryefjala, në atë vetë dhe numër përdoret edhe kallëzuesi. Po i japim edhe shembujt: *Unë shkruaj. Ti lexon. Dritani vizaton. Ne përparojmë. Ata janë përgatitur.* Pas-taj edhe rastet ku kemi dy ose më shumë kryefjalë atëherë kallëzuesi është në numrin shumës, si: *Beni dhe Goni merren me sport. Gazmendin më të vëllanë u kthyen në fshat.* Kur si kryefjalë janë përemrat vetorë të vetave të ndryshme, atëherë kallëzuesi përdoret në numrin shumës dhe në vetën më të vogël: *Ti dhe ai ke përparuar mjaft. Ne, ju dhe ata i ndjekim rregullisht mësimet.* Në vetë dhe numër edhe kallëzuesi emëror (KE) i përshtatet kryefjalës, përkatësisht pjesa foljore e (KE), ndërsa pjesa emërore sidomos e shprehur me mbiemër, i përshtatet kryefjalës në gjini dhe jep këta shembuj: *Luli është mjek. Teuta është mjekë. Rrushin është i ëmbël. Molla është e ëmbël.*

Në **shënimin 1** paraqet edhe ato raste kur pjesa emërore e KE shprehet me emër, atëherë mund edhe të mos i përshtatet kryefjalës në gjini: *Hëna është trup qiellor. Tetova është qytet i bukur.* Ndërsa në **shënimin 2** rastet kur kryefjala e fjalisë shprehet me ndonjë emër përmbledhës si *bota, njerëzia, rinia* etj., kallëzuesi mund të përdoret edhe në njëjës edhe në shumës: *Bota flasin dhe Bota flet. Njerëzia mendojnë ndryshe dhe Njerëzia mendon ndryshe. Janë mbledhur gjithë rinia dhe Është mbledhur gjithë rinia.* Qëndrim të njëjtë mban edhe Gr.A. (fq.199). Megjithatë, mendoj se duhet të përcaktohet një rregull sintaksore për këto situata,

përdorimi i kallëzuesit në njëjës do të ishte më mirë të mbetet si rregull e Sintaksës së shqipes standarde, (për më gjerë shih: Sulejmani, 2010), këtë qëndrim e mban edhe R. Memushaj në librin e tij *Shqipja standarde (si ta flasim dhe ta shkruajmë)*. E paraqita këtë vetëm se u dha rasti e jo për ndonjë qëllim tjetër. Fundja s'është forma e vetme dyshe në shqipe që pret/sin zgjedhjen e njëjës) pra: *Bota flet* e jo: *Bota flasim*.

Gjymtyrët e dyta të fjalisë: *përcaktorin, kundrinorin* dhe *rrethnarin* (si më të dallueshme) dhe gjymtyrën e krahasimit, gjymtyrët homogjene, gjymtyrët e veçuara, fjalët dhe togjet e fjalëve të ndërmjetme si dhe rendin e gjymtyrëve të fjalisë i përfshinë në faqet (36 – 85) të librit në fjalë.

Kapitulli III dhe i fundit i kushtohet periudhës. Duke dhënë njëhuri të përgjithshme për këtë njësi sintaksore e fillon këtë kapitull. Sipas marrëdhënieve a raporteve të fjalive, periudhat i ndanë në: 1. periudha me bashkërenditje; 2. periudha me nënrenditje; 3. periudha asindetike.

E pashë të arsyeshme të tregoj një dukuri, përkatësisht përfshirjen e lidhëzës *ndërsa* edhe si lidhëz bashkërenditëse (përqasore–kundërshtore), edhe si lidhëz nënrenditëse (kohore) që prof. Remziu e trajton në librin e vet. Në Gr.A kjo lidhëz trajtohet vetëm si lidhëz kohore e jo si përqasore–kundërshtore. Për mendimin tim, kjo lidhëz duhet të përfshihet ashtu siç e trajton profesori.

Disa fjalë më tepër përfunksionin sintaksor i lidhëzës *ndërsa* në periudhë dhe trajtimi i saj në Gramatikën e gjuhës shqipe për shkollat e mesme II (SINTAKSA) (Gr.2 Sint.). Lidhëza *ndërsa* në gjuhën shqipe, mund të përdoret edhe në funksionin e lidhëzës bashkërenditëse, që bashkon dy pjesë të njëjta të periudhës, edhe në funksionin e lidhëzës nënrenditëse, që bashkon një pjesë të varur me një pjesë drejtuese të periudhës (shih më tepër: Sulejmani, 2013 : 111–118). Në Fjalorin Shpjegues të Gjuhës Shqipe, për lidhëzën *ndërsa* jepen këto sqarime: 1. *Përdoret përpara një fjalie të varur që*

tregon një veprim, i cili kryhet njëkohësisht me veprimin e shprehur në fjalinë kryesore; 2. Përdoret përpara një fjalie të bashkërenditur që tregon një veprim a gjendje të kundërt me veprimin a gjendjen e shprehur në fjalinë tjetër; 3. Përdoret përpara një fjalie për të përqsaur veprimin ose gjendjen e shprehur në fjalinë tjetër. Në Gr.2 Sint. këtë lidhëz e përfshijnë edhe si lidhëz bashkërenditëse edhe si nënrenditëse (fjalitë e varura kohore). Në Gr. e Akad. kjo lidhëz na paraqitet vetëm si lidhëz kohore e jo si lidhëz përqsasore–kundërshtore. Aty tregohet se në shqipen e sotme letrare përdoren këto lidhëza përqsasore–kundërshtore: *po, por, mirëpo, porse, kurse*; pa pjesëzat–lidhëza: *vetëm, veç*; lidhëzat: *veçse, vetëm se* (2002 : 469). Prof. Remzi Nesimi në Gr.2 Sint. fq. 93 shkruan se fjalitë e bashkërenditura kundërshtore bashkohen me anë të lidhëzave bashkërenditëse: *po, por, mirëpo, kurse, ndërsa, megjithatë, megjithëkëtë, veç, vetëm, vetëm se*. Dhe jep shembujt: *Në të thatë njihet kroi i mirë, ndërsa miku njihet në ditë të vështirë. Shkenca i zbulon të fshehtat, ndërsa njeshtëria i krijon gjërat* (këtë në ushtrimin 81). Te fjalitë kohore (temporale) thuhet se lidhëza *ndërsa, kur, tek, sa sa kohë që* përdoren për të shprehur marrëdhënie të njëkohësisë (Nesimi; Toska, 2001 : 115). Edhe në Gr. e Akad. është e përfshirë në periudhat me marrëdhënie të njëkohësisë. Lidhëza *ndërsa* tregon njëkohësi të veprimeve pa ngjyrimin e përsëritjes: *Ndërsa Guri shikonte në dritare, ë oborr të mullirit kërcitën rrobat e një qerreje* (2002 : 542–544).

Lidhëza *ndërsa* në studimet dialektologjike, përkatësisht te monografia shkencore, “E folmja e Dervenit”. Në pjesën dërmuese të kërkimeve dialektologjike nuk flitet aspak për veçoritë sintaksore të të folmeve që studiohen, madje edhe në disa studime të gjuhëtarëve të njohur si Menella Totonit, Mehmet Çelikut, Bahri Becit, Mehmet Halimit etj. çështjet sintaksore trajtohen fare shkurtimisht, thekson prof. R. Nesimi (Nesimi, 2008 : 375). Megjithatë, siç e përmendëm më lart se prof. Remziu ia kushton 15 faqe sintaksës në këtë monografi, me të cilën sjell një pasqyrë shumë të

qartë të dukurive sintaksore të së folmes së Dervenit. Nga fjalitë e nënrenditura rrethanore një përdorim më të gjerë kanë fjalitë kohore. Këto lloj fjalish, ndërtohen thuajse me po ato lidhëza që përdoren edhe në gjuhën e shkruar e meqë mjetet lidhëse janë të shumta, fjalitë kohore dalin më të larmishme (fq.386 –387). Për këtë flasin edhe shembujt: *Kur ta zone burin xhumi*, kom me ja pre krajet. *Sa najsin me ngon buk, ni pusto mac e prekën. Njersa (derisa) t’vaj unë, mos ja vin emrin. Mbasi han buk, e ngre traisën. Tu (duke) dal pi dere, u zatek me najpin*. Kryesisht në këtë të folme fjalitë kohore përdoren në inversion, por ato përdoren edhe pas fjalisë kryesore. Ja shembujt nga monografia e profesorit: *Rraini (rrini) ene pak sa t’i sosi punët. Nait (ndenji) njer te (deri sa) erdh baba*. Ajo që e karakterizon këtë të folme është mos përdorimi i lidhëzave kohore: *ndërsa, sapo, porsa, tek, sapa* e ndonjë tjetër, por hasim konstrukte edhe me shprehjet *çish kur, sa her ç* (fq.387).

Mund të thuhet se përdorim të dendur kanë edhe periudhat me marrëdhënie kundërshtore, të cilat kryesisht bashkohen me lidhëzat: *amon, mairpo, mairaman*, dhe *po*. P.sh.: *E marr, amon nuk e pi duhanin. Po, oj non, po amanetin sun ta prauna*. Edhe te periudhat me bashkërenditje, në të folmen e Dervenit, lidhëza **ndërsa** nuk përdoret si lidhëz përqsore–kundërshtore. Nuk përdoren edhe lidhëzat: *kurse, por, prapëseprapë, megjithatë, megjithëkëtë*. Fjalitë kundërshtore në ndonjë rast i hasim në formë asindetike: *Un do shkoj te grai vorrin, taj gjere mbrapa nonën*.

Përshtatja e gjymtyrëve të fjalisë në monografinë “E folmja e Dervenit”. Kjo e folme, pra e folmja e Dervenit nuk paraqet ndonjë përjashtim nga të folmet e tjera të arealit gegë. Duhet përmendur se përcaktorët mbiemërorë, kur u referohen emrave që shumësin e formojnë me prapashtesën –e, atyre në shumës u përshtaten sipas gjinisë femërore: *vende t’larkta, sende t’maira, male t’nalta* etj., (Nesimi, 2008 : 379).

Në dallim nga gjuha e shkruar (shqipja standarde) e në përputhje me disa të folme geqe (Nesimi, 2008 : 380), në togfjalëshat emërore

të formuar me një emër dhe përemër dëftor, emrat zakonisht përdoren në trajtë të shquar. P.sh.: *Unë s'i fraigna ataj azgonit. Athere i mur ata askerët ene i çiti n'granic. Shaum azgon ki burii i ksaj t'kojshis. Ajo gruja nauk e kishte dasht burrin e vet. Shkojn te dera e kuaj mbretit.*

Trajtimi i kryegjymtyrëve të fjalisë në këtë monografi. Në këtë të folme kallëzuesi foljor mund të jetë edhe i përbërë e në raste të këtilla, siç dihet, ai shprehet me një folje gjysmëndihmëse modale apo që tregon fillimin e veprimit dhe me një folje themelore, e cila përdoret paralelisht në mënyrën lidhore dhe në formën e paskajores: *Nais t'shkoje n'lavër. Vetë duhet t'shkojsh ta kërkujsh. Najset t'vaje. Zu t'bërtase. Zon t'larojn; dhe: Duhet me punaue; najsi me hongër; naiset me shku n'sheher; zu me kajt; a mundem me i marr?* etj. Megjithatë, krahas këtyre dy formave, në disa raste të rralla folja themelore përdoret edhe në mënyrën dëftore dhe bashkohen me lidhëzën *e*. *Ajo zen e kan se s'di xhit bon motra. Ato zon e i raujn dhent.* Në raste të rralla si folje gjysmëndihmëse përdoret edhe folja marr, *Merr t'kallzoje*, vëren prof. Remzi Nesimi.

Karakteristikë tjetër e kallëzuesit në këtë të folme është edhe përsëritja e kallëzuesit për të treguar zgjatjen dhe përsëritjen e veprimit. P.sh.: *Bon sa bon muhabet, mbasandaj u derdhën. Hongër sa hongër e qetrën va fugi çenve. Laron sa laron, dikur hunxhet t'haje buk. T'u fkat, t'u fkat kishte mbraj te shpajja e Selmonit.*

Vendi i kryefjalësnë fjali. Kryesisht përdoret para kallëzuesit, por në fjalitë pyetëse të drejta e të zhdrejta, në fjalitë dëshirore si edhe në fjalitë e varura kohore kushtore etj., në pjesën më të madhe ajo përdoret pas kallëzuesit: *A erdh Hasipi? Ku do shkojsh taj? Pse u vonaut ju? T'rrofshin gjemt? I raft damlla? Kur d'vajn ment, hikin dhent. N'kofit çu vajn Emini, do vaj ene une* etj. Siç shihet, si në gjuhën e shkruar, në këtë lloj periudhash me inversion kryefjala përdoret pas kallëzuesit edhe në fjalinë kryesore.

Kongruenca e kallëzuesit me kryefjalën. Te fjalitë dykryegjym–tyrëshe të kësaj të folmeje, kallëzuesi i përshtatet kryefjalës sipas vetës e numrit, por ka raste edhe të përshtatjes sipas kuptimit. Kjo e fundit ndodh kur si kryefjalë janë disa emra, të cilët me formën e njëjësit tregojnë shumësin, si *askerija, dunjoja, hallki, mileti* e ndonjë tjetër. Në këtë të folme, në raste të këtilla kallëzuesi përdoret kryesisht në shumës, si p.sh: *E murrën askerija ni deve ene e çitën me e shait n'pazar. Askeri kur e pan se kjo nausja ishte e mair shoum, e hupën menden. Insoni bohen pa hesap* (mblidhen shumë njerëz). Edhe pse mjaft rrallë, por paraqiten raste kur kallëzuesi përdoret në njëjës: *U çudit kit askeri.* Tjetër karakteristikë e kësaj të folmeje janë rastet e përdorimit të kallëzuesit në numrin shumës kur si kryefjalë është përemri i pacaktuar *sicalli* “secili”. P.sh.: *Ene sicalli t'ken ka n mushk allton.* Po kështu është karakteristikë se kur këta emra janë në funksion të kundrinës, trajtat e shkurtra që e përsëritin kundrinën, përdoren në shumës. P.sh.: *U kallëzoj kit dyngjos, ene më para Turkija i linte askerin pa buk. I fkatën krali at miletin e vet etj.*

IV. Për në fund dua të them se vërtetë është një kënaqësi dhe nder i madh për mua që të shkruaj e të prezantoj në këtë sesion shkencor të organizuar nga ITSHKSH–ja për profesor Remzi Nesimin i cili në rend të parë shquhet si gjuhëtar e pedagog i shkëlqyer, por pa e anashkaluar edhe punën e tij si prijës e organizator edhe i konferencës shkencore me rastin e 20–vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe në Tetovë (1992). Frytet e punës së tij fisnike në shërbim të arsimit dhe të shkencës shqiptare, me theks të veçantë arsimit e gjuhësisë shqiptare që zhvillohet në këto treva shqiptare (sot Maqedonia e Veriut), me dashamirësinë dhe zemërgjerësinë e tij fisnike ka dhënë një ndihmesë të madhe edhe në përgatitjen e një plejade gjuhëtarësh të rinj.

Literatura e shfrytëzuar:

Nesimi, Prof. dr. Remzi, *E foluja e Dervenit*, botime të veçanta, Seminari Ndërkombëtar i Albanologjisë, Universiteti Shtetëror i Tetovës, 2008.

Nesimi Remzi; Toska Valbona, *GRAMATIKA e gjuhës shqipe për shkollat e mesme II (SINTAKSA)*, Prosvetno Dello SHA, Shkup, 2001.

Poloska, Agim, *Bibliografia e punimeve, studimeve, artikujve dhe monografive shkencore të prof. dr. Remzi Nesimit*, Shqyrtime albanologjike 5, Shkup, 1998, fq. 19–28.

Hamiti, Aslan, *Ndihmesa e profesor Remzi Nesimit për arsimin, shkencën dhe kulturën shqiptare*, FILOLOGJIA nr. 1, Universiteti Shtetëror i Tetovës, Fakulteti Filologjik, prill, 2013, fq. 101–110.

GRAMATIKA E GJUHËS SHQIPE 2, ASHSH, IGJL, Tiranë, 2002

Memushaj, Rami, *Shqipja standarde* (si ta flasim dhe ta shkruajmë), BOTIMET TOENA, Tiranë, 2005.

Sulejmani, Berton, “*Studimet për sintaksën e gjuhës shqipe të profesor Remzi Nesimit*”, Унив. „Св. Кирил и Методиј“ – Филолошки факултет „Блаже Конески“, годишен зборник (ANNUAL), КНИГА 39–40, зборник posveten na проф. д-р Ремзи Несими, по повод 80–годишнинта од раѓањето, fq. 97–104, Shkup, 2014.

Sulejmani, Berton, *Vështrim mbi disa fjali kohore me lidhëzën ndërsanë prozën e Ismail Kadaresë*, FILOLOGJIA nr. 1, Universiteti Shtetëror i Tetovës, Fakulteti Filologjik, prill, 2013, fq. 111–118.).

Shkurtesat:

Gr. e Akad. = GRAMATIKA E GJUHËS SHQIPE 2, ASHSH, IGJL, Tiranë, 2002.

Gr.2 Sint. = Nesimi Remzi; Toska Valbona, *GRAMATIKA e gjuhës shqipe për shkollat e mesme II (SINTAKSA)*, Prosvetno Dello SHA, Shkup, 2001.

BUKURIJE MUSTAFA

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore
të Shqiptarëve – Shkup*

VËSHTRIM MBI LIBRIN “УЧЕБНИК ПО АЛБАНСКИ ЈАЗИК” I REMZI NESIMIT DHE LEKSIONET PËR FOLËSIT JOSHQIPTARË

Gjuha për nga definicioni, shihet si një komunikim e që realisht në shoqërinë e në vendin tonë, po kthehet në çështje problemore, kur përballen dy bashkëbisedues që nuk njohin gjuhën e njëri-tjetrit. Në rrethana të këtylla, nevoja e përditshmërisë i bënë njerëzit të vetëdijshëm për mësimin e gjuhës së njëri-tjetrit. Kjo është baza e zbatimit praktik, por gjuha shqipe e shikuar në një kontekst tjetër, merr rolin e gjuhës që lidhet me gjuhët tjera fqinje dhe sipas këtij parimi, ajo bëhet ndihmëse e të kuptuarit të çështjeve të shumta gjuhësore ballkanike. Kjo e çon drejt praktikimit të gjuhës shqipe, që R. Nesimi dhe Gj. Shushka e bëjnë me hartimin e librit didaktik edhe atë jo vetëm shqip-maqedonisht, por edhe shqip-serbisht.

Gjurmët që lanë pas emra të ndryshëm studiuesish, mes të cilëve radhitet edhe emri i Remzi Nesimit në shkencën e albanologjisë, janë arritje për të cilat sot paraqesin referenca për studiues të shumë, të përfshirë edhe ata të degëve të tjera gjuhësore. Prof. dr. Remzi Nesimin, si njohës i mirë i gjuhës shqipe, ka arritur të jetë një nga personalitetet më të pranuar për rrethet e ndryshme akademike e shkencore. Njëherësh, personaliteti i tij prej pedagogu, për nxënësit e studentët, ka reflektuar si një njeri i urtë e i përkushtuar për të nxitur e për të nxënë njohurit e gjuhës shqipe. Fillimisht, që nga gramatikat e para, me të cilat jemi njohur që në bankat shkollore për të vazhduar rrugën e njohurive më vonë, si studentë, pedagogë a studiues. Studimi i vëmendshëm i profesor Nesimit, me një dia-

pazon të gjerë njohurish edhe të gjuhëve tjera,⁵⁰ ka krijuar gjuhëtarin, i cili ka trajtuar mënyrën më të mirë të shpjegimit e të sqarimit të çështjeve të gjuhës shqipe për studentët shqiptarë, por edhe për ata të huaj, që treguan interesim për të mësuar shqipen si folës apo si studiues, duke e vendosur atë në një kontekst më të gjerë gjuhësor.

Leksionet e gjuhës shqipe dhe kontaktet gjuhësore, në veçanti kur ato zhvillohen brenda një konteksti ndër-gjuhësor e ndërkulturor, sado që të jenë të ndryshme, kanë nxitur interesimin për të mësuar gjuhën e njëri-tjetrit.

Teksti më i përmbledhur i leksioneve të gjuhës shqipe i punuar nga dy studiues, dr. Remzi Nesimi dhe Gjustina Shushka, është “Libri i gjuhës shqipe” i vitit 1989. Një version i ngjashëm i këtij libri, shqip-serbisht për folësit e huaj është botuar më vitin 1987.⁵¹ Në këtë tekst didaktik, që llogaritet si tekst i parë i këtij lloji, autorët theksojnë grupin e studentëve joshqiptarë, të cilëve u dedikohet ky libër e që u shërben në studimin e mëtejshëm të tyre, në veçanti të grupit që merren me çështje ballkanistike, e që studionin në Fakultetin Filologjik të Shkupit. Mirëpo, ky libër ka gjetur përdorim më të gjerë, duke pasur parasysh se e kanë përdorur edhe të tjerë të interesuar, për të mësuarit e shqipes. Në libër përmbahen 22 leksione të shkruara në gjuhën shqipe dhe në kuadër të këtyre teksteve, po ashtu i është dhënë kujdes përfshirjes më të gjerë të teksteve, duke marrë parasysh se në të thuhet se 17 tekste janë të letërsisë shqiptare dhe të tjerat janë të letërsisë jugosllave e botërore. Në fund të teksteve të shkruara shqip, jepen fjalët e reja të përkthyer në gjuhën maqedonase.

⁵⁰ Të dhënat biografike tregojnë se ka njohur mirë edhe gjuhët tjera, si frëngjishten, serbishten e maqedonishten dhe shpesh i vë në një paralele krahasimi për të qenë më i kuptueshëm në sqarimin e çështjeve gjuhësore të shqipes.

⁵¹ Libri në fjalë, ka një botim të mëhershëm, në bashkautorësi Nesimi-Shushka, në Prishtinë në vitin 1987. Avzi Mustafa, “Kontributi i Remzi Nesimit në hartimin e teksteve shkollorë”, Годишен зборник, кн. 39-40, Скопје, 2013-2014, 43.

Libri në fjalë është i ndërtuar sipas modelit të gramatikave të mëhershme të profesorit të nderuar Nesimi, duke pasur parasysh vështirësitë e folësve të huaj, të cilët nuk e njohin natyrën gjuhësore të shqipes. Kështu, njohuritë bazike për të huajt janë të përmbledhura që në hyrje, ku fillimisht jepen njohuri të përgjithshme rreth gjuhës shqipe dhe përdorimit të saj, një vështrim i shkurtër mbi veçoritë dalluese në mes dy kryedialekteve, histori e shkurtër e njësimit të gjuhës shqipe etj.

Sistemi i alfabetit i shqipes prej 36 shkronjash është sfida e parë për studentët që në gjuhën e tyre kanë më pak, mirëpo shqiptimi i zanoreve, ashtu si edhe i bashkëtingëlloreve, jepen duke u krahasuar me gjuhët si maqedonishtja e serbokroatishtja, por edhe me frëngjishten, që më me lehtësi dhe më saktë të shqiptohen nga folësit joshqiptarë dhe të gjejnë zbatim praktik në të lexuarit e në të folurit. Në këtë drejtim, ajo plotësohet edhe me transkriptimin fonetik, që jepet në tabela të caktuara, duke dhënë shembuj të përdorimit konkret.

Kategoritë morfologjike jepen përmes shembujve të shumtë dhe siç i quajnë autorët “elemente strukturore të gjuhës shqipe”, me qëllim që të kuptohen mënyrat e ndërtimit të fjalive dhe zbatimi në të folur. Kështu leksionet e morfologjisë fillojnë me kohët e foljeve dhe me foljet ndihmëse, si dhe përenrrat, për të vazhduar me leksionet që mbështeten kryesisht në përsëritje dhe në vazhdimin e zgjerimin e njohurive të tjera, të kategorisë së numrit, gjinisë, sistemit rasor etj. Nuk mungojnë as njohuritë rreth sistemit të numërimit apo të operacioneve të thjeshta matematikore, ato të kalendarit apo fjalët e pandryshueshme, duke përfshirë këtu llojet e ndajfoljeve, parafjalëve, lidhëzave, pjesëzave e pasthirmave. Në aspekt të sintaksës dhe topikës së fjalëve, i mësojnë mjetet e ndërtimit të fjalive të thjeshta të formës së pyetjeve apo të përgjigjeve të shkurtra. Secili tekst përmban njohuritë rreth një kategorie gramatikore dhe përfundojnë me ushtrime që përmbajnë detyra të caktuara dhe ndërliqhen me atë që kanë mësuar.

Një tërësi përmbajtjesore është fondi leksikor me leksema të përkthyer nga shqip në maqedonisht dhe një fjalor dygjuhësh në fund të librit, e që autorët e thonë se ka diku 2000 fjalë. Ky është një fond bazik i fjalëve, mirëpo ofron mundësinë e zgjerimit edhe në rrafshin semantik. Të vendosura në një kontekst paralel të përdorimit të shprehjeve frazeologjike, autorët thonë: “jepen numër i madh i shprehjeve frazeologjike dhe proverba me fjalë të ndryshme dhe përkthim adekuat në maqedonishte, në të cilat vijnë në shprehje elementet e përbashkëta të shqipes dhe maqedonishtes si gjuhë ballkanike”.⁵²Në këtë drejtim, shqipja dhe maqedonishtja, si degë të ndryshme gjuhësore, reflektojnë ngjasime të caktuara gramatikore, sidomos në atë të rrafshit leksikor e që rezultojnë nga kontakti i gjatë gjuhësor, duke qenë se të dyja gjuhët i takojnë gjuhëve ballkanike.⁵³

Ky libër ofron njohuritë bazë mbi kategoritë e ndryshme gramatikore e gjuhësore dhe me zgjedhjet e përgjigjet e dhëna në fund të librit, u mundëson të interesuarve të mësojnë edhe në mënyrë të pavarur autodidakte. Po ashtu, mund të konsiderohet edhe si libër doracak, që u ndihmon atyre që duan të mësojnë gjuhën shqipe dhe të vazhdojnë më tej me ndërtimin e konstrukteve gjuhësore me qëllim të komunikimit ndërkulturor apo shkencor e për të mbinëdërtuar aftësinë e komunikimit ndëretnik, që po krijon sfidën e vërtetë të kohës dhe të vendit tonë.

⁵² Ремзи Несими, Ѓустина Шушка, *Учебник по албански јазик*, 1989, Скопје, 7.

⁵³ N. Jokli për kontaktet gjuhësore të shqipes karshi sllavishtes i konsideron të nivelit gjeografik: “S’është fjala aspak për fakte thjesht të historisë leksikore, por në radhë të parë për ato të gjeografisë leksikore”. Norbert Jokl, *Studime historikokrahasuese për gjuhën shqipe*, Prishtinë, 2017, 339.

BIBLIOGRAFI:

Jokl, Norbert. Studime historiko–krahasuese për gjuhën shqipe, Prishtinë, 2017.

Несими, Ремзи–Шушка, Ѓустина. Учебник по албански јазик, 1989, Скопје.

Годишен зборник, кн. 39–40, Универзитет „Св. Кирил и Методиј“, Фило–
лошки Факултет „Блаже Конески“, Скопје, 2013–2014.

PËRVOJË E PAHARRUAR ME REMZI NESIMIN SI PEDAGOG I GJUHËS SHQIPE

Kohë më parë (nga viti 1998 – 2001) kur unë isha studente në Fakultetin e Filologjisë “Blazhe Koneski” në Shkup dhe anëtare e redaksisë së revistës “Rrezja”, kurse profesori Remzi Nesimi ishte ende në marrëdhënie pune dhe ishte mësimdhënësi im, unë pata nderin dhe kënaqësinë ta intervistoj atë e me kureshtjen dhe ëndjen më të madhe ta dëgjoj tek fliste për sukseset, përvojën dhe këshillat prindërore që na i jepte.

Profesori Remzi është "rrëmbyer" nëpër revista e gazeta të ndryshme, kurse tash po i kushtohet edhe sesioni shkencor “Kontributi i prof. Remzi Nesimit për gjuhën shqipe dhe gjuhësinë shqiptare”. Ai komentohet e përmendet nëpër revista, artikuj e debate të ndryshme, sepse vetëm vlerat e mëdha janë gjëra që vazhdimisht janë objekt komentesh e sepse, edhe epitetet përulen para tij.

Të kujtosh ngjarje të bukura nga e kaluara ringjall dhe ripërtërin edhe njëherë përjetimet... Me këtë shkas, në këtë kumtesë do të ndaj me ju përvojën dhe këndvështrimin tim për profesorin Remzi Nesimi si pedagog të gjuhës shqipe. Unë i takoj asaj gjenerate që kishte fatin të ketë ligjërues profesorët: Remzi Nesimi, Xhevat Gega, Haki Ymeri, Zihni Osmani, Avzi Mustafa dhe të gjithë profesorët e tjerë që sot i kam kolegë.

Koha lëviz. Unë kthehem e mplakur. Eca gjatë nëpër “shtigjet” e jetës të cilat herë ndriçojnë e herë nxihen, herë ka batica e herë zbatice. Vitet kalojnë, kurse kujtimet mbeten të paprekura. Ora ishte ndalur në çastin kur unë me kënaqësinë më të madhe qëndroja para profesorit tim për të përthithur këshillat, njohuritë dhe

përvojën e tij shumëvjeçare. Çfarë dite! E bardhë dhe e qeshur apo jo? Pa hetuar u futa në një shtëllungë të madhe mendimesh e bashkë me të u çenda në hapësirë.⁵⁴ E nga atje e solla kujtimin për prof. Remziun, i cili ishte i sinqertë, bujar, besnik, i urtë, modest, gjithmonë i buzëqeshur, arsimdashës, largpamës e patriot. Me një vetëdije të lartë kombëtare, i shtyrë nga dëshira e flaktë për arsimimin e shqiptarëve, për disa vite rresht ligjëroi në Universitetin (siç e quanin jolegal) të Tetovës edhe përskaaj rreziqeve e pasojave që mund të kishte asokohe.

Profesor Remziu është pishtar i arsimit të lartë në gjuhën shqipe në Maqedoni si dhe studiues i zellshëm i shqipes. Me punën e frytshme arsimore, shkencore e kulturore ka dhënë ndihmesë shumë të çmuar për përvetësimin e normës letrare në shkollat shqipe, në mediet e shkruara dhe elektronike në Maqedoni dhe përgjithësisht për kultivimin, pasurimin, ruajtjen e pastërtisë së shqipes nga elementet e huaja, në veçanti nga elementet sllave.⁵⁵

Kujtoj çastin kur isha ulur përballë profesorit në zyrën e tij dhe nga goja e tij dëgjoja kur më rrëfente, përvojën e tij në Kongresin e Drejtshkrimit ku kishte marrë pjesë me referatin me titull "Procesi i njësimin të shqipes letrare në Maqedoni"⁵⁶ ku si moto kishte vënë thënien e prof. Aleksandër Xhuvanit: "*Njësia e gjuhës është njësia e kombit*", e cila flet edhe për aspiratat e profesorit për bashkimin e kombit. Pastaj, profesori, më tregonte se si kujdesej për zbatimin praktik të normës letrare, duke qenë fillimisht si lektor në Redaksinë e botimeve "Rilindja" në Prishtinë, si edhe në atë të "Flakës së Vëllazërimit" në Shkup. Po kështu, dy vjet ka qenë si lektor edhe në Katedrën Albanologjike të Fakultetit të Filologjisë në Beograd.

⁵⁴ Ajten Hajdari, Rrezja ngel e përhershme, *Rrezja*, Viti II, Nr. 3, Shkup, 1998, f. 6-7.

⁵⁵ Asllan Hamiti, *Prof. Remzi Nesimi –pedagog, humanist dhe studiues i shqipes*, Shqyrtime albanologjike 5, Shkup, 1998, f. 11-18.

⁵⁶ Remzi Nesimi (Shkup), *Procesi i njësimin të shqipes letrare në Maqedoni*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Kongresi i Drejtshkrimit të gjuhës shqipe 20-25 nëntor 1972, Prishtinë, 1974, f. 139-142.

Këtë punë ai e kishte zgjeruar edhe duke e përhapur dijen e tij gjeneratave të reja gjatë kohës kur gati 11 vjet ushtroi detyrën e pedagogut dhe profesorit të gjuhës shqipe në Akademinë Pedagogjike "Kliment Ohridski" në Shkup, e më pas që nga fillimi i vitit 1975 deri 1998 në Katedrën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare të Fakultetit të Filologjisë në Shkup.

Po kujtoj edhe rrëfimin e tij për punët që kishte bërë kur ishte kryetar i Lidhjes së Shoqatave të Arsimitarëve të Gjuhës dhe të Letërsisë Shqiptare të Maqedonisë, ku ishte njëri ndër organizatorët kryesorë për përgatitjen e Konferencës Shkencore për shënimin e 20-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit dhe njëri ndër tre bashkëkryetarët e Konferencës. Ky takim, në të cilin morën pjesë gjuhëtarët më në zë të Shqipërisë, Kosovës e Maqedonisë, u mbajt në Tetovë në qershor të vitit 1992.

Është konsideratë e përgjithshme se ndër dijetarët më të shquar të gjuhësisë shqipe janë: Eqrem Çabej, Shaban Demiraj, Mahir Domi, Selman Riza, Idriz Ajeti, S. Prifti, Androkli Kostallari etj. Pas këtyre vjen brezi i dytë për nga mosha, shumica e të cilëve shquhen me veprimtarinë e tyre shumë të pasur në fushë të gjuhësisë shqiptare, siç është Mehmet Çeliku, Jup Kastrati, Jani Thomai, Besim Bokshi, Emil Lafë, Rexhep Ismaili, R. Përnaska, Seit Mansaku, M. Totoni, Gjovalin Shkurtaj, Xhevat Lloshi, Rami Memushaj e shumë të tjerë, kurse në Maqedoni ndër të parët radhitet Remzi Nesimi.

Ai me fytyrë të buzëqeshur më tregonte se: *“Nevoja e deshi që edhe ne studiuesit nga Maqedonia, krahas punës pedagogjike të merreni edhe me punë kërkimore. Si orientimi i shumicës nga ne ashtu edhe angazhimi im në radhë të parë kanë qenë përpjekje për ruajtjen e pastërtisë së gjuhës letrare në mediet, teksteve shkollore etj., si edhe studimi i të folmeve shqipe në Maqedoni. Madje edhe artikulli im i parë ka qenë pikërisht lidhur me ruajtjen e gjuhës sonë nga ndikimet e huaja. Për nevojat e shkollave tetëvjeçare e të mesme, bashkë me kolegët e tjerë, jam marrë edhe me hartimin e teksteve shkollore, përkatësisht të gramatikës së gjuhës shqipe. Po*

kështu, për studentët që shqipen nuk e kanë gjuhë amtare bashkë me dr. Gj. Shushkën hartuam edhe tekstin universitar "Gjuha shqipe" që është botuar edhe në Universitetin e Shkupit, edhe atë të Beogradit".⁵⁷

Profesori shumë shpesh na jepte edhe këshilla prindërore e na thoshte se studentët nuk duhet të regjistrohen në fakultet vetëm sa për të marrë një indeks, por që nga viti i parë duhet të përipiqen me të gjitha fuqitë e tyre që t'i plotësojnë mangësitë sa i përket kulturës gjuhësore dhe të arrijnë t'i përvetësojnë dhe zotërojnë lëndët e parapara me program. Ata, përveç përgatitjes së provimeve në mënyrë solide, duhet të lexojnë sa më shumë vepra letrare dhe me përkushtim të duhur.

Ai synonte për cilësi në arsim dhe thoshte: *"Në radhë të parë mendoj se duhet të reduktohet numri i madh. Të pranohen studentët më të aftë që me të vërtetë dëshirojnë të studiojnë dhe prej të cilëve mund të pritët të dalin krijues dhe studiues të mirëfilltë, ashtu siç ka ndodhur me disa që i kanë kryer studimet në këtë Katedër dhe sot punojnë në fusha të ndryshme të arsimit, të kulturës dhe të shkencës".*

Për çështjen e metodologjisë së punës dhe për të arritur sukses më të mirë profesori këshillonte, se duhet të angazhohen me seriozitetin më të madh dhe t'i shfrytëzojnë të gjitha metodat e mundshme edhe pedagogët, edhe asistentët. Gjithashtu, do të ishte mirë të testohen më shpesh studentët gjatë gjithë vitit akademik dhe se tani ka kushte që të shfrytëzohen metodat dhe mjetet moderne teknike.

Më kujtohen edhe urimet e këshillat që na i jepte profesori Remzi Nesimi për revistën "Rrezja", ku u botua intervista ime që ia bëra atij. Ai uronte që kjo revistë të arrijë suksese sa më të mëdha dhe të kryejë misione të rëndësishme si tribunë e të gjitha preokupimeve të studentëve, jo vetëm të katedrës sonë, por edhe të fakulteteve të tjera. *Dalja e revistës "Rrezja" – thoshte ai – do të luajë një rol të*

⁵⁷ Ajten Hajdari – Qamili, *Perla gjuhësore*, Shkup, 2018, f. 200 - 205.

rëndësishëm në shumë pikëpanje. Në radhë të parë, ai shpresonte se ajo do të bëhet vatër e frymëzimit dhe e nxitjes së studentëve për t'i bërë "belbëzimet" dhe çapitjet e para në krijimtarinë letrare, për të rrahur çështje të ndryshme letrare, për të trajtuar tema të ndryshme gjuhësore duke filluar nga drejtshkrimi, fonetika, morfologjia, sintaksa, dialektologjia etj. dhe rubrika, në të cilat do të luftohen veset dhe të gjitha dukuritë negative.

Këshillë tjetër e tij ishte se fjala e shkruar peshon dhe ngel e përherëshme, prandaj çdo gjë që botohet edhe në faqet e kësaj reviste duhet të peshohet dhe të gjykohet mirë. Meqë është revistë e studentëve të Katedrës së Gjuhës dhe të Letërsisë Shqiptare, në pikëpanje gjuhësore duhet të dalë e përsosur, pa asnjë mangësi dhe të shërbejë edhe si burim i formimit gjuhësor për të gjithë studentët. Përndryshe mund të ketë efekt të kundërt dhe të luajë rol negativ. Natyrisht, gjithnjë duhet pasur kujdes edhe lidhur me brendinë e artikujve dhe të punimeve, duke mos harruar edhe anën edukative të materialeve.

..... Tash po kthehem 21 vjet më vonë dhe shoh se përballë meje nuk qëndron më profesori Remzi, por gjenden plot dashamirë të tij, të cilët janë mbledhur sot këtu për ta madhështuar dhe nderuar punën, mundin dhe sakrificën e tij për shqipen dhe në përgjithësi për arsimin e shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut.

Bibliografia:

Ajten Hajdari – Qamili, *Perla gjuhësore*, Shkup, 2018.

Ajten Hajdari, *Rrezja ngel e përherëshme*, *Rrezja*, Viti II, Nr. 3, Shkup, 1998, f. 6–7.

Ајтен Камили, *Një intervistë me prof. Remzi Nesimi para 16 vitesh*, f. 85–91, Универзитет Св. Кирил и Методиј во Скопје, Филолошки факултет „Блаже Конески“ – Скопје, Годишен зборник, Книга 39–40, Скопје, 2014.

Asllan Hamiti, *Prof. Remzi Nesimi –pedagog, humanist dhe studiues i shqipes*, Shqyrtime albanologjike 5, Shkup, 1998, f. 11–18.

Remzi Nesimi (Shkup), *Procesi i njësimt të shqipes letrare në Maqedoni*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Kongresi i Drejtshkrimit të gjuhës shqipe 20–25 nëntor 1972, Prishtinë, 1974, f. 139–142.

ZEQIRIJA IBRAHIMI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore
të Shqiptarëve – Shkup*

ALBANOLOGU I PARË NË MAQEDONI

Emri i prof. Remzi Nesimit nuk është vetëm njëri nga emrat e profesorëve të gjuhës shqipe në Maqedoni, por ai është emri sinonim i albanologut të parë shqiptar në këtë hapësirë. Dhe, kur themi “albanologu i parë”, kjo shkon përtej përkufizimit kohor, pra jo vetëm si njeriu i parë shqiptar që u shkollua për albanologji. Ndonëse është e vërtetë se Remzi Nesimi është i pari ose ndër të parët nga Maqedonia që u shkolluan për albanologji, por më e vërtetë është se gjithçka që ka pasur të bëjë me albanologjinë në Maqedoni pas Luftës së Dytë Botërore e deri 10–15 vitet e para të shekullit të ri, ka qenë e lidhur me emrin e tij.

Përmes gjuhës standarde të identiteti kombëtar

I shkolluar në Beograd dhe i mbindërtuar shkencërisht në Prishtinë para gjuhëtarit më të mirë shqiptar të Kosovës së shekullit të kaluar dhe të këtij fillimshkulli, prof. Idriz Ajeti, Remzi Nesimi shumë shpejt u bë figura qendrore e albanologjisë shkencore në Maqedoni. Në kohën e viteve të '60-ta, kur politika serbe në ish Jugosllavi kishte filluar ta ndërtojë narracionin se në Jugosllavi jetonin “šiptari”, ndërsa në Shqipëri jetonin “albanci”, në mënyrë që të legjitimohet ndarja e shqiptarëve të Jugosllavisë nga ata të Shqipërisë, ishin pikërisht gjuhëtarët shqiptarë, në radhë të parë të Kosovës e të Maqedonisë, që në mënyrë elegante, përmes gjuhës shqipe, ndihmuan të ruhet identiteti unik kombëtar shqiptar dhe të mos lejohet të krijohen subidentitete. Pa marrë parasysh a ka pasur tendenca politike nga ana e Shqipërisë komuniste për vendosjen e dialektit toskë në bazën e gjuhës standarde shqipe, për çka sot mund të flitet

e të diskutohet, e vërteta është se Konsulta Gjuhësore e Prishtinës më 1968 e imponoi ndërtimin e një standardit të përbashkët gjuhësor, sepse vetëm ashtu mbeti e pandarë njëësia e kombit. Dhe, nëse në Shqipëri kjo u artikulua përmes gjuhëtarëve si Eqrem Çabej, Mahir Domi e Androkli Kostallari, ndërsa në Kosovë kjo ide identifikohet me Idriz Ajetin, në Maqedoni emri emblemantik i standardit ishte pikërisht Remzi Nesimi. Andaj, po të ilustronim kjo me një trekëndësh, njëri kënd sigurisht është emri i tij.

Nga perspektiva e sotme edhe mund të mos e jetë e qartë se pse është kaq e shumë e rëndësishme që gjuhëtari kryesor i albanologjisë shkencore në Maqedoni u rreshtua në anën e gjuhës shqipe standarde, sepse kjo mund të interpretohet si një temë thjesht linguistike ose qëndrim shkencor, por në perspektivën e historisë së ndërtimit të identitetit kombëtar shqiptar në Maqedoni kjo është shumë e rëndësishme. Falë këtij angazhimi, shqiptarët e Maqedonisë e gjetën veten si bashkëkombës me të gjithë shqiptarët e tjerë dhe falë këtij angazhimi, shkolla shqipe, libri shqip dhe media shqipe u zhvillua duke e përdorur gjuhën standarde shqipe, që për shqiptarët nuk është vetëm kodi i komunikimit gjuhësor, por është edhe indi lidhor i kombit. E, kur kundrohesh kështu, i bie të konstatohet se mbrojtësi dhe vizionari për mbrojtjen dhe kultivimin e këtij identiteti në Maqedoni ishte pikërisht prof. Remzi Nesimi.

Se kjo ishte kështu flet edhe fakti se në Kongresin e Drejtshkrimit ai ishte vënë të mbajë kumtesë i katërti me radhë, menjëherë pas prof. Mahir Domit, prof. E. Çabejt dhe prof. I. Ajetit. Kështu perceptohet prof. Nesimi në qarqet albanologjike shqiptare. Ndërkaq, në të mirë të qëndrimit tonë flet edhe motoja e referatit të tij “*Njëësia e gjuhës është njëësia e kombit*”, që ai e kishte sjellë si citat nga prof. Aleksandër Xhuvani.

Kjo e bën Profesorin tonë që të shqiptarët në Maqedoni, por jo vetëm, ta zërë vendin meritore të një iluministi, vizionari dhe përndritësi rilindës, që me mjeshtërinë intelektuale linguistike ia doli ta bëjë aktin më madhor kombëtar, duke i bashkuar edhe shqiptarët e

Maqedonisë në trungun e përbashkët kombëtar, duke e mbajtur gjallë kështu edhe kujtesën kolektive se, pavarësisht kufijve, ne jemi një komb i njëjtë.

Pjesëmarrja e prof. Nesimit në Kongresin e Drejtshkrimit nuk është vetëm një pjesëmarrje simbolike e një gjuhëtari shqiptar nga Maqedonia, ndonëse për nga radhitja e kumtuesve ai është në aso rendi, por – duke shprehur çdo respekt për të gjithë pjesëmarrësit e tjerë nga Maqedonia – e kemi patjetër ta themi se, megjithatë, ai ishte i vetmi që atje mund të fliste me kompetencë shkencore për gjuhën standarde shqipe, në përgjithësi, dhe për zbatimin e saj në Maqedoni. Për këtë arsye, ai do të jetë edhe njëri nga nënshkruesit e Rezolutës së Drejtshkrimit dhe, madje, atij do t'i jepet një kopje nga kjo rezolutë.

E, tash, kur edhe pak do të bëhen 50 vjet nga ai kongres, kopja e kësaj rezolute në Shkup, në shtëpinë e tij, është ndoshta dokumenti më i rëndësishëm që e kanë shqiptarët në Maqedoni për ta dëshmuar vendosmërinë e tyre për të qenë pjesë e pandarë e kombit. Dhe, sa më shumë kohë që do të kalojë, kjo rezolutë do të bëhet po aq e vlefshme sa edhe vendimi për alfabetin e shqipes në Kongresin e Manastirit më 1908 ose sa akti i shpalljes së pavarësisë së shtetit shqiptar. Këto janë dokumentet që në shekullin e kaluar e kanë ndërtuar identitetin kombëtar shqiptar, ndërsa një i tillë, pra, është nënshkruar edhe nga Profesori ynë dhe ruhet peng i këtij angazhimi pikërisht në familjen tij.

Shkolla shqipe dhe libri shqip

Profesor Remzi Nesimi nga viti 1962 e deri më 1999 (37 vjet rresht) ka punuar si pedagog i gjuhës shqipe, në fillim në Beograd, pastaj në Akademinë Pedagogjike në Shkup, për të përfunduar në Katedrën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare në Shkup. Gjatë kësaj kohe ai ka mbajtur mësim edhe në fakultete të tjera, ndërsa duke qenë ndër themeluesit e Universitetit të Tetovës, ka qenë mësimdhënës edhe aty, si edhe në Fakultetin e Shkencave Islame në

Shkup. Thjesht, jeta e tij ishte mësimdhënia e gjuhës shqipe. Në kohën kur shkolla shqipe në Maqedoni lëngonte për mungesë të kuadrit, ishin pikërisht Akademia Pedagogjike dhe Katedra e Gjuhës në Shkup “fabrikat” që e mbajtën gjallë shkollën shqipe. Dhe, në këto dy institucione pa dyshim që strumbullar i gjuhës standarde ishte pikërisht Profesori.

Sa për ta pasur të qartë se sa ka qenë e rëndësishme kjo, po themi se në kohën e themelimit të Normales (1947/48), Shkollës së Lartë Pedagogjike (1952), që më vonë kaloi në Akademia Pedagogjike (1961) dhe të Katedrës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare (1971/72) kishte aq pak kuadër shqiptar të kualifikuar për të mbajtur mësim, sa gjithnjë ishte droja se a do të arrihej të mbaheshin ato institucione. E kur kësaj i shtohet edhe mungesa e vullnetit politik për mirëmbajtjen e arsimit të lartë shqip në Maqedoni, që u dëshmuar më saktë në vitet e themelimit të Universitetit të Tetovës (1994–2004), mund të merret me mend se çfarë pune vetëmohuese ka bërë gjenerata e pedagogëve të asaj kohe.

Sot puna në universitet mund të jetë edhe privilegj dhe, mbase, edhe mirëqenie ekonomike, por në vitet kur Profesori ka punuar në universitet ajo ka qenë përtej kësaj. Përveç kujdesit nga llupa me të cilën pushteti vëzhgonte çdo intelektual shqiptar, ishte – në anën tjetër – edhe detyrimi kombëtar që, duke përgatitur sa më shumë kuadro të reja, të mbahet në këmbë një shkollë e të edukohet një brez. Dhe, për ata që e kanë njohur Profesorin personalisht (ndër të cilët e pandeh edhe veten), ka qenë gëzim i madh kur një student i tij ka shërbyer në një shkollë, sepse ashtu dukej se ai e përmbushte edhe një mision kombëtar.

Meqë në vitet e ’70–ta e këndej të shekullit të kaluar ishte koha kur konsolidohej shkolla shqipe, ai do të angazhohej edhe në punën e teksteve shkollore, qoftë si autor i gramatikave e librave të leximit, por edhe si përkthyes e redaktor gjuhësor në shumë tekste shkollore të shkollës fillore e të mesme, ashtu që nuk ka nxënës shqiptar në Maqedoni nga ato vite e deri në fund të shekullit që e

lamë pas, që nuk ka përdorur së paku një libër që ka kaluar nëpër duart e tij. Meqë në historinë kombëtare këto figura i kemi radhitur ndër iluministët e kombit, këtë rol nuk mund të mos ia njohim edhe Profesorit në kontekstin shqiptar në Maqedoni. Natyrisht ka këtu edhe emra të tjerë të respektuar, si prof. Xhevat Gega, prof. Hamza Reka etj., por edhe emri i tij është në grupin e iluministëve të shkollës shqipe në Maqedoni.

Veprimtaria shkencore

Kur flasim për librat, duhet të theksojmë se duke punuar në universitet dhe duke qenë i angazhuar me tekste shkollore, Profesorit nuk është se i mbetej shumë kohë edhe për vepra shkencore dhe pjesëmarrje në tubime shkencore. Megjithatë, nga bibliografia e tij e gjatë, e shohim se ai ka gjetur kohë edhe për këtë detyrim. Kështu, që nga viti 1960-të e deri më 2001 ai ka qenë pjesëmarrës në konferenca të shumta shkencore vendore dhe ndërkombëtare dhe ka botuar në periodikun shkencor të kohës, qoftë në gjuhën shqipe ose në gjuhë të huaja. Artikujt e tij i dedikohen rëndom gjuhës standarde, por edhe të folmeve shqipe në Maqedoni, që ishin një fushë specifike e punës tij shkencore, për të cilën ai shkruante po ashtu me shumë kompetencë.

Dhe, kur flasim për të folmet shqipe, këtu duhet vënë re një dimension që mbase është vërejtur më pak. I shtyrë sigurisht nga profesori tij, Idriz Ajeti, prof. Nesimi në disertacionin e tij të doktoratës do të punojë pikërisht për të folmet shqipe të Dervenit, duke prodhuar një vepër shkencore që edhe sot mbetet e patejkalueshme në studimet e dialektologjisë shqiptare. Megjithatë, ajo që duam të vëmë në spikamë është shtytja ose fryti i këtij angazhimi.

Si e para, duke u marrë me të folmet shqipe në Maqedoni, prof. Nesimi po e plotësonte një boshllëk në studimet e përgjithshme dialektologjike shqiptare. Pas Luftës së Dytë Botërore ishin bërë disa studime për të folmet shqipe në Shqipëri e Kosovë, por për të folmet e shqiptarëve në Maqedoni kjo mungesë shfaqej gjithnjë dhe

kjo ishte detyrë pikërisht e gjuhëtarëve shqiptarë në këtë gjeografi. Madje, ky përkushtim i tij do të shihet edhe në nxitjen e shumë studiuesve të tjerë që të merren me të folmet shqipe në Maqedoni. Duke punuar në Katedrën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare në Shkup, ai do të kishte mundësi që shumë studentë të tij t'i orientonte të punojnë mbi të folmet e shqiptarëve në Maqedoni, qoftë në punime diplomash, qoftë në punime të magistraturës ose doktoratës, duke mundësuar kështu që për më pak se 30 vjet të mbulohej me studime mirëfilli shkencore gati të gjitha të folmet shqipe në Maqedoni.

Kundruar nga aspekti shkencor, ky është një mision shkencor që është pritur prej tij dhe prej gjuhëtarëve të tjerë pas tij, por studimi i të folmeve shqipe në këtë hapësirë e ka edhe një dimension tjetër përtejgjuhësor. Prania e këtyre të folmeve, kontakti me gjuhët e tjera, zhvillimet gjuhësore, huazimet e ndërsjella, si dhe toponimia e leksiku i tyre, flasin për shtrirjen dhe autoktoninë e shqiptarëve në hapësirë, si edhe për kontaktin historik gjuhësor të shqipes me gjuhët e tjera që nga lashtësia. Kjo e bën studimin e të folmeve shqipe po aq të rëndësishëm sa edhe qëndrimi i Profesorit për gjuhën e njëzuar shqipe në periudhën e konsolidimit të kombit dhe të gjuhës në shekullin e kaluar. Prandaj, pa mohuar edhe rolin e studiuesve dhe gjuhëtarëve të tjerë që kanë kontribuar në këtë fushë, është për t'u veçuar kontributi i Profesorit, sepse – përveç përfitimit shkencor – me këto studime shqiptarët e Maqedonisë sot dëshmojnë edhe për autoktoninë e tyre në këtë gjeografi. Madje, edhe në kohën që ka kaq shumë migrim nga këto troje, gjurmët gjuhësore dhe veprat e krijuara për këto të folme mbeten dëshmi të palëkundura për praninë shqiptare në këto treva. Rrjedhimisht, ndonëse tërthorazi, kjo është një meritë që vetëm sot lexohet si kaq e rëndësishme dhe dobiprurëse për kombin shqiptar në republikën e re të Maqedonisë së Veriut.

Përfundim

Nëse personalitetet e mëdha maten me vepra, veprimtaria pedagogjike, tekstet shkollore, qëndrimi ndaj gjuhës standarde dhe ndaj identitetit të përbashkët kombëtar, si dhe studimi i të folmeve shqipe, janë të mjaftueshme që, pa ekzagjerime e patetizma, prof. Remzi Nesimin ta konsiderojmë ndër intelektualët më të rëndësishëm që kanë pasur shqiptarët në Maqedoni në 50–60 vjetët e fundit.

Për ata që e kanë njohur, ai do të mbetet në kujtimet e tyre personale edhe si njeri me shumë vlera e virtyte, ndërsa për brezat që vijnë do të jetë vepra dëshmi e punës së tij. Nëse shqiptarët e Shqipërisë, por edhe mbarë shqiptarët, mburren me prof. Çabejn dhe ata të Kosovës me prof. Idriz Ajetin, s'do mend se për shqiptarët e Maqedonisë Eqrem Çabej dhe Idriz Ajeti është pikërisht prof. Remzi Nesimi. Shprehur ndryshe, ai edhe për shumë kohë do të jetë letërnjoftimi albanologjik i shqiptarëve të Maqedonisë.

HIDAJETE AZIZI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore
të Shqiptarëve – Shkup*

KËNDVËSHTRIMI I PROFESORIT REMZI NESIMI PËR TOPONIMINË E IMPONUAR

Veprimtaria e profesorit Remzi Nesimi është shumëdimensionale. Merita e tij për kulturën shqiptare në përgjithësi e për atë të shqiptarëve të Maqedonisë në veçanti, për shkencat filologjike shqiptare në përgjithësi e për drejtshkrimin e gjuhës shqipe në veçanti, për shkollën shqipe e arsimin universitar (me botimin e teksteve shkollore e universitare) dhe për formimin e brezave të shumtë të filologëve shqiptarë në Maqedoni, është e pamohueshme. E pamohueshme është sidomos merita e tij për reflektimin te bashkëpunëtorët, te studentët e te të gjithë ata që i njihite, e një shembulli frymëzues për karakterin njerëzor, e një modeli për një personalitet me virtyte të shumta, e një modeli të cilin shumë nga ne vetëm do ta kishim lakmi.

Veprimtaria e profesorit është e shumanshme edhe brenda fushës së gjuhësisë. Megjithëse veprimtaria e prof. Remzi Nesimit fokusohet rreth ruajtjes e kultivimit të standardit të gjuhës shqipe dhe rreth studimit të të folmeve shqipe në Maqedoni, ai nuk ka lënë pa prekur edhe shumë segmente të tjera të gjuhësisë. Një ndër to është edhe toponimia, një fushë mjaft delikate. Ndër shkrimet e profesorit që trajtojnë toponiminë po përmendim një artikull me titull “*Disa veçori strukturore dhe fonetike të toponimeve të rrethit të Tetovës*” (1977: 35) dhe një tjetër ku trajton toponiminë e rajonit të Kërçovës, me titull “*Për disa toponime dhe mikrotoponime në rajonin e Kërçovës*”.⁵⁸ Në këta artikuj, toponimet e mikrotoponi-

⁵⁸ Artikull të cilin e kemi siguruar nga arkivi familjar, i shkruar në gjuhën maqedonase, e për të cilin nuk kemi njohuri nëse është botuar apo jo.

met janë trajtuar nga aspekti gjuhësor, me theks të veçantë në rrafshin morfologjik, por në disa raste edhe në rrafshin etimologjik. Në punimin tonë nuk do të ndalemi në trajtimin e studimeve gjuhësore që ka bërë profesori në lidhje me toponiminë në artikujt e sipërpërmendur. Kësaj radhe jemi munduar të parashtrojmë një çështje akoma më delikate se vetë toponimia, respektivisht çështjen e toponimisë së imponuar. Në fokus do të kemi qëndrimin e profesorit në lidhje me këtë çështje.

Se çfarë do të thotë toponimi e imponuar e dinë të gjithë ata të cilët kanë qenë dëshmitarë, ashtu siç jemi edhe ne, të një kohe kur na janë imponuar edhe shumë gjëra të tjera, e madje edhe na janë bërë të detyrueshme me ligj. Qe kjo kohë kur pas demonstratave të 81-shit në Kosovë, u bënë një sërë ndryshimesh që vështirësuan dukshëm jetën shoqërore e politike për shqiptarët në ish-Jugosllavi, e sidomos në Republikën Socialiste të Maqedonisë, si një ndër republikat më të dalluara për fushatën antishqiptare në Jugosllavi. Në një intervistë të tij në “Fjala”,⁵⁹ prof. Nesimi do të shprehet kështu: “...Kjo Republikë disi u bë poligon eksperimentesh që më vonë ato të zbatohen edhe në Kosovë...”. Fushata antishqiptare, që zhvillohej në emër të luftës kundër “nacionalizmit, irredentizmit dhe separatizmit shqiptar”, preki deri në palcë sidomos intelektualët shqiptarë të kohës të cilët e paguan me frikën e vazhdueshme se çfarë do të sillte e nesërnja për ta, me vëzhgime të vazhdueshme nga organet e shërbimeve të ndryshme të pushtetit të atëhershëm, me diferencime ideopolitike e me burgosje. Kjo fushatë që nismën e pati në qarqet burokratike në krye me ish Komitetin Qendror të LKM-së u përcoll me shumë masa, shumica e të cilave mund të quhen absurde, që u ndërmorën në sferën e kulturës, të shkencës e të arsimit shqip. Madje, ajo preki rëndë edhe çështjen e planifikimit familjar (duke e kufizuar deri në tre numrin e fëmijëve të lindur në familje). Ndër këto masa absurde po përmendim edhe ndalimin me

⁵⁹ Revista “Fjala”: “*Maqedonia qe poligon eksperimentesh antishqiptare*”. Intervistë me prof. Remzi Nesimi. Bisedën e zhvilloi Qani Mehmedi, mars 1991, Shkup.

ligj të enrave shqip me karakter kombëtar, madje edhe me emra të zakonshëm që kanë kuptim shqip, si *Besa*, *Lirie*, *Shqipe* etj. (Lita, 2014: 113). Profesori nuk qëndroi indiferent atëherë kur, krahas këtyre diskriminimeve që u bënë shqiptarëve, morri hov edhe procesi i sllavizimit të dhunshëm të toponimisë shqiptare, atëherë kur u tentua të sillej edhe një ligj për shkrimin e përdorimin e toponimeve në gjuhën shqipe sipas natyrës së gjuhës maqedonase, me pretekst se ato po përktheheshin nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe.

Para se të shpалosim qëndrimin e profesorit në lidhje me procesin e këtij sllavizimi të dhunshëm të toponimisë shqiptare, po japim një kronologji të shkurtër të këtij procesi. Vetë profesori, në një intervistë të tijën të dhënë në “Flaka”⁶⁰ thotë që “...pas vitit 1981, në fushatën antishqiptare u ngrit një nismë edhe për përdorimin e toponimeve si në maqedonishte në njetet e informimit, në tekstet shkollore si dhe në të gjitha dokumentet zyrtare.” Kjo nismë që u imponua nga direktivat e Komitetit Republikan të Arsimit dhe të Kulturës Fizike e që kaloi në filtrat e shumë organeve të kohës, si në Konkluzionet e KQ të LKJ-së, në Programin operativ të KQ të LKM-së, Konkluzat e Kuvendit të RSM-së⁶¹ etj., megjithëse akoma nuk kishte kaluar në ligj, gjeti zbatim në tekstet e librave shkollorë në gjuhën shqipe dhe në mediat e kohës në gjuhën shqipe, si në Televizionin e Shkupit e në Radio Shkupin. E vetnaja

⁶⁰ Gazeta “Flaka”: “Në shkencë nuk ka politikë, paragjyime dhe dëshira!”. Intervistoi: Neat Duraku, 8 tetor 2004, Shkup.

⁶¹ Po përmendim në këtë rast tre dokumente nga arkivi shtetëror i Maqedonisë, në të cilat trajtohet edhe çështja e përdorimit të toponimisë sipas gjuhës maqedonase: ДАРМ.1.427.515.16/309-331, Општински Комитет на СКМ – Тетово; ДАРМ.1.427.513.13/318-341 Програма на Непосредните Задачи на членството, организациите и органите на ЦК СКН во остварувањето на Заклучоците од Деветата седница на ЦК СКЈ, Скопје, 1987 dhe ДАРМ. 1.427.525.17/249-272 Informatë me vlerësime të Kryesisë së KQ të LKM, lidhur me aktivitetet dhe masat e ndërmarë në LKM për implementimin e Konkluzioneve nga Mbledhja e 9 e KQ të LKJ gjatë periudhës janar-qershor 1988. Të tria këto dokumente janë të botuara nga Q. Lita, *Çështja shqiptare në RSFJ 1981-1990*, Shkup 2014, f.336, 407, 528.

qe “Flaka e vëllazërimit” (Dauti, 2015: 120) e cila përkundër trysnive të vazhdueshme e direktivave të Partisë, duke këmbëngulur në zgjidhjen e problemit me argumente shkencore dhe në mbështetje ligjore, arriti të rezistojë dhe të fitojë betejën në luftën kundër imponimit të përdorimit të toponimeve në gjuhën shqipe sipas natyrës së gjuhës maqedonase.

Kjo luftë e ashpër e cila u bë pjesë e njaft takimeve e diskutimeve të organeve të ndryshme të kohës,⁶² u zhvillua ndërmjet dy palëve. Nga njëra anë, palës që ishte kundër kësaj tentative e që mbështetej në arsyetime shkencore, dhe nga ana tjetër, palës që ishte pro kësaj tentative e që mbështetej në arsyetime joshkencore e politike se gjoja toponimet po përktheheshin në gjuhën shqipe.

Beteja me imponimin e toponimisë sipas natyrës së gjuhës maqedonase e në kundërshtim me normat gjuhësore të shqipes nuk mund të ketë qenë e lehtë në rrethanat e sundimit të Partisë dhe të vrojtimit të vazhdueshëm të shërbimeve sekrete të kohës. Siç do të shprehet Dauti (2015: 120), “kompromise e përkulje të kohëpas-kohshme” kundrejt direktivave që ishin pjesë e fushatës së ashpër ideologjike ka pasur edhe në radhët e shqiptarëve, mirëpo intelektualët shqiptarë të kohës janë munduar në mënyrën e vet edhe të rezistojnë duke u dalë përballë këtyre direktivave, qoftë përmes dorëheqjeve të vullnetshme nga posti i kryeredaktorit (siç ndodh me kryeredaktorin e TV Shkupit – Redaksia në gjuhën shqipe), qoftë përmes këmbëngulësisë që zgjidhja e kësaj çështjeje të mbështetet në ligj dhe të bazohet në argumente shkencore (siç ndodh me kryeredaktorin e redaksisë së “Flakës së vëllazërimit”).

Profesori R. Nesimi qe pjesë e betejës më të madhe që u bë për mbrojtjen e toponimisë shqiptare e cila u zhvillua në Komisionin

⁶² Si në Dhomën e Komunave të Kuvendit të RS të Maqedonisë (Arkivi i Maqedonisë, dosja nr. 22689, me datë 9.04.1987), në KK të LKM-së në Tetovë (Arkivi i Maqedonisë, dosja nr. 22689, kutia arkivore 685/9) etj. Shih për më tepër: Daut Dauti, *Një betejë madhore e fituar në monizëm dhe dështimi në pluralizëm*, “Scupi” 10, 2015, f. 122.

për Marrëdhënie Ndërnacionale të Kuvendit të RSM-së më 1987, e ku arma më e fortë qe argumentimi shkencor. Në këtë Komision ishte vënë në diskutim propozimi për nxjerrjen e Ligjit të Emrave të Vendbanimeve, propozuar nga Këshilli Ekzekutiv i RSM-së, ndërkohë që ky propozim-ligj, *de facto* tanimë po praktikohet sikur të ishte ligj i plotfuqishëm (Dauti, 2015: 122). Në këtë Komision qenë ftuar përfaqësues të shkencës të kombësive që jetonin në Maqedoni, respektivisht përfaqësues të Katedrave të Gjuhës Shqipe, të asaj Turke e Maqedonase dhe të Institutit të Gjuhës Maqedonase, si dhe përfaqësues të medias, gazetarë të redaksive në gjuhën shqipe, në gjuhën turke dhe në gjuhën maqedonase, pjesa dërrmuese e të cilëve kanë mbajtur qëndrimin për zgjidhjen e problemit duke u mbështetur në argumentet e arsyeshme shkencore (Dauti, 2015: 127). E argumentet shkencore të cilat janë shpalosur nga ana e pjesëmarrësve, jo vetëm shqiptarë, por edhe nga maqedonas e turq, qenë mjaft bindëse për të penguar këtë propozim ligj. Kështu do të shprehet prof. Nesimi në lidhje me këtë çështje:

“Në këtë mbledhje ishin ftuar Instituti i Gjuhës Maqedonase “Kërste Misirkov”, Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqiptare, katedra e Turqishtes dhe ajo e Maqedonishtes. Katedrën tonë e përfaqëson prof. Xhevat Gega, prof. Haki Ymeri dhe unë. Katedra jonë doli me një material të përgatitur me shkrim, me të cilin, me argumente shkencore, e arsyetoi absurditetin e imponimit të përdorimit të emrave të vendeve sipas formës së maqedonishtes, e jo sipas natyrës së gjuhës përkatëse. Në sajë të këtij materiali bindës, nuk u nxor Ligji për toponimet.”⁶³

Edhe pse nuk patëm mundësi ta kemi në duarshkresën që ishte hartuar atëbotë në emër të Katedrës me të cilën përfaqësuesit e saj, ndër ta edhe prof. Remzi Nesimi, morën pjesë në mbledhjen e sipërpërmendur, qëndrimin e profesorit në lidhje me toponiminë e imponuar e bëjmë të ditur nga artikujt e intervistat e shumta të tij

⁶³ Gazeta “Flaka”: “*Në shkencë nuk ka politikë, paragjykime dhe dëshira!*”. Intervistoi: Neat Duraku, 8 tetor 2004, Shkup.

në shtypin e asaj kohe. Duke iu falënderuar familjes së profesorit, ne kemi siguruar material edhe nga arkivi familjar. Për këtë material, i cili është i shkruar në gjuhën maqedonase, nuk kemi informatë nëse është i botuar apo jo, mirëpo nga përmbajtja që ka, na del të jetë i ngjashëm me shkrimet e tjera që janë të botuara në cilësinë e intervistave dhe artikujve në shtypin e kohës. Këndvështrimi i profesorit lidhur me këtë problematikë del në pah sidomos në shkrimet e gazetës “Flaka e vëllazërimit”.

Se qëndrimet e tij kanë qenë të drejta, flet para së gjithash mbështetja në argumente shkencore. Këtyre argumenteve shkencore u japin peshë edhe arsyetimet logjike që i paraqet profesori e të cilat dalin si rezultat, përveç tjerash, edhe i analizave që bën duke u mbështetur në përvojën e vendeve të tjera për mënyrën e përdorimit të toponimeve në gjuhë të ndryshme, ndër të cilat edhe në maqedonishten.

Në njërin nga artikujt e botuar në “Flaka e vëllazërimit”,⁶⁴ i titulluar “*Absurdi i një imponimi*”, ai gjerësisht e trajton çështjen e përdorimit të toponimisë dhe me bindje të plotë e mbron qëndrimin e tij për përdorimin e toponimeve në gjuhët e ndryshme sipas zhvillimit vetjak të gjuhëve, çdoherë duke u mbështetur në dëshmi të forta shkencore, të cilat diti shumë mirë t’i paraqesë. Për ta mbrojtur qëndrimin e vet, profesori jep arsye objektive edhe në intervistat e tij të shumta, arsye këto që mbështeten në faktin që toponimet janë forma të ngulitura “në vetëdijen gjuhësore shekuj me radhë dhe shpesh si të tilla përdoren edhe në folklor, kështu që nuk mund të çrrënjosen nga ndërgegjija gjuhësore e shtresave të gjera me diktate e akte ligjore sipas politikës së ditës”,⁶⁵ dhe të ndërrohen me forma të tjera. Për të qenë bindës, ai jep dëshmi gjuhësore, si në rrafshin fonetik, ashtu edhe në atë morfologjik. Në këtë drejtim, profesori shprehet: “Si ndërrimet fonetike ashtu edhe format

⁶⁴ Flaka e vëllazërimit, 26 tetor 1990, Shkup.

⁶⁵ Gazeta “Flaka”, “*Në shkencë nuk ka politikë, paragjykime dhe dëshira!*”. Intervistoi: Neat Duraku, 8 tetor 2004, Shkup.

morfologjike të toponimeve janë proces i natyrshëm i secilës gjuhë”.⁶⁶ Akoma më bindës janë edhe shembujt e panumërt që profesori i jep për ecurinë e zhvillimit historik të gjuhëve të ndryshme të botës, e me theks të veçantë për gjuhët sllave, dhe për përdorimin e toponimeve në këto gjuhë, për t’u shprehur më tutje, si në vijim: ”Ashtu siç kanë depërtuar thellë në vetëdijen gjuhësore te popullsia serbe e maqedonase format e toponimeve *Trst, Lerin, Solun, Kostur, Draç, Skadar, Valona* e shumë të tjera, ashtu janë rrënjësor thellë në vetëdijen gjuhësore të shqiptarëve format *Dibër, Kërçovë, Ohër, Shkup* etj.” (“Flaka e vëllazërimit”, 1990). Për këto arsye, profesori mban qëndrimin se ndalimi i përdorimit të këtyre toponimeve sipas traditës e rregullave të shqipes, pra ashtu siç janë përdorur ndër shekuj, nuk ka asnjë mbështetje shkencore meqë të njëjtat, as nuk janë të përkthyer, e as të shqiptarizuara. Ndërsa, sa i takon tentativës që kjo çështje të rregullohet me ligj, ai thotë që imponimi me ligj i përdorimit të toponimeve sipas gjuhës maqedonase do të ishte “një zgjidhje parciale”, duke e parashtruar më tutje këtë pyetje: “A nuk është qesharake kur në të gjitha qendrat e tjera brenda dhe jashtë Jugosllavisë, në botime të ndryshme dhe në emisionet e radios e të televizionit në gjuhën shqipe toponimet e lartpërmendura përdoren sipas traditës, ndërsa vetëm në emisionet e Rradiotelevizionit të Shkupit përdoren në formën e maqedonishtes?” (“Flaka e vëllazërimit”, 1990).

Kur flet për arsyet fonetike, profesori në radhë të parë përmend faktin e pamohueshëm që sistemet tingullore të gjuhëve të ndryshme nuk janë të njëjta. Këtë e shpjegon me shembuj konkretë për gjuhë të ndryshme në sistemin tingullor të të cilave mungojnë tinguj të ndryshëm, si bie fjala në maqedonishten, ku mungojnë zanoret *y* dhe *ë* dhe bashkëtingëlloret *dh, th* e *rr*, prandaj *Qafëthana* bëhet *Qafāsan*. Shembuj të këtillë jep edhe për gjuhë të tjera, si për serbokroatishten, ku mungon *x*-ja; greqishten, ku përveç tjerash, mungon edhe tingulli *sh* etj., por këtu po përqendrohemi vetëm në

⁶⁶ Po aty.

dallimet që shfaqen në sistemet tingullore të shqipes dhe të maqedonishtes. Më tutje profesori konsideron që "...është e pamundur, por edhe absurd të kërkohet e të insistohet të përdoren toponimet e madje edhe antroponimet vetëm në formën që përdoren në një gjuhë të caktuar, do të thotë është e pamundshme format drejtshkrimore e drejtshqiptimore të një gjuhe t'i imponohen një gjuhe tjetër, në rastin konkret maqedonishtes." ("Flaka e vëllazërimit", 1990).

Këtij argumenti i shton edhe faktin që, me kalimin e kohës, sikurse fjalët e tjera të leksikut të përgjithshëm, edhe emërtimet gjeografike pësojnë ndryshime fonetike sipas ligjeve gjuhësore të gjuhëve përkatëse. Për gjuhën shqipe përmend faktin që ndryshimet e këtilla nuk janë të pakta, duke dhënë vetëm disa shembuj ilustrues, bie fjala për dukurinë e njohur historike fonetike të alternimit *s=sh; spelum=shpellë*, e cila ka vepruar edhe në disa toponime të vjetra si: *Shüp* nga *Astibo*, *Sharr* nga *Scardus*, *Shkodra* nga *Scodra*, *Shkupi* nga *Skupi* etj. Ndërsa për gjuhën turke përmend faktin e njohur që në pozicionin fillestar fonetik është e pamundur të përdoren dy bashkëtingëllore, dukuri kjo që e bën të detyrueshme shtimin e një zanoreje, me ç'rast, *Shkupi/Skopje* shqiptohet *Uskup*. Këto fakte bindshëm flasin se nuk bëhet fjalë për përkthime, por për adaptime fonetike e morfologjike sipas natyrës së gjuhës përkatëse (nga materiali i arkivit familjar dhe nga "Flaka", 2004).

Për të dëshmuar se vështirësitë rreth zgjidhjes së çështjes së nomenklaturës gjeografike janë të shumta, si në pikëpamje të fonetikës ashtu edhe në pikëpamje të morfologjisë, profesori më tutje jep shembuj edhe për gjuhët e botës, në të cilat, jo vetëm mikrotoponimet, por edhe shumë makrotoponime ndeshen me forma të ndryshme, si për shembull emrat e shteteve: *Greqia*, maq. *Grcija*, fr. *Gréce*, serb. *Grçka*, gr. *Elada*, turq. *Junanistan*; *Mali i Zi*, maq. *Crna Gora*, turq. *Karadak*, fr. *Montenegro*; emrat e qyteteve, si: *Shkup – Skopje*, *Yskyp* e shumë shembuj të tjerë për emra të krahinave, rajoneve etj. Parashtrohet pyetja, nëse emërtimet e këtilla

gjeografike do të duhej të unifikoheshin, cila do të ishte ajo gjuhë me prestigj e cila do të duhej të ishte model për këtë unifikim, ndërkohë që në secilën gjuhë ka forma të ndryshme. Prandaj edhe profesori jep përgjigjen e saktë duke thënë që kjo çështje "...është një kompleksë prandaj për standardizimin e toponimeve në rrafshin ndërkombëtar nuk gjeti zgjidhje fatlume as UNESCO-ja, Organizata e Kombeve të Bashkuara e Edukimit, Shkencës dhe Kulturës..." (Flaka e vëllazërimit", 1990), pikërisht për shkak se arsytet dhe vështirësitë e sipërpërmendura janë të shumta.

Po të analizohen trajtat e emërtimeve gjeografike në gjuhën maqedonase, trajta këto të cilat nuk shkruhen në përputhje me rregullat drejtshkrimore të gjuhëve nga të cilat vijnë këto emërtime, si bie fjala: *Qafasan* për *Qafëthanë*, *Tesalia* për *Thesalia*, *Solun* për *Thesaloniki* etj. (për shkak se në sistemin tingullor të gjuhës maqedonase mungon *th*-ja); *Erusalim* për *Jerusalem*, *Saraevo* për *Sarajeva* etj. (për shkak të natyrës së maqedonishtes e cila kërkon që shpesh të mos përdoret *j*-ja në fillim të fjalës, e sidomos në pozicion në mes dy zanoresh) si dhe shumë trajta të tjera për të cilat profesori thotë se dalin me dallime shumë më të mëdha, sesa dallimet që hasen në shqipen kundrejt trajtave të maqedonishtes, si bie fjala: *Dibër* me *Debar*, *Ohër* me *Ohrid* etj., natyrshëm lind pyetja: Pse u dashka që këto emërtime të unifikohen në gjuhën shqipen sipas maqedonishtes ndërkohë që në maqedonishten nuk ka nevojë që të unifikohen sipas gjuhëve të tjera burimore? Për profesorin, të gjitha këto trajta të ndryshme për emërtimet gjeografike janë "fryt i jetës së për-bashkët shekullore të dy e më shumë popujve, prandaj edhe është vështirë e madje edhe gabim të unifikohen, apo më mirë të përdoren sipas natyrës vetëm të njëjës gjuhë." ("Flaka e vëllazërimit", 1990).

Edhe në rrafshin morfologjik vështirësitë janë po aq të mëdha sa edhe ato të rrafshit fonetik. Fakti që gjuha maqedonase, megjithëse e njëj kategorinë gramatikore të shquarsisë, nuk e përdor atë për kategorinë e emrave të përveçëm dhe nuk ka një sistem rasor sikur

edhe shqipja, e vështirëson tej mase përdorimin e emërtimeve gjeografike sipas gjuhës maqedonase dhe e bën të arsyetueshëm nocionin *absurd* kur flitet për nevojën e standardizimit të toponimeve në gjuhën shqipe sipas normave morfologjike të maqedonishtes. Se sa do të ishte i zbatueshëm ky unifikim, në rast se emërtimet gjeografike do të përdroreshin në gjuhën shqipe, pa e respektuar sistemin e lakimit në rasi, flasin vetë shembujt, si në vijim: *në qytetin e Skopje/ në qytetin e Gostivar* etj. Absurditeti i këtij unifikimi do të dilte në pah edhe në rast se këto toponime do të lakoheshin nëpër rasi sipas normave morfologjike të shqipes, si: *në qytetin e Skopjes/ në qytetin e Tetovos* e të ngjashme.

Në këtë drejtim, profesori shpalos komplikimet që do të paraqiteshin gjatë përdorimit nëpër rasi, sidomos atëherë kur këto emërtime do të përdroreshin me fjalë përcaktuese të cilat duhet të prishaten me fjalën bosht, ndërkohë që në të dyja gjuhët janë të pranishme emërtime gjeografike të cilat nuk përputhen në gjini, e cila përcaktohet nga tingujt fundorë. Si për shembull: emërtimi *Dibër/Dibra* në gjuhën shqipe, në bazë të tingullit fundor, i bie të jetë emër i gjinisë femërore, ndërsa në maqedonishten, *Debar* – është emër i gjinisë mashkullore; po ashtu edhe *Shkup/Shkupi* – në shqipen, emër i gjinisë mashkullore, ndërkohë që *Skopje* – në maqedonishten del emër i gjinisë asnjane, ashtu siç është edhe *Tetovo, Kumanovo, Saraevo* etj. Me këtë mospërputhje që kanë në gjini, gjatë përdorimit të këtyre emrave me fjalë përcaktuese, rezultati do të ishte si në vijim: *Debri ynë i bukur/Debri i Madh* etj., ashtu siç do të ishte rezultati edhe në maqedonishten, po qe se emërtimi *Struga*, i cili është i gjinisë femërore, t’i ndërrohej gjinia dhe të bëhej *Strug*, gjatë përdorimit në një sintagmë, si: *ubav nash Strug* për: *ubava nasha Struga*. Profesori me të drejtë thotë që në këtë mënyrë prishet norma morfologjike dhe natyra e cilësdo gjuhë. (“Flaka e vëllazërimit”, 1990).

Vështirësitë që dalin në pah gjatë përdorimit të toponimeve në gjuhën shqipe sipas gjuhës maqedonase janë po kaq të mëdha edhe

kur merren parasysh derivatet e këtyre emërtimeve, meqë krahas formave të para të tyre, janë krijuar edhe njaft fjalë të prejardhura, siç janë etnonimet dhe mbiemrat, si bie fjala, etnonimet *shkupjan*, *dibran*, *kërçovar*, *tetovar* etj. Prof. Nesimi në këtë drejtim parashtron këtë pyetje: “Si do të dukej në maqedonishte po të përdorej në origjinal emri *Roma* dhe derivati *romak-e* dhe a nuk është absurd dhe anakronizëm të thuhet në këtë gjuhë pas kaq shekujsh *Romsko* apo *Romansko carstvo* për *Rimsko carstvo*, “Perandoria romake” ose *Romjanin*, *Romjanka* për *Rimjanin*, *Rinjanka* “romak-e”? (Flaka e vëllazërimit, 1990). Në një shkrim të tij (nga arkivi i familjes), kësaj pyetje i përgjigjet në këtë mënyrë: “...siç nuk mund të thuhet në maq. *Romsko* ose *Romansko Carstvo* në vend të *Rimsko Carstvo*, ashtu është e pamundur që edhe në shqip të përdoret *debarçan* në vend *dibran-dibrane*.” Pas kësaj që u tha, natyrisht lind pyetja: a nuk do të çoroditej edhe maqedonishtja, dhe jo vetëm shqipja, po të thuhej në shqipen *skopjani/skopjanja*, ose edhe *skopjançe*?

Për të qenë gjithëpërfshirës e bindës në reagimet e veta, profesori flet edhe për vështirësitë që paraqiten lidhur me emërtimet gjeografike të përbëra. Në këto emërtime, ku në cilësinë e fjalëve përcaktuese shpesh përdoren edhe mbiemrat, problemi bëhet i pamangshëm pikërisht për shkak të përdorimit të këtyre mbiemrave sipas gjuhës maqedonase. Është i njohur fakti që në të gjitha gjuhët e botës, mbiemrat në funksion të përcaktorit në toponimet e përbëra, në të shumtën e rasteve përdoren në gjuhën amtare, si: *Britania e Madhe*, maq. *Velika Britanija*, angl. *Great Britain*; *Amerika Jugore*, maq. *Juzhna Amerika*, *Shtetet e Bashkuara të Amerikës*, srb. *Sjedinene Ameriçke Drzhave*, maq. *Soedinetite Amerikanski Drzhavi*, angl. *Unitet States of America* etj. Por ky fakt, nuk është i njaftueshëm edhe për KE të Kuvendit të Komunës së Tetovës, i cili, sipas të dhënave që na jep profesori (“Flaka e vëllazërimit”, 1990), toponimet e llojit *Reçica e Vogël*, *Reçica e Madhe*, *Leshnica e Poshtme* etj. i trajton si përkthime në gjuhën shqipe, ani pse elementi bosht i këtyre toponimeve përdoret në formën

burimore, me origjinë nga sllavishtja: *Leshnicë* – nga *Leshnik* dhe *Reçicë* – nga *Reka*. E sa i takon fjalëve përcaktuese të këtyre toponimeve, si: *e Madhe*, *e Vogël*, *e Poshtme* etj., profesori po ashtu përmend faktin se këto emërtime i takojnë vendbanimeve të banuara kryesisht me popullsi shqiptare, prandaj dhe është e natyrshme që këta përcaktorë në fillim të jenë krijuar në gjuhën shqipe, nga popullata shqiptare, e pastaj të jenë përkthyer në dokumentet administrative edhe në gjuhën maqedonase. Profesori e sheh të natyrshme e të nevojshme që sidomos në rajonet me popullsi kombesh të ndryshme, siç është edhe Maqedonia, mbiemrat në funksion të toponimeve të përbëra, të përdoren, e madje edhe të përkthehen në gjuhën amtare. Sigurisht që përjashtim bëjnë toponimet të cilat nuk kanë një traditë përdorimi në gjuhën shqipe meqë janë krijuar larg vendbanimeve shqiptare. Si të tilla, këto toponime nuk i janë nënshtuar ligjeve fonetike e morfologjike të gjuhës shqipe prandaj edhe nuk është ndier nevoja për përkthimin e pjesës mbiemërore të tyre. Sipas profesorit, këto toponime duhet të përdoren në formën e gjuhës burimore, si: *Sveti-Nikole*, *Kriva Pallanka*, *Bella-Crkva* etj. Profesori jep shembuj edhe për disa toponime të përbëra që në strukturën e tyre kanë emra të përgjithshëm si *det*, *mal*, *liqen*, *fushë* etj, që kryejnë funksionin e përcaktorit e të cilët edhe te shqiptarët përdoren në gjuhën amtare, ashtu siç përdoren te secili popull, si për shembull: *Mali i Zi – Crna Gora – Karadak*; *Deti i Mesdhe – Sredozemno More*, *Liqeni i Shkodrës – Skadarsko Ezero*, *Fushë-Kosova – Kosovopole* etj.

Nëse këto tendenca poshtëruese për shqiptarët e ish-Jugosllavisë arsyetohen me regjimin absurd të kohës së monizmit, atëherë si do të arsyetoheshin edhe në pluralizëm? E parashatrojmë këtë pyetje nga fakti që, për ironi, këto tendenca vazhdojnë të jenë të pranishme edhe në kohën e pluralizmit. Edhe pse fill pas monizmit, të gjitha mjetet e informimit e ndërprejnë politikën e imponimit të toponimisë, një gjë të tillë nuk e pa të arsyeshme edhe shtëpia botuese “Prosvetno dello”, megjithëse në v. 1991, siç na bën të ditur

profesori⁶⁷, “shoqatat e arsimitarëve të gjuhës dhe letërsisë shqiptare, duke e pasur parasysh rëndësinë e përdorimit të toponimeve ... iu drejtuan me një letër të hapur “Prosvetno dellos”, Ministrisë së Arsimit dhe të gjitha segmenteve të tjera përkatëse në Republikë”. Profesori më tutje na bën të ditur se jo vetëm që nuk është marrë një përgjigje nga ana e kësaj shtëpie botuese, por edhe është vazhduar me traditën e përdorimit të toponimeve në tekstet shkollorë në gjuhën shqipe sipas gjuhës maqedonase, ndërkohë që Ministria është arsyetuar asaj kohe se akoma ka qenë në pritje që të nxirret një ligji për toponimet. Në lidhje me këtë, profesori shprehet kështu: “...një ligji i tillë nuk mund të aplikohet për toponimet. Ky ligj mund të dalë për emërtimet e vendbanimeve të reja, për ndërrimin e emrit të ndonjë lokaliteti, e jo të toponimeve, sidomos për mikrotoponimet siç janë *Shkupi, Manastiri* etj.”⁶⁸

Madje edhe në v. 2004, çështja e toponimeve vazhdon të jetë aktuale, atëherë kur gjuhëtarët maqedonas po kërkonin që të tërhiqet përkthimi i Ligjit të ri për organizimin territorial, me pretekstin se në variantin shqip të këtij Ligji, ishin përkthyer shumë emra qytetesh e vendbanimesh të tjera për të cilat do të duhej të bëhej vetëm transliterimi fonetik. Në një intervistë të dhënë për “Flakën”,⁶⁹ duke reaguar ndaj këtyre gjuhëtarëve, profesori thotë që “ato emërtime që përdoren prej kohësh në shtresat e gjera sipas ligjeve fonetike e morfologjike të shqipes dhe që janë krijuar paralelisht të dyja bashkësitë, duhet të ngelin si të tilla, p.sh., *Pallçishti i Epërm, Pallçishti i Poshtëm, Reçica e Madhe, Reçica e Vogël* etj., ndërsa ato toponime qofshin të thjeshta apo të përbëra dhe që janë larg vendbanimeve shqiptare, duhet të përdoren në formën e gjuhës burimore, si: *Sveti Nikolla, Kriva Pallanka* etj., por

⁶⁷ Intervistë me prof. Remzi Nesimin. Gazeta “Flaka e vëllazërimit”, “Do të bojkotohen tekstet e papërshtatshme”. Intervistoi: Nazif Zejnullahu, 13 mars 1994, Shkup.

⁶⁸ Po aty.

⁶⁹ Gazeta “Flaka”, “Në shkencë nuk ka politikë, paragjykimë dhe dëshira!”. Intervistoi: Neat Duraku, 8 tetor 2004, Shkup.

edhe këto toponime gjatë përdorimit nëpër rasi u nënshtrohen ligjeve morfologjike të shqipes.”

Për fat të keq, as në ditët e sotme nuk kemi një standardizim të plotë të toponimisë në gjuhën shqipe në Maqedoni. Si pasojë e kësaj gjendje, gjatë përkthimit nga maqedonishtja në shqip të Ligjit për organizimin territorial të vetadministrimit lokal në Republikën e Maqedonisë, janë bërë lëshime të mëdha që kanë dëmтуar rëndë toponimet shqipe dhe versionet shqipe të toponime të tjera që përdoren nga popullata shqiptare. Ky Ligj, i sjellë në v. 2004, akoma është në fuqi dhe në bazë të tij, edhe sot e kësaj dite, të gjitha toponimet duhet të përdoren edhe në dokumentet zyrtare të shtetit, ashtu siç janë të përcaktuara në Ligj, meqë i njëjti është botuar në Gazetën zyrtare. Megjithëse edhe në këtë Ligj është lënë një shteg për përmirësimin e gjendjes aktuale, përmes nenin 2 në të cilin thuhet: “...ndryshimi i emrit dhe i selisë së Komunës mund të bëhet me ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji, pas konsultimit paraprak me qytetarët e rajonit të komunave...”⁷⁰, akoma nuk është marrë ndonjë hap në këtë drejtim meqë nuk është bërë sa duhet në drejtim të standardizimit të toponimeve. Si rezultat i kësaj, sot në të gjitha dokumentet zyrtare, bazuar në po këtë Ligj, toponimet dalin të shtrembëruara, jo vetëm nga aspekti drejtshkrimor, por edhe nga aspekti i përdorimit të tyre sipas traditës së përdorimit nga ana e popullatës shqiptare.⁷¹ Mbështetur në këtë gjendje, s’do mend se nuk mjaftojnë vetëm përpjekje individuale për t’i dhënë kahe të duhur kësaj çështje, si shembulli i prof. Remzi Nesimit, sado qofshin të mëdha e këmbëngulëse këto përpjekje, por një interesim serioz institucional i cili do ta kryente punën e vet, ashtu siç i takon.

⁷⁰ Gazeta zyrtare nr. 55, 16 gusht 2004, f. 7.

⁷¹ Shih për më tepër, Z. Ibrahim, *Standardizimi i toponimisë shqiptare në Maqedoni*, Scupi 5, Shkup, 2014.

Bibliografia:

Dauti, Daut. “*Një betejë madhore e fituar në monizëm dhe dështimi në pluralizëm*”, Scupi 10, Shkup, 2015.

Ibrahimi, Zeqirija. “*Standardizimi i toponimisë shqiptare në Maqedoni*”, Scupi 5, Shkup, 2014.

Lita, Qerim. *Çështja shqiptare në RSFJ 1981–1990*, SHHSHM, Shkup, 2014.

Nesimi, Remzi. “*Disa veçori strukturore dhe fonetike të toponimeve të rrethit të Tetovës*”, 25 години албански јазик на Филолошкиот Факултет во Скопје 1951–1976, Shkup, 1977.

Nesimi, Remzi. “*Absurdi i një imponimi*”. Flaka e vëllazërimit, 26 tetor 1990, Shkup.

Nesimi, Remzi “*Për disa toponime dhe mikrotoponime në rajonin e Kërçovës*”. (nga arkivi i familjes).

SHEJNAZE AJDINI–MURTEZI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore
të Shqiptarëve – Shkup*

SHTJELLIMI I GRAMATIKËS NË TEKSTET SHKOLLORE TË REMZI NESIMIT

Përmbledhje

Profesor Remzi Nesimi ishte një personalitet shumëdimensional, vlerat e të cilit u shprehën në shumë rrafshë, por kontributin e tij më të madh e dha në fushën e gjuhësisë. Krahas veprimtarisë studiimore e shkencore nga fusha e gjuhës shqipe (drejtshkrim, gramatikë, dialektologji, etj.), Remzi Nesimi është autor dhe bashkautor i shumë teksteve shkollore, kryesisht gramatika për shkollat fillore dhe të mesme, por edhe tekste të tjera, siç është teksti universitar “Libri i gjuhës shqipe për të huaj”.

Në këtë kumtesë do t’i analizojmë tekstet shkollore të gjuhës shqipe të autorit Remzi Nesimi, gjegjësisht shtjellimin e gramatikës në këto tekste.

Përmes njësive të trajtuara në këto gramatika, nxënësit njihen me strukturat e sistemit gjuhësor të shqipes dhe me normat e shqipes standarde, që ndërliidhen me strukturën e fjalëve e të fjalive si edhe me veçoritë dhe mënyrën e përdorimit praktik të tyre.

Shembujt e përzgjedhur për ilustrim në këto gramatika janë aq të rëndësishëm nga pikëpamja didaktike dhe ndikojnë pozitivisht duke i dhënë kuptim dhe gjallërim përmbajtjes së tekstit.

Gjithashtu edhe rubrikat që i shoqërojnë njësitë mësimore, si: ushtrime, pyetje dhe detyra, janë të hartuara në atë mënyrë që tek nxënësit të nxiten aftësitë ndërvepruese dhe komunikative, si edhe lidhjet e njohurive të përgjithshme më njohuritë e mëparshme.

Fjalë kyçe: gramatikë, tekste shkollore, analizë, gjuhë, njohuri gjuhësore.

Hyrje

Didaktika është një disiplinë e cila tradicionalisht përqëndrohet në përmbytjen e asaj që ligjërohet dhe asaj që mësohet në këtë lëmi. Një analizë didaktike e teksteve shkollore ka të bëjë kështu me përmbytjen e tyre, por njëkohësisht ajo kërkon gjithashtu të marrë parasysh edhe porosinë e tyre qofshin ato eksplicite apo implicite.

Duke e konsideruar tekstin shkollor si një nga burimet kryesore prej nga nxënësi qëmton dijet dhe, për shkak se lënda e gjuhës jep njohuri mbi parimet e proklamuar historike gjuhësore, teorike gjuhësore, nga përpiluesi i tekstit kërkohen sisteme të veçanta metodike të njohjes, të cilat i përgjigjen qëllimeve të proklamuar shkencore e arsimore në përputhje me programet mësimore.

Që tekstet shkollore të bëhen njete të vërteta pune për nxënësit, ato duhet të jenë të qarta, duke respektuar standardin gjuhësor dhe ligjësitë e gjuhës shqipe; të mos kenë shprehje abstrakte të tepërta, që përbëjnë mbingarkesë; të kenë material të kapshëm për moshën që kërkon formimi i nxënësve në një lëndë të caktuar etj.

Për ta kuptuar dhe folur mirë një gjuhë duhet që të njihet mirë edhe gramatika e saj. Pa njohjen thelbësore dhe të sigurt të bazës së gramatikës, pa ushtrime të shumta gramatikore nuk mund të përvetësohet një gjuhë ashtu si duhet. Pra, siç thekson edhe Maria Brăescu se „nëse gramatika nuk është e tërë gjuha, ajo është baza, skeleti i saj“.⁷² Gramatika ka për detyrë t’i bëjë nxënësit të zotë ta shkruajnë dhe ta flasin gjuhën amtare mirë, pra t’i shprehin qartë mendimet e tyre, si në të folur ashtu edhe në të shkruar.

Duke u nisur nga këto fakte, ne jemi përcaktuar që në këtë kumtesë t’i analizojmë tekstet shkollore të gjuhës shqipe të autorit Remzi

⁷² Maria Brăescu, *Méthodologie de l'enseignement du français*, 1979, Bukurești, f. 61.

Nesimi, gjegjësisht shtjellimin e gramatikës në këto tekste. Meqë kishim të bënim me një korpus jo të vogël tekstesh shkollore të dy niveleve të shkollimit, të atij fillor e të mesëm, ne i morëm në shqyrtim tekstet shkollore të shkollave të mesme, respektivisht tekstet Gjuhë dhe letërsi shqipe për vitin e I, II dhe III të gjimnazit të reformuar. Me qëllim të përkufizimit të materies, këndvështrimi ynë ka të bëjë vetëm me pjesën e gramatikës, por jo edhe të letërsisë.

Që në fillim të punës, për të dhënë vlerësimin e drejtë për rolin arsimor e edukativ të tekstit, për nivelin shkencor të interpretimit, ishte e nevojshme të njihen rezultatet kryesore të shkencës së gjuhësisë, të njihet e të studiohet një numër punimesh të autorëve tanë e të huaj, të cilët i janë qasur studimit të tekstit shkollor të gjuhës nga pozita të avancuara bashkëkohore metodike. Për një analizë më të plotë përshkruese janë shqyrtuar punime monografike të autorëve vendas dhe të huaj, punime aplikative me karakter didaktik në fushën e gjuhës, tekste mësimore të gjuhës shqipe, plane e programe mësimore. Në këtë studim është hulumtuar një literatura më e hershme si dhe e kohëve të fundit në fushën studimeve të problematikës së teksteve shkollore të gjuhës shqipe. Analiza deskriptive e teksteve na ka mundësuar për një analizë strukturore, përmbajtësore, duke vënë në pah risitë didaktike.

Prezantimi dhe shtjellimi i gramatikës

Tekstet shkollore ose librat letrarë ilustrojnë forma gramatikore dhe struktura gjuhësore dhe janë të lidhur zakonisht me metodën e qartë të gramatikës që jepet në mësim.⁷³

Teksti shkollor mund të përcaktohet si një botim shtypi i strukturuar në mënyrë të tillë, që të përdoret në procesin e mësimin, kuptohet për të rritur efektivitetin e tij. Teksti shkollor ka këto karakteristika: ai realizon disa funksione, të cilat lidhen më procesin mësimor; prek aspekte të ndryshme të të mësuarit dhe propozon

⁷³Lirak Dodbiba, Sterjo Spasse - Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1947, 1948.

aspekte të ndryshme të veprimtarisë në procesin mësimor.⁷⁴Së bashku me programet mësimore, tekstet shkollore përcaktojnë brendinë e të mësuarit në shkollë. Që tekstet shkollore të bëhen mjete të vërteta pune për nxënësit, ato duhet të jenë të qarta, duke respektuar standardin gjuhësor dhe ligjësitë e gjuhës shqipe, të mos kenë shprehje abstrakte, të tepërta, që përbëjnë mbingarkesë; të kenë material të kapshëm për moshën që kërkon formimi i nxënësve në një lëndë të caktuar etj.

Pra, teksti mund të konsiderohet si tipar thelbësor i përbashkët midis pedagogjisë dhe institucionit. Ai kontribuon në imagjinatën kolektive, të përballet me mësuesin në rolin e tij si agjent dhe aktor i sistemit edukativ.⁷⁵

Kështu sipas Programit mësimor për Gjuhë dhe letërsi shqipe për gjimnazet – viti i parë, qëllimet konkrete nga fusha programore Gjuhë janë që nxënësit duhet të aftësohen:

- të njihen me gjuhën si mjet komunikimi ndërmjet njerëzve, me gjuhën si sistem tingujsh e shprehjes;
- të njihen me karakteristikat e gjuhës popullore dhe asaj letrare, me emërtimin e gjuhës popullore dhe letrare, me rrugën e formimit të gjuhës letrare;
- të njihen me gjuhësinë si shkencë;
- të njihen me fonetikën si degë e gjuhësisë, që për objekt studimi ka sistemin tingullor;
- të njihen me fonologjinë si degë e gjuhësisë së përgjithshme që studion tingujt si njësi më të vogla diferencuese të kuptimit të fjalës;

⁷⁴ François-Marie Gérard, Xavier Roegiers, Des manuels scolaires pour apprendre, concevoir, évaluer, utiliser, De Boeck Supérieur, Paris, 2009, fq. 17.

⁷⁵ Soria-Borg Marilu, «Marché éditorial et didactique des langues: facteurs qui président à l'élaboration d'un manuel», Synergies Brésil n=6, Univ. Franche Comté, Gerflint, 2006, fq. 124.

- të njihen me fjalinë e thjeshtë e cila përmban një folje dhe pa folje;
- të njihen dhe aftësohen të dallojnë kryefjalën të dijnë mbi vendin e saj në fjali përshtatjen e saj me kallëzuesin;
- të njihen me kundrinorin dhe atë, me kundrinorin e drejtë dhe të zhdrejtë, kallëzuesorin rrethanorin;
- të dallojë fjalën dhe pjesët e saj dhe pjesët e saj;
- të njihet me mënyrën e formimit të fjalëve, etj.⁷⁶

Kështu edhe teksti shkollor “Gjuhë dhe letërsi shqipe për vitin e parë të gjimnazit të reformuar” (Prosvetno dello, Shkup, 2002) i autorit Remzi Nesimi me bashkautorët Mahmud Hysa dhe Xhevat Gega, të cilin e kemi marrë për shqyrtim, është hartuar mbi bazën e planprogramit të lëndës së gjuhës shqipe për vitin e parë të shkollave të mesme.

Ky tekst është i ndarë në dy pjesë: Gjuha shqipe (Gramatika) dhe Letërsia. Pjesa e Gramatikës fillon nga faqja 3 dhe përfundon në faqen 113 dhe është e ndarë në katër kapituj, të cilët pastaj janë ndarë në tituj e nëntituj të shumtë. Në kapitullin e parë të pjesës së parë të këtij libri janë dhënë njohuri të përgjithshme në lidhje me gjuhën dhe rëndësinë e saj, është sqaruar dallimi në mes të gjuhës popullore dhe asaj letrare, ndarja e gjuhës shqipe në dy dialekte dhe në nëndialekte e të folme, ku nëpërmjet shembujve është sqaruar mjaft qartë dallimi në mes të dy dialekteve, të gegërishtes dhe të toskërishtes, pastaj janë sqaruar parimet në të cilat bazohet drejtshkrimi në përgjithësi dhe drejtshkrimi i gjuhës shqipe në veçanti dhe krejt në fund janë dhënë përkufizimet për degët kryesore të gjuhësisë. Në kapitullin e dytë është shtjelluar lënda e fonetikës, probleme të fonetikës, të drejtshkrimit e të drejtshqiptimit, ku është

⁷⁶ Ministria e Arsimit dhe Shkencës në Republikën e Maqedonisë, Byroja për Zhvillimin e Arsimit, Programi mësimor Gjuhë dhe letërsi shqipe për gjimnazet - viti i parë, Shkup, maj 2001.

squaruar më gjerësisht dallimi midis objektit të studimit të fonetikës dhe fonologjisë, përkatësisht dallimi midis tingujve dhe fonemave. Në kapitullin e tretë, i emërtuar “Sintaksa”, janë interpretuar fjalitë njëkryegjymtyrëshe, me gjymtyrë kryesore të shprehur me folje dhe ato të shprehur me emër, pastaj fjalitë dykryegjymtyrëshe, kryefjala, kundrina e rrethanori. Në kapitullin e katërt është shtjelluar dhe interpretuar lënda e morfologjisë: fjala dhe pjesët e saj përbërëse, mënyra e formimit të fjalëve, kuptimet gramatikore dhe format gramatikore, emri dhe kategoritë e emrit, kategoritë gramatikore të rasës, nyja–funksioni dhe përdorimi i saj, folja–klasifikimi i foljeve, kategoritë gramatikore të foljes, kategoria gramatikore e mënyrës, kategoritë gramatikore të kohës, diateza e foljeve, zgjedhimi i foljeve dhe krejt në fund, format e pashtjelluara të foljes.

Brenda teksteve shkollore, aparatura didaktike zë një vend tejet të rëndësishëm, prandaj gjithnjë duhet të jetë në funksion të tekstit dhe në funksion të mësimdhënësve e të nxënësve, për punë më atraktive dhe më të lehtë me tekstin.⁷⁷ Në shumë punime gjejmë vetëm ndonjë fjali që flet për rolin dhe funksionin e aparaturës didaktike në tekstet shkollore.⁷⁸

Duke e marrë parasysh faktin se përmirësimi i mësimdhënies varet në masë të konsiderueshme nga formësimi didaktik i teksteve, autori i kushton mjaft kujdes strukturës metodike duke i dhënë rëndësi të posaçme pajisjes me aparaturë të qëlluar, e cila është në funksion të të kuptuarit më efikas të përmbajtjeve mësimore. Në këtë rast, ai ka marrë parasysh që të njëjtën t’ia përshtat moshës së nxënësve. Pra, çdo njësi mësimore është e shoqëruar me rubrikat: shënime, ushtrime, pyetje për përsëritje, gjegjësisht pyetje për përsëritje dhe diskutim. Rubrika e parë numëron gjithsej 48 shënime. Numri i këtyre shënimeve është më i madh apo më i vogël, varë-

⁷⁷ Bashkim Azemi & Bekim Morina, *Aparatura didaktike në tekstet shkollore*, Instituti Pedagogjik i Kosovës, Prishtinë, 2013.

⁷⁸ Abdy Ramaj, *“Formësimi didaktik i lëndës në tekstin mësimor”*, Libri Shkollor, Prishtinë, 2001.

sisht nga kompleksiteti i njësisë mësimore. Rubrika e dytë numëron 100 ushtrime, kurse rubrika e tretë ka gjithsej 17 pyetje për përsëritje, gjegjësisht pyetje për përsëritje dhe diskutim.

Lënda e trajtuar në këtë pjesë të titulluar Gjuha shqipe (Gramatika) paraqet një studim të thukët, ku çdo pjesë e formave të fjalëve, fjalisë e lidhjeve ndërmjet tyre sipas rregullave gramatikore, janë dhënë qartë, në një tërësi, që formojnë strukturën e sistemit të gjuhës shqipe. Për hartimin e kësaj gramatike, autori Remzi Nesimi, i merr si bazë rezultatet e arritura të gjuhësisë shqiptare dhe asaj bashkëkohore, duke e paraqitur në këtë mënyrë, të sistemuar mjaft mirë, tërësinë kryesore të problemeve gramatikore e fonetike të shqipes së sotme standarde, të parashtruar në programet e gjuhës shqipe për shkollat e mesme në Maqedoni.

Në tekstin shkollor “Gjuhë shqipe (Gramatikë) dhe letërsi për vitin e dytë të gjimnazit të reformuar” (Prosvetno dello – Shkup, 2008) të autorit Remzi Nesimi me bashkëautorin Mahmud Hysa, gjithashtu do të paraqesim disa vështrime për lëndën gjuhësore të trajtuar aty, kriteret shkencore dhe didaktike si dhe shembujt ilustrativë të përdorur nga autori gjatë përpilimit të kësaj gramatike shkollore. Në këtë tekst shkollor është paraqitur përmbajtja e njohurive gjuhësore si edhe qëllimet konkrete sipas programit mësimor për vitin e dytë.

Lënda mësimore e përfshirë në këtë tekst është e ndarë në dy pjesë: Gjuhë shqipe (Gramatikë) dhe Letërsia shqiptare dhe botërore, e këto të ndara në disa kapituj, e shumë tituj e nëntituj. Pjesa e Gramatikës fillon prej faqes 4 dhe përfundon në faqen 87. Në këtë pjesë janë shtjelluar njohuri nga leksikologjia, morfologjia e sintaksa, si dhe ushtrime e aktivitete të tjera gjuhësore. Pra, kapitulli i parë i Gramatikës fillon me leksikologjinë ku trajtohet kuptimi i fjalës, fjalët me shumë kuptime, sinonimet, antonimet, homonimet, shtresa e leksikut të gjuhës shqipe, arkaizmat, historizmat, dialektizmat dhe krahinorizmat, neologjizmat, profesionalizmat, njësitë frazeologjike dhe fjalët e ndryshueshme e të pandryshueshme. Kapitulli i dytë, ku trajtohen çështje të morfologjisë: mbiemrat (gjinia,

numri dhe shkalla e tyre), përemrat (vetorë, dëftorë, pronorë, pyetës, lidhorë dhe të pacaktuar) dhe pjesët e pandryshueshme të ligjëratës (ndajfoljet, parafralët, lidhëzat, pjesëzat, pasthirrmat), është vazhdimësi e materialit të shtjelluar në librin e vitit të parë, d.m.th. duke i përsëritur njohuritë e fituara më herët vazhdohet me njohuri më të gjëra në këtë fushë. Në kapitullin e tretë shtjellohet dhe interpretohet sintaksa e fjalisë, fjalitë sipas kumtimit, fjalitë pohore e mohore, gjymtyrët e dyta të fjalisë–përcaktori, kundrina dhe rrethanori.

Përmes këtyre mësimëve të trajtuara në këtë tekst të gramatikës, nxënësit njihen me strukturat e sistemit gjuhësor të shqipes dhe me normat e shqipes standarde, që ndërlihen me strukturën e fjalëve e të fjalive si dhe me veçoritë e mënyrën e përdorimit praktik të tyre.

Edhe në këtë tekst, si në tekstin shkollor të vitit të parë, njësitë mësimore që i kushtohen çështjeve të sistemit gjuhësor, janë të zhvilluara sipas një ecurie të ndarë përmes rubrikave: shënime, ushtrime, pyetje për përsëritje, gjegjësisht pyetje për përsëritje dhe diskutim. Rubrika e parë përmban 28 shënime, 78 ushtrime dhe 13 pyetje për përsëritje.

Teksti shkollor “Gjuhë shqipe (Gramatikë) dhe letërsi për vitin e tretë të gjimnazit të reformuar” (Prosvetno dello –Shkup, 2003) i autorit Remzi Nesimi me bashkëautorë Valbona Toska, Zeqirja Neziri dhe Agim Leka, është hartuar mbi bazën e planprogramit të lëndës së gjuhës shqipe për vitin e tretë të shkollave të mesme. Edhe ky tekst është i ndarë në dy pjesë: Gramatika e gjuhës shqipe dhe letërsia. Pjesa e Gramatikës fillon prej faqes 5 deri në faqen 75 dhe ndahet në tre kapituj dhe në shumë tituj e nëntituj. Në kapitullin e parë janë trajtuar fusha të ndryshme të studimit të gjuhës shqipe, si nga historia e gjuhës shkruar (komunikimi me shkrim, alfabeti i gjuhës shqipe, vendi i gjuhës shqipe në familjen e gjuhëve indoevropiane, formimi i gjuhës letrare, periudha para kombëtare dhe kombëtare dhe bazat dialektore të gjuhës së sotme letrare. Sintaksa e periudhës, marrëdhëniet e fjalive në periudhë, fjalitë e

bashkërenditura, tipat e periudhave me bashkërenditje, fjalitë e nënrenditura, karakteristikat e periudhës me nënrenditje, klasifikimi i fjalive të nënrenditura, periudha asidentike, fjalitë e ndërmjetme, si edhe ligjërata e drejtë dhe e zhdrejtë, trajtohen në kapitullin e dytë. Në kapitullin e fundit, janë trajtuar shenjat e pikësimit.

Për hartimin e këtij teksti të gramatikës, autori ka marrë parasysh, po ashtu kriteret shkencore e didaktike dhe është bazuar në teoritë dhe të arriturat shkencore të gjuhësisë në përgjithësi dhe të gjuhësisë shqipe në veçanti.

Edhe në këtë tekst njësitë gramatikore janë të shoqëruara me rubrikat: shënime, ushtrime, pyetje për përsëritje, gjegjësisht pyetje për përsëritje dhe diskutim. Në rubrikën e parë ka gjithsej 28 shënime, në rubrikën e dytë 78 ushtrime, ndërsa në të tretën 5 grupe pyetjesh për përsëritje. Pyetjet për përsëritje dhe diskutim janë të hartuara mjaft mirë dhe ndihmojnë në zbërthimin e përm-bajtjeve mësimore.

Është me interes të theksohet se një veçori metodologjike që i karakterizon këto tekste shkollore është përpjekja për integrimin e njohurive gjuhësore me ato letrare, gjë e cila është realizuar nëpërmjet zgjedhjes së modeleve më të mira të shqipes së shkruar. Por ajo që bie në sy në përzgjedhjen e shembujve janë sidomos proverbat, të cilat medoemos zgjojnë kërshtërinë të nxënësit dhe ndikojnë dukshëm në motivimin e tyre. Këtë kam mundur ta vërtetoj edhe nga përvoja ime disa vjeçare me nxënës të shkollave të mesme, por gjithashtu edhe nga bisedat më mesimdhënës të tjerë të gjuhës shqipe.

Pra, me ndihmën e shembujve konkretë të nxjerrë nga letërsia shqiptare janë ilustruar njohuritë gjuhësore, të cilët e aftësojnë nxënësin në përvetësimin teorik dhe zbatimin praktik të tyre, që do të thotë se njohuritë letrare gërshetohen me ato gjuhësore, kuptohet duke qenë në funksion të përvetësimit të sistemit gjuhësor të gjuhës amtare.

Duke marrë parasysh rolin e shembujve në mësimin e njëjësive gramatikore dhe zbatimin praktik të sistemit gjuhësor, ne kemi analizuar disa prej tyre, të cilët i kemi përzgjedhur nga të tre tekstet shkollore të marra për shqyrtim.

Për shembull:

Në ushtrimin 35, fq. 45 (Gjuhë shqipe dhe letërsi për vitin e parë), kërkohet nga nxënësi t'i analizojë vargjet dhe të rrethojë rrethanorin e vendit në vjershën “Zëmëra”

<i>Fuqi e Perëndisë</i>	<i>Ajo është gjithë ç'janë</i>
<i>Duket tek do,</i>	<i>Në çdo vend</i>
<i>Se shpirt i gjithësisë</i>	<i>E duket në çdo anë</i>
<i>Po është ajo.</i>	<i>Në trup e në mënt.</i>

E shohim në qiej,
Në shi e në re,
Ndë hën'e nëpër diej
Është edhe nën dhe.

Nëpërmjet kësaj vjershe, nxënësi jo vetëm që aftësohet t'i dallojë veçoritë gramatikore të rrethanorit të vendit, por njëkohësisht te ai zhvillohet ndjenja estetike, si edhe mendimi filozofik, botëkuptimi në lidhje me funksionimin e universit. Autori, në këtë rast, e ka marrë parasysh faktin se edukimi estetik ka ndikim të gjithanshëm në formimin më të plotë të personalitetit të nxënësit.

Pastaj në ushtrimin 50, fq.61 (Gjuhë shqipe dhe letërsi për vitin e dytë) thuhet: Në tekstin e mëposhtëm janë dhënë fjali të ndryshme sipas qëllimit të thënies. Lexoni me intonacionin e duhur dhe dalloni fjalitë dëftore, dëshirore, nxitëse dhe pyetëse. Thoni mënyrën e foljeve–kallëzues.

“...Vallë ka gjë më të shtrenjtë se kombi dhe gjuha?”, “Jo, ska, tha me vete plaku dhe në atë çast m’u kujtuan vargjet e Naimit:

Pa shihni ç’gjuhë e mirë

Sa e bukuri ka e hije,

Ç’e bukur dhe e lirë

Si gjuhë Perëndie!

Edhe me këto vargje të bukura, autori synon që nxënësi të aftësohet t’i zotërojë jo vetëm njohuritë gjuhësore, pra, në këtë rast t’i dallojë fjalitë sipas qëllimit të thënies, por edhe ta mbjellë tek ai dashurinë për kultivimin dhe ruajtjen e gjuhës sonë të bukur.

Siç përmendëm edhe më lart, për ta bërë më tërheqës dhe më të kuptueshëm procesin e të nxënies të njohurive gjuhësore, autori Remzi Nesimi në shembujt ilustrativë ka përdorur një numër të madh proverbash, padyshim duke u nisur nga funksioni multidimensional dhe roli pedagogjik që kanë ato. Kjo përzgjedhje është bërë, kuptohet duke iu përshtatur moshës së nxënësve. Kështu kemi:

Në ushtrimin 28, fq 39 (Gjuhë shqipe dhe letërsi për vitin e tretë) thuhet: Në periudhat e dhëna dalloni fjalitë kohore dhe thoni se në cilat shprehen marrëdhënie njëkohësie, paskohësie dhe parakohësie. Vëreni edhe rendin e gjymtyrëve të fjalisë në këto periudha:

– *Njeriu duhet të mendojë para se të veprojë.*

Në ushtrimin 29, fq. 39.thoni në ç’pozicion janë përdorur fjalitë e varura.

– *Kush mbledh hardhi, ka rrush në shtëpi*

– *Ai që është në firiq mbahet se çdo gjë di.*

Në ushtrimin 49, fq.58 (Gjuhë shqipe dhe letërsi për vitin e dytë), thuhet: Lexoni me kujdes thëniet e mëposhtme dhe dalloni fjalitë dëftore, dëshirore dhe nxitëse.

- *Njeriu i mësuar ka gjithkund me vete pasurinë e tij.*
- *Në vendin e huaj s'të ngroh as dielli.*
- *Bëhu trim që të të respektojnë gjithë bota.*

Në ushtrimin 46, fq.54 (Gjuhë shqipe dhe letërsi për vitin e parë), thuhet: Në fjalitë e mëposhtme gjeni rrethanorët e sasisë, thoni me ç'pjesë të ligjëratës janë shprehur dhe kuptimin e cilave gjymtyrë e plotësojnë.

- *Ata që flasin shumë s'thonë asgjë.*
- *Dëgjo dy herë dhe fol njëherë.*
- *Kush ka miq ka dy palë krahë.*

Nëpërmjet këtyre shembujve, gjegjësisht proverbave, autori ka për qëllim që jo vetëm ta bëjë më tërheqës dhe më të kuptueshëm të nxëniet e njohurive gjuhësore, por njëkohësisht të zbulojë aspekte të ndryshme të jetës dhe të të menduarit nëpër periudha të ndryshme si edhe të tejçojë në mënyrë të qartë porosinë që ato përcjellin.

Nga vështrimi që i bëjmë këtyre gramatikave, mund të themi se rregullat gramatikore, përkufizimet si dhe nocionet e kategorive gramatikore, autori i ka sistemuar e parashtruar përmes një metodologjie të përshtatshme shkencore. Për zbërthimin e problemeve gramatikore ai ka përdorur metodën e njohur analitike–sintetike si një tërësi unike, duke nxjerrë të tërën nga pjesët përbërëse të saj si dhe nga e tëra duke nxjerrë pjesët e veçanta.

Autori Remzi Nesimi nëpërmjet metodës induktive dhe asaj deduktive, ka analizuar me kujdes veçoritë fonetike e fonologjike të tingujve të shqipes strukturën dhe sistemin e emrave, foljeve; llojet e fjalive në bazë të numrit të gjymtyrëve, etj., duke nxjerrë përfundime të përgjithshme në bazë të shembujve ilustrativë. Nëpërmjet sistemimit mjaft të qartë të lëndës, janë shpjeguar edhe nocionet e termave: fonemë, fonologji morfologji, leksikologji, sintaksë, etj., të ndërlydhura në marrëdhënie me njëra–tjetrën.

Përfundimi

Së bashku me programet mësimore, tekstet shkollore përcaktojnë brendinë e të mësuarit në shkollë. Që tekstet shkollore të bëhen mjete të vërteta pune për nxënësit, ato duhet të jenë: të qarta, duke respektuar standardin gjuhësor dhe ligjësitë e gjuhës shqipe; të mos kenë shprehje abstrakte, të tepërta, që përbëjnë mbingarkesë; të kenë material të kapshëm për moshën që kërkon formimi i nxënësve në lëndën në fjalë, etj.

Meqë teksti shkollos ende mbetet pothuajse mjete i vetëm mësimor për një pjesë të madhe të mësimit në shkollë, përmirësimi i mësimit varet në masë të konsiderueshme nga formësimi didaktik i teksteve, pajisja me aparaturë të qëlluar didaktike.

Pra, karakteristikë e përbashkët për këto tekste të gramatikës, që u morën në shqyrtim, është sistemimi i qartë i lëndës, ku idetë, faktet, argumentet janë trajtuar me një radhitje të qartë e logjike, në përputhje e lidhshmëri reciproke si me pjesët më të mëdha të saj, ashtu edhe me pjesët më të vogla. Sipas kriterëve shkencorë janë përshtatur fjalët në fjali, fjalitë në periudha duke u mbajtur një rend i ndërsjellë kuptimor i fjalive dhe periudhave në paragraf, në kapituj dhe i të gjitha pjesëve përbërëse në tërësi.

Si përfundim, mund të thuhet se këto tekste mund t'u shërbejnë si model autorëve të cilët përpilojnë gramatika për shkollat e mesme. Pra, bëhet fjalë për tekste origjinale të përpiluara sipas rregullave gramatikore të shqipes standarde.

Bibliografia:

1. Ramaj, Abdyl, "Formësimi didaktik i lëndës në tekstin mësimor", Libri Shkollos, Prishtinë, 2001.
2. Azemi, Bashkim & Morina, Bekim, Aparatura didaktike në tekstet shkollore, Instituti pedagogjik i Kosovës, Prishtinë, 2013.
3. Brârescu, Maria, Méthodologie de l'enseignement du français, Bukuresti, 1979.

4. Gérard, François-Marie & Roegiers, Xavier, Des manuels scolaires pour apprendre, concevoir, évaluer, utiliser, De Boeck Supérieur, Paris, 2009..
5. Dodbiba, Lirak & Spasse, Sterjo, Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1947, 1948.
6. Marilu, Soria-Borg, « Marché éditorial et didactique des langues: facteurs qui président à l'élaboration d'un manuel », Synergies Brésil n=6, Univ. Franche Comté, Gerflint, 2006.
7. Ministria e Arsimit dhe Shkencës në Republikën e Maqedonisë, Byroja për zhvillimin e arsimit, Programi mësimor Gjuhë dhe letërsi shqipe për gjimnazet – viti i parë, Shkup, maj 2001.

APARATURA DIDAKTIKE NË TEKSTET SHKOLLORE TË PROF.REMZI NESIMIT

Të flasësh për emra të mëdhenj nuk është e lehtë, sepse fjalët gjithmonë janë të pakta. Aq më tepër kur kemi të bëjmë me një personalitet të shquar dhe të gjithanshëm, siç ishte prof. Remzi Nesimi. Personaliteti i tij është shumë i gjerë. Ai nuk ishte vetëm studiues, por edhe gjuhëtar, mësimdhënës, pedagog, përkthyes, lektor, recensent, hartues tekstesh mësimore për nxënës e studentë etj. Pra, ai është një personalitet me peshë, dhe njeri model në të gjitha pikëpamjet.

Si pedagog, profesor Nesimi shquhet për modelin e një mësimdhënësi, që mishëronte në mënyrën më të shkëlqyer vullnetin e madh, urtësinë, zgjuarsinë, përkushtimin dhe këmbënguljen për ta zbuluar të vërtetën shkencore. Bashkëpunimi i tij me kolegë e studentë dhe veprimtaria kaq sasiore e cilësore dëshmojnë për cilësitë e një shkencëtari, që ka lënë gjurmë të pashlyeshme në fushën e shkencës, arsimit dhe edukimit në Maqedoninë e Veriut. Me veprimtarinë e tij pedagogjike dhe shkencore, ai u bë bashkudhëtar i të gjitha ndryshimeve që ka pësuar arsimi në vendin tonë. Kontributi i tij më i rëndësishëm në fushën e arsimit është pasuria e madhe që ai ka krijuar si hartues programesh e tekstesh shkollore, që përbëjnë një bazë të fuqishme metodike dhe shkencore për zhvillimin e arsimit fillor, të mesëm dhe atë universitar. Pra, gjithë potencialin e tij shkencor dhe mendor prej eruditi e patrioti, ai e vuri në funksion të ngritjes, arsimit dhe përparimit të popullit dhe kulturës kombëtare shqiptare.

Prof. Remzi Nesimi e nisi krijimtarinë e tij në vitet e ‘70-ta të shekullit të kaluar, duke lënë pas vetes një gamë të gjerë krijimesh

nga më të larmishmet, që trajtojnë çështje të fonetikës e fonologjisë, morfologjisë, sintaksës, dialektologjisë, si dhe shumë pjesëmarrje në kongrese, simpoziume, konferenca e sesione shkencore kushtuar ngjarjeve dhe figurave kryesore të kulturës kombëtare. Gjatë këtij itinerari për nevojat e arsimit dhe të shkollës shqipe në Maqedoninë e Veriut, por edhe për t'u dalë në ndihmë nxënësve shqiptarë, ai përktheu tekste shkollore të shkencave natyrore nga gjuha maqedonase në atë shqipe. Mirëpo, objekt studimi gjatë gjithë jetës së tij ka qenë lëvrimi dhe kristalizimi i gjuhës shqipe, duke u munduar ta shpjerë atë në pedestalin më të lartë. Këtë mision gjuhësor e arriti me një numër të madh, si asnjëherë më parë, të gramatikave që i botoi, të cilat për nga vlera dhe cilësia ishin të jashtëzakonshme dhe të papërsëritshme, si për kohën kur u botuan, ashtu edhe sot. Këto vlera dhe merita u dëshmuuan me botimet dhe ribotimet e shumta, që pasuan dekada me radhë. Një pasqyrë kronologjike e teksteve të botuara dhe të ribotuara të profesor Renzi Nesimit duket si vijon:

1. Gramatika e gjuhës shqipe për klasën IV të shkollës fillore (1976, 1985, 1989, 1990, 1991, 1992, 1993, 1994, 1995, 1998);
2. Gramatika e gjuhës shqipe për klasën V të shkollës fillore (1979, 1982, 1985, 1987, 1996, 1997, 1998, 1999);
3. Gramatika e gjuhës shqipe për klasën VI të shkollës fillore (1979, 1980, 1982, 1985, 1989, 1995, 1997, 1998, 1999);
4. Gramatika e gjuhës shqipe për klasën VIII të shkollës fillore (1981, 1982, 1987, 1989, 1996, 1998, 1999, 2003);
5. Gramatika e gjuhës shqipe – Sintaksa për klasën VIII të shkollës fillore, 1987;
6. Gramatika e gjuhës shqipe për shkollat e mesme I (Fonetika, Leksikologjia dhe Morfologjia), 1992, 1994, 1996, 2000;
7. Gjuhë shqipe dhe letërsi për vitin e parë të gjimnazit të reformuar (në bashkautorësi, viti 2002);
8. Gjuhë shqipe dhe letërsi për vitin II të gjimnazit të reformuar (në bashkautorësi, botimi i dytë, viti 2004);

9. Gjuhë shqipe dhe letërsi për vitin III të gjimnazit të reformuar (në bashkautorësi, viti 2003);
10. Libër leximi për klasën V të shkollës fillore, 1981;
11. Libër leximi për klasën VI të shkollës fillore, 1981, 1983;
12. Libër leximi për klasën VII të shkollës fillore, 1981;
13. Libër leximi për klasën VIII të shkollës fillore, 1981.

Nga ky opus tekstesh mësimore përzgjedhëm që në këtë punim vëmendjen ta përqendrojmë në kontributin që ka dhënë ky pishtar i arsimit dhe i dijes për hartimin e teksteve shkollore për shkollën fillore të ciklit të ulët, të lartë, si dhe për shkollën e mesme. Më saktë, objekt studimi në këtë trajtesë modeste do ta kemi aparaturën didaktike në tekstet shkollore të hartuara nga prof. Nesimi.

"Dy prej faktorëve që kushtëzojnë formimin gjuhësor të nxënësit janë: programi mësimor dhe teksti".⁷⁹ Teksti shkollor për një pjesë bukur të madhe mësimdhënësish akoma mbetet instrumenti më i përhapur, dhe më efektiv në procesin edukativo–arsimor. Ai, duhet të ngërthejë në vete disa kërkesa, pa të cilat nuk mund të realizohen objektivat dhe synimet e parapara brenda orës mësimore. Teksti mësimor, para së gjithash, duhet:

- të jetë në harmonizim me plan–programin mësimor;
- të jetë në funksion të zotërimit të njohurive, shkathtësive dhe rezultateve të të nxënësit, të parapara për nivelin e caktuar;
- të ofrojë përmbajtje në përputhje me të arriturat bashkëkohore të fushës së caktuar shkencore, me metodologjinë e mësimin të lëndëve dhe përdorimin e terminologjisë profesionale;
- ta respektojë gjuhën standarde dhe rregullat e drejtshkrimit;
- ta nxisë të menduarit kritik dhe kreativ të nxënësve;

⁷⁹[http://www.pasqyre.al/te-gjitha/vrasja-e-gjuhes-shqipe/\(11.03.2019\)](http://www.pasqyre.al/te-gjitha/vrasja-e-gjuhes-shqipe/(11.03.2019)).

- të ketë aparaturë në përputhje me kërkesat bashkëkohore për të nxënit aktiv dhe kreativ;
- të përmbajë fjalor për interpretim të fjalëve dhe koncepteve të panjohura ose më pak të njohura;
- t'i përshtatet moshës dhe karakteristikave zhvillimore të nxënësve etj.

Kjo mori kërkesash ekziston në kriteret bazë për hartimin dhe vlerësimin e sotëm të teksteve shkollore. Por, nëse i kundrojmë me hollësi tekstet shkollore të prof. Nesimit, duke filluar që nga ai i klasës së katërt të ciklit të ulët e për të vazhduar më tej deri tek ai i vitit të tretë për shkollë të mesme, mund të themi, se tekstet e tij i plotësonin kriteret e lartpërmendura që në vitet e '70-ta kur u botuan për herë të parë. Në këto tekste shkollore ndeshim një aparaturë didaktike shumë të begatë e të larmishme, e cila është definuar përmes rubrikave të emërtuara, si: *pyetje për diskutim dhe përsëritje, ushtrime, shembuj, mbani mend, vini re, shënime, pyetje dhe përsëritje, ushtrime për drejtshkrimin, shenjat e pikësimit* etj. Një përmbajtje kaq e plotë e këtyre teksteve dhe me një aparaturë didaktike kaq gjithëpërfshirëse nuk është rastësi, por dëshmon nivelin e lartë shkencor epedagogjik dhe dëshirën e etur të një gjuhëtari për t'i ndihmuar brezat e ardhshëm drejt të nxënit të një shqipeje standarde, në një kohë kur përdorimi i saj nuk kishte marrë përmasat e duhura, por njihej dhe flitej nga një shtresë e paktë njerëzish në Maqedoninë e Veriut. Gjykojmë se pasioni për të zbuluar, krijuar dhe për t'i njohur e trajtuar çështjet gjuhësore, është një arsye e fortë që e shtyri prof. Nesimin të kalojë në një rrugë ku nuk kishte kaluar askush para tij. Të jesh i pari që i hap dyert për të ecur në këtë rrugë plotë vështirësi dhe të thyesh të gjitha barrikatat që dalin rrugës, do të thotë të jesh i guximshëm në çdo hap që bën; t'i njohësh çështjet gjuhësore në thelb, që t'i arsyetosh mendimet dhe idetë e tua. Për të marrë një përgjegjësi dhe barrë të tillë mbi supe nuk është e lehtë. Kjo është një punë për t'u admiruar dhe përshëndetur. Këtë arriti ta bëjë vetëm një gjuhëtar me një bagazh

dhe formim të gjerë njohurish shkencore dhe i pazëvendësueshëm deri tani, siç ishte prof. Nesimi. Prandaj, me plot kuptimine fjalës themi se mësimi i gramatikës së gjuhës shqipe në Maqedoninë e Veriut fillon me emrin e Remzi Nesimit. Ai është gjuhëtar, i cili filloi nga zeroja, duke mos pasur një model pararendës për hartimin e gramatikave për mësimin e gjuhës shqipe në Maqedoninë e Veriut. I gjendur në rrethana të tilla, ai me elanin dhe punën e palodhshme arriti të na lë një trashëgimi të pasur tekstesh gjuhësore, që ne me plot mburrje dhe krenari i shfrytëzojmë edhe në ditët e sotme. Ky seriozitet i personalitetit dhe punës së tij bën që prof. Remzi Nesimi të konsiderohet themeluesi ose nismëtari i parë në Maqedoninë e Veriut, i gramatikave të para për të tre ciklet e shkollimit. Si kriter bazë gjatë hartimit të teksteve gramatikore prof. Nesimi pati mbështetje në përmbajtjen e plan-programit mësimor, sepse mësimi i gramatikës zë një vend të rëndësishëm dhe një numër tejet të madh të orëve në plan-programet mësimore, si për ciklin fillor të ulët dhe të lartë, ashtu edhe për atë të mesëm. Ky vend i mësimin të gramatikës flet për rëndësinë që ka kjo degë e gjuhës gjatë sistemit të shkollimit, që te nxënësi të krijohen shprehje të drejta në të folur dhe në të shkruar pa gabime. Përveç kësaj, duke i pajisur nxënësit me njohuritë gramatikore, zgjerohet edhe horizonti i tyre mendor. Siç thuhet rëndom në studimet e kësaj fushe "*vetë procesi i mësimin të gramatikës ndihmon në zhvillimin e të menduarit, pasi gjatë studimit të kësaj dege bëhet thellimi në ligjëratë, analizohen pjesët e saja, vihen në dukje rregullat e ndërtimit të saj etj. Në ligjëratë nëpërmjet ndërtimit të gramatikës shprehen mendimet kështu, ligjëratë, mendim dhe gramatikë janë të pandara*".⁸⁰

Përkritazi me këtë studiuësit Tomason dhe Uard (Thomason – Ward) shprehen se: "*Gramatika e mirë mund të kontribuojë në*

⁸⁰ Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i krahinës socialiste autonome të Kosovës, *Metodika e gjuhës amtare (për shkollën normale dhe për mësuesit e shkollës fillore)*, Tiranë, 1963, f. 206.

qartësi, kuptim, rrjedhshmëri dhe stil".⁸¹ Ndërkaq studiuesi Jame Dale Uilliams konstaton se: "*Mësimi i gramatikës çon në të folur të saktë. Teoria më e përshtatshme për ta shpjeguar gramatikën është me ushtrime gojore dhe ushtrime me shkrim. Mësimi i gramatikës zhvillon të menduarit logjik, përmirëson të shkruarit dhe zvogëlon apo eliminon gabimet*".⁸²

Si rrjedhojë, mbështetur në vlerësimet dhe mendimet e studiuesve të lartpërmendur, vërejmë se mësimi i gjuhës është vlerësuar si hap vendimtar për zhvillimin, suksesin dhe përparimin e nxënësit në shkollë e në jetë, sepse përvetësimi i saj ndikon dukshëm në zhvillimin intelektual, emocional dhe shoqëror të nxënësit. Mësimi i gjuhës shqipe në shkollë është hartuar në programet mësimore sipas rathëve koncentrikë, që do të thotë se edhe prof. Nesimi në grammatikat e tij për ciklin e ulët të shkollës fillore e fillon mësimin e gjuhës nga ajo që është më e afërt, më e lehtë dhe më e kuptueshme për nxënësin, nivel ky i përvetësimit që nga metodistët quhet *imante* (*intuitive*). Në tekstet gramatikore të hartuara për ciklin e lartë të shkollës fillore prof. Nesimi i jep njohuritë gramatikore më të thelluara dhe më të zgjeruara dhe ato janë në përputhje me aftësitë psiko-fizike të nxënësit, pra i përshtaten moshës dhe parajnohurive gjuhësore që i zotëron nxënësi nga secila degë gjuhësore. Përvetësimi i njohurive gjuhësore lidhet me zhvillimin e shprehive gjuhësore dhe me ngritjen e kulturës së të folurit. Fondi i fjalëve, që i posedon leksiku i gjuhës shqipe, është shumë i gjerë. Ky fond shtohet vazhdimisht gjatë studimit të të gjitha lëndëve mësimore, d.m.th. puna rreth pasurimit të fjalorit të nxënësve lidhet edhe me ushtrimet, që i pajisin nxënësit me shprehitë drejtshkrimore të leximit korrekt dhe të gjuhës së folur e të shkruar.

⁸¹ Tommy Thason, Geoff Word, *Tools not rules teaching grammar in the writing classroom*, USA, 2009, f. 12.

⁸² Jame Dale Uilliams, *Teaching grammar në The teacher 's grammar book*, Routledge, 2005, f. 17.

Sa i përket rubrikës së ushtrimeve gjuhësore, që ka të bëjë me drejtshkrimin, e drejtshqiptimin, aparatura didaktike e teksteve të prof. Nesimit është e pasuruar edhe në këtë drejtim. Materiali që ka përzgjedhur prof. Nesimi për t'u përpunuar në ushtrimet e të folurit i përsos operacionet dhe proceset e të menduarit dhe bën të mundur formimin e shprehisë për të gjurmuar marrëdhëniet themelore dhe lidhjet e rëndësishme mes të dhënave, si dhe për të shmangur lidhjet jothelbësore ose të rastësishme, të cilat na largojnë prej zgjedhjes së drejtë. Këto ushtrime vihen në shërbim të interpretimit të atij materiali. Kështu nxënësit e bëjnë krahasimin në mënyrë aktive dhe i gjejnë ndryshimet dhe ngjashmëritë mes sendeve që krahasohen, si dhe i njohin marrëdhëniet në mes tyre, kryejnë analizën dhe sintezën, ndërsa abstraktimi vihet në shërbim të përpunimit të lëndës së ushtrimeve të të folurit. Nxënësit, po ashtu, mësojnë t'i veçojnë cilësitë dytësore të sendeve e të dukurive nga ato thelbësore. Në këtë mënyrë ata e përgjithësojnë dhe e kryejnë procesin e deduksionit dhe të induksionit (Gjokutaj, 2009: 93).

Çështja e terminologjisëgjuhësore zë një vend të rëndësishëm në aparaturën didaktike të teksteve shkollore të prof. Nesimit. Kjo terminologji është një çështje e rëndësishme për nxënësit, ndërsa njohja e terminologjisë është njëzet për ta nxënë një njësi mësimore dhe, rrjedhimisht, edhe gjithë lëndën. Kohëve të fundit në tekstet gjuhësore gjithnjë e më shumë hasim një terminologji që nuk i përshtatet moshës dhe aftësive psiko-fizike të nxënësve. Hartuesit e teksteve shkollore, duke dashur që teksti i tyre të përmbajë informacione të shumta dhe shprehje të “gjuhës së intelektualizuar”, në këtë mënyrë vetëm e ngarkojnë nxënësin me koncepte të pakuptueshme, që nuk përputhen me moshën dhe nivelin e nxënësve. Në këtë mënyrë pretendohet se ndikojnë pozitivisht te nxënësit, duke u dhënë njohuri të shumta, por nga ana tjetër ndodh e kundërta, sepse shumicën e shprehjeve nxënësit nuk i kanë të qarta dhe të njohura. Kjo është një ngarkesë edhe për mësuesin, i cili në vend që ta shpjegojë mësimin, brenda orës mësimore duhet të ndalet t'ua shpjegojë fjalët dhe termete panjohura dhe të paqarta nxënësve. Në

këtë vazhdë në tekstet e prof. Nesimit nuk e hasim këtë problema-tikë. Niveli i gjuhës që përdor ai në tekstet e tij është i qartë, i kuptueshëm, dhe aty nuk ndeshim shprehje abstrakte dhe konfuze, që e detyrojnë nxënësin ta mësojë mësimin përmes kujtesës mekani-ke, por ndodh e kundërta çdo frazë ose pjesë mësimi nxënësi e mëson përmes kujtesës logjike. Pra, ndihmesa e prof. Nesimit në standardizimin e terminologjisë gjuhësore është e madhe. Ai ka luajtur një rol të jashtëzakonshëm, sepse në një kohë kur tradita e hartimit të teksteve shkollore në gjuhën shqipe në Maqedoninë e Veriut ishte e paktë, ai arriti të hartojë tekste të unifikuara që kanë pasur mundësi t'i kuptojnë dhe përdorin si nxënësit e Maqedonisë së Veriut, ashtu edhe ata të Kosovës dhe Shqipërisë. Kjo dëshmon se ai e ka njohur në thelb traditën e shkrimit shqip. Nëse sot lufto-het për një abetare të unifikuar Shqipëri–Kosovë–Maqedoni, një nxënës i Maqedonisë që në vitet e '70-ta përmes teksteve grama-tikore të profesor Remzi Nesimit e ka pasur mundësinë e unifikasi-mit të terminologjisë gjuhësore.

Një çështje tjetër që nuk kalon pa u vërejtur në aparaturën didak-tike të gramatikave të prof. Nesimit është mënyra e mësimit të gjuhës përmes shembujve të letërsisë artistike. Ndërthurja e këtyre njohurive me tekstet eseistike dhe ndërtimi i pyetjeve dhe usht-rimeve synojnë aftësimin praktik të nxënësve për të konkretizuar në shkrimet e tyre njohuritë gjuhësore. Gramatikat e prof. Remziut janë hartuar në atë mënyrë që njohuritë gjuhësore të merren nëpërmjet veprimtarive praktike, si dhe zbatimit konkret të tyre në tekstet letrare. Gjuha dhe letërsia, gjithnjë e më shumë përdoren në mënyrat dhe format e tyre komplekse, që bart sistemi gjuhësor dhe letrar, kurse integrimi synon t'i aftësojë nxënësit në përdorimin e gjuhës dhe trajtimin e letërsisë si një proces aktiv për ndërtimin e domethënies a kuptimit.

Në përzgjedhjen e fragmenteve që ka përdorur në gramatikat e tij, profesor Nesimi, duke respektuar kriteret e programit, ka zgjedhur krijime vërtet të arritura, si nga ana artistike, ashtu edhe nga ajo

ideore. Këto tekste e përcjellin edhe misionin edukativ, ngase shembujt e përzgjedhur nuk janë një improvizim rasti, por janë shembuj të menduar, të planifikuar dhe të qëlluar për secilën njësi mësimore. Me këtë ide ai solli një frymë pozitive dhe ndikoi deri në atë shkallë, sa që nxënësit të nxitën për ta admiruar letërsinë. Në këto gramatika ndeshim mesazhe të fuqishme humaniste, mesazhe të mirësisë dhe bujarisë, mesazhe të paqes dhe tolerancës, mesazhe të punës dhe, mbi të gjitha, mesazhe të dashurisë ndërnjerëzore në të gjitha format e saja. Të gjitha këto vlera janë menduar se duhet t'i jepen një brezi që është në zhvillim për ta formuar identitetin e tij, për të qenë krenar për historinë, kulturën, traditën dhe përkatësinë e tij kombëtare. Nga ana tjetër, prof. Nesimi, ka menduar edhe për përzgjedhjen e kryeveprave të letërsisë botërore *"duke dashur që ato të përcjellin mesazhe që synojnë të përçojnë te nxënësit elementet e qytetarisë dhe kulturës globale. Të gjitha së bashku, vlerat dhe tradita shqiptare si dhe kultura dhe qytetërimin evropian synojnë të pajisin nxënësit me vërtetet e njeriut të epokës së globalizmit me mendje të hapur dhe me shije të kultivuar"*.⁸³

Si përfundim, mund të themi se prof. Remzi Nesimi, me seriozitetin dhe objektivitetin e një studiuesi dhe me punën e palodhur të një shkencëtari me kulturë e dije gjuhësore të gjerë, i ka krijuar vetes një vend të denjë në fushën shkencore dhe arsimore. Personaliteti i tij do të qëndrojë brez pas brezi në mesin e figurave më elitare të popullit shqiptar në Maqedoni dhe më gjerë.

Bibliografia e cituar:

1. Jame Dale Uilliams. 2005. *"Teaching grammar në The teacher 's grammar book"*, USA.
2. Gjokutaj, Mimoza. 2009. *"Didaktika e gjuhës shqipe"*, Tiranë.
3. Tommy Thamazon, Geoff Word. 2009. *"Tools not rules teaching grammar in the ritng classroom"*, USA.

⁸³[botimetmorava.com/uploads/Liber mesuesi Gjuha shqipe 11.doc](http://botimetmorava.com/uploads/Liber_mesuesi_Gjuha_shqipe_11.doc), marrë më 11.03.2019.

4. Enti i teksteve dhe i njeteve mësimore i krahinës socialiste autonome të Kosovës.1963. "*Metodika e gjuhës amtare (për shkollën normale dhe për mësuesit e shkollës fillore)*", Tiranë.
5. <http://www.pasqyre.al/te-gjitha/vrasja-e-gjuhesh-shqipe/>
6. http://www.botimetnorava.com/uploads/Liber_mesuesi_Gjuha_shqipe_11.doc

Bibliografia e konsultuar:

1. Mustafë, Avzi. 2014. "*Kontributi i Remzi Nesimit në hartimin e teksteve shkollore*", Vjetari i Fakultetit Filologjik libri 39–40, Shkup.
2. Nesimi, Remzi – Zorba, Stevan – Mishkovski, Dragan – Reka, Hamza – Karanfili, Islam. 1981. "*Libër Leximi për klasën VIII të shkollës fillore*", Prosvetno Dello, Shkup.
3. Nesimi, Remzi – Zorba, Stevan – Mishkovski, Dragan – Reka, Hamza – Karanfili, Islam. 1981. "*Libër leximi për klasën V të shkollës fillore*", Prosvetno Dello, Shkup.
4. Nesimi, Remzi – Gega, Xhevat – Reka, Hamza. 1985. "*Gramatika e gjuhës shqipe për klasën IV të shkollës fillore*", Prosvetno Dello, Shkup.
5. Nesimi, Remzi – Gega, Xhevat – Reka, Hamza. 1979. "*Gramatika e gjuhës shqipe për klasën V të shkollës fillore*", Prosvetno Dello, Shkup.
6. Nesimi, Remzi – Gega, Xhevat. 2001. "*Gjuha shqipe (gramatikë) 5*", Prosvetno Dello, Shkup.
7. Nesimi, Remzi – Reka, Hamza. 1980. "*Gramatika e gjuhës shqipe për klasën VI*", Prosvetno Dello, Shkup.
8. Nesimi, Remzi. 1984. "*Gramatika e gjuhës shqipe për klasën VIII të shkollës fillore*", Prosvetno Dello, Shkup.
9. Nesimi, Remzi – Gega, Xhevat. 2004. "*Fletrore punë për ushtrime gramatikore për klasën IV*", Prosvetno Dello, Shkup.
10. Nesimi, Remzi. 2000. "*Gramatika e gjuhës shqipe për shkollat e mesme I (Fonetika, Leksikologjia dhe Morfologjia)*", Prosvetno Dello, Shkup.
11. Nesimi, Ramzi – Hysa, Mahmud – Gega, Xhevat. 2002. "*Gjuhë shqipe dhe letërsi për vitin e parë të gjimnazit të reformuar*", Prosvetno Dello, Shkup.
12. Nesimi, Remzi – Toska, Valbona 2001. "*Gramatika e gjuhës shqipe për shkollat e mesme II (Sintaksa)*", Prosvetno Dello, Shkup.
13. Nesimi, Remzi – Toska, Valbona – Neziri, Zeqirja – Leka, Agim. 2003. "*Gjuhë shqipe dhe letërsi për vitin III të gjimnazit të reformuar*", Prosvetno Dello, Shkup.
14. Паини, Флорије. 2012. „*Ремзи Несими и албанската лингвистика* (punim magistrature, i mbrojtur në Fakultetin e Filologjisë “Bllazhe Koneski” në Shkup).

BESNIK EMINI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore
të Shqiptarëve – Shkup*

REMZI NESIMI NË KONGRESIN E DREJTSHKRIMIT

Aktivitetet e Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, i cili u mbajt në Tiranë në vitin 1972, u pasqyruan edhe nga mediat e kohës në Maqedoni, mes tjerash edhe për faktin se në të morën pjesë edhe pjesëmarrës nga Republika e atëhershme Socialiste e Maqedonisë. Kongresi miratoi edhe një rezolutë.

Në mesin e atyre që e nënshkruan këtë rezolutë janë edhe emrat e tre delegatëve nga Republika Socialiste e Maqedonisë, si: Mr. Remzi Nesimi, pedagog i gjuhës shqipe në Akademinë pedagogjike, Shkup; Dr. Petro Janura, drejtor i Degës së gjuhës shqipe në Universitetin e Shkupit dhe Sefedin Sulejmani, drejtor i Njesisë së bashkuar të punës botuese “Flaka e vëllazërimit”, Shkup.⁸⁴

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, më 13 qershor 2012 organizoi një konferencë shkencore kushtuar Kongresit të Drejtshkrimit. Në lidhje me këtë konferencë pata mundësinë të zhvilloj një bisedë me prof. Remzi Nesimi në banesën e Tij në Shkup. Gjatë bisedës m’u ofrua një material i bollshëm faktografik në lidhje me konferencën e Tiranës, një pjesë të së cilës e kam fotografuar, duke filluar nga ftesat, programi, fotografitë, vet kopja origjinale e rezolutës etj.

⁸⁴ Përveç nënshkruesve të Rezolutës, në Tiranë nga Republika Socialiste e Maqedonisë ishin të ftuar edhe: Kimete Agai, Mahmud Hysa, Emin Pustia, Shahe Jegeni –Sulejmani (nga Manastiri), Hatixhe Qulafku, Hamza Reka, Xhevat Gega dhe Ali Aliu.

Në kohën kur u mbajt Kongresi, si ngjarje e rëndësishme për zhvillimin e gjuhës standarde, më së shumti rëndësi në faqet e saj i kushtoi gazeta në gjuhën shqipe “Flaka e Vëllazërimit”. Një shkrim i vetëm për këtë ngjarje është botuar edhe në gazetën e përditshme në gjuhën maqedonase “Nova Makedonija”.

Gazeta e përditshme në gjuhën maqedonase “Nova Makedonija” më 20 nëntor 1972 në rubrikën “Ballkani sot” për Shqipërinë e botoi shkrimin informues me titull “Sot Kongres për Drejtshkrimin” të autorit Lutfi Rusi. Shkrimi shoqërohet me nëntitullin “Në Kongres marrin pjesë edhe gjuhëtarë të shquar shqiptarë nga Jugosllavia”. Autori i shkrimit thekson se: *“ky kongres është takimi i dytë i këtij lloji pas kongresit të alfabetit shqip, të mbajtur në Manastir në vitin 1908, kur alfabeti latin u miratua si alfabet i gjuhës shqipe.”* Në lidhje me nevojën për sjelljen e rregullave të drejtshkrimit autori thekson: *“Që nga çlirimi i Shqipërisë dhe Jugosllavisë kësaj teme disa herë i është kushtuar vëmendje e veçantë. Edhe në të dy vendet janë sjellë zgjidhje të pjesshme të drejtshkrimit, të cilat janë ndryshuar dhe korrigjuar sipas nevojave të shfaqura, por çdoherë pa ndonjë konsultim të përbashkët, edhe pse zhvillimi i gjuhës ka çuar drejt saj. Nisma për miratimin e drejtshkrimit vjen në kohën kur gjuha letrare (që nuk ishte edhe më parë) është e njëjtë për të gjithë shqiptarët, qoftë nëse ata jetojnë në RP të Shqipërisë ose në vendet tjera. Në miratimin e projektit të drejtshkrimit kanë marrë pjesë, ndërsa edhe tani me pjesëmarrje në kongres japin kontributin e tyre, edhe shumica e gjuhëtarëve të shquar shqiptarë nga Jugosllavia. Në këtë mënyrë për herë të parë shkençëtarët e RP të Shqipërisë dhe të RSFJ-së bashkërisht vendosin për një çështje të tillë të rëndësishme për zhvillimin e gjuhës shqipe.”*⁸⁵

Tekstin e radhës lidhur me çështjen e Kongresit të Drejtshkrimit gazeta “Flaka e Vëllazërimit” e boton më 3 dhjetor 1972. Bëhet fjalë pikërisht për kumtesën e Mr. Remzi Nesimit me titull “Procesi i njësimimit të shqipes letrare në Maqedoni”, të mbajtur në

⁸⁵Po aty, 20.11.1972

Kongresin e Drejtshkrimit në Tiranë.⁸⁶ Remzi Nesimi, përveçse ishte pjesëmarrës në Kongres, ai ishte edhe njëri nga nënshkruesit e rezolutës së këtij kongresi. Në numrin e njëjtë të gazetës, në faqet 17 dhe 18, botohet teksti *“Rezolutë e Kongresit të Drejtshkrimit të gjuhës shqipe”*.

Teksti e përmban vetëm rezolutën, ndërsa emrat e nënshkruesve nuk janë përfshirë në tekst. Përndryshe, teksti fillon me një pjesë e cila nuk është pjesë përbërëse e rezolutës origjinale të Kongresit të Drejtshkrimit. Bëhet fjalë për sqarimin e redaksisë rreth rezolutës, përmbajtja e së cilit është kjo: *“Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe i zhvilloi me sukses punimet e tij prej 20 deri më 25 nëntor në Tiranë. Nëpërmjet të më se 150 referuesve dhe kumtesave u ndriçuan problemet e ndryshme të drejtshkrimit dhe të gjuhës së njësuar letrare shqipe. Në fund të punimeve, Kongresi aprovoi njëzëri Rezolutën e drejtshkrimit të gjuhës letrare shqipe të cilën e nënshkruan edhe delegatët nga Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë – nga Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi. Rezolutën e Kongresit – këtë dokument të rëndësishëm shkencor, kombëtar e historik, po e botojmë të bindur se synimet e tij do të vihen në jetë në përpikëri dhe konsekuencë të plotë”*.⁸⁷ Pas këtij teksti hyrës vijon përmbajtja e tekstit të Rezolutës, që është tanimë i botuar disa herë dhe është i njohur për lexuesit.⁸⁸

⁸⁶“Flaka e Vëllazërimit”, 03.12.1972, fq. 12

⁸⁷Po aty

⁸⁸Rezoluta e Kongresit të Drejtshkrimit është shtypur me makinë shkrimi dhe është nënshkruar në gjashtë kopje në Tiranë më 25 dhjetor 1972 dhe për herë të parë është botuar në *“Drejtshkrimi i gjuhës shqipe”*, Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë – Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 1973. Në kopjen origjinale të kësaj rezolute në fund të saj qëndron ky shënim: *Kjo Rezolutë u hartua dhe u nënshkrua në gjashtë kopje*. Njëri nga këto kopje origjinale pata mundësi ta shoh gjatë bisedës që zhvillova në banesën e profesorit Remzi Nesimi në Shkup më 6 qershor 2012 në vigjilje të 40-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit. Kopja ishte ruajtur në gjendje të mirë, e lidhur me kapakë të fortë me ngjyrë të kuqe dhe të gjitha faqet e saja ishin të vulosura me të ashtuquajtur *vulë të thatë* në formë të rumbullakët, në të cilën shkruan: **KONGRESI I DREJTSHKRIMIT TIRANË 1972**. Në mes të vulës është paraqitur libri dhe pena. Në fund të tekstit është edhe

Tekstin e radhës lidhur me Kongresin e Drejtshkrimit gazeta “Flaka e Vëllazërimit” e boton më 10.12.1972. Bëhet fjalë për një intervistë të zhvilluar nga ana e gazetarit Rexhep Zllatku me tre nënshkruesit e rezolutës nga RS e Maqedonisë: Petro Janurën, Remzi Nesimin dhe Sejfedin Sulejmanin. Intervista mban titullin: “*Për një gjuhë kristale, stabile*”⁸⁹. Pyetjet e intervistës nuk janë shënuar, por i pari që shpalos përshtypjet e tija gjatë intervistës është Petro Janura. Ndërkaq Remzi Nesimi për përshtypjet e kongresit shprehet: “*Mendoj se Kongresi u mbajt në një kohë të duhur, kur më ishin pjekur kushtet për unifikimin e plotë të drejtshkrimit dhe të gjuhës shqipe. E kjo, siç duhet, ka qenë ideal i të gjithë letrarëve, gjuhëtarëve shqiptarë, që nga Rilindja e deri më sot*”.

Rreth drejtshkrimit të aprovuar Remzi Nesimi shprehet: “*Vetë fakti se drejtshkrimi i aprovuar bazohet në parimet fonetike bën që të jetë shumë i afërt dhe i përshtatshëm për masat e gjera e jo vetëm për një rreth të ngushtë intelektualësh*”.

Dua të theksoj se delegatët nga RS e Maqedonisë ishin mjaft aktiv. Dr. Janura dhe Magjistri R. Nesimi u paraqitën me kumtesa të tyre. Ata ishin edhe anëtarë komisionesh të punës së Kongresit.” Sa i përket vazhdimësisë së zbatimit të gjuhës letrare, Remzi Nesimi rreth kësaj do të shprehet: “*Sikurse drejtshkrimi i vitit 1965 që paraqet një hap para në krahasim me drejtshkrimin e vitit 1951–52, ashtu edhe drejtshkrimi definitiv i gjuhës shqipe paraqet disa lehtësi.*

lista e emrave të delegatëve të Kongresit të Drejtshkrimit të gjuhës shqipe dhe nënshkrimet e tyre. Lista përmban gjithsej 87 delegatë, ku figurojnë nënshkrimet e 86 delegatëve. Mungon vetëm nënshkrimi i Lasgush Poradecit, shkrimtar, Tiranë. Gjatë ditës që u mbajt konferenca kushtuar prof. Remzi Nesimit, më 21.03.2019 në ITSHKSH në Shkup, Emil Lafe, pjesëmarrës në këtë konferencë, revokoi kujtimet e tij në lidhje me hartimin e tekstit të rezolutës, e që për shkak të shkrimit me makinë shkrimi ekipi ishte vonuar deri në orën 4 të mëngjesit. Të 6 kopjet e Rezolutës janë shpërndarë si vijon: 1. Instituti i gjuhës dhe i letërsisë pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë; 2. Instituti Albanologjik Prishtinë; 3. Pjesëmarrësve nga R.S e Maqedonisë (ruajtur nga prof. Remzi Nesimi); 4. Arkivi i Shtetit; 5. Komitetit Qendror; 6. Pjesëmarrësve nga Mali i Zi (Ismail Doda).

⁸⁹ “Flaka e Vëllazërimit”, 10.12.1972, fq. 15

Intencat kryesore të pjesëmarrësve të Kongresit si dhe të hartuesve të projektit kanë qenë që të kemi një drejtshkrim sa më pak përjashtime. Në drejtshkrimin e ri pothuajse janë rrafshuar të gjitha dubletet që aty-këtu figurojnë në projektin e rregullave të vitit 1967. Po kështu do të jetë një lehtësim për nxënësit dhe redaksitë ndarja e fjalëve në fund të rreshtit, sepse sipas këtij drejtshkrimi thjeshtohen shumë kriteret rigorozë të deritashme.⁹⁰

Përndryshe prof. Remzi Nesimi me pjesëmarrjen e tij e nderoi edhe konferencën e drejtshkrimit që e mbajti instituti më 13 qershor 1972, këtu në të njëjtën Sallë ku jemi sot.

KULTURË ARËSIM LETËRSI SHKENCË ART

Pas Kongresit të drejtshkrimit të gjuhës shqipe

PER NJE GJUHE KRISTALE, STABILE




DR. PETER ZEBER, NIKOLLA PAVLOVSKI, DR. GJERGJI RAKOZI, MESTRI D. HANDEK. DR. GJERGJI RAKOZI, MESTRI D. HANDEK.


... (The rest of the page contains dense text columns, likely the transcript of the conference mentioned in the text above.)

Faqja e gazetës “Flaka e Vëllazërimit” e datës 10 dhjetor 1972, në të cilën është botuar intervista me tre nënshkruesit e Rezolutës nga RS e Maqedonisë.

⁹⁰Po aty



Ftesa drejtuar prof. Remzi Nesimit për pjesëmarrje në Kongresin e Drejtshkrimit



Nënshkrimi i prof. Remzi Nesimit në Rezolutë



Duke e nënshkruar Rezolutën



Duke e lexuar kumtesën në Kongresin e Drejtshkrimit

NDIHMESA E PROFESOR REMZI NESIMIT PËR LEKSIKUN E SHQIPES

Për profesor Remzi Nesimin, mund të thuhet se është ndër ata njerëz që janë ndodhur në kohën e duhur, në vendin e duhur. Emri i tij është i mirënjohur jo vetëm në Maqedoninë e Veriut, por në mbarë botën intelektuale shqiptare, veçanërisht në rrethet e shkencave filologjike. Ai na la trashëgim një veprimtari të pasur e të larmishme shkencore dhe një karrierë të gjatë e të frytshme pedagogjike. Ishte mësues i nderuar i shumë brezave dhe një meritë e madhe e tij është se ka ditur t’u mësojë mirë studentëve të vet jo vetëm ato dije shkencore që kanë librat, por edhe diçka më tepër, që nuk e kanë librat, por që e rrezaton personaliteti i mësuesit, zemra dhe sjellja e tij.⁹¹

Kontributi i tij i jashtëzakonshëm për gjuhësinë dhe kulturën shqiptare është shumë i madh. Më se gjysmë shekulli, me një përkushtim të madh, punoi pandërprerë për ngritjen e përgjithshme të vetëdijes arsimore, kulturore dhe të vetëdijes kombëtare të popullit shqiptar në Maqedoni e më gjerë. Është e dukshme ndihmesa e tij që ka dhënë në pastrimin, pasurimin dhe kultivimin e gjuhës letrare shqipe, me çka dëshmon edhe pjesëmarrja e tij aktive në organizimin dhe zhvillimin e Kongresit të Drejtshkrimit të gjuhës shqipe në vitin 1972, ku mori pjesë si një ndër delegatët e shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut dhe si anëtar i komisionit për hartimin e projektrezolutës.

⁹¹ Emil Lafe, Revista “Perla”, 2013, nr. 3-4.

Veprimtaria e tij është e pasur dhe e shumëllojshme, por ndihmesa e tij në fushën e gjuhës, la gjurmë të thella në gjuhësinë shqiptare në përgjithësi. Pjesa më e madhe e shkrimeve të kësaj fushe janë përfshirë në kreun e parë dhe të dytë të librit të tij “*Çështje gjuhësore*” (Shkup, 1998), i cili përbëhet nga këta krerë: I. *Çështje të normës letrare dhe të pastërtisë së gjuhës letrare*, II. *Shqipja e shkruar në Maqedoni*, III. *Nga të folmet shqipe në Maqedoni*, IV. *Përvjetorë*, V. *Shqipja në kontekstin ballkanik*.⁹²

Duke u nisur nga veprimtaria e tij në fushën e dialektologjisë, shohim se të folmet shqipe në Maqedoni, për profesor Remziun, kanë ngjallur interes që nga mosha më e hershme e tij.

Kontributi i tij në këtë fushë të gjuhës, filloi që në kohën e përgatitjes së punimit të tij të magistraturës “*Veçoritë fonetike të së folmes shqipe të rrethit të Tetovës*” (Beograd, 1971), për të vazhduar më vonë edhe me disertacionin e doktoratës “*E folmja e Dervenit*” (Prishtinë, 1988). Puna e tij nuk pushoi me kaq. Dialektologjisë shqiptare i dhuroi edhe disa studime të rëndësishme si “*Mbi disa veçori të sistemit vokalik të së folmes shqipe të rrethit të Tetovës*”, Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978, “*Përdorimi dhe diftongimi i vokaleve i dhe u në të folmen shqipe të rrethit të Tetovës*”, Jehona 2, Shkup, 1972, “*Përdorimi i zanores ë në të folmet shqipe të rrethit të Tetovës*”, Flaka e Vëllazërimit, Shkup, 1972, “*Studime nga dialektologjia shqiptare*” (intervistë), Flaka e Vëllazërimit, Shkup, 1972, “*Disa veçori strukturore dhe fonetike të toponimeve të rrethit të Tetovës*”, 1977, “*Fjalë të rralla nga e folmja e Dervenit*”, Gjuha shqipe 2, Prishtinë, 1989, “*Kategoria e numrit të emrave në të folmen e Dervenit*”, Gjurmime albanologjike, Prishtinë, 1990, “*Shumësi i emrave të gjinisë mashkullore në të folmen e Dervenit*”, Gjurmime albanologjike, Prishtinë, 1990 etj.

⁹² Remzi Nesimi, *Çështje gjuhësore*, Shkup, 1997.

E folmja e Dervenit

Disertacionin e doktoratës “*E folmja e Dervenit*”, profesor Nesimi, më vonë e zgjeroi dhe e plotësoi hap pas hapi, duke na dhënë një punim dialektologjik klasik, si nga ndërtimi, ashtu edhe nga përmbajtja. Monografia e tij e gjerë dhe e thelluar për të folmen e Dervenit, plotëson hartën e dialektologjisë shqiptare me të dhëna të sigurta e me shpjegime të hollësishme për një të folme me karakteristika të veçanta të gegërishtes qendrore. Përshkrimi i së folmes së Dervenit, në masën dhe në mënyrën si është bërë në këtë studim, parakupton një njohje të gjerë të dialektologjisë shqiptare, nga njëra anë, dhe të sistemit të përgjithshëm të gjuhës shqipe në gjendjen e sotme e në zhvillimin historik të tij, nga ana tjetër.⁹³

Vepra “*E folmja e Dervenit*” me 500 faqe tekst, i është kushtuar një të folmeje të pastudiuar deri në atë kohë dhe të panjohur për dialektologjinë shqiptare. Në këtë monografi, në detaje janë përshkruar të gjitha veçoritë fonetike, morfologjike, fjalëformuese, sintaksore, frazeologjike dhe leksikore të së folmes. Në fund na jepet një fjalorth i cili përmban emra, mbiemra, folje, ndajfolje parafjalë etj, të radhitura sipas alfabetit dhe në fund fare, kemi tekste origjinale nga e folmja, që janë në interes të madh për dialektologjinë dhe gjuhën shqipe në përgjithësi.

Sipas profesor Nesimit, e folmja e Dervenit është vazhdim i së folmes shqipe të Pollogut dhe bën pjesë në arealin e gegërishtes qendrore e cila dallohet nga të folmet e tjera geqe sidomos me tri inovacionet e njohura fonetike: me diftongimin e *i*-së dhe *u*-së së theksuar në pozicione të caktuara fonetike, me afrikimin e qiellzoreve *gj* në *xh* dhe *q* në *ç* dhe palatalizimin e *g*-së. Përveç këtyre, pjesën më të madhe të këtij areali, e karakterizon edhe delabializimi i *y*-së dhe kalimi i kësaj foneme në *i*.

⁹³ Emil Lafe, Revista “*Perla*”, 2013, nr. 3-4.

Mënyra e përshkrimit të kësaj të folmeje, duke përfshirë këtu edhe krahasimet që ka bërë me të folmet e tjera të gegërishtes qendrore, na lë të kuptojmë se Remzi Nesimi ka pasur një njohje të gjerë të dialektologjisë shqiptare dhe të sistemit të përgjithshëm të gjuhës standarde shqipe.

Leksiku i të folmes së Dervenit

Përshkrimi i një të folmeje pa shqyrtuar fondin leksikor të saj, nuk do të ishte i plotë sepse lënda leksikore së bashku me materialin fonetik të saj, janë elemente shumë të rëndësishme për përcaktimin e vendit të saj në strukturën dialektore të gjuhës, ku ajo bën pjesë.⁹⁴

Fondi leksikor i të folmes së Dervenit, ashtu si edhe i të folmeve tjera përreth, është i pasur dhe shumë i përshtatshëm për të parë lidhjet dhe ndikimet reciproke me të folmet tjera, e veçanërisht me ato të folme me të cilat ka qenë dhe është në kontakt.

Duke parë rëndësinë e leksikut të këtyre vendbanimeve, autori e ka trajtuar atë në një kapitull të veçantë në monografinë e tij.

Sipas prof. Nesimit, pjesën dërmuese të fondit leksikor, e përbejnë fjalët e brumit të shqipes që përdoren edhe në të folmet e tjera si dhe në gjuhën standarde letrare. Në këtë të folme, hasen një numër i konsiderueshëm elementesh leksikore me prejardhje nga gjuhët orientale, si dhe nga gjuhët sllave të cilat nuk janë karakteristike për mbarë shqipen.⁹⁵ Pra, si në çdo të folme, edhe në të folmen e Dervenit, ai dallon fjalë me etimologji të ndryshme.

Prania e elementit të huaj leksikor, është kushtëzuar nga shumë faktorë historikë, ekonomik, shoqëror e kulturor si dhe faktorëve tjerë ndërgjuhësorë që kanë ndikuar në jetën e përbashkët të etnive që kanë jetuar në këtë rajon. Huazimet janë rezultat i kontakteve dhe marrëdhënieve të përhershme me pushtuesit dhe popujt tjerë

⁹⁴ Haki Ymeri, *E folmja shqipe e Karshiakës*, Shkup, f. 195.

⁹⁵ Remzi Nesimi, *E folmja e Dervenit*, Seminari i Albanologjisë, Tetovë, 2008.

fqinjë. Nevoja për të komunikuar njerëzit mes vete, e veçanërisht në mjediset shumëgjuhësore, është arsyeja kryesore për ngjashmëri si dhe ndërndikim gjuhësor.⁹⁶ Numri më i madh i fjalëve të huaja që janë përfshirë në këtë areal gjuhësor, përfshijnë të gjitha sferat e jetës materiale e mendore të këtij rajoni.

Shqipja si gjuhë indoevropiane dhe si gjuhë ballkanike është ndikuar nga gjuhë të ndryshme, jo vetëm nga gjuhët e popujve fqinjë ballkanikë por edhe nga gjuhët e pushtuesve euroaziatikë. Prandaj, mund të thuhet se shqipja pësoi ndikime jo vetëm nga gjuhët indoevropiane, por edhe nga gjuhët joindoevropiane, siç është turqishtja dhe arabishtja.

Nëpërmjet turqishtes, si gjuhë e drejtpërdrejtë e pushtuesit, në të folmen shqipe depërtuan edhe një numër i konsiderueshëm i fjalëve arabe e persiane, të cilat në shkencën e gjuhësisë u emërtuan më një term të përbashkët, orientalizma.

Edhe pse ndikimi më i madh i orientalizmave vërehej në të folmet e qytetit, ndërsa gjurmët më të dobëta ishin në fshat, e veçanërisht në sferën e bagëtisë e të bujqësisë, në fushën e emërtimit të bimëve dhe shtazëve dhe se jeta me tipare turko-orientale ishte përqendruar shumë më tepër në qytete, kurse shumë më pak në fshatra, përsëri edhe në të folmen e fshatrave kanë depërtuar një numër goxha i madh i orientalizmave.

Sipas profesor Nesimit, në të folmen e fshatrave të Dervenit, huazimet përfshijnë të gjitha sferat e jetës shtëpiake, sociale e shtetërore. Në mënyrë të veçantë banimin, të ngrënët, veshjen, folklorin, doket e zakonet, festat, artin, jetën fetare, administratën, ushtrinë etj.

Orientalizmat, ashtu si edhe në gjuhët tjera ballkanike, edhe në gjuhën shqipe, në përgjithësi filluan të depërtojnë pas pushtimit osman të këtyre trojeve me anë të ushtrisë, administratës e sidomos me anë të fesë. Për shkak se pjesa dërmuese e popullatës së Dervenit

⁹⁶ Asllan Hamiti, *E folmja shqipe e Karadakut të Shkupit*, Shkup, 2014, f. 367.

është e përkatësisë fetare islame, edhe numri i huazimeve orientale është shumë i madh.

Duke mos e njohur terminologjinë adekuate fetare, por edhe duke ia përshtatur gjuhën shqipe nevojave të ligjërimit religjioz islam, predikuesit e fesë, kanë përdorur termat e gjuhëve burimore si: *Allah, abdes, ahiret, amin, azap, Bajram, iftar, imsak, këble, namaz, medereze, mekptep, ramazan, xhehenem, xhenet, zekat, reqat, ruqu, sexhde, tekbir*, etj. Këto janë ndër huazimet e para që kanë depërtuar me anë të gjuhës së folur.

Osmanishtja nuk ishte një gjuhë homogjene, por një përzierje e turqishtes, persishtes e arabishtes. Prandaj, në gjuhën shqipe hasim edhe fjalë të leksikut arab e pers. Ndërkaq, përmes osmanishtes, kanë ardhur edhe huazime nga greqishtja e italishtja si p.sh. *efëndi*<gr. e re *authentēs*, përkatësisht nga *athendi* dhe *afendi*, *llamba*; <gr. e re *lampa*, *karanfil*<ar, *qaranfil*<*karnafilon* etj. Një pjesë nga këto huazime, janë bërë pronë e leksikut të shqipes dhe të folmeve të saja. Sipas profesor Nesimit, në FGJSH të v. 1954, janë përfshirë afër 1500 huazime orientale, ndërsa në të folmen e Dervenit, përdoren rreth 160 emra të gjuhëve orientale si element i dytë i shprehjeve me foljen bëj si p.sh. *bëj hizmet, bëj bela, bëj sefa* etj.⁹⁷

Rajoni i Dervenit, edhe pse nuk ka qenë larg qendrave të rëndësishme politike-ekonomike dhe kulturore e administrative siç janë Shkupi, Tetova dhe Gostivari, këtu nuk janë infiltruar të gjitha ato elemente dhe shprehje të huazuara që i hasim në këto qendra urbane.

Duke u mbështetur në numrin e huazimeve turke, profesor Nesimi, konstaton se numri i tyre në të folmen e Dervenit është përafërsisht sa gjysma e huazimeve orientale në mbarë shqipen.

Është e pamundur të numërohen të gjitha ato orientalizma që tash më janë bërë pjesë e leksikut të Dervenit, por profesori ka dhënë

⁹⁷Remzi Nesimi, *E folmja e Dervenit*, Tetovë, 2008, f. 399.

vetëm disa që më së shumti përdoren në jetën përditshme si: *açaik* “e çelë”, *akron* “inoshatar”, *akraba* “farefis”, *akshom* “mbrëmje”, “*amel* “vepër e mirë”, “*arallaik* “hapësirë në mes dy sendeve”, “*ashap* “shok”, “*ashiqare* “haptas”, “*avxhi* “gjuetar”, “*azap* “grykim”, “*batil* “i poshtër”, “*bina* “ndërtesë”, “*birinxhi* “i pari” e shumë e shumë fjalë të tjera.

Sipas profesor Nesimit, numri më i madh i fjalëve të huazuara që kanë hyrë në leksikon e kësaj të folmeje, janë emra dhe mbiemra, ndërkaq edhe pse në numër më të vogël, këtu kemi edhe folje. Këto folje zakonisht dalin me tëmë në *-is*. p.sh. *begenis*, *bojadis*, *çalldis*, *gjezdis*, *ujdis*, *vardis*, *çatis*, *dalldis*, etj.

Njëjtë si në gjuhën standarde edhe në të folmen e Dervenit, profesor Nesimi konstaton se elementet e huazuara u nënshtrohen ligjeve fonetike dhe morfologjike të gjuhës. Te një numër i madh i orientalizmeve me *-i* të theksuar, ka vepruar edhe fenomeni i diftongimit të *i*-së. P.sh. *açik*-*açaik*, *bakshish*-*bakshaish*, *begenis*-*begenais*, *çivi*-*çivai*, *dervish*-*dervaish*, *efëndi*-*efëndai*, *mavi*-*mavai* etj.

Diftongimi i *i*-së dhe *u*-së theksuar është një ndër inovacionet më karakteristike fonetike të së folmes së Dervenit dhe të mbarë gegërishtes qendrore. Pikërisht ky inovacion si edhe disa inovacione të tjera, bëjnë që gegërishtja qendrore të dallohet nga të folmet e tjera geqe dhe të paraqesë një të folme me tiparet e saj karakteristike.⁹⁸

Prandaj për të folmen e Dervenit dhe marrë në përgjithësi për dialektologjinë dhe gjuhësinë shqiptare, profesori ka dhënë një kontribut të madh duke vënë në pah fenomenin e diftongimit të *i*-së dhe *u*-së dhe pasurimin e fondit leksikor me fjalë që formohen si rrjedhojë e këtij fenomeni.

⁹⁸ Remzi Nesimi, *Çështje gjuhësore*, Shkup, 1997, f. 85.

Edhe numri i fjalëve që kanë prejardhje nga gjuhët sllave është i madh për shkak se shqiptarët si popull çdoherë kanë qenë në kontakt të vazhdueshëm me popujt sllav të ballkanit, me maqedonasit, serbët, bullgarët etj, dhe si rezultat i këtyre kontakteve edhe leksiku i shqiptarëve të kësaj ane, na del përplot me sllavizma.

Me kalimin e kohës, me ndërrimin e gjeneratave, jo vetëm në gjuhën e shkruar por edhe në gjuhën e folur, disa fjalë dhe shprehje orientale filluan të hiqen nga përdorimi. Disa fjalë të tjera e sidomos ato që kishin të bëjnë me administratën, filluan të zëvendësohen me sllavizma si: *kadija-sudija*, *aza-odbor*, *devrije-çuvar*, *astahane-bollnic etj.*

Deri në Luftën e Dytë Botërore, në këto vise, serbokroatishtja ishte gjuhë zyrtare e administrative, gjuhë e shkollës, gjuhë e shtypit dhe e kulturës, prandaj në këtë periudhë në gjuhën shqipe të këtij rajoni, depërtuan shumë terma të rinj nga sfera të ndryshme të jetës e sidomos nga terminologjia administrative. Si terma të këtyre mund të numërohen: *nazërnik*<nadzornik “inspektor shkolle,” *poreznik* “tagrambledhës”, *poziv* “thirrje”, *pretsednik* “kryetar”, *srez* “rreth”, *bukvicë* “librezë ushtarake”, *nadnicë* “mëditje” etj.⁹⁹

E folmja shqipe e Dervenit, lidhur me sllavizmat, nuk paraqet ndonjë veçanti nga të folmet e tjera shqipe në Maqedoninë e Veriut. Marrë në përgjithësi, huazimet e njëjta sllave, kanë përhapje të përgjithshme në të gjitha të folmet në Maqedoninë e Veriut.

Në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore, me formimin e maqedonishtes si gjuhë zyrtare, shumica e fjalëve me prejardhje nga serbokroatishtja, u zëvendësuan me terme adekuate të maqedonishtes apo me fjalë të tjera shqipe.

Sipas pjesëve të ligjëratës, numri më i madh i huazimeve sllave janë emra, pastaj vijnë foljet, ndajfoljet, mbiemrat etj.

⁹⁹ Idaete Sinani, *Veçorite leksikore të fshatrave Krushopek, Gërçec dhe Nerez të Shkupit*, 2016 (punim magjistrature në dorëshkrim).

Profesor Nesimi me të drejtë konsideron se disa huazime sllave që përdoren në të folmen e Dervenit e që në leksikun e kësaj të folmeje kanë hyrë dekadave të fundit, konsiderohen si barbarizma.

Fjalët si: *autoput, bollnic, bollovanje, carinë, çllanarinë, çuvar, dërzhavë, dobrovollno, dogovor, domazet, gërklon, izvod, jaz, kni-zhar, koçnic, molb, nepismen, odbor, okoli, peçat, pllata, pritisak, prodavaç, slluzhb, shtrajk, ulic, uput, zapisnik, zhallb* etj, përdoren pa pasur nevojë për shkak se ekzistojnë fjalë adekuate në gjuhën shqipe.

Si të gjitha huazimet e tjera ashtu edhe ato me burim nga gjuhët sllave të jugut, përgjithësisht u përshtaten ligjeve fonologjike e morfologjike të shqipes, përkatësisht sistemit gramatikor të gjuhës marrëse.¹⁰⁰

Njëjtë si te huazimet turke, edhe te fjalët me burim sllav, ka vepëruar dukuria e diftongimit të *i*-së së theksuar në të gjitha pozicionet fonetike, sidomos te prapashtesat *-ica, -ina* dhe te foljet që mbarojnë me *-it*. p.sh. *Beramaic, Isenaic, Kopanaic, coftain, gllavain, mërcain*, te foljet: *glasaiti, kosaiti, përzhaiti, prashaiti* etj.

Sikurse gjuha letrare shqipe, ashtu edhe gjuha e fshatrave të Dervenit, është shumë e pasur me sinonime. Sinonimia leksikore siç thotë prof. Jani Thomaj, është mundësi gjuhësore nxitëse për thithjen e fjalëve nga të folmet. Shtresa më e gjerë e fjalëve dialektore e krahinore, përbëhet nga ato fjalë që kanë hyrë ose mund të hyjnë në gjuhën letrare si sinonime leksikore të fjalëve më të përgjithshme a të dialektit tjetër, duke sjellë jo vetëm larmi, por edhe pasurim me nuanca kuptimore, ngjyresa emocionuese etj.

Profesor Nesimi vë në dukje se çiftet sinonimike në të folmen e Dervenit, më së shpeshti hasen në klasën e emrave e pastaj në atë të mbienrave dhe foljeve. Ai ka veçuar çifte sinonimike që përbëhen prej fjalëve shqipe si p.sh : *frigem-tautem, kallí-ndezi, teri-thaj,*

¹⁰⁰Remzi Nesimi, *E folmja e Dervenit*, Tetovë, 2008, f. 409.

fakton-veton, tek mbiemrat si: *i gjuftaisgëm-i lodhët, i mçartët -i prashët, i mbledhët - i ngurët* etj. Një numër të madh sinonimesh kemi me fjalë shqipe dhe turke, arabe, perse, si p.sh. *çill-hava, dom-zarar-zullun, helm-zeher, kal-at, kerr-rab, kufai-hudut, i duraushëm-sabërli* etj.

Sinonime të shumta hasen edhe me fjalë paralele nga maqedonishtja dhe gjuhët sllave të jugut si p.sh. *boskuçe-tatabit, bretkos-zhabë, dushk-lesnaik, këpurdh-peçurk, lipsak-pitaç, sopatë-sakicë, sparriher-përviçe, vek-razboj, zgebe-zhug, zotnaji-gospodin* etj.¹⁰¹

Profesori ka përmendur edhe raste kur sinonime mund të jenë fjalët turke, fjalët turke e arabe ose persiane dhe fjalë turke e sllave si p.sh. *bilizik-hallhalle, çapkën-zevzek, irish-huxhum, paqllek-tenis, ilaç-melhem ose tekrar-ope, aza-odbor, astahone-bollnic* etj.

Përveç analizës etimologjike, profesor Remziu, leksikun e banorëve të Dervenit e studioi edhe në bazë të fjalëformimit.

Pas një punë dhe analize të detajuar, për përshkrimin e mënyrës së fjalëformimit në të folmen e Dervenit, prof. Remziu, konstaton se ashtu si në pjesën më të madhe të të folmeve të tjera dhe në gjuhën standarde shqipe, edhe në këtë të folme, pjesa më e madhe e fjalëve të prejardhura, formohen me anë të prapashtesimit, një pjesë me anë të parashtesimit dhe me kompozita. Prandaj ai shton se për formimin e fjalëve të reja përdoren afër një e treta e prapashtesave të gjuhës shqipe dhe të atyre që në gjuhën tonë kanë hyrë nga gjuhët e tjera.

Rëndësi të veçantë për leksikun e Dervenit, paraqesin edhe njësitë frazeologjike që janë dhënë në monografi (rreth 90 njësi frazeologjike) të cilat kanë shtrirje të kufizuar ose që njihen vetëm në të folmen e Dervenit si dhe fjalori i të folmes me fjalë karakteristike për këtë të folme i cili përmban emra, mbiemra, folje, ndajfolje etj, të radhitura sipas alfabetit.

¹⁰¹ Po aty f. 422.

Pasuria leksikore e frazeologjike e rajonit të Dervenit, vlerësojmë se është shumë e rëndësishme për leksikun e gjuhës në përgjithësi për shkak se leksiku popullor është gurrë e pashtershme për pasurimin e gjuhës së përbashkët.

Duke u bazuar në punën disavjeçare në mbledhjen, përpunimin dhe sistemimin e materialit dialektor, vlerësojmë se profesor, Remzi Nesimi, mund të llogaritet si njëri ndër themeluesit e dialektologjisë shqiptare në Maqedoni. Ai dha një ndihmesë goxha të madhe në fushën e leksikut dhe dialektologjisë, duke i plotësuar këto arritje me të dhëna të sakta e të sigurta, dhe duke i çuar edhe më tej për të hapur shtigje të reja hulumtimi në këtë fushë.

Përmbyllje

Si një nga figurat më të mëdha të jetës intelektuale të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, dijetari e profesori ynë, Remzi Nesimi, bëri një kthesë të madhe në gjuhësinë dhe kulturën shqiptare në përgjithësi.

Në personalitetin e tij gjejmë të harmonizuar profesorin fjalëurtë me këshillat e tij të kujdesshme, studiuesin e palodhur e të apasionuar, që ka dhënë ndihmesë në disa fusha studimore të shqipes, autorin e mbi 100 artikujve shkencore, librave shkollorë, mjeshtrin e mprehtë të gojës së popullit, por, mbi të gjitha, njeriun që i fali jetën kombit dhe gjuhës.

Ky intelektual i rrallë, e me dëshira të gjithanshme për të kontribuar në zhvillimin e kulturës shqiptare, me mish e shpirt punoi në lëvrimin dhe ruajtjen e gjuhës amtare shqipe.

U bë pishtar i arsimit të lartë në Maqedoni. Mësoi e edukoi shumë breza të ri. Shërbeu pa kursyer asgjë nga vetja dhe nga shpirti i tij i madh e bujar, dha gjithçka për studentët. Për vite me radhë, rrezatoi kulturë dhe dije dhe me plot pasion ua përcolli gjeneratave që la pas.

Monografia e tij “E folmja e Dervenit”, me tiparet e një vepre të mirëfillte shkencore, arriti të plotësojë një hapësirë të vogël nga gjithë ajo hapësirë e madhe e hartës dialektore të të folmeve shqipe në Maqedoni e më gjerë.

Ai ishte ndër gjuhëtarët e parë që voli, studioi dhe shkencorizoi leksikun e rajonit të Dervenit, një lëndë shumë e pasur dhe e rëndësishme për gjuhësinë.

Në bazë të analizave etimologjike e fjalëformuese, ndikimeve ndër-gjuhësore, huazimeve dhe fjalëve të brumit të shqipes, ai na jep një pasqyrë të saktë për leksikun e të folmes së Dervenit.

Me punën e një mjeshtri të rrallë, arriti të vë në pah dukuri që janë karakteristike për leksikun e Dervenit, por edhe ngjashmëri që ky leksik ka me leksikun e të folmeve të tjera të gegërishtes qendrore.

Puna e tij shumëvjeçare e me plot përkushtim në fushën e leksikut është një ndihmesë jashtëzakonisht e madhe dhe paraqet bazë për kërkime dhe hulumtime të reja.

Remzi Nesimi erdhi në botën e dijes shqiptare, krijoi dhe iku duke na lënë neve një trashëgimi të madhe shkencore dhe atdhetare, për të mbetur i pavdekshëm në altarin e shkencës, kulturës shqiptare dhe të shqiptarisë.

Ky dijetar me merita të mëdha që bëri shumë për kombin dhe gjuhën, do të na mungojë shumë, por jo edhe vepra e tij madhështore e cila do të mbetet një udhëzim dhe udhërrëfim për ne, për gjeneratat që la pas.

LITERATURA E KONSULTUAR:

Hamiti, Asllan: *Ndihmesa e profesor Remzi Nesimit për arsimin, shkencën dhe kulturën shqiptare*, „Filologjia”, Revistë Shkencore Ndërkombëtare për Gjuhësi, Letërsi dhe Kulturë, Viti I, prill, 2013, Universiteti Shtetëror i Tetovës, Tetovë, 2013, f. 101–109.

Hamiti, Asllan: *Ndihmesa e studiuesve të Maqedonisë në fushën e dialektologjisë shqiptare*, http://alpa.mali-it.eu/journal/aktet/vol/vol2/Aktet_Vol_II_Nr_1_pp_53_57.pdf.

Hamiti, Asllan: *Prof. Remzi Nesimi – pedagog, humanist dhe studiues i shqipes*, Shqyrtime albanologjike 5, Shkup, 1998, f. 11–18.

Hamiti, Asllan – Qamili, Ajten – Osmani, Ismet: *Kontributi i delegatëve të Kongresit të Drejtshkrimit nga Maqedonia për shqipen standarde*, “Akademi solemne në 40-vjetorin e Kongresit të Drejtshkrimit të gjuhës shqipe”, Korçë, 16–17 nëntor 2012.

Hamiti, Asllan: *E folmja shqipe e Karadakut të Shkupit*, Logos A, Shkup, 2014.

Lafe, Emil: Revista “Perla”, 2013, nr. 3–4 (66).

Nesimi, Remzi: *Çështje gjuhësore*, Shkupi, Shkup, 1997.

Nesimi, Remzi: *E folmja e Dervenit* (disertacion doktorate), Prishtinë, 1988.

Nesimi, Remzi: *E folmja e Dervenit*, Seminari i Albanologjisë, Universiteti i Tetovës, Tetovë, 2008.

Sinani, Idaete: *Veçorite leksikore të fshatrave Krushopek, Gërçec dhe Nerez të Shkupit*, 2016 (punim magjistrature në dorëshkrim).

Ymeri, Haki: *E folmja shqipe e Karshiakës*, Shkupi, Shkup, 1997.

BOTUES:
INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

SCUPI, vëllimi 24 – 2019
(KONTRIBUTI I PROF. REMZI NESIMIT
PËR GJUHËN SHQIPE DHE GJUHËSINË SHQIPTARE)

Kryeredaktor: Hidajete Azizi
Përgjegjës i botimit: Sevdail Demiri
Redaktor teknik: Naser Fera

Shtypi: Focus Print – Shkup
Tirazhi: 500 copë

Ky vëllim i ‘Scupi-t’ botohet me vendimin e Këshillit
të ITSHKSH–Shkup nr. 0201–09/2 të datës 14.01.2019.

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје